



REPUBLIKA E SHQIPËRISË



KUVENDI I SHQIPERISE

AVOKATI I POPULLIT

R A P O R T

**Për veprimtarinë e Avokatit të Popullit
1 Janar – 31 Dhjetor
Viti 2011**

Tiranë, Shkurt 2011

**E nderuar Zj. Kryetare e Kuvendit të Shqipërisë,
Të nderuar deputetë,**

Në mbështetje të nenit 63 pika 1 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë dhe nenit 26 të Ligjit nr.8454, datë 4.2.1999, plotësuar me Ligjin nr.8600 datë 10.04.2000, ndryshuar me Ligjin nr.9398, datë 12.05.2005 “Për Avokatin e Popullit”, kam nderin që, në emër të Institucionit të Avokatit të Popullit, t’ju paraqes raportin për veprimtarinë e tij gjatë vitit 2011.

Me respekt,

AVOKATI I POPULLIT

Igli TOTOZANI

PERMBAJTJA

	Faqe
Hyrje	5
Prezantimi i shkurtër i strukturës së Raportit Vjetor 2011	7
KREU I	9
Opinione dhe rekomandime për gjëndjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri	9
KREU II	22
Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit në zgjidhjen e ankesave konkrete, e ndarë sipas të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore	22
1. Barazia përpara ligjit dhe ndalimi i diskriminimit	22
2. E drejta për informim	27
3. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë	33
4. Kufizime të lirise se personit	34
- Veprimtaria e Policisë së Shtetit	34
- Veprimtaria e Avokatit të Popullit në lidhje me Forcat e Armatosura	57
5. Çështje të administrimit të drejtësisë	60
- E drejta për një proces të rregullt ligjor	60
- Intitucioni i Avokatit të Popullit dhe organet e pushtetit Gjyqësor	60
- Veprimtaria e Prokurorise	64
- Veprimtaria e Zyrave të Shërbimit Përmbarimor Shtetëror	69
- Ndhma ligjore falas	78
6. E drejta e Pronës	78
7. E drejta e mbrojtjes shoqërore të punës	90
8. E drejta për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore	95
9. E drejta për arsimim	98
10. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim	100
11. Ndhma ekonomike	102
12. Mbrojtja e konsumatorit	104
13. E drejta për kujdes shëndetësor	110
14. Synimi për një mjedis të shëndetshëm	115
15. Problematikat e pushtetit vendor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së organeve të tij	119
16. Veprimtaria e Zyrës Rajonale Shkodër	130

17. Trajtimi i ankesave te të përndjekurve politikë	135
Kreu III	137
Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar kundër Torturës	137
Kreu IV	172
Informacion i përgjithshëm lidhur me veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit	172
1. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me publikun	174
2. “Ditët e Hapura”	176
3. Marrëdhëniet me median	176
4. Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse	179
5. Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare	181
6. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2011	182
7. Struktura e zyrës së Avokatit të Popullit	183
8. Buxheti i Institucionit për vitin 2011	183
9. Statistika përmbledhëse e vitit 2011	185

HYRJE

Raporti Vjetor për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit i prezantohet çdo vit Kuvendit, për të realizuar tre qëllime: e para, për t'i dhënë mundësinë këtij të fundit të mbikqyrë punën e institucionit të Avokatit të Popullit; e dyta, të shërbejë si instrument për rritjen e performancës qeverisëse dhe e treta, për t'i dëshmuar opinionit publik se ky institucion është për të garantuar respektimin e të drejtave dhe lirive të individëve në Shqipëri.

Funksioni i Avokatit të Popullit, si një mandat i deleguar nga Kuvendi, synon mbikqyrjen e performancës së administratës publike, dhe si i tille ai është për tu vlerësuar nga ana e përfaqësuesve të popullit. Kuvendi, me këtë rast ka mundësinë që të ketë në duar një instrument, sikurse është Raporti, për të ballafaquar administratën publike me gjetjet e një institucioni kushtetues, i cili ka për mision të rrisë cilësisht standardet e mirëqeverisjes, duke e parë këtë si një sfidë për të avancuar integrimin e vendit tonë në Bashkimin Europian. Ky raport, gjithashtu synon t'i dëshmojë opinionit publik se taksapaguesit shqiptarë paguajnë që një institucion i tille të jete syri i tyre mbi moralin dhe mënyrën se si funksionon një sistem ligjor transparent, si realizohet pjesëmarrja e publikut në vendimmarrje, si dhe sa respektojnë normat e sanksionuara në ligje apo kodet e etikes punonjësit e të tre pushteteve, sa realizohet zbatimi i vendimeve të gjykatës e kështu me radhe. Nga perspektiva e kuadrit ligjor ekzistues, gjithmonë në përqasjen e tij me legjislacionin Europian, të gjithë kemi parasysh angazhimet e marra nga Shqipëria për t'iu bashkuar familjes së madhe Europiane. Nëpërmjet prezantimit të punës së Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011, ne kemi mundësinë për t'i rikujtuar administratës publike shqiptare detyrimin për të bashkëpunuar dhe mirëkuptuar çdo rekomandim të Avokatit të Popullit, tek i cili individët adresojnë ankesat e tyre, zgjidhja e drejtë e të cilave, sjell si rezultat rritjen e besimit të qytetarëve tek shteti i tyre. Të drejtat dhe liritë e individëve, parimet e shtetit të së drejtës, demokracia, drejtësia dhe mirëqeverisja, janë drejtimet e nevojshme për të cilat Avokati i Popullit është i detyruar të japë opinionin e tij apo të veprojë.

Ashtu si dhe vitin e kaluar, Raporti Vjetor i Institucionit të Avokatit të Popullit, është konceptuar sipas një strukture të bazuar në analizën e të drejtave dhe lirive themelore të individëve të garantuara nga Kushtetuta, duke i dhënë mundësi anëtarëve të Kuvendit të kenë një panoramë të qartë të situatës së të drejtave dhe lirive themelore të individëve në vend. Ia vlen të theksojmë se pikërisht, vitin e kaluar, ne synuam që analizën e punës sonë ta bënim nga këndvështrimi i këtyre të drejtave për të reflektuar më pas në veprimtarinë me institucionet konkrete. Ky është një ndryshim i cili kushtëzon një sens më të gjerë analize dhe deduksionesh, për të realizuar atë që tashmë kërkohet nga një institucion i tillë, me përvojë jo të pakët në fushën ku vepron.

Edhe këtë vit, ju do të gjeni në këtë raport një analizë të plotë të të drejtave të cënuara nga veprimet e autoriteteve publike bazuar në të dhënat statistikore që ne kemi, sipas çdo të drejte të shkelur. Si gjithmonë do të mbetemi të hapur, jo vetëm në kuptim të detyrimit tonë për të raportuar para jush, por mbi të gjitha për të synuar një përmirësim të vazhdueshëm të punës sonë.

Prezantim i shkurtër i strukturës së Raportit Vjetor 2011

Raporti Vjetor për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011, është i dymbëdhjeti që ky institucion prezanton përpara Kuvendit. Ashtu si dhe vitin e kaluar, ai përmban një analizë të veprimtarisë së Institucionit të ndarë sipas katalogut të të drejtave dhe lirive të garantuara në Kushtetutë dhe në përputhje me to, edhe të rasteve më të spikatura të prezantuara pranë nesh, për të cilat ne kemi bërë ndërhyrjet tona pranë organeve përkatëse.

Raporti përmban, ndër të tjera, rekomandime dhe propozime për eliminimin e të metave dhe parregullsive, të cilat janë identifikuar gjatë shqyrtimit të ankesave që na janë adresuar.

Raporti është ndarë në katër krerë.

Kreu i parë bën një prezantim të situatës së të drejtave dhe lirive të individëve gjatë vitit për te cilin bëjmë raportimin, e trajtuar kjo në vështrim të ankesave të shqyrtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit.

Kreu i dytë, i cili zë dhe pjesën më të madhe në raport, ka të bëjë me ankesat, kërkesat dhe njoftimet e trajtuara nga Avokati i Popullit, të ndara sipas të drejtave të cënuara nga veprimet e organeve të administratës publike dhe të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore në fuqi, hetimet e kryera si dhe rezultatet. Këtu kemi prezantuar dhe mjetet për zgjidhjen e rasteve tipike dhe të përsëritura, të cilat mendojmë se duhet të mbahen parasysh në veprimet e organeve përgjegjëse të administratës në situata të ngjashme.

Kreu i tretë prezanton performancën e Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe çdo Dënimi tjetër Çnjerëzor dhe Degradues, si dhe disa analiza të detajuara për raste të veçanta, të cilat sipas këndvështrimit tonë, janë konsideruar të rëndësishme.

Kreu i katërt paraqet veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit, ku përfshihen ndër të tjera aktivitete të informimit dhe komunikimit të tij, sikurse janë organizimi i “Ditëve të hapura”, komunikimi me mediat, bashkëpunimi me zyrat homologe, të dhëna statistikore për ankesat, kërkesat dhe njoftimet e shqyrtuara gjatë vitit 2011 si dhe të dhëna të tjera lidhur me strukturën e Institucionit.

Kreu I

Opinione dhe rekomandime për gjendjen e të drejtave të njeriut në Shqipëri

Opinionet dhe rekomandimet e Avokatit të Popullit synojnë të reflektojnë çështjet më të rëndësishme lidhur me standartet e të drejtave të njeriut në Shqipëri. Eksperienca ka treguar se zgjidhja e një rasti individual në fakt, shpesh evidenton një problem në fushën e respektimit të drejtave të njeriut, duke nxitur përgjegjësinë e organeve të administratës publike.

Avokati i Popullit nuk është një institucion për të gjykuar ngjarje individuale, fakte historike apo sisteme politike, por është përgjegjësi e tij të japë një paraqitje të pranueshme të konstatimeve dhe opinioneve të tij, lidhur me gjendjen e të drejtave të njeriut në vendin tone. Çështje të tilla si e drejta e pronës, të drejtat e fëmijëve, mbrojtja nga diskriminimi i grupeve vulnerabel, janë çështje të cilat kanë ekzistuar dhe do të vazhdojnë të ekzistojnë, por kur nderhyrjet për të njejtin problem perseriten nga viti në vit dhe nuk gjejnë zgjidhje, atëherë kjo tregon se organet e administratës publike kanë dështuar në zgjidhjen e tyre, duke mos garantuar respektimin e se drejtes së individit.

Edhe gjatë vitit 2011, kemi trajtuar raste të shkeljeve të të drejtave të individit nga policia, mosrespektim të të drejtave të të burgosurve, shkelje të të drejtes për informim, zvarritje të procedurave administrative, shkelje të të drejtave që rrjedhin nga marrëdhëniet e punës, probleme me përfitimin nga sistemi i sigurimeve shoqërore, shkelje të të drejtës së pronës, probleme në ushtrimin e lire dhe efektiv të së drejtës për arsimim, zvarritje të procedurave gjyqësore, etj. Për të gjitha rastet që kemi çmuar, kemi bërë ndërhyrjen tonë me të vetmin instrument të fortë që na njeh ligji, rekomandimin. Po kështu, kemi reaguar pas çdo problemi që ka rezultuar nga inspektimet dhe kontrollet periodike nëpër burgje, në dhomat e paraburgimit, në spitalet psikiatrike apo ambiente të tjera të mbyllura. Në rekomandimet tona, kemi qenë tepër kërkues ndaj punonjësve të administratës së këtyre institucioneve, për dhunën, torturën dhe çdo formë tjetër keqtrajtimi të lidhur me to.

Fusha e veprimit të Avokatit të Popullit në kuadër të mbrojtjes dhe të promovimit të të drejtave dhe lirive të individëve është e gjërë dhe mbështetet në një kuadër ligjor të plotë.

Ligji Nr.8503 date 30.6.1999 “Për të drejten e informimit për dokumentat zyrtare”, i ngarkon institucionit tone një mision të veçantë, i cili lidhet me atë të kujdestarit të zbatimit dhe respektimit të kesaj të drejte të publikut të gjere, nga ana e administratës publike. Duke ju referuar ankesave dhe kerkesave drejtuar Avokatit te Popullit, por edhe pa përjashtuar mjedisin social dhe zhvillimet e tij në këtë drejtim, mund të thuhet se ligji “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, njihet në masë jo të mjaftueshme nga një pjesë e administratës, gjë që sjell vështirësi dhe pengesa në funksionimin normal dhe transparent të saj, në marrëdhëniet e kësaj të fundit me publikun. Nuk zbatohen afatet ligjore për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion për dokumentet zyrtare drejtuar autoriteteve publike, qoftë për refuzimin, qoftë për përmbushjen e tyre.

Një hap i domosdoshëm dhe cilësor në drejtim të zgjerimit të garancive për respektimin e të drejtës për informim, do të sillte ratifikimi i Konventës së Këshillit të Europës “Për të drejtën e aksesit në dokumentet zyrtare”, proces i cili ka filluar nga Kuvendi i Shqipërisë, por nuk është finalizuar akoma.

Gjatë shqyrtimit të ankesave që janë depozituar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, kemi konstatuar se, jo pak prej tyre kanë patur të bëjnë me shkelje të elementëve të ndryshëm që garantojnë parimin e mirëadministrimit, me qeverisjen në një nivel sa më afër shtetasve, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, me ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimin e detyrave, realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, të shpejta, etj, nga ana e autoriteteve publike.

Kodi i Procedurave Administrative parashikon të drejtën e informimit si një nga parimet bazë të funksionimit të Administratës Publike. Lidhur me rregullimin që i bën ky Kod të drejtës për informim, nga çështjet e trajtuara nga Institucioni i Avokatit të Popullit, rezulton se nga ana e Administratës Publike nuk respektohet dhe nuk zbatohet e drejta për informim gjatë zhvillimit të një procedimi administrativ, ndaj atyre subjekteve të së drejtës administrative që kanë një interes të drejtëpërdrejtë ose të ligjshëm në këtë procedim. Në parim, të gjithë pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të marrin informacion dhe të njihen me dokumentet e përdorura në këtë procedurë, përveç rasteve kur me ligj janë vendosur kufizime.

Mosrespektimi i dispozitave ligjore që rregullojnë këto marrëdhënie, përkundër kërkesave të paraqitura nga individë, sigurisht me pasojë shkeljen e së drejtës kushtetuese të shtetasve për informim, përbën një pjesë të konsiderueshme të veprimtarisë së Avokatit të Popullit.

Mosrespektimi i afateve ligjore, si në trajtimin e ankesave apo kërkesave të personave fizikë dhe juridikë privatë nga organet e administratës publike, ka qenë dhe mbetet një problem mjaft i mprehtë. I njëjti konstatim qëndron edhe në bashkëpunimin me Institucionin e Avokatit të Popullit; kërkesat për shpjegime, sqarime apo përgjigjet për rekomandimet e bëra, jo gjithmonë na dërgohen brënda afateve ligjore.

Edhe gjatë vitit 2011, Avokati i Popullit, ka shqyrtuar me vëmendje të veçantë raste, në të cilat është pretenduar nga subjekte, trajtimi diskriminues nga organe të administratës publike. Kjo edhe për vetë faktin e problematikës së veçantë që ato paraqesin, por edhe të cilësive të veçanta të subjekteve ankues. Pak ankesa janë paraqitur pranë nesh për këtë çështje, ndoshta dhe për shkak të ndërjegjësimin të publikut për funksionimin e Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi. Megjithatë, shfrytëzimi maksimal i kapaciteteve dhe bashkëpunimi real dhe i vazhdueshëm ndërmjet shoqërisë civile dhe organeve të specializuara të administratës shtetërore, është i domosdoshëm.

Në vëmendje dhe interesim të vazhdueshëm të Avokatit të Popullit, janë të gjitha shtresat në nevojë dhe të ekspozuara ndaj rreziqeve, si të miturit, të moshuarit, personat me aftësi të kufizuara fizike dhe mendore, si dhe pjestarët e komunitetit rom. Tashmë është miratuar Plani Kombëtar i Veprimit 2010-2015, në kuadër të Dekadës së Përfshirjes së Romëve.

Problem shqetësues mbetet punësimi i fëmijëve romë, që janë ndër me të preferuarit nga punedhësit private, për shkak të abuzimit me pagesën e ulët. Romët e mitur i sheh neper semaforë si larës makinash, ose duke lypur në rrugë, ura dhe kryqëzime. Ata përbejnë shtresën më të rrezikuar nga përjashtimi social, nga liria dhe të gëzuarit e fëmijëve, janë të keqtrajtuar brenda komunitetit dhe jashtë tij, duke qenë kështu një gjeneratë e pasigurtë. Niveli shumë i ulët familjar i kulturës dhe arsimimit, për arsye mentaliteti, varfërie, diskriminimi apo përjashtimi, nuk i ka lejuar anëtarët e komunitetit rom të hedhin hapa drejt civilizimit dhe të bëhen pjesë integrale e shoqërisë shqiptare. Mungesa e të kuptuarit të proceseve ligjore, mosnjohja e ligjeve, shoqëruar me moskerkimin e ndihmës juridike e vështiresojnë më tej jetesën e tyre. Po kështu dhe mungesa e kualifikimit dhe e arsimimit të tyre, ndikojnë shumë në pamundesinë e futjes së këtij komuniteti në tregun e punës. Avokati i Popullit nënvizon se zgjidhjet e problemeve të Romëve nuk janë as të lehta, as të shpejta, por jo të pamundura. Ato janë pjesë integrale, të lidhura pazgjidhshmërisht me zhvillimin tërësor të Shqipërisë edhe me forcimin e vazhdueshëm të ekonomisë.

Lidhur me mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve, miratimi i Ligjit nr.10347 date 4.11.2010 “Për mbrojtjen e të drejtave të fëmijës”, shënoi një

hap përpara për mbrojtjen efektive e përkujdesin e posaçëm lidhur me të drejtat e fëmijëve në vendin tonë. Ndonese ligji është miratuar që në vitin 2010, akoma nuk rezultojnë të kënaqësive të gjitha aktet e nevojshme nenligjore për zbatimin real të tij.

Promovimi dhe garantimi i të drejtave të fëmijëve për mbrojtje dhe kujdes social, përbën një nga detyrimet dhe përgjegjësitë për të gjitha strukturat qendrore dhe vendore. Decentralizimi i kompetencave, i ka dhënë rol të rëndësishëm qeverisjes vendore, në kuadrin e institucionalizimit të respektimit e të mbrojtjes sa më të mirë të të drejtave të fëmijëve.

Ngritja e Agjencisë Shtetërore për Mbrojtjen e të Drejtave të Fëmijëve si institucion përgjegjës në nivel qendror që monitoron respektimin e Ligjit të të drejtave të fëmijës, mendohet se do të rrisë rolin e strukturave vendore për mbrojtjen më të mirë të fëmijëve nga dhuna, shfrytëzimi, mosgëzimi i të drejtave.

Puna e fëmijëve apo shfrytëzimi i tyre nga të rriturit për të përfituar ekonomikisht vijon të mbetet problem që duhet të marrë zgjidhje, nëpërmjet koordinimit dhe referimit të rasteve nga administratorët shoqërorë në bashki e komuna, psikologët në shkolla, mësuesit, mjekët e familjeve, policia, punonjësit e qendrave të zhvillimit e të përkujdesit shoqëror si dhe OJF-te.

Njësitë për mbrojtjen e fëmijëve pranë njësive vendore, janë përgjegjëse për koordinimin dhe referimin e çdo rasti të fëmijëve në rrezik abuzimi, dëmtimi, trafikimi, shfrytëzimi apo neglizhimi. Por sfida në këto pike është ngritja e këtyre njësive në të gjitha njësitet e qeverisjes vendore, pasi na ka rezultuar se vetëm në 28 bashki dhe 9 qarqe, janë ngritur këto njësi.

Bazuar në kuadrin ligjor ekzistues, prindrit, janë të detyruar të regjistrojnë fëmijët e tyre, në të njëjtin vend ku janë regjistruar edhe ata. Rezultojnë që në rastet e familjeve romë, ka një numër të konsiderueshëm fëmijësh të paregjistruar, pavarësisht iniciativave dhe programeve të aktoreve të ndryshëm si të administratës publike ashtu dhe të shoqërisë civile.

Lidhur me kuadrin ligjor që garanton të drejtat e fëmijëve, gjatë vitit 2011, të rëndësishme konsiderojmë ratifikimin e Konventës së Këshillit të Evropës “Për ushtrimin e të drejtave të fëmijëve”, miratuar me ligjin nr. 10425, datë 02.06.2011, si dhe Konventën e Këshillit të Evropës, “Për statusin juridik të fëmijëve të lindur jashtë martesë”, miratuar me ligjin nr. 10424, datë 02.06.2011.

Në lidhje me të drejtat e grave, konstatohet se pavarësisht kuadrit ligjor, një çështje që mbetet problem serioz ka të bëjë me keqtrajtimin bashkëshortor apo dhunën në familje ndaj grave apo vajzave.

Situata duket që nuk është përmirësuar gjatë vitit për të cilin po bëjmë këtë raportim. Përveç punës që bëjnë disa organizata jofitimpruese për ndergjegjesimin dhe gjetjen e rrugëve konkrete për përmirësimin e situatës, duhet që të gjenden mjete efektive në kuadrin e një mekanizmi, për të garantuar që të ruhen dhe zbatohen të drejtat e grave, për të përmirësuar trajtimin dhe pozitën e femrave në familje dhe në shoqërinë shqiptare. Organet që merren me dhenien e drejtësisë duhet të shohin me prioritet rastet kur pjesë e keqtrajtit dhe e dhunës së ushtruar janë gratë dhe vajzat. Ato shpesh detyrohen të heqin dorë nga akuza për një arsye apo tjetër. Shumë krime të ndodhura ndaj grave vite me parë, janë akoma pa autor.

Strategjia Kombëtare për Barazim Gjinor dhe kundër Dhunës me Bazë Gjinore dhe asaj në Familje 2011-2015 e miratuar me VKM nr.573 datë 16.06.2011, ka parashikuar ndër të tjera dhe problemin e nenkontraktimit të OJF-ve për të ofruar shërbimet perkatese për viktimat e kesaj dhune.

Mundësia dhe detyrimi për të bashkëpunuar ndërmjet organeve të qeverisjes vendore dhe qendrore për shërbimet sociale, është vendosur qartësisht në Ligjin nr.9669, datë 18.12.2006 “Për masat ndaj dhunës në marrëdhëniet familjare”. Por zbatimi rigoroz i këtij ligji kërkon financim të organizatave të shoqërisë civile nga organet kompetente shtetërore, në mënyrë që ato të kryejnë siç duhet shërbimet për viktimat e dhunës në familje, për parandalimin e saj dhe rehabilitimin e dhunuesve.

Një hap i rëndësishëm që garanton mbrojtjen e të drejtave të grave, si dhe viktimave në marrëdhëniet familjare në vendin tonë, është nënshkrimi i këtij vit i Konventës së Këshillit të Evropës “Për parandalimin dhe luftën kundër dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje”.

Lidhur me mënyrën e trajtimit të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar gjatë vitit 2011, Avokati i Popullit ka ndjekur me prioritet ankesat e shtetasve që pretendojnë për ushtrim të dhunës fizike nga punonjësit të Policisë së Shtetit në ambientet e sigurisë dhe hetimit. Gjatë këtij viti është konstatuar se ka patur raste të ushtrimit të dhunës fizike dhe psikologjike nga punonjësit të Policisë së Shtetit, për të cilat është rekomanduar fillimi i procedimit penal, për punonjësit e policisë që i kanë bërë këto shkelje.

Problemi shqetësues vazhdon të mbetet shoqërimi i shtetasve në organet, zyrat dhe ambientet e policisë. Kështu, kemi konstatuar se, shoqërimi i personave në organet e policisë bëhet jo gjithmonë sipas kritereve ligjore të përcaktuara në nenet 11/6, 101/1/ “a” dhe “b” dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

Të shoqëruarve u bëhet kontroll personal, u hiqen e bllokohen sendet personale si telefona etj. dhe u merren gjurmët daktiloskopike (të gishtave),

veprime të cilat nuk janë në përputhje me ligjin. Librat e shoqërimit, nuk janë të modeluara sipas kërkesave të ligjit nr.9749, date 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualit për Rregullat e Trajtimit dhe Sigurimit të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njesitë Policore, pasi ka mungesa të disa rubrikave, siç është ajo për njoftimin e familjarëve të shoqëruarit.

Ambiente shoqërimi sipas konceptimit të bërë nga ligji nr. 9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, ka vetëm në Komisarjat e Policisë Gjyrokastër, Lezhë, Kukës, Korçë, Fier, Kavajë dhe Komisarjat e Policisë Nr.5 Tiranë. Në gjithë organet e tjera të policisë në vend, dhomat për të shoqëruar, në fakt si nga përmasat, ndriçimi natyral, higjiena ashtu edhe nga konceptimi dhe trajtimi i personave të shoqëruar, janë dhoma izolimi, sepse janë të ftohta, me dyer hekuri, të mbyllura me dryna dhe pa ndriçim nga rrjeti. Në disa komisarjate si Përmet, Krujë, Librazhd, Elbasan, Pogradec dhe Mallakastër dhomat e shoqërimit janë jashtë ndërtesës së komisarjatisë, në ndërtesa një katëshe, me soletë të cilat janë të ftohta në dimër dhe të nxehta në verë dhe për pasojë e bëjnë të pamundur qëndrimin e të shoqëruarve.

Nga inspektimet ka rezultuar se në ambientet e shoqërimit ka mungesë të orëdivave të nevojshme si tavolina, karrige apo stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar.

Në ambjentet e shoqërimit, gjithashtu nuk ka postera me të drejtat ligjore të të shoqëruarve.

Nga inspektimet e bëra në dhomat e sigurisë, në të gjitha Drejtoritë dhe Komisarjat e Policisë në vend, ka rezultuar se, në disa drejtori e komisarjate policie (Drejtoritë e Policisë së Qarqeve Fier, Lezhë, si dhe në Komisarjat e Policisë Kavajë, Korçë, Gjyrokastër, Kukës dhe atë Nr.5 Tiranë, dhomat e sigurisë (Paraburgimit) janë të përshtatëshme për banim pasi ofrojnë kushte normale për jetesë, ushqim, ajrim, higjenë, kubaturë, trajtim të diferencuar për të mitur, femra dhe të sëmurë.

Megjithatë, duhet theksuar fakti se për ambjentet e sigurisë (Paraburgimit) nuk ka standarte të përcaktuara në ligj, pasi kjo pjesë e veprimtarisë së Policisë së Shtetit, nuk është përfshirë në Ligjin Nr.9749 date 04.06.2007 “Për Policinë Shtetit”. Në asnjë nen të ligjit nuk përmendet detyra e këtij institucioni për të kryer detyrën e paraburgimit. Ky shërbim, sipas legjisllacionit në fuqi, i është ngarkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe organeve të saj vartëse.

Aktualisht, siç është deklaruar edhe më parë nga ana jonë, Policia e Shtetit e kryen këtë detyrë në kundërshtim me dispozitat kushtetuese dhe ligjore. Madje, hartimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së

Shtetit i Manualit për organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimi, është refuzuar me argumente juridike nga ana jonë, pasi një akt i tillë nuk është i autorizuar nga Ligji "Për Policinë e Shtetit".

Për të zgjidhur këtë problem ligjor është i domosdoshëm ndryshimi i nenit 4, të Ligjit "Për Policinë e Shtetit", duke e parashikuar një detyrë të tillë për Policinë e Shtetit ose ndryshimi i nenit 15/1, të Ligjit Nr.8328 dt.16.04.1998 "Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim dhe të paraburgosurve" (i ndryshuar), në të cilin duhet shtuar një paragraf që, në Institucionet e Paraburgimit të mbahen edhe individë, ndaj të cilëve është vendosur masa e arrestit ose e ndalimit nga Policia e Shtetit ose Prokuroria. Këto masa ligjore i hapin rrugë përligjies së veprimtarisë së Policisë së Shtetit për kryerjen e detyrës së paraburgimit ose lehtësimit të veprimtarisë së saj nga ky shërbim.

Gjatë vitit 2011 kemi konstatuar se ka patur ankesa lidhur me shkeljen e te drejtave ligjore te ankuesve gjate gjykimit, apo shkelje te tjera nga administrata gjyqesore. Nga analiza e ankesave te trajtuara, rezulton se vendin kryesor e zënë ato për zvarritje të padrejta dhe të pajustificuara të gjykimeve, pra për shkelje të procedurave gjyqësore, si për çështje civile, ashtu edhe për çështje penale. Në zyrën tonë, edhe gjate këtij viti, jane paraqitur ankesa ndaj vendimeve gjyqësore, duke ngritur pretendime të ndryshme se ato janë vendime të padrejta dhe të pabazuara në ligj, ose janë marrë me veprime korruptive nga gjyqtarë të veçante.

Instituti i shërbimit ligjor falas, si një e drejtë e individëve, rregullohet aktualisht nga legjisllacioni ynë. Ky është një fakt pozitiv. Por nga ana tjetër konstatojmë se, ky shërbim ka ende probleme, sidomos në kërkesat e ndryshme për rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë, për çështje të ndryshme penale. Gjatë zbatimit të ligjit "Për Ndihmën juridike", në praktikë verehet se kanë dalë probleme të ndryshme si në drejtim të cilësisë së kësaj mbrojtjeje nga ana e avokatëve, ashtu edhe në mos pagimin e këtij shërbimi nga shteti, për arsye të ndryshme dhe të pajustificuara. Kjo ne fakt përben cenim efektiv të kesaj të drejte.

Ankesat e individeve ndaj veprimtarise se Prokurorive të Rretheve Gjyqësore kane konsistuar në, zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale; arrestimin dhe ngritjen e akuzës të padrejtë; në marrjen e vendimit të padrejtë për mosfillim të procedimeve penale apo pushime të çështjeve penale për vepra penale të ndryshme kryesisht, për "Falsifikim të dokumentave", "Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor"; për mosnjohje të palëve në procesin penal me vendimet për zgjatjet e afatit të hetimit të procedimit penal etj, për mos informimin lidhur me mënyrën e zgjidhjes së çështjeve të cilat fillojnë mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasve;

moskthim të përgjigjeve ose kthim të tyre me vonesë (jashtë afatit prej 15 ditë që parashikon pika 2, e nenit 110 të Kodit të Proçedurës Penale), për kërkesa apo memorie me shkrim të paraqitura nga palët gjatë hetimit; si dhe mosdhënie të kopjeve të akteve të ekspertimeve të ndryshme si autoteknik, mjeko-ligjor, apo tekniko- grafik të nënshkrimit. Ka patur raste të ankesave kur prokurorët që merren me ekzekutimin e vendimeve penale, nuk kanë kryer veprimet e nevojshme me qëllim nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit në afatin e caktuar, çka ka sjellë për pasojë qëndrimin e të dënuarit në paraburgim ose burgim, më tepër se koha e vuajtjes së dënimit të përcaktuar në vendimin e gjykatës.

Evidentohet një grup ankesash të drejtuar ndaj organit të Prokurorisë, lidhur me trajtimin e sendeve prova materiale të sekuestruara gjatë hetimit, të cilat në disa raste u janë kthyer me vonesë personave të interesuar.

Nga veprimtaria e shërbimit përmbartimor gjyqësor vërehet shqetësimi për mosekzekutimin e titujve ekzekutiv, sipas të cilëve është vendosur detyrimi i institucioneve buxhetore të rikthejnë paditësin (ankuesin) në vendin e mëparshëm të punës apo t'u paguajnë atyre pagën për kohën e qëndrimit pa punë. Organet e administratës shtetërore nuk kryejnë përmbushjen e detyrimeve të vendosura në vendimin përkatës të gjykates, jo vetëm në afatin ligjor për ekzekutimin vullnetar të detyrimit, nga dita e lajmërimit të këtij detyrimi prej Shërbimit të Përmbartimit, por edhe as pas kalimit të këtij afati.

Nga ana tjetër, përmbartuesit gjyqësor të çështjeve, menjëherë pas kalimit të afatit ligjor për ekzekutimin vullnetar të detyrimit prej palës debitore, nuk kryejnë veprimet përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv.

Vërehet gjithashtu, mosaplikimi prej përmbartuesve gjyqësor i së drejtës së tyre, të parashikuar në nenin 606 të Kodit të Procedurës Civile, për vendosjen e sanksionit të gjobitjes ndaj personit të tretë që, sipas urdhërit të ekzekutimit ose ligjit, është i detyruar të kryejë veprime të caktuara.

Në trajtimin e titujve ekzekutiv, me objekt detyrimin e institucioneve buxhetore të paguajnë shumën të caktuar në të holla, konstatohet se Shërbimi i Përmbartimit nuk kryen në mënyrë rigoroz procedurën ligjore të parashikuar në nenin 589 të Kodit të Procedurës Civile, për çdo rast të paraqitur. Përkundër qëndrimit të mbajtur prej institucioneve buxhetore debitore në procesin e ekzekutimit të detyrimeve në të holla ndaj palëve gjyqësuese, Institucioni i Avokatit të Popullit, referuar parashikimit të nenit 589 të K.Pr.C., ka kërkuar nxjerrjen e aktit nënligjor përkatës prej Këshillit të Ministrave, i cili është realizuar nëpërmjet Udhëzimit nr. 02, datë 18.08.2011, *“Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të*

institucioneve buxhetore në llogari të thesarit". Në vlerësim të Institucionit të Avokatit të Popullit, ky Udhezim, nuk vjen në funksion të parashikimeve të nenit 517, 529 dhe 581, paragrafi i dytë, i K.Pr.C., si dhe nenit 20 dhe 21 të Ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999, "*Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore*". Në referim të parashikimit të nenit 20 dhe 21 të Ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999, institucionet buxhetore debitore duhet të kishin kryer apo të kryejnë veprimet për futjen si zë i veçantë në ligjin e buxhetit të shtetit të vitit pasardhës të detyrimit të vendosur sipas titujve ekzekutivë, veprime të cilat ose nuk janë kryer ose dhe kur janë kryer nuk janë marrë dhe nuk merren në konsideratë rast pas rasti prej organeve eprore financiare.

Më shqetësuese paraqitet situata në bashkëpunimin e Avokatit të Popullit me zyrat e përmbarimit në rrethe, dhe në mënyrë të vacantë me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror. Ky i fundit, në procesin e shqyrtimit të rekomandimeve të dërguara prej Institucionit të Avokatit të Popullit, apo kërkesave për të bërë të mundur dhënien e shpjegimeve dhe informacionit nga zyrat e përmbarimit, nuk ka shprehur vullnet për bashkëpunim, qëndrim i cili jo vetëm ka shkelur detyrimin ligjor, por ka krijuar dhe premisat për mosushtimin nga ana e tij të përgjegjësive, të parashikuara në nenin 8 të Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001, "*Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor*", i ndryshuar.

Garantimi i të drejtes se prones ka qene nder prioritetet e Institucionit të Avokatit të Popullit gjate vitit 2011. Ankesat drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit per te cilin po raportojme, kane patur te bejne me veprimtarinë e Agjensisë Qëndrore të Kthimit dhe Kompesimit të Pronave. Ka shumë të shpronësuar që ende nuk kanë marrë një vendim për kërkesën e depozituar e protokolluar prej vitesh pranë ish-AKKP-ve vendore.

Problematike mbetet ngadalësia dhe mjetet e pamjaftueshme të rezervuara për kompensimin financiar të ish pronarëve. Neni 23 i Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 "*Për kthimin dhe kompensimin e pronave*", i ndryshuar, parashikonte krijimin e Fondit të Kompensimit të Pronave nga të ardhurat buxhetore, i cili do administrohej nga ish Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sot Agjencia Qëndrore e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, proces që pritet të përfundojë në vitin 2015. Nisur nga ritmet e deritanishme të pagesës dhe nga ndryshimet e përvitshme të procedurave të përcaktuara në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, perspektiva nuk duket shumë optimiste. Afati i njohjes, përgatitjes dhe paraqitjes së dokumentacionit të përcaktuar në aktin nënligjor vlerësohet si i

pamjaftueshem, si dhe ka mungesë transparence në listat, aktet e të cilave pranohen ose jo dhe e përfituesve të kompensimit.

Po ashtu, lë për të dëshiruar bashkëpunimi i administratës së AKKP-së Qëndrore me aplikuesit, duke mos ju krijuar realizimin e kontakteve për informacion, sqarime apo sugjerime, e mundësive të subjekteve për t'u shprehur ose marrja pjesë personalisht apo me përfaqësues ligjor në shqyrtimin administrativ të rastit të tyre.

Lidhur me këtë të fundit, në shumë praktika të trajtimit të kërkesave kemi konstatuar, se Agjencia Qëndrore e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, shmanget nga kryerja e funksioneve të saj, përfshirë dhe procesin e hetimit të plotë administrativ për të marrë dhe vlerësuar prova, si dhe për të kryer ekspertime me qëllim dhënien e vendimit përfundimtar, dhe të mos kërkojë nga ankuesit t'u drejtohen gjykatave për formimin e provave.

Konstatohet, se e drejta e gëzimit lirisht të pronës, e cila vazhdon të çenohet, si nëpërmjet ndërtimeve informale, ashtu edhe e atyre me leje ndërtimi me mosrespektim të kondicioneve urbanistike kundrejt objekteve ekzistuese, përbën një shqetësim tjetër, të cilin Avokati i Popullit, nëpërmjet trajtimit të ankesave individuale ka tentuar ta minimizojë sadopak.

Gjithashtu, është konstatuar shkelje e së drejtës mbi pronën, nëpërmjet mosrespektimit të neneve 1 dhe 2 të Ligjit nr. 8651, dt. 22.12.2009 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

Konkretisht, shkelja vërehet në trajtimin e rasteve të ndryshme në lidhje me moskryerjen e procedurave të shpronësimit, me deklaratimet publike për sipërfaqe me të vogla se sa janë shpronësuar në fakt në terren dhe për vonesa në dhënien e dëmshpërblimit.

Një grup tjetër ankesash, gjatë vitit 2011, kishin të bënin me veprimtarinë e Komisioneve Vendore të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të çdo Qarku, struktura të ngritura në bazë të Ligjit nr.9948, dt.07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar, me të cilin përfundonte procesi i ndarjes dhe rindarjes së tokës bujqësore, i krijimit të titujve të rinj të pronësisë dhe mbarimi i funksionimit të veprimtarisë së komisioneve të ndarjes së tokës. Kjo gjë solli fluks ankimesh dhe ndjeshmërinë e shumë familjeve bujqësore që nuk kanë gjetur zgjidhje përfundimtare, që nga mosmarrja e aktit përkatës të fitimit të pronës, deri tek mosregjistrimi e pajisja me certifikatë nga Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme.

Gjatë trajtimit të ankesave lidhur me veprimet e ZRPP-ve, më të pakta se një vit më parë, pretendimi kryesor mbetet mosrespektimi i afateve

administrative dhe ligjore për dërgim informacioni, për shqyrtimin e ankimeve administrative dhe informimi për urdhërin e marre dhe përpunimin e tyre në regjistrimin e kërkesave të parashtruara si dhe mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Me një fjalë, në pergjithësi nuk zbatohen afatet dhe kërkesat e Kodit të Procedurave Administrative. Një dukuri tjetër mbetet hermetizimi, zyra dhe dyer që nuk hapen, te mbyllura për komunikim me ankuesit, avokatët dhe përfaqësuesit e tyre.

Qëndrime të tilla dhe sugjerimi ndaj aplikuesve për t'iu drejtuar gjykatës, jo në pak raste, janë të gabuara, pasi zgjidhen dhe shqyrtohen administrativisht brënda normave dhe parashikimeve të Ligjit nr.7843 datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Rezulton se një pjesë e madhe e pronave, sidomos në zonat urbane, mbeten të pafutura në sistem për mungesë fondesh, gjë që përbën një nga shqetësimet kryesore të qytetarëve.

Lidhur me standartin e respektimit të së drejtës për punë, nga ana e organeve të administratës publike, konstatohen çështje që kanë të bëjnë me largime të pamotivuara nga puna, mosrespektim të afateve ligjore paraprake të ndërprerjes së marrëdhënieve të punës nga ana e punedhënesit dhe shkelje të procedurave të parashikuara në ligj për largimin nga puna dhe mosarsyetim të vendimeve, gje e cila pengon realisht subjektet të infomohen lidhur me arsyet e vendimit dhe, për rrjedhojë, të parashtrajnë kundër argumentet e tyre. Realisht këto shkelje kanë një pasojë finale që bie pikërisht mbi buxhetin e shtetit, pasi shumica e këtyre individëve i fitojnë proceset gjyqësore. Duke u nisur nga ankesat që ne kemi trajtuar, por edhe vendimet gjyqësore të formes se prere lidhur me cenimin e kesaj marrëdhënieje, çmojmë se marrja e nismave për rregullimin e mekanizmave që garantojnë këtë të drejtë, janë të domosdoshme.

Lidhur me të drejtën për të përfitur nga sistemi i sigurimeve shoqerore, pavaresisht natyres sociale të saj, konstatojmë se mbetet përparasi çështja e reformimit të sistemit të sigurimeve shoqerore në vend. Çështja e pensioneve shume të ulta, krejt të pamjaftueshme për një jetë normale për të moshuarit, mbetet një çështje e ndjeshme publike. Duke qendruar pikërisht në problemin e pamjaftueshmerise se të ardhurave minimale për jetese, vlen të përmendim se ndihma ekonomike është shume e ulet dhe nuk i ploteson nevojat baze jetesore. E themi këtë, mbeshtetur dhe në faktin se ende nuk kemi të formalizuar minimumin jetik.

E drejta për një ambient të shëndetshëm është e lidhur pazgjidhshmerisht me cilesine e jetes. Këtë vit, vihet re një tendencë në rritje sa i përket ndotjes së mjedisit në qendra të mëdha urbane, nëpërmjet ndotjes akustike shkaktuar nga subjekte shërbimi, përgjatë ushtrimit të aktivitetit të

tyre. Paraqitja e ankesave ka qenë e shpeshtë edhe për shkak të kapaciteteve të limituara në personel dhe teknikë të Agjencive Rajonale të Mjedisit (A.R.M.) në qarqe, të cilat, sidomos në qendra të mëdha urbane nuk arrijnë të monitorojnë plotësisht tejkalinin e nivelit të zhurmave të lejuara nga mijëra subjekte shërbimi.

Plotësimi i nevojës së shtetasve për strehim, përseri prezantohet si një problem madhor dhe jetik. Numri i familjeve të pastreha dhe kërkesat e tyre vijnë të rriten, duke sjellë zgjidhje të pamjaftueshme të këtyre kërkesave, në drejtim të projekteve minimale të realizuara nga pushteti vendor. Gjatë trajtimit të ankesave, kemi konstatuar se qytetaret vijnë të pretendojnë që mungon transparenca në përzgjedhjen e kategorive apo në vendimmarrjet për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe sidomos në vendimet që marrin këshillat bashkiake, për të cilat pretendohet se asnjëherë nuk dihen kriteret vlerësuese dhe radha e trajtimit të shtetasve, probleme të cilat janë prezantuar dhe në raportet e mëparshme. Zvarritja e procedurave për t'u trajtuar me strehim ka ardhur si rezultat i mungesës së fondeve që kanë Bashkitë për trajtimin me strehim, për t'ju ardhur në ndihmë qytetarëve.

Lidhur me respektimin e të drejtave të konsumatoreve, gjatë vitit 2011 ka rezultuar se janë paraqitur pretendime kundrejt kompanisë CEZ Shperndarje sh.a, Ndermarrjeve të Ujesjelles Kanalizimeve (duke kryesuar me Drejtorinë e Tiranës, por dhe të rrethëve), si dhe shoqërisë së telefonisë fikse ALBtelecom sh.a.

Në drejtim të operatorit që ben shitjen me pakice të energjisë, nga zyra jone u vu re se, me gjithë perpjekjet që kishte bere kompania CEZ Shperndarje sh.a. në drejtim të përmirësimit të shërbimeve të ofruara (me hapjen e shumë pikave të quajtura “Zyra e Kujdesit ndaj Klientit”, uljen e ankesave në drejtim të mbifaturimit abuziv të faturuesve, informimin “on line” të faturave, furnizimin pa ndërprerje të theksuar të energjisë, njoftimin paraprak për ndërprerjet për shkaqe teknike, si dhe marrëdhëniet me konsumatorët e saj), ende gjatë vitit 2011 u prezantuan dhe u perseriten pretendimet për: mbifaturim të energjisë për muaj të caktuar nga ankues të ndryshëm dhe mosballafaqim me matësin nga CEZ Shperndarje sh.a..

Gjithashtu kemi trajtuar ankesat për faturim të padrejte nga CEZ shperndarje sh.a. të takses vjetore të Radio-Televizionit Shqiptar, e cila faturohej edhe për ambientet e garazheve të mjeteve levizëse. Për këtë çështje i drejtuam rekomandim të veçantë Ministrisë së Financave dhe Entitetit Rregullator të Energjisë. Në përgjigje të rekomandimit tonë, Ministria e Financave ka nxjerrë në fund të dhjetorit 2011, udhëzimin përkatës në të cilin përcaktohej përjashtimi i këtyre ambienteve të mjeteve levizëse, nga taksa vjetore e RTSh-së.

Ne mbrojtje te interesave te konsumatoreve, Institucioni i Avokatit te Popullit gjate vitit 2011 trajtoi nje numer te konsiderueshem ankesash nga qytetaret, drejtuar sherbimit te Ndermarrjeve te Ujesjelles Kanalizimeve. Ankesat i referoheshin mungeses se informimit lidhur me pretendime per mbifaturim te ujit dhe keqperdorim te marredhenieve furnizues-konsumatore nga Ndermarrjet e Ujesjelles-Kanalizimeve.

Mjaft ankesa i jane referuar procedures se nderrimit te matesve te vjeter, ku nga ana e UKT-se i eshte faturuar konsumatoreve, e gjithë sasia e ujit e gjendur ne mates, ne nje muaj te vetem.

Gjate shqyrtimit të ankesave që janë depozituar pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, kemi konstatuar se pavaresisht standarteve të mireqeverisjes, të garantuara si ne Kodin e Procedurave Administrative, edhe ne të drejten tone pozitive, për administratën publike shqiptare mbetet ende një sfide respektimi i elementeve proceduriale ne një vendimmarrje individuale e cila është në favor të individit, pasi ky i fundit, duke u bërë pjese e saj, duke u informuar, duke u dëgjuar, duke marrë vendimin në kohë, bindet në realitet për drejtësinë e kësaj vendimmarrjeje. Nga ana tjeter, sa më pak konflikte administrative dhe gjyqësore të ketë, aq më shumë rritet kredibiliteti i administratës publike në realizimin e misionit të saj, atë të mbrojtjes së interesit publik. Për këtë, një nga prioritetet tona në vijim, do të jetë pikërisht edukimi i administratës publike për implementimin e parimeve të mirëadministrimit, duke përfshirë konkretisht në termat e kontrollit tonë administrativ, kërkesat e parashtruara në dispozitat e Kodit të Procedurave Administrative dhe gjithashtu të ligjeve të posaçme.

Avokati i Popullit nuk pretendon te jete gjyqtari i pagabueshem i performances se adminsitrates publike. Ne synojme thjesht te jemi syri i taksapagueve shqiptare ndaj administrates qe mbahet me taksat e tij, ne perpiqemi te jemi instrument i ligjvenesit per te ushtruar nje nder funksionet e tij si organi me i larte prej nga edhe derivojne organet e tjera.

Per gjithçka, ashtu si ne traditen tone me te mire, ne ngelemi te hapur ndaj te gjitha objeksioneve te mundshme.

KREU II

Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit në zgjidhjen e ankesave konkrete, e ndarë sipas të drejtave dhe lirive të garantuara nga Kushtetuta dhe aktet e tjera ligjore

1. Barazia përpara ligjit dhe ndalimi i diskriminimit

Kuptimi i konceptit të barazisë, ne frymën e nenit 18 te Kushtetutës është parë gjithmonë ne kuptim të mosdiskriminimit. Megjithatë, këndvështrimi i vlerësimit të kësaj barazie, mbetet gjithmonë, raporti aktual dhe real që ekziston ndërmjet koncepteve të barazisë formale dhe asaj thelbësore, rast pas rasti, raport i cili evidenton diskriminimin ne një nga format e tij të njohura tashme.

Konventa Europiane e të Drejtave të Njeriut, ne nenin 14 të saj vendos ndalimin që individët t'i nënshtrohen një trajtimi diskriminues vetëm ne rastet që kanë të bëjnë me gëzimin e një prej të drejtave themelore të garantuara nga ky akt ndërkombëtar apo protokollet e saj. Barazia ne trajtim quhet e dhunuar nëse diskriminimi nuk ka një justifikim objektiv dhe të arsyeshëm.

Aktualisht, ne vendin tonë ekziston një baze e mire ligjore për mbrojtjen nga diskriminimi. Ligji nr.10221 date 4.02.2010 “Për mbrojtjen nga diskriminimi” shërbeu si baze për krijimin e institucionit të Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi, me kompetenca jo thjesht rekomanduese, por edhe vendimmarrëse.

Mbrojtja nga diskriminimi është jo vetëm një e drejtë e individit, por edhe një detyrim i organeve të administratës shtetërore si dhe i të gjithë aktoreve dhe faktorëve të tjerë ne vend, të cilët kanë dhënë dhe japin një kontribut të rëndësishëm ne këtë fushe, kjo duke e konsideruar këtë te drejtë si një te drejtë universale.

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2011, ka shqyrtuar me vëmendje të veçantë raste, ne të cilat është pretenduar nga subjekte, trajtimi diskriminues nga organe të administratës publike. Kjo edhe për vetë faktin e

problematikës së veçantë që ato paraqesin, por edhe të cilësive të veçanta të subjekteve ankues.

Ne dukje pa lidhje me nocionin e diskriminimit, por pretenduar si i tille, pak ankesa janë paraqitur pranë Zyrës sonë, ndoshta kjo për faktin e njohjes prej publikut të funksionimit të Zyrës së Komisionerit për Mbrojtjen nga Diskriminimi.

Nder rastet e trajtuara përmendim:

Rasti me **Nr. Dok. 201100553/7**, i filluar me iniciative nga Zyra jone, pas botimit në median e shkruar të problemit të grevës së Invalidëve Para e Tetraplegjike. Perfaqesues të Institucionit tone shkuan në ambientet ku zhvillohej greva e Invalidëve Paraplegjike dhe Tetraplegjike. Qëllimi i kësaj greve, ku një numër i konsiderueshëm ishin gra invalidë, ishte plotësimi i disa kërkesave të cilat ishin imediate për jetesën e tyre të përditshme, si: rritja e masës së pagesës për aftësinë e kufizuar, rritja e përfitimit të karburantit apo e paketës higjienosanitare. Grevistët pretendonin se ndjeheshin të diskriminuar përse i përkiste masës së përfitimeve nga invalidët e tjerë. Nga analiza e akteve ligjore dhe nënligjore, në lidhje me masën e pagesës së aftësisë së kufizuar për invalidët paraplegjike dhe tetraplegjike, vërejtëm se:

Udhëzimi nr.2211 datë 25.11.2010 “Mbi zbatimin e VKM-se nr.31, date 20.01.2001, “Për përfitimet nga Statusi i Invalidit, Paraplegjik dhe Tetraplegjike”, i ndryshuar, përcakton se: *“Masa e përfitimit për invalidët paraplegjikë dhe tetraplegjikë, të përcaktuar në pikën 4 të VKM-se nr.31 date 20.01.2001, është 9000 leke në muaj, ndërsa për kujdestarin e invalidit paraplegjik dhe tetraplegjik është 9500 leke në muaj”*. Pavarësisht kësaj rritjeje të masës së pagesës, kërkesa e grevisteve, ishte barazimi i masës së pagesës së aftësisë së kufizuar me atë të invalidëve për shkak të verbërisë. Kjo pasi në bazë të Udhëzimit nr.2209, date 25.11.2010 “Mbi zbatimin e VKM-se nr.277 date 18.07.1997, “Për përfitimet nga Statusi i te Verbërit”, i ndryshuar: *“Masa e përfitimit për shkak të verbërisë, të përcaktuar në pikën 4 të VKM nr.277 date 18.07.1997, është 10200 lekë në muaj. Të njëjtën masë përfiton edhe kujdestari i te verbërit”*.

Po kështu edhe për kategorinë e personave me aftësi të kufizuar fizike dhe mendore, Udhëzimi nr.2210, date 25.11.2010 “Mbi zbatimin e VKM-se nr.618 date 07.09.2006 “Për përcaktimin e kriterëve të dokumentacionit dhe masës së përfitimit të pagesës për personat me aftësi të kufizuar”, i ndryshuar, përcakton se: *“Masa e përfitimit të aftësisë së kufizuar, të përcaktuar në pikën 8 të VKM-se nr.618 date 07.09.2006, është 9000 leke në muaj për personat e përcaktuar në pikën 1 të vendimit. Të njëjtën masë*

përfiton edhe kujdestari i personit te aftësisë se kufizuar”. Pra, rezulton se masa e përfitimit te aftësisë se kufizuar është e ndryshme për kategoritë e sipërcituara te PAK-se. Ndaj ju drejtuam Ministrit te Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta me rekomandimin për marrjen e iniciativës për ndryshimin e VKM-se nr.31, date 20.01.2001 “Për përfitimet nga Statusi i Invalidëve Paraplegjik dhe Tetraplegjik” dhe te VKM-se nr.618, date 07.09.2006 “Për përcaktimin e kriterëve te dokumentacionit dhe masës se përfitimit te pagesës për personat me aftësi te kufizuar”, i ndryshuar, lidhur me barazimin e masës se pagesës se aftësisë se kufizuar te invalidëve para&tetraplegjike, te personave me aftësi te kufizuar fizike dhe mendore me atë te pagesës për shkak te verbërisë. Ne përgjigjen e kësaj Ministrie lidhur me rekomandimin, jemi informuar se ne kuadrin e procesit drejt ratifikimit te Konventës se OKB-se “Për mbrojtjen e te drejtave te Personave me Aftësi te Kufizuar”, një grup ndërministror i koordinuar nga MPCSSHJ-ja, po punon për ndryshimin e te gjithë legjislacionit shqiptar qe prek çështje te aftësisë se kufizuar. Aktualisht me asistencën e një eksperti ndërkombëtar është bere analize e hollësishme e këtij legjislacioni. Duke qene se Rekomandimi ynë është pjesë dhe ka lidhje te drejtpërdrejte me terë reformën legjislative për PAK-un, kanë siguruar se ai do te jete ne vëmendje te punës se grupit ndërministror, si gjate hartimit te Ligjit Kuadër për Mbrojtjen e te Drejtave te Personave me Aftësi te Kufizuar, ashtu edhe akteve te tjera nënligjore.

Në çështjen me **nr. Dok. 201100184/5**, Kryetari i Unionit për Zhvillim dhe Integrim te Minoritetit Rom ne Shqipëri “Amaro Drom”, na paraqiti ankesën e disa anëtarëve te komunitetit rom qe jetonin ne lagjen pranë Stacionit te Trenit ne Tirane, duke pretenduar keqtrajtimin dhe dëbimin nga banesat e tyre ne muajin Shkurt 2011. Ata u ankuan se rreth orës 23.30, te datës 20.02.2011, tek barakat ku ata banonin, ishin dhunuar fizikisht duke u goditur me mjete te forta si shkopinj, kaçavida etj, nga një grup te rinjsh. Përveç dhunimit fizik ata pretendonin se ishin kërcënuar seriozisht me shprehje “se do t’i zhdukjin”, “do t’i vrisin”, si dhe janë fyer me fjale te ndryshme. Sipas përfaqësuesit të ankuesve, këto veprime diskriminuese ndaj tyre janë bere për shkak te etnisë se tyre rome. Si pasoje e goditjeve fizike, një pjesëtar i romeve, ishte plagosur rende dhe ishte dërguar e shtruar për mjekim ne Spitalin Ushtarak ne Tirane. Te dëmtuarit te nesërmen ne datën 22.02.2011, kishin paraqitur ne Komisaratin e Policisë Nr. 3 Tiranë kallëzimin përkatës. Ata pretenduan se nga punonjësit e policisë, nuk ishte marrë kallëzimi duke i përcjellë me fjalët që “te iknin se nuk do te ndodhte me kjo ngjarje”. Komisarati i Policisë Nr. 3 Tirane, pas kërkesës sonë, shkresërisht na informoi se nga ana e këtij organi nuk ka

patur asnjë neglizhence për ndjekjen e kësaj ngjarjeje. Nga policia ky rast ishte vlerësuar duke shkuar ne vend menjëherë pas marrjes se informacionit, por nga te dëmtuarit është refuzuar bërja e kallëzimeve dhe dhënia e shpjegimeve për ndjekjen e saj. Po te njëjtin qëndrim refuzues ka mbajtur me policinë edhe personi i plagosur i cili ishte shtruar ne Spitalin Ushtarak Tirane, si dhe familjaret e tij. Me pas janë marre deklaramet nga disa shtetas rome te cilët treguan rrethanat e hetimit. Ndërsa ne dt. 17.03.2011 atyre ju janë marre kallëzimet për veprat penale te parashikuara nga neni 151 dhe 265 te K.Penal. Mbi bazën e materialit kallëzues u krye arrestimi i shtetasve B. V. e K. V. si autore te dyshuar te ngjarjes se ndodhur. Materialet hetimore iu dërguan organit te Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tirane për hetime te mëtejshme.

Nga ndjekja që i bëmë rastit, nuk rezultoi se nga punonjësit e Komisarariatit të Policisë Nr 3, të ishin kryer veprime diskriminuese ndaj ankuesve për shkak të etnisë së tyre.

Ankesa me **Nr. Dok. 201101010/3** e Ambasadës Pink, e cila parashtrroi pretendimin për keqtrajtimin dhe ushtrimin e dhunës nga efektivët të Policisë së Shtetit ndaj një personi transgjinnor. Rezultoi se efektivët e Policisë se Shtetit të shoqëruar nga një qytetare, kishin kryer verifikime lidhur me vjedhjen që i kishte ndodhur kësaj të fundit dhe mes personave të pyetur, ka qenë edhe një djalë, shoqërues i grupit transgjinnor, ndalimi i të cilit ka hasur në rezistencën e personit transgjinnor të quajtur E.M. Nga verifikimi i kryer nga Institucioni i Avokatit te Popullit pranë Komisarariatit te Policisë nr.1, rezultoi se sipas regjistrit të personave të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar, shtetasi E. M ishte shoqëruar për afro 4 ore në Komisariatin e Policisë Nr.1 Tiranë. Kundërshtimi i punonjësve të policisë gjatë kryerjes së detyrës (duke ofenduar, sharë dhe kundërshtuar me fjalë dhe fizikisht punonjësit e policisë) ishte arsyeja e shoqërimit të tij në ambientet e Komisarariatit të Policisë Nr.1 Tiranë. Punonjësit e policisë që kishin bërë shoqërimin dhe marrjen në pyetje të shtetasit E. M shpjeguan se ky shtetas nuk ishte dërguar në spital dhe për të nuk ishte marrë vendim për ekspertim mjeko-ligjor, pasi ndaj tij nuk ishte përdorur dhunë fizike, ashtu siç ai pretendonte. Po kështu, pyetja e tij ishte bere pa avokat, pasi ai nuk e kishte kërkuar prezencën e tij. Nga verifikimet e bëra si dhe dokumentacioni shkresor i administruar ne QSUT dhe konkretisht ne Urgjencën e Spitalit Nr.2, rezultoi se shtetasi E. M. nuk ishte vizituar në këtë urgjencë as në datën 14.08.2011 dhe as në datat 13 dhe 15 të këtij muaji, ashtu siç ai pretendonte. Materialet ishin dërguar në Prokurorinë e Rrethit Gjyqësor Tiranë për veprën penale të kundërshtimit të punonjësit të rendit publik e parashikuar nga neni 236 i Kodit Penal në ngarkim të E. M në gjëndje të lirë.

Ndaj në përputhje me dispozitat përkatëse për aq sa çështja po ndiqej nga organi specializuar, Prokuroria, nuk kishte me vend për vijim shqyrtimi. Pra nuk u provua të ishin kryer veprime diskriminuese në këtë çështje.

Ankesa me nr. **201001538/11** e Shoqatës Humanitare e Invalidëve të Punës në Gramsh, për moszbatimin e rimbursimit të biletës në masën 50% të vlerës në udhëtimin ndërurban.

Megjithëse Ligji nr.8626, datë 22.06.2000 “Për Statusin e Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik” në nenin 11 të tij ka përcaktuar se, udhëtimi ndërurban rimbursohet nga shteti në masën 50% të vlerës, u pretendua se ky përcaktim nuk zbatohet në mënyrë diskriminuese nga drejtuesit e mjeteve udhëtuese.

Në këtë kuadër, gjatë hetimit të këtij rasti, konstatoam se janë shkelur edhe të drejtat e subjekteve të tjera, të garantuara në:

Nenin 11 të Ligjit nr.8098 datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”, në nenin 11 të Ligjit nr.8626 datë 22.06.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, në nenin 10 të Ligjit nr.8153 datë 31.10.1996 “Për Statusin e Jetimit”, si dhe në nenin 6 të Ligjit nr.7663 datë 20.01.1993 “Lufta kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”.

Në bazë të Udhëzimit nr.20 datë 10.10.2007 “Për modelet e liçensave, autorizimeve dhe çertifikatave për ushtrimin e veprimtarisë në transportin rrugor” të Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, në dispozitat e përgjithshme të formateve të liçensave për transportin qytetës, rrethqytetës dhe ndërqytetës të udhëtarëve si dhe çertifikatave të autobusëve, janë përcaktuar detyrimet për shoqëritë transportuese, të cilat liçensohen nga organet e qeverisjes vendore, të cilat duhet të përcaktojnë të gjitha lehtësirat kundrejt personave me aftësi të kufizuar.

Shoqata Humanitare e Invalidëve të Punës në Gramsh në kërkesën e saj sqaronte se nga subjektet e transportit, pretendohet se nuk ekzistojnë akte nënligjore që rregullojnë ligjet specifike të kategorive të personave me aftësi të kufizuar për rimbursimin e biletës ndërqytetase në vlerën 50%, ndaj ligji bëhej i pazbatueshëm.

Në këto kushte, i rekomandua Ministrit të Punëve Publike dhe Transportit, marrjen e iniciativës për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të nenit 11 të Ligjit nr.7889 datë 14.12.1994 “Për Statusin e Invalidit”; të nenit 11 të Ligjit nr.8098 datë 28.03.1996 “Për Statusin e të Verbërit”; të nenit 11 të Ligjit nr.8626 datë 22.06.2000 “Statusi i Invalidit Paraplegjik dhe Tetraplegjik”, të nenit 10 të Ligjit nr.8153 datë 31.10.1996 “Për Statusin e Jetimit” si dhe të nenit 6 të Ligjit nr.7663 datë 20.01.1993 “Lufta kundër pushtuesve nazifashistë të popullit shqiptar”, me qëllim që të rregullohet

situata e paligjshmërisë ndaj kësaj kategorie të popullsisë për të përfituar rimbursimin e vlerës së biletës në transportin qytetës dhe ndërqytetës.

Në përgjigje të këtij Rekomandimi, u sqaruam se kjo Ministri në zbatim të misionit të saj, ka hartuar një pakete ligjore në funksion të politikave për një transport rrugor të qëndrueshëm dhe gjithëpërfshirës, të cilat garantojnë të gjitha lehtësirat kundrejt personave me aftësi të kufizuara.

Pavarësisht kësaj, çështja e rimbursimit të biletave në transportin e udhëtarëve qytetës dhe ndërqytetës për këto kategori, ka mbetur ende e pazgjidhur. Në këto kushte, i rekomanduam Ministrin të Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta që brenda kompetencës së tij, të bashkërendojë punën me ministritë e tjera të linjës, konkretisht me Ministrinë e Punëve Publike dhe Transportit, Ministrinë e Financave si dhe me Ministrinë e Mbrojtjes për marrjen e iniciativës për nxjerrjen e akteve nënligjore në zbatim të ligjeve të sipërcituara.

Denoncimi me force i çdo rasti diskriminimi, duhet vlerësuar si mjet i rëndësishëm për parandalimin e këtij fenomeni. Megjithatë, kuadri ligjor ekzistues në fuqi nuk garanton nivelin e duhur të mbrojtjes ligjore ndaj diskriminimit për disa kategori personash me aftësi të kufizuara, duke i bërë ata vulnerabël ndaj diskriminimit: të tillë persona, janë personat me aftësi të kufizuara mendore dhe shqisore.

Për të gjitha këto raste nevojitet përmirësimi i kuadrit ligjor ekzistues në fuqi, apo edhe plotësimi i legjislacionit me akte të reja ligjore, të cilat logjikshëm do të parandalojnë gjendjen e diskriminimit real ndaj kësaj kategorie personash, duke shërbyer njëkohësisht edhe si garanci për ushtrimin real të te drejtave të tjera themelore kushtuese të këtyre personave me aftësi të kufizuara.

Ne këtë kontekst vlen të përmendim dhe vijimësinë e punës sonë lidhur me zbatimin sa më konkret të rekomandimeve të Komitetit për Eliminimin e Diskriminimit Racial (CERD), pas shqyrtimit të Raportit të Qeverisë Shqiptare në Gjenevë me 22-23 Gusht 2011, si një institucion që do të kontribuojë në përmbushjen e tyre për eliminimin e të gjitha formave të diskriminimit racial.

2. E drejta për informim

Dokumenti më i rëndësishëm në kuptimin e akteve normative që garantojnë të drejtën e informimit, është Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në nenin 23 të saj garanton të drejtën për informim.

Si pjesë e paketës së ligjeve në zbatim të Kushtetutës, është miratuar nga ana e Kuvendit të Shqipërisë dhe ka hyrë në fuqi, Ligji Nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

Kodi i Procedurave Administrative miratuar me Ligjin nr. 8485, datë 12.05.1999, e parashikon të drejtën e informimit si një nga parimet bazë të funksionimit të Administratës Publike. Ai bën një rregullim specifik të së drejtës për informim, duke ia njohur këtë të drejtë subjekteve që janë palë në një procedim administrativ ose atyre që kanë një interes të ligjshëm në lidhje me këtë proces.

Duke u trajtuar si pjesë e katalogut të të drejtave të individit dhe si një nga të drejtat themelore vetjake, e drejta e informimit ka gjetur pasqyrim në akte të rëndësishme ndërkombëtare.

Qënia palë në këto akte, sjell për rrjedhojë detyrimin e shtetit për marrjen e masave për respektimin e detyrimeve të parashikuara në to, ose të paktën të një pjese të këtyre detyrimeve. Ndër aktet ndërkombëtare, më të rëndësishme në këtë fushë, listojmë:

a) Deklaratën Universale të të Drejtave të Njeriut, miratuar nga Asambleja e Përgjithshme e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, në 10 Dhjetor 1948, e cila në nenin 19 të saj afirmon të drejtën për informim si një nga të drejtat themelore të individit;

b) Konventën Europiane të të Drejtave të Njeriut. Në paragrafin e parë të nenit 10 të saj, bëhet një riformulim dhe theksim i përcaktimit të bërë në nenin 19, të Deklaratës Universale të të Drejtave të Njeriut;

c) Paktin Ndërkombëtar mbi të Drejtat Civile dhe Politike (Dhjetor 1966). Ky është një akt i rëndësishëm, i cili njeh dhe garanton të drejtën për informim;

d) Deklaratën e Këshillit të Europës, mbi Lirinë e Shprehjes dhe të Informimit, të vitit 1982, e cila shpreh si një nga përparësitë në veprimtarinë e Këshillit të Europës, aksesin në informacion. Në këtë deklaratë jepen parimet kryesore në lidhje me të drejtën e informimit dhe rolin që luan kjo e drejtë në shoqëri “si një kusht i nevojshëm për zhvillimin e shoqërisë”.

e) një akt tjetër që elaboron këtë të drejtë, në një fushë të caktuar është Konventa e Aarhusit, “Mbi të drejtën e publikut për informim, pjesëmarrje në vendimmarrje dhe të drejtën për t’iu drejtuar gjykatës, për çështje që lidhen me mjedisin”.

Çështjet e shqyrtuara për shkelje të së drejtës për informim, gjatë vitit 2011 nga Institucionit i Avokatit të Popullit, kanë nxjerrë edhe problematikën e zbatimit të ligjit në Administratën Publike, nga e cila konstatohet ashtu si dhe vitin e kaluar se:

- Nuk zbatohen afatet ligjore për kthimin e përgjigjes ndaj kërkesave për informacion, qoftë për refuzimin, qoftë për përmbushjen e tyre;

- Legjislacioni mbi të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare nga Administrata Publike, nuk zbatohet, duke shmangur kështu përgjegjësinë e saj për dhënien e dokumentacionit të kërkuar.

Gjithmonë, duke ju referuar kësaj praktike, por edhe pa përjashtuar mjedisin social dhe zhvillimet e tij në këtë drejtim, mund të thuhet se Ligji Nr.8503 datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, njihet në masë jo të mjaftueshme dhe jo nga e gjithë administrata, gjë që sjell vështirësi dhe pengesa në funksionimin normal dhe transparent të Administratës Publike, në marrëdhëniet e kësaj të fundit me publikun.

Gjatë vitit 2011, numri i rasteve të shqyrtuara ka qene 59, ne të cilat është pretenduar nga ana e ankuesve shkelje e së drejtës për informim. Ato janë drejtuar ne kuadër të veprimtarisë së organeve të pushtetit qendror, njërive të pushtetit vendor, të veprimtarisë së enteve publike, si dhe të personave juridike që ofrojnë shërbime publike.

Ne gjykojmë se, pavarësisht punës konkrete që bëhet në lidhje me çështjet përkatëse në këtë fushë, duhet kuptuar fakti se vetë procesi i shqyrtimit të çështjeve në tërësi, nga ana e Avokatit të Popullit, dhe informimi që i bëhet ankuesve apo kërkuarve rast pas rasti, në thelb është realizim direkt i së drejtës për informim ndaj individit. Në thelb veprimtaria e këtij institucioni mbart realizimin e të drejtës për informim.

Ndër rastet e trajtuara përmendim:

Në ankesën me nr. **201101553 Doc.**, përfaqësuesi i një subjekti mediatik, paraqiste pretendim lidhur me mosplotësimin e kërkesës së tij për informim dhe dhënie kopje dokumentash zyrtare, përse i përket zhvillimit të një procedure tenderimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, në cilësinë e Autoritetit Kontraktor.

Sikundër ankuesi shkruante, nëpërmjet një shkrese drejtuar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, kishte kërkuar t’i vihej në dispozicion një kopje e dokumentacionit të plotë të hapjes dhe zhvillimit të tenderit, përfshirë proces-verbalin përkatës të vlerësimit të ofertave, tender ky i realizuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit, me objekt: “Blerjen e uniformës së Policisë së Shtetit”.

Në këtë tërësi dokumentacioni zyrtar të kërkuar, përfshihej edhe kopja e kontratës së lidhur me subjektin fitues të këtij tenderi.

Me anë të një shkrese zyrtare, ankuesi shprehej se kishte marrë një përgjigje negative nga organi në fjalë, në të cilën sqarohej se ky

dokumentacion nuk mund të jepej, ndërkohë që kërkuesi mund ta gjente këtë të fundit në Agjencinë e Prokurimit Publik.

Në këto kushte, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Avokatit të Popullit për mundësimin e marrjes së një kopje të dokumentacionit zyrtar të kërkuar, lidhur me procedurën e tenderimit për blerjen e uniformës së policisë së shtetit.

Përgjatë hetimit administrativ të ndërmarrë nga Avokati i Popullit, ku sigurisht përkundër definimeve kushtetuese dhe ligjore në të cilat qartësisht e drejta e informimit konsiderohet e drejtë themelore e njeriut e garantuar në nenin 23, të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, më tej në Ligjin Nr.8503 datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, i kemi rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, Informimin dhe dhënien e kopjes së dokumentacionit zyrtar të kërkuar nga përfaqësuesi i subjektit mediatik, në bazë të kërkesës të cilën ai kishte paraqitur pranë Autoritetit Kontraktor.

Në ankesën me **nr. 201101576 Doc**, shtetasi ankues kërkonte ndërhyrjen e Avokatit të Popullit pranë A.L.U.I.Z.N.I.-t të qarkut, me qëllim përfitim të një informacioni konsideruar prej tij themelor, sa i përket rrugës ligjore që gjykohej e nevojshme të ndiqej, në mbrojtje të të drejtave të tij mbi pronën.

Duke qenë se përgjatë hetimit administrativ të ndërmarrë nga ana jonë, pretendimet e ankuesit rezultojnë të ishin të bazuara në aspektin ligjor, i kemi rekomanduar A.L.U.I.Z.N.I.-t në qark, përmbushjen e së drejtës për informim të ankuesit në dhënien e dokumentave zyrtare.

Ankesa me **nr.doc. 201101726**, ku ankuesi shprehte pretendimin e tij ndaj Komunës Levan, në lidhje me zvarritje në vënien në dispozicion të informacionit të kërkuar me anë të një kërkesë zyrtare të parashtruar që me datë 06.10.2011 dhe protokolluar me nr. prot. 532. Në kushtet e mosmarrjes së një përgjigje zyrtare brenda afateve të parashikuara, ankuesi kërkoi ndërhyrjen e institucionit të Avokatit të Popullit.

Avokati i Popullit iu drejtua Kryetarit të Komunës Levan, për të kërkuar shpjegime lidhur me pretendimet, nëse i ishte kthyer tashmë ankuesit një përgjigje zyrtare mbi bazën e kërkesës për informim. Në përgjigje të shkresës tonë, pati një reagim zyrtar nga ana e Kryetarit të Komunës Levan, i cili me shkresën me nr. 600/1 prot, datë 17.11.2011 ka sqaruar me detaje lidhur me kërkesën e parashtruar për informim, duke theksuar mes të tjerash edhe faktin se nuk kishte patur ndryshime në buxhetin e Komunës, çka përbënte edhe thelbin e kërkesës së parashtruar nga ankuesi.

Ankesa me **nr.doc. 201100371** në të cilën ankuesi shprehte pretendimin e tij ndaj Drejtorisë Rajonale të Administrimit të Pasurisë Shtetërore Lezhë për moskthim përgjigje dhe shkelje të së drejtës për informim.

Konkretisht, ai shprehej se me anë të kërkesës së tij, referuar të drejtës së shtetasve për informim në dokumenta zyrtare, kishte kërkuar kopje të dokumentacionit të privatizimit të Hotel Restorant “Lis”, duke qenë se ishte bashkëpronar i truallit ku ishte ndërtuar objekti. Pas verifikimit të pretendimeve dhe korrespondencës zyrtare, Drejtoresha e Degës së Shoqërive Publike Lezhë na bëri me dije se dosja për të cilën ankuesi kishte kërkuar informacion, nuk ndodhej më pranë kësaj Drejtorie, por në Drejtorinë e Administrimit dhe Shitjes së Pasurive Publike Tiranë, dhe se rezultonte se dosja ishte mbyllur që në vitin 1994. Lidhur me këtë fakt, ankuesi u orientua që t’i drejtohej, si subjekt i interesuar, DASHP Tiranë për të kërkuar informacion dhe më pas të procedonte më tej lidhur me pretendimet mbi pronën.

Ankesa me **nr.doc. 201101033** në të cilën ankuesit i ishtë mohuar e drejta për të marrë me shkrim dokumenta nga Ministria e Mbrojtjes. Administrata e kësaj ministrie e kishte sorollatur për të plotësuar në kohë dokumentat e daljes në pension, duke e detyruar ankuesin t’i drejtohet gjykatës. Me të njëjtin objekt u praqet ankesa me **nr.doc. 201100177** në të cilën ankuesit nuk i jepej dokumentacioni i kërkuar nga Ministria e Mbrojtjes. Në të dy rastet ndërhyrja e Avokatit të Popullit rezultoi e suksesshme, me rezultat marrjen e shërbimit të kërkuar nga ankuesit, pranë Ministrisë së Mbrojtjes.

Nevoja për përmirësime në Ligjin “Për të drejtën e informimit me dokumentet zyrtare”.

Si dhe në vite të kaluara, funksionimi i regjimit të informimit publik në vend vazhdon të ketë probleme të dukshme. Arsyet paraqiten të karakterit infrastrukturor, në dobësinë gjithashtu të kapaciteteve administrative shfaqur sidomos në komuna të vendit, tendencat autokratike të funksionarëve të administratës, por edhe të kushtëzuara nga mangësi të kuadrit ligjor të së drejtës së informimit, i cili ka mbetur i pandryshuar që prej vitit 1999.

Në këtë kontekst, mbeten parësore ndryshimet dhe përmirësimet e Ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, si një kërkesë e përshtatjes së legjislacionit të brendshëm me “Acquis Communautaire”.

Për nga eksperiencia 12 vjeçare e Institucionit të Avokatit të Popullit në pozicionin e kujdestarit të respektimit të së drejtës për informim, është arritur në konkluzionin se për të mundur ushtrimin sa më efikas të kësaj të

drejte nga ana e individëve, nevojiten ndryshime në bazën ligjore ekzistuese që garanton të drejtën për informim.

Ndryshimet e mundshme të ligjit duhet të konsistojnë në:

- *Zgjerimin e rrethit të subjekteve që kanë detyrim, dhënien e informacionit, duke përfshirë;*

a. personat fizikë ose juridikë që përmbushin funksione publike ose administrative (p.sh. kompanitë private që kanë monopole ose koncesione për furnizimin me ujë, energji elektrike etj).

Lidhur me ndryshimin në fjalë, duhet theksuar se drejta për informim e kësaj kategorie të popullatës është e parashikuar në Ligjin Nr.9902, date 17.4.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, por dhe dispozitave të Kontratave Tip në fuqi ndërmjet palëve, të miratuara nga Entet mbikqyrëse të operatoreve tregtare.

Për nevoja të komunikimit sa më korrekt të palëve ndërkontraktuale, marrëdhënieve ndërinstitucionale, por dhe në funksion të transparencës, e cila ndër të tjera konsiderohet si elementi kryesor që krijon perceptimin për funksionimin korrekt të këtyre subjekteve, konsiderohet mjaft e rëndësishme përfshirja shprehimisht e subjekteve tregtare me ndjeshmëri të lartë në treg, në detyrimin për dhënie informacioni në dispozita të Ligjit Nr.8503 datë 30.06.1999, “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”.

- *Shtesën e kritereve përjashtimore, që do të thotë të parashikohet një listë shteruese e kritereve për mosdhënien e informacionit. Një ndryshim i tillë shihet i nevojshëm sidomos sa i përket kërkesave të përsëritura nga shtetas, të cilët edhe se marrin informacionin e kërkuar prej tyre, vazhdojnë të paraqesin kërkesa të cilat nuk janë gjë tjetër përveçse përsëritje e kërkesave të para. Në të tilla raste është e kuptueshme vështirësia e organit publik pranë të cilit është paraqitur kërkesa e përsëritur për të respektuar afatet ligjore në refuzimin apo përmbushjen e një kërkesë të trajtuar më parë.*

- *Rishikimin e afateve për dhënien e informacionit.*

Lidhur me afatet ligjore në dhënien e informacionit, gjykohet i nevojshëm unifikimi i tyre në refuzimin apo përmbushjen e kërkesave. Për nga eksperiencia e akumuluar në shqyrtimin e çështjeve të kësaj natyre, konsiderohet jo praktik definimi, refuzohet përgjatë një periudhe 15 ditore, përmbushet brenda një periudhe 40 ditore. Në interpretim të dispozitave në fjalë, organit të administratës publike me kalimin e afatit 15 ditor nuk i ngelet tjetër përveçse detyrimisht të përmbushë një kërkesë, e cila fare mirë mund të jetë e pabazuar ligjërisht, ndërkohë që për arsye objektive nuk ka mundur të marrë në shqyrtim e më tej të kthejë përgjigje brenda afatit të parashikuar.

- *Detyrimin për të orientuar kërkuesin të identifikojë dokumentet që kërkon* pasi administrata ka njohuri më të plota se çfarë dokumentesh zyrtare mban dhe në fund të fundit, sqarimi i kërkesës thjeshtëzon punën e të dyja palëve, duke pranuar detyrimisht kërkesën, në rast se i disponon dokumentet në fjalë, ose në të kundërt, detyrimi është që, për sa të jetë e mundur, të drejtohet kërkesa ose kërkuesi te subjekti kompetent që duhet të japë informacion sipas ligjit.

Ndryshimi në fjalë konsiderohet mjaft i nevojshëm dhe për faktin e thjeshtë, së në jo pak raste konstatohen kërkesa drejtuar organeve që nuk disponojnë dokumentacion, apo nuk kanë tagër të shqyrtojnë çështje të shprehura në kërkesën përkatëse. Në përcaktimet aktuale të ligjit, një situatë e tillë nuk është e parashikuar, gjë që sjell pashmangshmërisht shkelje të afateve ligjore në kthimin e një përgjigje, e në më të shumtën e rasteve konstatohet moskthim përgjigje.

- *Parashikimin shprehimisht në lehtësirat për formën e dhënies së informacionit, në rastet kur ato kërkohen nga personat me aftësi të kufizuar.*

Megjithëse në ligj shprehet se kërkuesit i jepet informacioni në formën më të përshtatshme, në rastet e personave me aftësi të kufizuar, duhet të parashikohet shprehimisht dhënia e informacionit në formën më të përshtatshme për ta, në varësi të paaftësisë që ata kanë.

Gjithashtu një parashikim që duhet shtuar është që kërkuesit i jepen dokumentet në formatin e preferuar prej tij, duke përfshirë dhe formatin elektronik, përveçse kur kjo paraqet vështirësi teknike të konsiderueshme.

- *Koston e pagesave për dhënien e informacionit.* Do të ishte mjaft i volitshëm një rregullim i ligjit lidhur me këtë pikë, qoftë për p.sh. tarifatat maksimale që mund të aplikohen nga organet shtetërore, pasi në praktikë vërehen subjekte që caktojnë tarifa tepër të larta dhe artificiale, me qëllim vështirësimin e marrjes së informacionit të kërkuar, gjë që çon në përfundimin se formulimi i dispozitave përkatëse ligjore nuk është i plotë.

- Në caktimin e sanksioneve dhe dëmshpërblimin, pasi sanksionet për moszbatimin e ligjit “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, nëse shkelja nuk përbën vepër penale, caktohen sipas ligjit nr.7697 datë 7.04.1993 “Për kundërvajtjet administrative”.

Ndërkohë, lidhur me shpërblimin e dëmit, parashikohet se: “Çdo person, që ka pësuar një dëm, për shkak të shkeljes së dispozitave të këtij ligji, ka të drejtë të kërkojë shpërblimin e dëmit nga subjekti që shkel të drejtën.

Procedurat për ankim dhe për shpërblimin e dëmit rregullohen me ligj”.

Nga praktika e deritanishme është evidentuar se, zbatimi i këtyre dispozitave mbi sanksionet dhe dëmshpërblimin ka qenë pothuajse inekzistent.

Duke pasur parasysh që e drejta e informimit mund të përdoret nga individët, edhe për të mbrojtur interesat e tyre private, është mëse e logjikshme që pamundësia për të përfituar nga kjo e drejtë të përkthehet në dëm për qytetarët. Në kontekstin e të drejtës së informimit, do të mjaftonte të vërtetohej që refuzimi i administratës, për të servitur dokumentacionin e kërkuar, të ishte i pambështetur në ligj, si dhe të tregohej një lidhje shkakësore midis këtij veprimi të paligjshëm të administratës dhe një dëmi të pësuar nga personi privat, që ky i fundit të legjitimohej për një dëmshpërblim nga administrata fajtoare, sipas parashikimeve të Ligjit nr.8510 datë 15.07.1999 “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”.

Në përfundim të problematikës së lartpërmendur, sigurisht në raport me shqyrtimin e ankesave konkrete nga Avokati i Popullit, mund të konkludohet se tashmë janë bërë të domosdoshme ndryshimet e lartpërmendura në Ligjin Nr.8503, datë 30.06.1999 “Për të drejtën e informimit për dokumentet zyrtare”, ndër të tjera për faktin e ushtrimit gjithmonë e më të shpeshtë të kësaj të drejtë nga komuniteti. Sigurisht që ndryshimet në fjalë, konsistojnë në pajisjen e ligjit me potenciale më të mëdha, praktikitet, e sidomos thjeshtësi në zbatim, konsideruar si elementi kryesor që karakterizon ligje të mirëformulara e të përshtatshme për tu zbatuar në periudha të gjata kohore.

3. Liria e ndërgjegjes dhe e fesë

Në analizë të lirisë së besimit ndërgjegjes dhe fesë, evidentojmë se Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2011, nuk ka patur ankesa, ku të

jetë pretenduar cënimi i kësaj të drejte nga veprimet apo mosveprimet e organeve të administratës publike.

Kontributi ynë ka qenë në vijimësi për hartimin e projektligjit “Për fenë”, i cili është në vazhdimësi të punës së bërë për hartimin e marrëveshjeve tip me komunitet fetare në Shqipëri, detyrim ky që buron nga neni 10 i Kushtetutës. Qeveria ka gati projektligjin “Për Fenë”, i cili rregullon në bazë të Kushtetutës së Shqipërisë, marrëdhëniet e shtetit me komunitetet fetare, dhe është në pritje të miratimit të tij nga Kuvendi i Shqipërisë. Ky projekt-ligj është mbështetur në Kushtetutën shqiptare, rekomandimet e Komisionit të Venecias dhe ligji do të jetë i njëjtë me ligje të tilla që janë hartuar në gjithë Europën.

Gjatë vitit 2011 ka patur vetëm një risi përsa i përket lirisë së fesë dhe ushtrimit të lirë të saj. Konkretisht Kuvendi i Shqipërisë ka miratuar Ligjin nr.10 394, datë 10.03.2011 “Për ratifikimin e Marrëveshjes ndërmjet Këshillit të Ministrave të Republikës së Shqipërisë dhe Bashkësisë fetare “Vëllazëria ungjillore e Shqipërisë” për rregullimin e marrëdhënieve të ndërsjella”.

Njëkohësisht, janë ndjekur edhe zhvillimet e projektligjit “Për sistemin arsimor parauniversitar, i cili duhet të mbështetet në parashikimet e Kushtetutës dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si pjesë e legjislacionit të brendshëm. Kemi konstatuar se ky ligj ka ngelur ende në fazën e shqyrtimit dhe ende nuk janë ndërmarrë procedurat ligjore për miratimin e Ligjit të ri “Për sistemin arsimor parauniversitar”, duke azhornuar në këtë mënyrë legjislacion e këtij cikli me standartet bashkëkohore dhe risitë e vendeve europiane.

Liria e mendimit, ndërgjegjes dhe e fesë përfaqëson një prej themeleve të një “shoqërie demokratike” dhe renditet ndër elementet më thelbësore të identitetit të besimtarëve dhe të konceptit të tyre për jetën, por është gjithashtu një gjë e çmuar për ateistet, agnostikët, skeptikët apo indiferentët. Në referencë të projektligjit, i cili parashikon ndalimin e mbajtjes së simboleve fetare në shkollë, evidentojmë se, natyrisht politika e ndjekur nëpërmjet ligjit, kryesisht në arsimin parauniversitar, duhet të këtë si qëllim që të akomodojë çdo njeri në mënyrën sa më të arsyeshme të mundshme, për të krijuar një klimë të përshtatshme, në të cilën fëmijët të mund të mësojnë dhe të jetojnë së bashku në harmoni.

4. Kufizime të lirisë së personit

- Veprimtaria e Policisë së Shtetit

Policia e Shtetit, për vetë specifikën e funksionit të saj, është organi i cili lidhet në mënyrë direkte me cënimin e të drejtave dhe lirive të individëve, për shkak të objektit të veprimtarisë ligjore të saj, që është ruajtja e rendit dhe sigurisë publike.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka patur vazhdimisht ankesa të qytetarëve për veprime ose mosveprime të caktuara të organit të Policisë së Shtetit. Për vitin 2011, **119** ankues janë drejtuar për ndihmë ndaj veprimeve të paligjshme dhe të parregullta të organeve apo të punonjësve të policisë. Pretendimet e ankuesve kanë qënë: për torturë dhe keqtrajtim të tyre nga punonjësit e policisë, për arrestime e ndalime të kundërligjshme, për shoqërime të paligjshme në organet e mjediset e policisë, për mosmarrje apo mosndjekje të kallëzimeve, të ankesave të bëra nga shtetasit dhe për veprime të tjera të paligjshme apo të parregullta nga organet dhe punonjësit e policisë.

Gjatë vitit 2011 në funksion të mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Avokati i Popullit ka kryer dhe 42 inspektime, ri-inspektime dhe kontrole tematike në të gjitha Strukturat e Policisë së Shtetit në vend, institucione këto që janë në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme. Në këtë kuadër, janë hartuar dhe paraqitur 33 rekomandime, në lidhje me përmirësimin e standarteve të të drejtave dhe trajtimit të individëve që strehohen në këto institucione.

Problem shqetësues vazhdon të mbetet shoqërimi i shtetasve në organet, zyrat dhe ambientet e policisë. Gjatë ndjekjes së ankesave të ardhura për këtë çështje dhe nga inspektimet e bëra në organet e policisë, janë konstatuar disa shkelje të cilat do t'i rendisim me poshtë. Ambiente shoqërimi sipas konceptimit të bërë në ligjin nr. 9749, dt. 04.06.2007 "*Për Policinë e Shtetit*", ka vetëm në Komisaratin e Policisë Gjirokastrë, Lezhë, Kukës, Korçë, Fier, Kavajë dhe Komisaratin e Policisë Nr.5 Tiranë. Megjithatë edhe në këto dhoma ka rezultuar mungesë e orendive të nevojshme si tavolina, karrige apo stola për qëndrimin ulur të shtetasve të shoqëruar.

Vitin e kaluar në raportin vjetor përmendëm fillimin e punimeve për ndërtimin e dhomave të shoqërimit të shtetasve sipas standarteve në Drejtorinë dhe Komisaratin e Policisë Gjirokastrë. Nga inspektimet e kryera për vitin 2011 në Komisaratin e Policisë Gjirokastrë rezultoi se dhomat e shoqërimit vërtet ishin përshtatur sipas kërkesave të përcaktuara në ligj, por

nuk kishte gjetur zbatim rekomandimi i bërë nga ana jonë (Rekomandim Nr.201100759, datë 04.07.2011), për spostimin nga këto ambiente të Dhomës së Gjurmimit Teknik dhe Dhomës së Paraqitjes për Njohje, me qëllim mos kompromentimin e pozitës së të shoqëruarit.

Në Komisariatin e Policisë Kavajë dhomat e shoqërimit ishin ndërtuar brenda standarteve dhe kërkesave të ligjit, por përsëri nuk ishin kompletuar me orenditë e nevojshme për qëndrim.

Në gjithë organet e tjera të policisë në vend dhomat për të shoqëruar, në fakt si nga përmasat, ndriçimi natyral, higjena ashtu edhe nga konceptimi dhe trajtimi i personave të shoqëruar, janë dhoma izolimi, sepse janë të ftohta, me dyer hekuri, të mbyllura me dryna dhe pa ndriçim nga rrjeti si p.sh Komisaritet e Policisë Sarandë, Pukë, Durrës, Tepelenë, Peshkopi, Përmet, Pogradec etj. Në disa komisariate si Përmet, Krujë, Librazhd, Elbasan, Pogradec dhe Mallakastër dhomat e shoqërimit janë jashtë ndërtesës së komisaritatit, në ndërtesa një katëshe, me soletë të cilat janë të ftohta në dimër dhe të nxehta në verë dhe për pasojë e bëjnë të pamundur qëndrimin e të shoqëruarve. Këto ambiente janë me lagështi, të pa lyera, pa ndriçim natyral, pa ndriçim nga rrjeti, pa stola, pa tavolina dhe pa tualet. Nga biseda me punonjësit e policisë kemi mësuar se në periudhë dimri të shoqëruarit i lënë nëpër korridore pasi është e pa mundur që ata të qëndrojnë në ambientet e shoqërimit.

Kjo tregon se sa pak vlerësohet nga Strukturat e Policisë së Shtetit, mbrojtja e të drejtave të shtetasve në këto ambiente.

Gjatë inspektimeve në të gjitha Komisaritet e Policisë është konstatuar se në plan-vendosjen e shërbimeve të policisë së rendit, i miratuar nga drejtuesit e këtyre komisariateve, punonjësit e policisë që kanë për detyrë, mbikëqyrjen e të shoqëruarve, ndaluarve apo arrestuarve nuk janë në gjendje për ta kryer këtë detyrë, pasi janë të ngarkuar me shumë detyra të tjera. Sipas plan-vendosjes, shërbimi në këtë vend është i organizuar 24 orë nga ora 07.00 deri 07.00 të ditës pasardhëse. Kjo ngarkesë e punonjësit të policisë së rendit, e bën të pamundur mbajtjen e të shoqëruarve, ndaluarve dhe arrestuarve nën mbikëqyrje me qëllim parandalimin e veprimeve që mund të rrezikojnë jetën e tyre, siç edhe ka ndodhur në disa komisariate policie (ku persona të shoqëruar janë vetëvarur), si dhe nuk përmbushin detyrimin ligjor për respektimin e të drejtave të të shoqëruarve, ndaluarve dhe arrestuarve sipas parametrave të përcaktuar në ligj.

Nga moria e detyrave që ka ky vend shërbimi, si dhe nga koha e gjatë e punës prej 24 orë pa ndërprerje që kryen punonjësi i policisë i dislokuar në këtë vend, arrihet në konkluzionin kategorik se, përpiluesit e plan-vendosjes

së shërbimeve të policisë së rendit, e kanë bërë atë në mënyrë formale, të pa studjuar mirë dhe të pa mbështetur në baza e mundësi reale. Është e pamundur fizikisht dhe psikologjikisht, që një punonjës policie t'i kryejë mirë të gjitha detyrat e ngarkuara sipas këtij plani, edhe në qoftë se shërbimi do të ishte i organizuar vetëm për 8 orë pune dhe jo më për 24 orë sikurse dhe bëhej në fakt. Mos verifikimi i bazueshmërisë dhe objektivitetit të planvendosjeve të shërbimeve të policisë së rendit, tregon mungesë kontrolli nga strukturat e Drejtorive të Policisë së Qarqeve dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit, ndaj organeve vendore të policisë lidhur me zbatimin e detyrave, të përcaktuara në ligj, në Letër – Porosi, Manual, Urdhëra, Udhëzime, Rekomandime e akte të tjera nënligjore.

Në disa komisariate dyert dhe dritaret janë prej zgare hekuri. Rreziku për jetën e të shoqëruarve është akoma më i madh pasi në to krijohen premisa për vetëvarje të të shoqëruarve siç edhe ka ndodhur në Komisarariatet e Policisë Durrës dhe Lezhë.

Pas çdo inspektimi të bërë në dhomat e shoqërimit janë hartuar rekomandime në lidhje me problemet e konstatuara duke kërkuar ndërtimin apo rikonstruksionin e tyre, sipas konceptimit të bërë në ligjin nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”.

Institucioni i Avokatit të Popullit vëren se, megjithë interesimin e Ministrisë së Brendshme, për këtë shërbim ka mangësi të cilat lidhen kryesisht me fondet që duhen lëvruar nga vetë Ministria e Brendshme.

Nga ballafaqimi i praktikave të punës së policisë me librat e shoqërimit të shtetasve, rezulton që, në shumë raste, janë shoqëruar në polici, persona jashtë kriterëve ligjore të përcaktuara në nenet 11/6, 101/1/ “a” dhe “b” dhe 106 të ligjit nr. 9749, dt. 04.06.2007, “Për Policinë e Shtetit”.

Kategoritë e personave të shoqëruar në mënyrë të paligjshme janë si më poshtë:

1. Trajtohen si të shoqëruar personat që kanë kryer apo dyshohen se kanë kryer vepra penale si, vrasje, vjedhje, kundërshtim të punonjësve të policisë, rrahje, prishje të rendit dhe qetësisë publike, dhunë në familje etj. Kjo praktikë është vërejtur kryesisht në Komisarariatet e Policisë Nr.6 Tiranë, Tepelenë, Sarandë, Vlorë, Pogradec, Lezhë dhe Berat. Në këto raste policia duhet të veprojë sipas dispozitave ligjore parashikuar në nenin 253 të K.Pr.Penale.

2. Trajtohen si të shoqëruar personat për shkak të një konflikti, veprim i cili nuk është i parashikuar në ligjin “Për Policinë e Shtetit”. Këto janë rastet që dominojnë pothuajse në të gjitha Komisarariatet e Policisë në vend. Por meqenëse qëllimi i shoqërimit nga policia në këtë rast është i mirë,

sepse parandalon ndodhjen e ndonjë krimi të mundshëm ndërmjet të konfliktuarve, atëherë e ritheksojmë që ky rast duhet të rregullohet në ligj dhe jo të bëhet shoqërimi i tyre në organin e policisë (Komisariatet e Policisë Fier, Vlorë, Krujë, Shkodër si dhe Komisariatet e Policisë 5 dhe 6 Tiranë).

3. Trajtohen si të shoqëruar personat për të cilët lind nevoja për të marrë prej tyre informacion për parandalimin e një rreziku, për të identifikuar persona që mund të kenë dijeni për rrezikun apo incidentin dhe për të identifikuar shkelësit e mundshëm të ligjit. Në këto raste nga ana e punonjësve të policisë duhet aplikuar e drejta ligjore për “njoftim për paraqitje në polici”, e parashikuar në nenin 100 të ligjit “*Për Policinë e Shtetit*” dhe jo të bëhet shoqërimi i tyre në organin e policisë. (Komisariatet e Policisë Peshkopi, Vlorë, Durrës Shkodër si dhe Komisariatet e Policisë 1, 2, 3 dhe 4 Tiranë).

4. Trajtohen si të shoqëruar personat që tregojnë rrethana të dobishme për hetimin. Në këto raste nga ana e punonjësve të policisë duhet aplikuar e drejta ligjore e parashikuar në nenin 312 i K.Pr.Penale, duke i thirrur ata me urdhër apo fletë thirrje dhe paralajmëruar për shoqërim të detyrueshëm në rast mosparaqitje, pa patur pengesë të ligjshme (Komisariati i Policisë Vlorë Pogradec, Korçë dhe Tepelenë).

5. Trajtohen si të shoqëruar personat e kapur në kushtet e flagrancës, kur dihet se ndaj autorit të veprës penale që kapet gjatë kryerjes së veprës penale apo menjëherë pas kryerjes së saj, duhet të bëhet arrestimi i tij konform dispozitave ligjore parashikuar në nenin 251 të K.Pr.Penale dhe pa e mbajtur atë në gjëndje shoqërimi 10 orë (Komisariatet e Policisë Shkodër, Tepelenë, Sarandë dhe Komisariatet e Policisë 1, 2, 4, 6 Tiranë).

6. Konstatohet se trajtohen si të shoqëruar edhe personat në kërkim. Vlen të theksohet se, për këtë kategori personash, ndaj të cilëve është nxjerrë urdhër ekzekutimi i një vendimi penal, si dhe në rastet kur një person ka kryer më parë (është fjala kur nuk jemi në kushtet e flagrancës) apo dyshohet si autor i mundshëm i një vepre penale, ai duhet të ndalohe sipas dispozitave ligjore, parashikuar në nenin 464 të K.Pr.Penale. Kjo dukuri ndodh pothuajse në të gjitha Strukturat e Policisë në vend.

7. Pjesa më e madhe e të shoqëruarve është në rastet, kur arsyeja e shoqërimit në organin e policisë është “*për verifikim*”. Arsyeja e shoqërimit është e përgjithshme dhe ka nevojë që të specifikohet konkretisht se për çfarë verifikohet. Nga verifikimet e bëra në librat e shoqërimit dhe pyetja e punonjësve të policisë, ka rezultuar se, arsyeja e shoqërimit shënohet “*për verifikim*” edhe kur në fakt personi shoqërohet për rastet e përmendura më lart.

Personat e arrestuar dhe të ndaluar nuk duhen regjistruar në librin e shoqërimit, sikurse ndodh shpesh herë, por në librin e personave të arrestuar dhe të ndaluar.

Librat e shoqërimit, ndalimit dhe arrestimit të shtetasve nuk janë të modeluar sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, pasi ka mungesë të disa rubrikave siç është ajo e njoftimit të familjarëve.

Rubrikat e librave të shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të shtetasve në polici plotësohen pa shumë përgjegjësi. Në to nuk pasqyrohet saktë shkaku ligjor i shoqërimit, personi që ka urdhëruar shoqërimin, adresa e saktë e të shoqëruarit etj.

Ka raste që shtetasit e shoqëruar nuk regjistrohen fare në librin e shoqërimit të shtetasve.

Edhe në rastet kur rubrika e njoftimit të familjarëve është e hapur, përsëri nuk plotësohet saktë, pasi shkruhet “u njoftua familja” dhe nuk hidhen të plota të dhënat e personit që mori njoftim. Njoftimi i familjarëve të të shoqëruarit për shoqërimin e tij në polici dhe arsyet ligjore, përbën detyrim ligjor për punonjësit e policisë, i cili është parashikuar në nenin 107 të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Punonjësit e policisë pretendonin se bëhej njoftimi i familjarëve, mirëpo fakti që nuk pasqyrohet në libër ky veprim, lë vend për dyshime.

Në dinamikën e punës të Policisë së Shtetit konstatohet se të shoqëruarve, në të gjitha organet e policisë ju bëhet kontrolli personal dhe ju hiqen e bllokohen sendet personale. Ky veprim vjen në kundërshtim me nenin 106, pika 3 të ligjit nr.9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” në të cilin është parashikuar se: “Punonjësi i policisë bën kontrollin dhe këqyrjen fizike, me qëllim marrjen e masave mbrojtëse ndaj personave të sëmurë mendorë, të dehurve, të droguarve ose ndaj personave me sëmundje ngjitëse”.

Ndërsa lidhur me bllokimin e sendeve personale në nenin 108 të ligjit “Për Policinë e Shtetit” është përcaktuar se: “Sendet mund të bllokohen vetëm në se është krejtësisht i pashmangshëm evitimi i kërcënimit të çastit ndaj rendit dhe sigurisë publike”.

Vërehen raste kur shtetasve të shoqëruar ju hiqen dhe bllokohen sendet personale dhe nga punonjësit e policisë nuk mbahet e nuk i jepet poseduesve procesverbali përkatës. Ky veprim vjen në kundërshtim me nenin 108, paragrafi i dytë të ligjit nr.9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” ku thuhet se “Punonjësi i Policisë që vepron, harton procesverbalin e caktuar, i cili i jepet poseduesit për tu njohur me të”, nenin 37/3 të

Kushtetutës, ku thuhet se: *“Askujt nuk mund t’i bëhet kontroll vetjak jashtë procesit penal, me përjashtim të rasteve të hyrjes në territorin e shtetit dhe të daljes prej tij ose për të mënjeluar një rrezik që i kanoset sigurimit publik”*, nenin 202 e vijues të K.Pr.Penale ku parashikohet se: *“Kur ka arsye të bazuara për të menduar se dikush fsheh në personin e tij prova materiale të veprës penale ose sende që i përkasin veprës penale, gjykata merr vendim për kontrollin personal...”*. Në rast flagrance ose në rast ndjekje të personit që është duke ikur dhe që nuk lejojnë nxjerrjen e një vendimi kontrolli, oficerët e policisë gjyqësore kryejnë kontrollin e personit ose të vendit, duke zbatuar rregullat e caktuara në nenin 299 të K.Pr.Penale.

Në praktikat e punës së policisë konstatohet se të gjithë të shoqëruarve ju merren gjurmët daktiloskopike (të gishtave). Punonjësit e Policisë justifikohen me faktin se marrja e gjurmëve përdoret si mjet identifikimi duke u bazuar në nenin 103, pika 5 e Ligjit Nr.9749 dt.04.06.2007 *“Për Policinë Shtetit”*. Ky qëndrim është i pa bazë pasi të gjithë personat që ju merren gjurmët e gishtave lihen të lirë përpara se të vijë përgjigjja nga Instituti Shkencor i Kriminalistikës. Kjo tregon se marrja e gjurmëve të gishtave nuk përdoret si mjet identifikimi, por për t’i përdorur ato si model krahasimi me gjurmët e mbetura në ngjarje të pa zbuluara. Këto veprime vijnë në kundërshtim me nenin 3 dhe 16 të ligjit nr. 9887, dt. 10.03.2008 *“Për mbrojtjen e të dhënave personale”*.

Në disa komisariate vërehet se në ambientet e shoqërimit ku mbahen shtetasit e shoqëruar nuk ka postera me të drejtat ligjore të të shoqëruarve.

Shkeljet e të drejtave ligjore të shtetasve të shoqëruar, ndaluar dhe arrestuar nga policia, vijnë për faktin se nga punonjësit e policisë të rolit bazë ka mungesë të njohurive në zbatim të ligjit nr.9749, dt.04.06.2007 *“Për Policinë e Shtetit”*, të veprimtarisë së institucioneve të pavarura në mbrojtje të të drejtave të njeriut, ligjit për Avokatin e Popullit në rolin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, Protokollit Opsional të Konventës Kundër Torturës dhe Ndëshkimeve të tjera Çnjerëzore dhe Degraduese (OPCAT) si dhe të Konventës Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut.

Ky nivel njohurish ka demonstruar në situata të caktuara një performancë të dobët të efektivave të Policisë së Shtetit, të rolit bazë. Madje në disa raste përgatitja e ulët në këtë aspekt ka qenë burimi kryesor i ngjarjeve dhe shkeljeve të rënda, nga të cilat punonjës të veçantë të Policisë së Shtetit janë ndëshkuar me masa disiplinore ose janë dërguar për ndjekje penale.

Avokati i Popullit gjykon se, parandalimi i rasteve të mësipërme është një detyrë që ngarkon me përgjegjësi një sërë organesh të administratës

shtetërore dhe të Policisë së Shtetit, ku një vend të veçantë luajnë kryesisht institucionet e formimit arsimor dhe trajnues të efektivave të policisë.

Nga vizita dhe kontaktet e zhvilluara me drejtues të Qendrës së Formimit Policor Saur Tiranë, Avokati i Popullit ka vërejtur se, pavarësisht përpjekjeve të mëparëshme nxitur edhe nga ndërhyrjet tona, programet arsimore dhe trajnuese ndaj kategorive të veçanta të punonjësve të Policisë së Shtetit, mbeten shumë të varfra me njohuri mbi të drejtat e njeriut, institucionet që i mbrojnë ato dhe me kuadrin ligjor kombëtar dhe ndërkombëtar në këtë fushë.

Një konstatim i tillë është shprehur në takime të veçanta edhe nga vetë pedagogët e Qendrës së Formimit Policor Tiranë, të cilët kërkojnë si nevojë thelbësore të formimit të gjithanshëm policor pasurimin e kurrikulave akademike me tema mbi të drejtat e njeriut.

Në këtë kuadër, duke e konsideruar shumë të rëndësishme nismën për rishikimin e kurrikulave akademike policore me qëllim pasurimin e tyre me njohuri të plota mbi të drejtat e njeriut, Avokati i Popullit shpreh gadishmërinë për të ofruar të gjithë asistencën e nevojshme nëpërmjet ekspertëve të tij në këtë fushë, duke ofruar referenca dhe njohuri të hollësishme mbi të drejtat e njeriut për një formim policor bashkëkohor.

Për problemet e konstatuara Institucioni i Avokatit të Popullit i ka rekomanduar gjithë strukturave të Policisë së Shtetit zgjidhjen e tyre të menjëhershme. Sa më sipër i është rekomanduar edhe Qendrës së Formimit Policor për të bashkëpunuar me qëllim promovimin e të drejtave të njeriut edhe në këtë Qendër Formimi.

Lidhur me ambientet e sigurisë, ku mbahen personat e ndaluar dhe arrestuar është konstatuar se:

Gjatë vitit 2011 janë inspektuar dhomat e sigurisë në të gjitha Drejtoritë dhe Komisarariatet e Policisë në vend. Pas inspektimeve të bëra rezultoi se, vetëm në Komisariatin e Policisë Korçë, Gjirokastër, Fier, Lezhë, Kukës, Kavajë dhe Komisariatin e Policisë Nr.5 Tiranë dhomat e sigurisë ishin të ndërtuara sipas kërkesave të Ligjit Nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Manualin “Për Rregullat e Trajtimit e Sigurimin e të Ndaluarve dhe Arrestuarve në Dhomat e Sigurisë në Njësitë Policore”, pasi ishin të ndara më vete, për meshkuj, femra dhe të mitur. Në të gjitha dhomat dhe në korridor kishte të vendosur postera për të drejtat e personave të ndaluar dhe arrestuar. Dhomat plotësonin normat dhe parametrat teknikë jetësorë, për një person të arrestuar apo ndaluar, pasi sipërfaqja e përgjithshme ishte 10 metër katror, e ndarë në ambient qëndrimi (dhomë) me sipërfaqe 6 m² dhe paradhomë me sipërfaqe 4 m². Ishin vendosur pajisjet dhe orënditë e nevojshme për jetesë si krevat, tavolinë, stola etj. Në dhomë

kishte pajisje audiovizive (kamera) për survejimin e mbajtjen në kontroll të personit të arrestuar apo të ndaluar.

Personave të arrestuar apo ndaluar ju ofrohej mundësia të lexonin shtypin e ditës, i cili sigurohej me shpenzimet e veta. Kishin akses për larje e pastrim të vazhdueshëm si dhe u lejohej të mbanin letër dhe laps për të shkruar, pastë e furçë dhëmbësh, pastë rroje tubet dhe brisqe rroje të plastifikuar. Kishte mundësi të korrespondecës me telefon, letër etj. Gjithashtu ata merrnin nga Komisariati i Policisë sapun, detergjente, letra higjienike, letra për fshirjen e duarve ose peshqir e mjete të tjera për ruajtjen e higjienës e pastërtisë vetjake e të ambientit ku qëndronin, sipas normave e rregullave për këtë qëllim. Dritaret e dhomave mundësonin qarkullimin mjaftueshm të ajrit.

Theksojmë se dhomat e sigurisë dhe pse ishin ndërtuar sipas kërkesave të përcaktuara në ligj, përsëri kishin mangësi pasi brenda tyre nuk kishte ambient ajrimi më vete, për rrjedhojë personat e ndaluar dhe arrestuar nuk dilnin në ajrim sipas kërkesave të ligjit (jo më pak se dy orë në ditë). Dhomat nuk kishin ambient të posaçëm për ushtrimin e rriteve fetare apo aktivitete të tjera. Brenda dhomave të sigurisë kishte shumë elementë teknikë të cilët nuk ishin ndërtuar apo montuar sipas parametrave të përcaktuara në Manual.

Të arrestuarit dhe të ndaluarit trajtohen me ushqim tre herë në ditë sipas normave për trajtimin me ushqim të përcaktuar në urdhërin e përbashkët Nr.432, datë 10.03.2008 të Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Shëndetësisë. Ushqimi përgatitej me nënkontraktor dhe servirej brenda gjithë parametrave të përcaktuar në ligj.

Për të ndaluarit dhe të arrestuarit që ishin bartës të sëmundjeve ngjitëse, kishte ambient më vete të ndarë dhe i izoluar nga të tjerët.

Në të gjitha Drejtoritë dhe Komisariatet e tjera të Policisë ku është përcaktuar se duhet të kenë dhoma sigurie, në pjesën më të madhe të tyre, dhomat janë të trashëguara nga ish-dhomat e Paraburgimit të para viteve 90-të dhe kanë mbetur po në atë gjendje, të pa lyera, pa ndriçim nga rrjeti, pa dushe për tu larë, pa krevat, pa dyshek, pa çarçaf si dhe pa orenditë e nevojshme për të jetuar si: karrige, stola apo tavolinë. Kjo gjendje i bënte ato të papërshtatshme për banim duke mos ju ofruar atyre kushtet minimale jetike, për ushqim, higjenë, kubaturë, trajtim të diferencuar për të mitur, femra dhe të sëmurë etj.

Në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë edhe pse numri i të ndaluarve dhe të arrestuarve është më i madh, vazhdon të ketë vetëm një dhomë sigurie për femra dhe një dhomë për të mitur ndërsa për të rritur nuk ka.

Mbetet shqetësuese situata në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Berat pasi nuk ka asnjë dhomë sigurie. Të gjithë personat e ndaluar dhe arrestuar dërgohen (sigurohen) në Komisaratin e Policisë Lushnjë, edhe pse ky i fundit nuk ka kushte dhe kapacitet për të përballuar një fluks të tillë.

Në disa Komisariate Policie ambientet e sigurisë janë të trashëguara me arkitekturë me dhoma nëntokë dhe për pasojë kanë probleme të lagështisë dhe amortizimit të tyre në tërësi si p.sh: në Komisaratin e Policisë Lushnjë.

Nuk kemi konstatuar raste që të arrestuarit e mitur të mbahen së bashku me të arrestuarit madhorë.

Në Komisaritet e Policisë Pogradec, Elbasan, Shkodër, Sarandë, Tropojë, Pukë dhe Kukës mungojnë posterat për të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia.

Në të gjitha inspektimet që janë konstatuar probleme, Institucioni i Avokatit të Popullit ka paraqitur rekomandime duke kërkuar zgjidhjen e problematikave që ekzistojnë në veprimtarinë që kryen Policia e Shtetit gjatë mbajtjes së qytetarëve në dhomat e sigurisë.

Avokati i Popullit vëren se, megjithëse rekomandimet e tij janë mirëpritur nga drejtuesit e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme përsëri ato nuk janë realizuar me pretendimin se ka mangësi fondesh.

Lidhur me mënyrën e trajtimit të shtetasve të ndaluar dhe arrestuar:

Avokati i Popullit në veprimtarinë e tij ndjek me prioritet ankesat e shtetasve që pretendojnë për ushtrim të dhunës fizike nga punonjës të Policisë së Shtetit në ambientet e sigurisë dhe hetimit. Gjatë këtij viti është konstatuar se ka patur raste të ushtrimit të dhunës fizike dhe psikologjike nga punonjës të Policisë së Shtetit, për të cilat është rekomanduar fillimi i procedimit penal, për punonjësit e policisë që i kanë bërë këto shkelje.

Avokati i Popullit nënvizon rëndësinë se, trajtimi i shtetasve në këto ambiente, duhet të bëhet në përputhje të plotë me kërkesat dhe standardet e përcaktuara në Kushtetutë, Aktet Ndërkombëtare për të Drejtat e Njeriut, K.Pr.Penale, si dhe në zbatim të të gjitha akteve të tjera ligjore e nënligjore ndaj individëve që ju është privuar liria. Në aktet e mësipërme parashikohet se përdorimi i torturës, dhunës, trajtimit degradues, diskriminues, jo human apo çnjerëzor, përfshirë edhe dhunën verbale si kërcënime, fyerje e cila krijon përshtypjen dhe imazhin e frikës, pasigurisë për jetën e shëndetin e të shoqëruarve, ndaluarve dhe arrestuarve apo dhe të familjarëve të tyre, janë veprime të dënueshme dhe duhen të parandalohen nga çdo institucion i administratës publike. Ky ndalim vlen për tu marrë në konsideratë për

zbatim edhe në ambientet e Policisë së Shtetit ku mbahen persona të izoluar apo ndaj të cilëve zhvillohen seanca hetimore.

Në praktikën e deritanishme rezulton se, në një numër të konsiderueshëm të rasteve është bërë i pamundur dokumentimi ligjor i ngjarjeve të tilla, për faktin se i shoqëruari, ndaluar apo i arrestuari qëndron në ambiente sigurie të policisë të pa monitoruara me kamera.

Avokati i Popullit e ka konsideruar procesin e monitorimit filmik të ambienteve të shoqërimit, të sigurisë dhe hetimit, si masë parësore për parandalimin e rasteve të torturës. Për rrjedhojë, procesi i mbikqyrjes së këtyre ambienteve me anë të kamerave është një veprim i domosdoshëm për katër arsye kryesore:

Së pari, mbikqyrja me kamera ka një efekt parandalues për kryerjen e veprave të dhunshme dhe të dënueshme, si nga ana e të shoqëruarve, ndaluarve e arrestuarve, ashtu dhe nga vetë punonjësit e policisë së shtetit;

Së dyti, mbikqyrja me kamera dokumenton shumicën e ngjarjeve brenda ambienteve të shoqërimit e të sigurisë në organet e policisë dhe jep garanci për një gjykim objektiv dhe të paanshëm mbi masat disiplinore apo penale që duhet të merren ndaj personave përgjegjës;

Së treti, dokumentimi filmik është një element mbi të cilin mund të konsultohen mjaft të dhëna apo pretendime për trajtimin e të dënuarve dhe mund të nxirren përfundime të vlefshme dhe objektive në rekomandimet apo raportet përkatëse të institucioneve monitoruese të pavarura;

Së katërti, monitorimi filmik gjatë marrjes në pyetje të të ndaluarve dhe arrestuarve përben një avantazh për të shmangur pretendime të personave për marrjen me dhunë të dëshmive dhe deklaratave, të cilat vënë në dyshim profesionalizmin e policisë dhe të të gjithë procesit hetimor.

Në këtë aspekt, Avokati i Popullit duke përshëndetur nismën e fundit të Policisë së Shtetit për vendosjen e kamerave monitoruese në ambientet publike, shtron si nevojë imediate instalimin e tyre brenda Institucioneve të Policisë së Shtetit, duke e parë të lidhur ngushtë këtë proces me parandalimin e rasteve të dhunës, dokumentimit e saj, si dhe evitimin e akuzave të pabazuara ndaj punonjësve të Policisë së Shtetit.

2. Konstatohet se në shumicën e Komisariateve të Policisë nuk respektohen kriteret ligjore të përcaktuara në ligjin nr.9749, dt. 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe Kodin e Proçedurës Penale për ndalimin dhe arrestimin, pasi trajtohen si të shoqëruar edhe personat që kanë kryer apo dyshohen se kanë kryer vepra penale. Vetëm në Komisariatit e Policisë Nr.1 Tiranë, për një periudhë 2 mujore ishin ndaluar dhe arrestuar 16 shtetas të dyshuar si autor të veprave penale. Këta shtetas ishin trajtuar fillimisht si të

shoqëruar mbi 5 orë secili (gjithsej 85 orë privim lirie i paligjshëm) dhe më pas janë kryer veprimet procedurale të arrestimit apo ndalimit të tyre.

Duke vendosur në proçesverbalet e arrestimit dhe të ndalimit orën e përpilimit të procesverbaleve të arrestimit apo ndalimit dhe jo orën faktike, kur ju është privuar liria në fakt, atyre nuk ju llogaritet në kohën e paraburgimit dhe më pas edhe atë të vuajtjes së dënimit, koha e qëndrimit si të shoqëruar, gjatë së cilës policia bën verifikime apo veprimet e ndryshme procedurale, kohë e cila mund të shkojë deri në 10 orë. Në bazë të neneve 144, 250 të K.Pr.Penale, shënimi në procesverbal i çastit (orës) së arrestimit në flagrancë ose të ndalimit është një element i rëndësishëm mbi bazën e të cilit fillojnë të llogariten efektet e paraburgimit. Ndërsa në bazë të nenit 258 të K.Pr.Penale, nga çasti (ora) e arrestimit ose ndalimit fillon afati i 48-të orëve, brenda të cilës prokurori kërkon vleftësimin e masës së sigurimit në gjykatën e vendit ku është kryer arrestimi ose ndalimi.

Mbajtjen në këtë gjendje punonjësit e policisë e justifikojnë me mendësinë se, *“në qoftë se do t’i arrestojnë personat që në momentin e parë, atëherë nuk mund të kryejnë asnjë veprim procedural për të provuar veprën e kryer”*. Ky qëndrim dhe justifikim nuk ka mbështetje ligjore, përkundrazi bëhet në kundërshtim me dispozitat e K.Pr.Penale. Sipas neneve 30 dhe 294 të K.Pr.Penale, *policia gjyqësore*, atributet e të cilës i kanë edhe punonjësit e Policisë së Shtetit, *“edhe pas referimit të veprës penale te prokurori, ka të drejtë të kryejë me inisiativën e vet funksionet e tij ligjore si, të pengojë ardhjen e pasojave të mëtejshme të veprës penale, të kërkojë autorët e tyre, të kryejë hetime dhe të grumbullojë gjithçka që i shërben zbatimit të ligjit penal”*.

Ky fenomen vazhdon të ekzistojë edhe pse për eliminim e tij është rekomanduar nga ana jonë gjatë viti 2009 dhe Drejtori i Përgjithshëm i Policisë së Shtetit nxori Letër-Porosinë Nr.1328, dt. 23.11.2009 *“Për respektimin dhe garantimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese e ligjore të personave gjatë veprimtarisë së Policisë së Shtetit”*. Në pikën 2 të saj parashikohet që, personat e dyshuar si autorë të veprave penale dhe ata të dënuar me vendim të formës së prerë me burgim në mungesë, të mos trajtohen e mbahen si të shoqëruar, por ndaj tyre të aplikohet menjëherë masa e arrestit në flagrancë apo e ndalimit.

3. Në dhomat e sigurimit vazhdonin të qëndronin persona të paraburgosur ndaj të cilëve ishte caktuar masa e sigurimit *“arrest në burg”*, si dhe persona të ndaluar për ekzekutimin e vendimeve penale me burgim të formës së prerë, të dhënë në mungesë dhe nuk ishin dërguar në institucionet e paraburgimit dhe ato të burgimit në varësi të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve për shkak të pengesave që krijonte vazhdimisht kjo e fundit. Koha

e qëndrimit të tyre në ambientet e policisë pas caktimit të masave të sigurimit varionte nga 1 deri 8 ditë.

4. Vërehet se gjatë këtij viti janë konstatuar raste që për të arrestuarit e mitur të mos jetë siguruar mbrojtja e detyrueshme me avokat, si dhe ndihma (asistenca) psikologjike, siç parashikohet në nenet 35 e 49 të K.Pr.Penale.

Punonjësit e policisë e justifikojnë mungesën e psikologut me arsyetimin se ky funksion nuk është i përfshirë në organikën e Komisariateve, por vetëm në atë të Drejtorive të Policisë së Qarqeve. Në disa raste, distanca e madhe mes komisariateve dhe Drejtorive të Policisë së Qarqeve e bëjnë të pamundur praninë e tij. Gjithashtu konstatohet se ka Drejtori Policie që këtë funksion nuk e kanë të plotësuar, sepse nuk ka kërkesë për tu punësuar në këtë vend pune. Avokati i Popullit i ka rekomanduar Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit për të marrë të gjitha masat, për prezencën e psikologut dhe të avokatit në çdo rast, pasi të gjitha veprimet që kryhen pa prezencën e tyre vijnë në kundërshtim me kërkesat e K.Pr.Penale të parashikuara në nenet 35, 37, 48 dhe 296/1.

5. Të ndaluarve dhe arrestuarve në polici, ju bëhet detyrimisht kontroll mjekësor lidhur me sëmundjet që ata mund të kenë, aq më tepër kur bëhet fjalë për sëmundje ngjitëse, të cilat përbëjnë rrezik dhe mund të përhapet edhe te personat që janë në të njëjtën dhomë me të infektuarin. Ata vizitohen nga mjeku brenda 24 orëve të para të ndalimit apo arrestimit.

6. Në të gjitha organet e policisë mungojnë formularë në gjuhë të huaj për të drejtat e personave të shoqëruar, të ndaluar apo arrestuar kur këta janë shtetas të huaj.

7. Ekspozimi i posterave për të drejtat e personave të shoqëruar, ndaluar apo arrestuar nga policia është konstatuar në pjesën më madhe të Drejtorive dhe Komisariateve të Policisë në vend.

8. Në disa Komisariate Policie nuk ka libra për të ndaluarit dhe të arrestuarit, sepse ata, siç e kemi thënë edhe më sipër, regjistrohen fillimisht në librat e shoqërimit pasi fillimisht trajtohen si të tillë.

Për gjithë problematikat e konstatuara gjatë këtij viti, Avokati i Popullit në funksion dhe të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, i ka bërë disa rekomandime Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit dhe Ministrisë së Brendshme, respektimi i të cilëve do të sillte parandalimin e torturës, keqtrajtimit, shkeljeve të ligjit nga punonjësit e Policisë së Shtetit si dhe plotësimin e standarteve në ambientet e shoqërimit dhe të sigurisë ku qëndrojnë shtetasit që ju privohet liria.

Problematika e mësipërme prezantohet nepërmjet rasteve dhe rekomandimeve të dhena me poshte:

Në ankesën e shqyrtuar me numër **201100472 Doc.** rezultonte se në datën 25.03.2011 ishte bërë e mundur kapja e personit në kërkim R. H. nga fshati Resulaj, Selenicë Vlorë. Veprimet e policisë të Sektorit të Operacioneve Speciale në Drejtorinë e Policisë Qarkut Vlorë dhe Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë Fier, gjatë kryerjes së operacionit për kapjen e këtij shtetasi ishin të paligjshme sepse, nuk kishin ekzistuar kushtet e përcaktuara në nenin 118 të Ligjit *“Për Policinë e Shtetit”*, në të cilin thuhet se: *“Punonjësi i Policisë përdor forcën për të përmbushur një synim të ligjshëm vetëm kur kjo është e nevojshme dhe vetëm nëse të gjitha masat e tjera janë të pasuksesshme apo të pa mundura.....punonjësi i policisë përzgjedh nivelin e nevojshëm të forcës ndër të cilat është dhe bindja me fjalësi dhe punonjësi i policisë duhet të paralajmërojë se do të përdori forcë para përdorimit të saj”*.

Pretendimet e policisë se, forca është përdorur në kushtet kur shtetasi R. H. kishte qëlluar me armë zjarri (automatik model 56), në drejtim të forcave të policisë me qëllim arratisjen e tij, rezultonin jo të bazuara, pasi në bazë të akteve të ekspertimit tekniko-balistik, tekniko-kimik dhe tekniko-vlerësues, nuk rezultonte që ky shtetas të kishte bërë qitje si dhe nuk ishin treguar detaje, të qitjes, pozicioni i tyre, etj. Rrëzimi poshtë i pretendimit të policisë se R. H. kishte qëlluar me armë, hidhte dyshimin edhe mbi vërtetësinë e faktit nëse ky person kishte pasur ose jo armë në momentin e kapjes së tij.

Në aktin e ekspertimit mjeko-ligjor Nr.627, datë 03.05.2011, të Institutit të Mjekësisë Ligjore Tiranë, ishte arritur në përfundimin se, në trupin e shtetasit R. H. konstatoheshin ekimoza në të dy sytë dhe dërmishje në ekstremitetet e poshtme. Këto dëmtime ishin shkaktuar me mjete të forta mbrehtëse. Dëmtimet e mësipërme hynin në kategorinë e atyre dëmtimeve që kanë shkaktuar humbjen e aftësisë së përkohshme për punë në masën deri në 9 (nëntë) ditë.

Kapja dhe shoqërimi në Komisariatin e Policisë Vlorë nën efektin e dhunës fizike si dhe aplikimi i metodave të presionit psikologjik gjatë shoqërimit duke e kërcënuar me jetë ankuesin R.H., përmbushnin plotësisht elementët e veprës penale të *“Torturës”*, parashikuar nga neni 86, gërma “ç” dhe “d” të K.Penal.

Për sa më sipër, bazuar në nenin 63/3 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë dhe nenin 21 germa “ç” të ligjit nr. 8454 datë 04.02.1999 *“Për Avokatin e Popullit”*, i ndryshuar, i rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, fillimin e hetimit të procedimit penal për veprat penale të

“Torturës”, parashikuar në nenin 86 të Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të Policisë të Sektorit të Operacioneve Speciale në Drejtorinë e Policisë Qarkut Vlorë dhe Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë Fier. Rekomandimi është pranuar dhe çështja është nën hetim.

Rasti i filluar me iniciativë pas bërjes publike në media, të regjistruar me nr. dok **201100653**, që bën fjalë për trajtimin çnjerëzor të dy shtetasve nga punonjësit e policisë të Forcave Speciale. Për shkak të dëmtimeve të rënda ata ishin shtruar në Spitalin Ushtarak. Nga hetimi i këtij rasti rezultoi se, në datën 19.05.2011, në Bulevardin “Zogu i Parë” Tiranë, në afërsi të Ministrisë së Drejtësisë, të dëmtuarit janë ndaluar nga rreth 30 policë të Repartit RENE A, të cilët kishin ushtruar, dhunë ndaj tyre duke i goditur në kokë, në fytyrë dhe në pjesë të ndryshme të trupit. Për shkak të goditjeve të shumta dhe të forta, ata kanë humbur ndjenjat. Më pas ankuesit janë shoqëruar në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë. Meqenëse gjendja e tyre shëndetësore ishte e rëndë, ata janë dërguar në Spitalin Ushtarak Tiranë për ekzaminim dhe ndihmë mjekësore. Për shkak të gjendjes së rëndë shëndetësore, ishin shtruar të dy duke bërë ekzaminimet dhe mjekimet përkatëse. Duke qenë në spital, rreth orës 02.00 të datës 20.05.2011 ankuesit janë arrestuar në flagrancë për veprat penale të “Kundërshtimit me dhunë të punonjësit të policisë” dhe “Fyerjes për shkak të detyrës”, parashikuar nga nenet 236/2 dhe 239, të K.Penal. Nga verifikimet e bëra dhe provat e administruara rezultoi se:

- Gjendja shëndetësore e ankuesve ishte e rënduar. Në trupin e tyre, si në kokë, në fytyrë e vende të tjera dukeshin shenja të qarta dhune, si plagë, hematoma, dërrmishje dhe ënjtje. Pasojat e dhunës u provuan edhe nga Aktet e Ekspertimit Mjeko-Ligjor, të bëra me kërkesën tonë;

- Ankuesit nuk kishin patur armë apo sende të tjera të ndaluara nga ligji, nuk kishin kundërshtuar me dhunë apo të kishin bërë ndonjë rezistencë ndaj punonjësve të policisë të Repartit RENE A, kur janë kapur prej tyre në Bulevardin “Zogu i Parë” Tiranë;

- Ata nuk ishin regjistruar në asnjërin prej librave që administrohen nga Drejtoria e Policisë e Qarkut Tiranë, megjithëse ishin shoqëruar në këtë organ dhe më pas ishin arrestuar prej punonjësve të tij.

- Nga procesverbalet e arrestimit në flagrancë të ankuesve rezultoi se, ora e arrestimit të tyre ishte 02.00 e datës 20.05.2011, megjithëse ata ishin kapur në flagrancë në orën 21.00 të datës 19.05.2011. Pra në këtë rast si kohë e arrestimit ishte shënuar ora dhe data e përpilimit të proces-verbaleve të arrestimit të tyre dhe jo ora e data faktike si çasti, kur atyre iu është privuar liria në fakt.

Në përfundim të shqyrtimit të këtij rasti arritëm në konkluzionin se:

Ankuesit ishin keqtrajtuar fizikisht dhe pa asnjë shkak nga punonjësit e policisë, duke iu shkaktuar vuajtje të rënda fizike deri në humbjen e ndjenjave. Ankuesve iu ishte shkelur e drejta themelore e garantuar nga neni 25, i Kushtetutës dhe neni 3, i Konventës Evropiane për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive themelore të Njeriut, “*për mos ju nënshtruar torturës, dënimit apo trajtimit mizor, çnjerëzor ose poshtëruës*”. Përdorimi i strukturave të Policisë së Shtetit ishte në kundërshtim me nenin 121, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, ku janë parashikuar përgjegjësitë (detyrat) e këtyre strukturave. Mos regjistrimi i ankuesve në librat përkatës të Policisë ishte shkelje e detyrimeve ligjore. Detyrimi për regjistrimin e tyre është parashikuar në nenin 103, i ligjit nr.9749, datë 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” dhe në akte nënligjore. Mos shënimi në procesverbalet e arrestimit në flagrancë të ankuesve i orës faktike të arrestimit të tyre, ishte gjithashtu një shkelje ligjore tjetër. Duke i trajtuar në këtë mënyrë, atyre nuk iu llogaritet në kohën e paraburgimit dhe më pas edhe atë të vuajtjes së dënimit koha prej 5 orë që në fakt atyre iu ishte privuar liria. Ky veprim vinte në kundërshtim me nenet 144, 250 dhe 258, të K.Pr.Penale. Për shkeljet ligjore të përshkruara më sipër u bënë tre rekomandime përkatësisht:

1. Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë, “Për fillimin e ndjekjes penale ndaj punonjësve të policisë të për veprën penale të “Torturës” të kryer në bashkëpunim”, parashikuar nga nenet 86, e 25, të K.Penal, i ndryshuar. Rekomandimi u mirëprit dhe organi i Prokurorisë filloi hetimet.

2. Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit të cilit ju rekomanduam:

a) Analizimi i kësaj ngjarjeje me pasoja të rënda dhe nxjerrjen e përgjegjësive ligjore përkatëse.

b) Përdorimi konform ligjit të strukturave speciale operacionale të Policisë së Shtetit dhe të mos abuzimi me përdorimin e tyre në të ardhmen.

c) Trajnimi në vazhdimësi i punonjësve të policisë e të strukturave speciale lidhur me njohjen dhe respektimin e të drejtave kushtetuese e ligjore të shtetasve gjatë kryerjes së veprimeve operacionale, edhe në rastet kur ata kanë të bëjnë me elementë kriminelë.

ç) Përgjithësimi i këtij rasti në efektivin e strukturave speciale me qëllim që të mospërsëritet në të ardhmen. Rekomandimi u mirëprit dhe filloi procesi disiplinor ndaj 11 punonjësve të policisë.

Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë, për problemet e trajtuara më lart, të cilit i rekomanduam analizimin e kësaj ngjarjeje dhe të shkeljeve të konstatuara nga ana jonë, si dhe ndëshkimin disiplinor të punonjësve të policisë që nuk kanë zbatuar detyrimet ligjore të parashtruara. Rekomandimi u mirëprit dhe u ndëshkuan me masa disiplinore dy punonjës policie.

Në ankesën e shqyrtuar me nr. **dok 201100776**, shtetasi pretendonte se, në datën 21.06.2011 ka qenë duke ecur në rrugë së bashku me një shokun e tij. Pa prituri ata janë ndaluar nga disa punonjës të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Tiranë dhe pa u thënë asnjë fjalë i është bërë kontroll personal, por nuk u kanë gjetur as armë dhe asnjë gjë të ndaluar nga ligji. Më pas i kanë shoqëruar ata në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, pa u thënë asnjë arsye. Në polici atyre u janë marrë shenjat e gjurmëve të gishtave e të duarve, janë fotografuar dhe u janë marrë shënime gjeneralitetet dhe ishin pyetur me cilësinë e personave që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, si dhe gjithshka që lidhet me ngjarjet e ndodhura në atë zonë. Pasi janë mbajtur disa orë janë lënë të lirë, por as në këtë moment nuk iu është thënë shkaku ligjor dhe arsyeja e shoqërimit në polici dhe i kryerjes së veprimeve policore të përshkruara me sipër. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese arritën në konkluzionin se:

1. Shoqërimi në ambientet e D.P.Q. Tiranë, i ankuesve nga punonjësit e policisë ishte i kundërligjshëm. Ky rast nuk parashikohet në aktet ligjore e nënligjore që bëjnë fjalë për shoqërimin si, në nenin 11, pika 6 dhe 101, pika 1, të ligjit nr.9749, date 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”; Urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.711, date 11.10.2007 “Për zbatimin e kërkesave të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, lidhur me përdorimin e forcës dhe trajtimin e personave të shoqëruar, Letër - Porosinë e Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.1328, date 23.11.2009 “Për respektimin dhe garantimin e plotë të të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese e ligjore të personave gjatë veprimtarisë së Policisë së Shtetit”.

2. Kontrolli personal që u ishte bërë të shoqëruarëve ishte në kundërshtim me ligjin. Ai përbën shkelje të hapur të të drejtës kushtetuese të paprekshmërisë personale të personit të garantuar nga neni 37/3, i Kushtetutës dhe ndërkohë vjen në kundërshtim me nenet 202, e vijues të K.Pr.Penale, nenin 106, pika 3, dhe nenin 109, pika 4, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

3. Pyetja e të shoqëruarve në polici, me cilësinë e personave që kanë dijeni për rrethanat e hetimit, si dhe gjithçka që lidhet me ngjarjet e ndodhura, ishte e pa mbështetur në ligj dhe në kundërshtim me nenin 297, të K.Pr.Penale dhe nenin 100, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

4. Marrja e shenjave të gjurmëve të gishtave dhe të pëllëmbëve të duarve e të shoqëruarve ishte në kundërshtim me nenin 103, pika 5, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”. Ndërkohë ky veprim vjen në kundërshtim të plotë dhe të hapur edhe me nenin 6, të ligjit nr.9887, date 10.03.2008 “Për mbrojtjen e të dhënave personale”. Ky veprim i policisë nuk gjen as mbështetje në aktet nënligjore, sikurse është Urdhëri i Drejtorit të

Përgjithshëm të Policisë së Shtetit nr.777, date 22.04.2007 “Mbi procedurat që do të ndiqen për regjistrimin dhe administrimin e të dhënave të personave të shoqëruar ose të ndaluar/arrestuar”.

5. Këto veprime të punonjësve të policisë vijnë në kundërshtim edhe me nenin 6/1, të Rregullores së Disiplinës së Policisë së Shtetit. Në bazë të nenit 11/12 të Rregullores së cituar më sipër, këto veprime të punonjësve të policisë përbëjnë shkelje të rënda disiplinore. Ata duke i shoqëruar ankuesit në organin e policisë, pa patur asnjë shkak ligjor dhe pa u ndodhur në asnjërin prej rasteve të shoqërimit të parashikuara në ligj, duke u bërë kontroll personal, duke i pyetur ata për gjithshka që kishte ndodhur në atë zonë dhe marrë shenjat e gjurmëve të gishtave e pëllëmbëve, kanë shkelur e abuzuar me kompetencat ligjore të Policisë së Shtetit.

Për të gjitha shkeljet ligjore të përshkruara më sipër i rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe Drejtorit të Policisë së Qarkut Tiranë:

1. Të shqyrtonin me seriozitet, objektivitet dhe luajalitet këtë rast dhe fillimin e ecurisë disiplinore ndaj punonjësve të policisë që kishin kryer veprimet e kundërligjshme me ankuesit.

2. Ky rast të përgjithësohej me efektivin e policisë me qëllim që shkelje të tilla ligjore të mos përsëriten në të ardhmen.

3. Të merreshin masat e nevojshme dhe të menjëhershme për njohjen nga drejtuesit dhe efektivi i Policisë së Shtetit të ligjit “Për Policinë e Shtetit”, si dhe të akteve nënligjore të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit dhe sidomos të dispozitave që trajtojnë problemin e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë dhe problemet e tjera të konstatuar më sipër.

4. Drejtoria e Përgjithshme e Policisë së Shtetit të ushtrojë kontroll të vazhdueshëm në organet vendore të Policisë për verifikimin e zbatimit të akteve normative ligjore e nënligjore që përcaktojnë kriteret ligjore dhe rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë, pyetjen e shtetasve dhe marrjen e shenjave të gjurmëve të gishtave e të pëllëmbëve të duarve.

Pas disa kërkesave tona, nga Drejtoria e Policisë së Qarkut Tiranë u informua se në lidhje më këtë rekomandim ishin marrë masa disiplinore duke iu “tërhequr vëmendjen” dy punonjësve të policisë, ndërsa nga Drejtoria e Përgjithshme nuk është kthyer përgjigje. Qëndrimin e mbajtur nga D.P.Q.Tiranë në këtë rast nuk e konsiderojmë të drejtë dhe objektiv, pasi shkeljet e konstatuara nga ana jonë janë të rënda, ndërkohë që “tërheqja e vëmendjes” nuk parashikohet si masë disiplinore nga ligji “Për Policinë e Shtetit”.

Në ankesën e shqyrtuar me nr. **dok 201100176**, shtetasi me banim në rrethin e Shkodrës pretendonte se, para disa kohësh i kishin vjedhur dy herë 13 kokë dele në stallën që e kishte pranë shtëpisë. Për këtë ngjarje ankuesi kishte njoftuar policinë, por në vendin e ngjarjes nuk kishte shkuar asnjë punonjës policie për të bërë këqyrjen e tij dhe verifikuar rrethanat e ndodhjes së vjedhjeve. Pas ndodhjes së ngjarjeve ai ishte interesuar disa herë në Komisarlatin e Policisë Shkodër me qëllim që të bëhej i mundur zbulimi i autorëve të tyre.

Sipas ankuesit, policia nuk kishte ndërmarrë asnjë veprim për ndjekjen e zbulimin e autorëve të vjedhjeve, sepse punonjësit e policisë bashkëpunonin me vjedhësit. Për këto raste ai pretendonte se kishte bërë edhe disa ankesa me shkrim në organin e policisë, por nuk i ishte kthyer asnjë përgjigje. Nga shqyrtimi i kësaj ankese rezultoi se, pretendimet e ankuesit për ndodhjen e vjedhjes së pasurisë së tij (bagëtive) në dy raste dhe për mosndjekjen e ngjarjeve për zbulimin e autorëve nga Komisarlati i Policisë Shkodër, ishin të drejta dhe të vërteta.

Mosmarrja dhe administrimi i kallëzimeve të shtetasve konform procedurave ligjore nga organet e Policisë së Shtetit për veprat penale që iu kanë ndodhur atyre, është shkelje e rëndë e ligjit dhe përmban elementët e figurës së veprës penale të “Shpërdorimit të detyrës”, parashikuar nga neni 248 i K.Penal. E drejta e pronës private është një nga të drejtat themelore të shtetasve dhe gëzon mbrojtje kushtetuese dhe ligjore. Në bazë të nenit 1 dhe 2, të ligjit nr.9749, date 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit”, misioni i Policisë është të ruajë rendin dhe sigurinë publike, në përputhje me ligjin dhe duke respektuar të drejtat dhe liritë e njeriut.

Në bazë të nenit 4/1, të ligjit të cituar më sipër, Policia ka për detyrë që të mbrojë pronën personale, të parandalojë, të zbulojë dhe të hetojë, në përputhje me ligjin penal dhe me ligjin procedural, veprat penale dhe autorët e kryerjes së tyre. Në bazë të nenit 283, të K.Pr.Penale, punonjësit e Policisë së Shtetit kanë detyrim të marrin kallëzimet e shtetasve, të cilat mund të bëhen me gojë ose me shkrim. Ndërsa në bazë të nenit 293, të këtij Kodi, me marrjen e njoftimit për një vepër penale, pa vonesë, bën referimin e saj tek prokurori. Në rastin konkret ishin shkelur hapur detyrimet ligjore të Policisë së Shtetit të parashikuara në dispozitat e cituara më sipër dhe në akte të tjera ligjore e nënligjore lidhur me mbrojtjen e pronës së ankuesit. Policia jo vetëm që nuk kishte mundur që të parandalojë kryerjen e veprës penale, por nuk kishte kryer asnjë veprim ligjor për marrjen dhe administrimin e kallëzimit, si dhe për zbulimin dhe hetimin e autorëve të veprës penale të vjedhjes së pasurisë së ankuesit. Për të rivendosur në vend të drejtën e shkelur ankuesit nga zyra e Avokatit të Popullit ju rekomandua

Drejtorisë së Policisë të Qarkut Shkodër marrja e menjëhershme e kallëzimit për veprën penale të “Vjedhjes së pasurisë” dhe kryerjen e të gjitha veprimeve të nevojshme proceduriale konform dispozitave të K.Pr.Penale dhe të ligjit nr.9749, date 04.06.2007 “Për Policinë e Shtetit” ndjekja dhe zbulimi i autorit të saj. Gjithashtu rekomanduam që ky rast të përgjithësohej me efektivin e policisë me qëllim që të mos përsëritej në të ardhmen. Rekomandimi u mirëprit dhe u zbatua.

Rasti i filluar me inisiativë me **nr 21 prot. lidhur me ngjarjen e 21 janarit 2011.**

Ne vijim të situatës së krijuar nga incidentet e ndodhura në demonstratën e organizuar në Tiranë në datën 21 janar 2011, Institucioni i Avokatit të Popullit, në funksion të përmbushjes së detyrës së tij kushtetuese dhe në mbështetje të parashikimeve të bëra në Ligjin nr. 8454, date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe Ligjin nr. 9888, datë 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 8328 datë 16.04.2008 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, në datën 22 dhe 23 janar kreu disa inspekte, në Komisaritet e Policisë nr.1,2,3,4 në Tiranë, në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë si dhe në Burgun nr. 313 dhe 302 .

Këto inspekte kishin si qëllim kryesor monitorimin nga afër të të drejtave dhe trajtimin e personave të ndaluar gjatë demonstratës së organizuar në datën 21 janar në Bulevardin “Dëshmorët e Kombit”, të cilët mbaheshin në këto institucione, si dhe konstatimin e problemeve gjatë ushtrimit të veprimtarisë së administratës së institucioneve të sipërpërmendura.

Avokati i Popullit pasi u informua për një sërë konstatimesh të vena re nga grupet inspektuese, parashitë konkluzionet e tij duke ju referuar problemeve dhe masat që Institucioni ynë çmoi se duheshin marre për të mos u përsëritur në të ardhmen situata të ngjashme.

Nga inspektimet e kryera, prej nësh rezultoi se:

1. Në ditën e inspektimit në Drejtorinë e Policisë së Qarkut Tiranë, ndodheshin të arrestuar 16 persona. Arrestimi i tyre ishte bërë për kryerje të veprave penale të parashikuara nga nenet 236, 237, 238 dhe 239 të Kodit Penal, e respektivisht për “Kundërshtim i punonjësit të policisë së rendit publik”, “Goditje për shkak të detyrës”, “Kanosje për shkak të detyrës” dhe “Fyerje për shkak të detyrës”. Sipas personave të arrestuar akuzat nuk qëndronin, pasi disa prej tyre kishin qenë në demonstratë por, nuk kishin kryer këto vepra penale. Ndërsa disa të tjerë pretendonin se nuk kishin qenë pjesëmarrës në demonstratë.

- Të arrestuarit pretendonin për ushtrim dhune fizike ndaj tyre nga punonjësit e policisë ne momentin e shoqërimit ne organet e policisë, si dhe gjatë pyetjes se tyre ne këto organe. 2 prej tyre kishin shenja te dukshme te dëmtimit fizik ne pjese te ndryshme te trupit, te cilat u konstatuan nga ana jone. Nga ana jone u konstatua gjithashtu, prania e mjekut te policisë duke bere vizita e mjekime te te arrestuarve te dëmtuar, por te 2 personat e dëmtuar, kërkonin t'i behej ekspertim mjeko-ligjor, gjë e cila nuk rezultoi t'i ishte ofruar nga policia.

- Të 16 personat e arrestuar ishin banore te rretheve te ndryshme dhe asnjeri prej tyre nuk ishte me banim ne Tirane. Sipas tyre, ata ishin kapur nga policia disa ne dalje te qytetit te Tiranës duke ikur per ne rrethet përkatëse, ndërsa disa te tjerë ne hyrje te qyteteve te tyre te banimit si ne Lezhe e Shkodër. Personat e kapur ne hyrje te qyteteve Lezhe dhe Shkodër fillimisht ishin dërguar e pyetur ne Komisariatet e Policisë te këtyre rretheve dhe me pas ishin dërguar ne Policinë e Tiranës.

Të gjithë pretendonin se ishin detyruar nga punonjësit e policisë me dhune fizike e psikike qe te firmosnin procesverbalet e pyetjes dhe te arrestimit te tyre.

Kushtet fizike te ambienteve ku ata ishin siguruar ishin te papërshtatshme, nga përmasat e këtyre ambienteve, pasi ne një dhome rreth 3 m² qëndronin 7 te arrestuar, nuk kishte mbulesa, si dhe kushtet higjieno sanitare linin shume për te dëshiruar.

Pjesa me e madhe e te arrestuarve pretendonin se nuk ishin kryer njoftimet e familjareve për veprimin e arrestimit te tyre nga policia.

2. Në Komisarlatin Nr.3 te Drejtorisë se Policisë Tirane ndodheshin te ndaluar dhe arrestuar 19 persona, nga te cilët 4 te mitur. Ndaj tyre ishin kryer veprimet proceduriale dhe ata priteshin për te dale ne gjykate për vleftësim ose caktim mase sigurie. Nga ana jone u konstatua se te gjithë personat e mësipërm ishin pajisur me kopje te procesverbaleve te ndalimit dhe arrestimit, si dhe te sendeve personale te bllokuara nga policia. Nga intervistimi i te ndaluarve dhe arrestuarve u njohëm me pretendimet si vijon:

- Te gjithë pretendonin se ndaj tyre ishte ushtruar dhune fizike ne momentin e ndalimit nga policia dhe gjate shoqërimit te tyre per ne Komisarlatet e Policisë se Shtetit.

- Te gjithë pretendonin se ju ishin marre deklarime nga Oficerë te Policisë Gjyqësore ne kushte dhune psikologjike.

- Te gjithë pretendonin se megjithëse kishin firmosur, nuk kishin marre dijeni për përmbajtjen e deklarimeve te tyre dhe se ato kishin qene veprime formale te njëanshme te policisë.

- Megjithëse u verifikua nga ana jone rregullsia e pranisë procedurale te avokatit provuar me nënshkrimet përkatëse ne deklarime, te gjithë pretendonin se gjate marrjes se deklarimeve nuk ka qene i pranishëm avokati dhe nënshkrimet e tyre kane qene te mëvonshme.

- Megjithëse u verifikua nga ana jone rregullsia e pranisë procedurale te psikologut provuar me nënshkrimet përkatëse ne deklarime, 4 te miturit pretendonin se krahas mungesës se avokatit gjate marrjes se deklarimeve nga policia gjyqësore nuk ka qene i pranishëm psikologu dhe nënshkrimi i tij është bere me vonesë.

- 6 prej te ndaluarve pretenduan se familjaret apo te afërmit e tyre nuk ishin njoftuar dhe nuk kishin marre dijeni për vendqëndrimin e tyre. Ne kushtet kur ndaj tyre nevojitej identifikimi nëpërmjet kartave te identitetit apo çertifikatave një gjë e tille behej e pamundur nga mungesa e paraqitjes se personave te afërm. Nga ana e policisë u pretendua se po punohej ne këtë drejtim.

- Nga keqyrja e te ndaluarve dhe arrestuarve u konstatua se vetëm njeri prej tyre kishte një te çare ne kokë dhe për këtë i ishte dhënë ndihma mjekësore ne spital.

- Te gjithë te ndaluarit dhe arrestuarit pranuan se gjate qëndrimit ne Komisaritin e Policisë Nr.3 Tirane nuk ishin keqtrajtuar.

Ne Komisaritet e Policisë nr 1, 2, 3 dhe 4, rezultoi se personat te cilët ishin ndaluar, pasi ishin kryer veprimet procedurale, ishin përcjellë për ne ambientet e burgut 302 dhe 313 ne Tirane, ne pritje për te dale përpara gjykatës për vleftësim ose caktim mase sigurie.

3. Ne inspektimin e kryer ne Paraburgimin 313 ne Tirane u konstatua se ndodheshin te ndaluar dhe arrestuar 41 persona, nder te cilët 8 te mitur dhe 1 femër. Ndaj tyre ishin kryer veprimet procedurale dhe ata priteshin për te dale ne gjykate për vleftësim ose caktim mase sigurie. Nga ana jone u konstatua se te gjithë personat e mësipërm ishin pajisur me kopje te procesverbaleve te ndalimit dhe arrestimit, si dhe te sendeve personale te bllokuara nga policia. Nga intervistimi i te ndaluarve dhe arrestuarve dhe pas keqyrjes se ambienteve ku ishin sistemuar u konstatua si vijon:

- Te gjithë pretendonin se ndaj tyre ishte ushtruar dhune fizike ne momentin e ndalimit nga policia dhe gjate shoqërimit te tyre per ne Komisaritet e Policisë se Shtetit.

- Te gjithë pretendonin se ju ishin marre deklarime nga Oficere te Policisë Gjyqësore ne kushte dhune psikologjike.

- Te gjithë pretendonin se megjithëse kishin firmosur nuk kishin marre dijeni për përmbajtjen e deklarimeve të tyre dhe se ato kishin qene veprime formale të njëanshme të policisë.

- Te gjithë pretendonin se gjatë marrjes së deklarimeve nuk ka qene i pranishëm avokati dhe nënshkrimet e tyre kanë qene të mëvonshme.

- 8 të miturit pretendonin se krahas mungesës së avokatit gjatë marrjes së deklarimeve nga policia gjyqësore, nuk ka qene i pranishëm psikologu dhe nënshkrimi i tij mund të jetë bërë me vone.

- 18 prej të ndaluarve pretenduan se familjaret apo të afërmit e tyre nuk ishin njoftuar dhe nuk kishin marre dijeni për vendqëndrimin e tyre. Por nga ana e Sektorit të Edukimit të Paraburgimit 313 ishin marre masat jo vetëm për shpalljen e listës së personave të ndaluar dhe arrestuar por dhe të njoftimit me telefon të familjareve.

- Paraburgimi 313 ofronte shumë pak vend për strehimin e 41 personave dhe mbipopullimi në qeli ishte tepër i madh. U vunë re mungesa të theksuara në shtroje, dyshekë dhe krevate. Ushqimi ju ishte servitur normalisht. Te gjithë personat kishin dale përpara komisionit të pranimit ku ishte i pranishëm edhe një mjek. Me të ndaluarën femër dhe me të miturit kishte marre kontakt edhe psikologu i paraburgimit.

4. Në inspektimin e kryer në Paraburgimin 302 në Tiranë, u konstatua se ndodheshin të ndaluar dhe arrestuar 34 persona ndër të cilët 7 të mitur. Ndaj tyre ishin kryer veprimet proceduriale dhe ata priteshin për të dale në gjykatë për vleftësim ose caktim mase sigurie. Nga ana jone u konstatua se të gjithë personat e mësipërm ishin pajisur me kopje të procesverbaleve të ndalimit dhe arrestimit, si dhe të sendeve personale të bllokuara nga policia. Nga intervistimi i të ndaluarve dhe arrestuarve dhe pas këqyrjes së ambienteve ku ishin sistemuar u konstatua si vijon:

- Te gjithë pretendonin se ndaj tyre ishte ushtruar dhunë fizike në momentin e ndalimit nga policia dhe gjatë shoqërimit të tyre për në Komisaritet e Policisë së Shtetit.

- Te gjithë pretendonin se ju ishin marre deklarime nga Oficerë të Policisë Gjyqësore në kushte dhunë psikologjike.

- Te gjithë pretendonin se megjithëse kishin firmosur nuk kishin marre dijeni për përmbajtjen e deklarimeve të tyre dhe se ato kishin qene veprime formale të njëanshme të policisë.

- Te gjithë pretendonin se gjatë marrjes së deklarimeve nuk ka qene i pranishëm avokati dhe nënshkrimet e tyre kanë qene të mëvonshme.

- 7 të miturit pretendonin se krahas mungesës së avokatit gjatë marrjes së deklarimeve nga policia gjyqësore nuk ka qene i pranishëm psikologu dhe nënshkrimi i tij ishte bërë me vone.

- 10 prej te ndaluarve pretenduan se familjaret apo te afërmit e tyre nuk ishin njoftuar dhe nuk kishin marre dijeni për vendqëndrimin e tyre. Por nga ana e Sektorit të Edukimit të Paraburgimit 302 ishin marre masat jo vetëm për shpalljen e listës së personave të ndaluar dhe arrestuar por dhe te njoftimit me telefon te familjareve.

- Paraburgimi 302 ofronte shume pak vend për strehimin e 34 personave dhe mbipopullimi ne qeli ishte tepër i madh. U vunë re mungesa te theksuara ne shtroje, dyshekë dhe krevate. Ushqimi ju ishte servitur normalisht. Te gjithë personat kishin dale përpara komisionit te pranimit ku ishte i pranishëm edhe një mjek.

5. Jo vetëm nga te intervistuarit prej nesh, te cilët ndodheshin ne ambientet e institucioneve te sipërcituara, por edhe nëpërmjet medias elektronike, pame skena ku policia ushtronte dhune pas përfundimit te demonstratës dhe largimit te protestueseve, ndaj disave prej tyre ne kushte dukshëm te panevojshme. Eshtë e kuptueshme qe ne situata sado delikate, kryesorja për cilindo punonjës te shtetit është vetëm zbatimi i ligjit.

Për sa më sipër, në mbështetje të pikës 3, të nenit 63 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në bazë të nenit 21/c te Ligjit Nr.8454 dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, si dhe të Nenit 74/1 pika b te Ligjit Nr. 9888 dt. 10.03.2008 “Për disa shtesa dhe ndryshime ne Ligjin Nr. 8328 dt.16.04.1998 “Për te drejtat dhe trajtimin e te dënurave me burgim”, i rekomandua Drejtorit të Përgjithshëm të policisë së Shtetit dhe për dijeni Ministrit të Brendshëm që:

1. Te instruktohen te gjithë efektivat e policisë te cilët marrin pjese gjate ruajtjes se rendit ne tubime qe te tregohen gjakftohte, te arsyeshëm ne zbatimin me rigorozitet te kërkesave te ligjit dhe akteve nënligjore. Ndaj tyre duhet ofruar me shume trajnim profesional për te përballuar punën nen presion fizik dhe psikologjik për te mos ushtruar dhune, sidomos ne situata te panevojshme sikurse u pasqyrua gjerësisht nga organet e medias pas përfundimit te demonstratës.

2. Te instruktohen te gjithë efektivat e policisë te cilët marrin pjese gjate ruajtjes se rendit ne tubime qe te përdorin forcën dhe mjetet qe kane ne dispozicion ne mënyrën, kohen dhe intensitetin proporcional te arsyeshëm.

3. Te respektohen me korrektese te gjithë garancitë proceduriale te parashikuara ne Kodin e Procedurës Penale dhe ne akte te tjera ligjore ndaj te shoqëruarve, ndaluarve dhe arrestuarve ne lidhje me njoftimet e familjareve, praninë e avokatit dhe psikologut dhe veçanërisht për te miturit qe është dhe detyrim ligjor.

4. Te rritet eficensa dhe objektiviteti i veprimeve policore gjate shoqërimeve, ndalimeve dhe arrestimeve te personave duke synuar mos shkeljen e se drejtës kushtetuese te lirisë se personit.

5. Te merren masa për përmirësimin e kushteve te ambienteve te shoqërimit dhe sigurisë me te gjitha elementet dhe standartet e kërkuara sipas ligjit “Për Policinë e Shtetit” dhe standarteve ndërkombëtare.

Ndërsa Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve dhe Ministrit të Drejtësisë i rekomandua që: Te vihen sa me shpejt ne dispozicion te te ndaluarve dhe arrestuarve te gjitha pajimet e nevojshme jetike ne qelitë e paraburgimit 313 dhe 302.

Rekomandimit tonë ju përgjigj Ministria e Drejtësisë nëpërmjet Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve e cila mori masa për normalizimin e menjëhershëm të situatës së të ndaluarve.

Duke qenë se organet e specializuara për ndjekjen e pasojave të ngjarjes së 21 janarit u vunë menjëherë në lëvizje, Avokati i Popullit nuk e gjeti më me vend të ndërhynte më tej.

Përmirësimi i legjislacionit

Mbetet akoma shqetësimi i ngritur edhe vitin e kaluar që lidhet me sigurimin e të arrestuarve e të ndaluarve nga Policia e Shtetit, sikurse është theksuar detyra e Policisë së Shtetit për ruajtjen e sigurimin e të arrestuarve e të ndaluarve, derisa ndaj tyre të caktohet masa e sigurimit nga gjykata, nuk parashikohet në ligjin nr. 9749 datë 04.06.2007 “Për Policinë Shtetit”. Në asnjë dispozitë të këtij ligji, duke përfshirë edhe nenin 4, të tij ku janë parashikuar përgjegjësitë (detyrat) e Policisë së Shtetit, nuk përmendet përgjegjësia e këtij organi për të siguruar këtë kategori personash.

Ky shërbim, sipas legjislacionit në fuqi, i është ngarkuar Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve dhe organeve të saj vartëse. Policia e Shtetit po kryen këtë detyrë në kundërshtim me dispozitat ligjore. Madje hartimi nga ana e Drejtorisë së Përgjithshme të Policisë së Shtetit i manualit për organizimin dhe funksionimin e këtij shërbimi, është refuzuar me argumente juridike nga ana jonë, pasi një akt i tillë nuk ishte i autorizuar nga ligji “Për Policinë e Shtetit”. Për të zgjidhur këtë problem ligjor, nga ana jonë është rekomanduar ndryshimi i nenit 4, të ligjit “Për Policinë e Shtetit”.

Ky rekomandim ju dërgua Kryeministrit, Ministrit të Brendshëm dhe Ministrit të Drejtësisë. Në dijeninë tonë deri aktualisht nuk është ndërmarrë ndonjë nisëm ligjore për të bërë ndryshimet përkatëse.

2. Nga eksperiencia e viteve të fundit gjatë ndjekjes së ankesave dhe kryerjes së inspektimeve kemi konstatuar se, në organet e policisë

shoqërohen në mënyrë të vazhdueshme një numër i konsiderueshëm personash për shkak të konflikteve të ndryshme me njëri-tjetrin si rrahje, fyerje, shqetësime etj. Ky veprim i organeve të policisë, duke shoqëruar këtë kategori personash në këto raste, përveç qëllimit të mirë që ka për parandalimin e ngjarjeve më të rënda që mund të vijnë pas kësaj, në fakt ai nuk ka mbështetje ligjore. Për legjitimitimin e këtij veprimi kemi sugjeruar ndryshimin e ligjit “Për Policinë e Shtetit” duke shtuar rastet e shoqërimit të shtetasve në organet e policisë të parashikuara në nenin 101, të tij.

- Veprimtaria e Avokatit të Popullit ne lidhje me Forcat e Armatosura

Për vitin 2011 ndaj strukturave të Forcave të Armatosura janë bërë 71 kërkesa dhe ankesa nga subjekte që janë ushtarakë apo ish ushtarakë si dhe të tjerë.

Kushtetuta në nenet 166-176 të saj dhe ligji nr.9210, date 23.03.2004 “Për Statusin e Ushtarakut të F.A. në Republikën e Shqipërisë”, ka rregulluar veprimtarinë e Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë.

Duke analizuar në tërësinë e tyre ankesat e ardhura në Institucionin tonë për vitin 2011, konstatohet se ato janë bërë kryesisht nga oficerë, nënoficerë, nga punonjës civil, ushtarë si dhe ushtarakë të dalë në rezervë.

Nga ankesat e përfunduara gjatë vitit 2011, rezulton se 23 ankesa ose 35% e tyre kanë gjetur zgjidhje pozitive. Ndërsa 16 ankesa ose 26% kanë qenë jashtë kompetencës tonë, 19 raste ose 30 % kanë qenë ankesa të pabazuara. Në 4 raste ose 7% janë përfunduar me rekomandim të pranuar, në një rast ose 2% çështjet kanë përfunduar janë përfunduar me rekomandim të refuzuar.

Gjatë vitit 2011 zyra e Avokatit të Popullit ka marrë takim me një numër të madh subjektësh ushtarakë, të cilët kanë prezantuar ankesat e tyre. Për ato raste që ata kanë gjykuar, ankesat janë me shkrim.

Në përgjithësi objekti i ankesave të prezantuara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë kësaj kohe ka qenë, për moszbatim dhe për zvarritje ne dhënien e pensionit suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë; për mënyrën e trajtimit me ushqim në Forcat e Armatosura; për kohën e punës dhe pushimit të ushtarakëve; për kompensimin e qirasë së banesave; për zvarritje nga ana e Komisionit Qendror të Statusit të Veteranit dhe Dëshmorëve të Atdheut, të procedurave për dhënien e statusit të veteranit dhe dëshmorit të atdheut për trajtim financiar të subjekteve të sipërcituara.

Për mënyrën dhe masën e kompensimit me ushqim të ushtarakëve të Forcave të Armatosura, e drejtë që ju është njohur atyre nga Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 524, datë 30.07. 2004, janë regjistruar disa ankesa si ato me nr. doc. 201001057, 201001053, 201001069 etj. Disa prej ankeesve kanë kërkuar pranë zyrës së Avokatit të Popullit rishikimin e urdhrave të Ministrisë së Mbrojtjes me qëllim që kompensimi në ushqim t'ju jepej në vlerë leku. Kërkesa e tyre u vlerësua e arsyeshme dhe e bazuar dhe ju rekomandua Ministrisë së Mbrojtjes të shikohet mundësia e plotësimit të kësaj kërkesë.

Për trajtimin me uniformë të ushtarakut janë regjistruar disa ankesa si ato me nr. doc. 201001409, 201001410 etj. Gjatë vitit 2011 në disa raste nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes nuk është respektuar e drejta e ushtarakëve për marrjen e normave të veshmbathjes. Pas rekomandimit të tyre për këto raste u bë paisja me uniforma por vetëm për stërvitje. E drejta e njohur nga ligji në këtë aspekt nuk gëzohet plotësisht prej ushtarakëve. Për vitin në vijim një nga objektivat e punës do të jetë dhe ndjekja dhe realizimi i kësaj të drejte të cënuar.

Për “Të Drejtat Sociale të Ushtarakut dhe familjes së tij”, janë të regjistruara disa ankesa si ato me nr. doc. 201100270, 201100274, 201100279 etj. Në objekt të tyre pas verifikimeve të realizuara nga zyra e Avokatit të Popullit, konstatohen shkelje të të drejtave të ushtarakëve lidhur me kohën e punës dhe të pushimit, mbajtjen e tyre në punë tej orarit normal të punës. Për këtë qëllim i kemi rekomanduar shërbimet të Shtabit të Përgjithshëm, përmirësimin e kushteve për trajtimin e oficerëve, nënoficerëve dhe ushtarëve profesionistë në disa reparte të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Në përgjigje të rekomandimit, jemi informuar se janë marrë masa për shtesa në dhënie fondesh për përmirësimin e gjendjes.

Në ato raste kur ankesat kanë patur të bëjnë me ushtarakët të cilët janë thirrur në punë kur e kërkon misioni i njëjtit ose situata operationale, ato janë refuzuar nga ana jonë duke u mbështetur në pikën 2 të nenit 31 të Ligjit “Për Statusin e Ushtarakut në Republikën e Shqipërisë”, sipas të cilit në këto raste ushtaraku nuk ka të drejtë përfitimi ose pagesë suplementare. Ky shqetësim është ngritur përsëri në takimin që zyra jonë ka marrë me drejtues të Ministrisë së Mbrojtjes.

Në lidhje me ankesat e ushtarakëve apo ish ushtarakëve që ndërpresin karrierën apo e kanë ndërprerë atë kohë më parë në kuadrin e reformës në Forcat e Armatosura që prej vitit 1992, siç janë ankesat e regjistruara me Nr. doc. 201100216, 201100273 etj, ngrihej shqetësimi se, jo vetëm që masa e pensionit të tyre është më e ulët se pensioni i kolegeve të tyre që kanë dalë

në pension pas vitit 1993, edhe pse kanë qenë të barazvlefshëm në detyrë, por ata kundërshtojnë edhe iniciativën e Kryeministrit, për të ndryshuar ligjin nr. 9418, datë 20.05.2005 “Për sigurimin shoqëror suplementar të ushtarakëve të Forcave të Armatosura të Republikës së Shqipërisë”. Kërkesa apo ankesa të kësaj natyre kanë paraqitur jo vetëm individë të caktuar, por edhe shoqata e grupime të tjera ish ushtarakësh.

Kjo çështje vazhdon të mos gjejë ende zgjidhjen e duhur. Aktualisht shumë ushtarake kanë gjetur rrugën e zgjidhjes duke fituar gjyqësisht te drejtat e tyre te njohura me ligj.

Vazhdojmë të kemi ankesa për zvarritje me vite në shqyrtimin nga ana e Komisionit Qendror të Statusit të Dëshmorit të Atdheut, të kërkesave të individëve për dhënien e këtij statusi. Përmendim këtu ankesat e regjistruara me nr. Doc. 201100236, 201100889, 201100960 etj.

Me ndryshimet e bëra Vendimit të Këshillit të Ministrave, duke caktuar si Kryetar Komisioni, Ministrin e Mbrojtjes, shpresojmë që ky problem të marrë zgjidhje sa me shpejt dhe përfundimisht.

Një kategori ankesash për vitin 2011, kanë qenë ato që lidhen me kushtet e banimit dhe të jetesës së ushtarakëve të cilat janë konstatuar edhe gjatë inspektimeve në Komandën e Doktrinës dhe Stërviçes, ne Repartin nr. 1111 Vau i Dejës, ne Batalionin Komando Zall-Herr etj. Këto ankesa janë regjistruar me nr. doc. 201100944, 201100288, 201101371 etj, dhe lidhen me të drejtën që ju njeh Statusi i Ushtarakut qytetarëve me uniformë të Forcave tona të Armatosura. Rekomandimet me qëllim përmirësimin e kushteve, për rastet e përmendura më sipër, janë vlerësuar pozitivisht nga Shefi i Shtabit të Përgjithshëm. Në përgjigje të këtyre rekomandimeve jemi informuar se kanë përfunduar projektet për rikonstruksion dhe janë për zbatim në planin e investimeve për vitin 2012.

Gjatë vitit 2011 janë filluar me iniciativë 9 raste, një nga të cilat është ende në shqyrtim.

Ajo që ka rezultuar nga komunikimi ynë me Ministrinë e Mbrojtjes gjatë vitit 2011, është se në disa raste ka patur vonesa të theksuara në kthimin e përgjigjeve zyrës së Avokatit të Popullit.

5. Çështje të administrimit të drejtësisë

E drejta për një proces të rregullt ligjor

E drejta për një proces të rregullt ligjor, si një e drejtë themelore e individit, është e garantuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës së Shqipërisë, në të cilën sanksionohet se: “*Liria, prona dhe të drejtat e*

njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të çenohen pa një proces të rregullt ligjor”. “Kushdo për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publikë brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj”.

Në nenin 6 të “ Konventës Europiane për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut dhe të Lirive Themelore”, përcaktohet se: *“Gjithkush ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e krijuar ligjërisht, e cila të vendos qoftë për pretendimet që mund të shfaqen ndaj të drejtave dhe detyrimeve të tij me karakter civil, qoftë për të përcaktuar nëse është e bazuar çdo akuzë e natyrës penale e drejtuar kundër tij”.*

Duke zgjeruar garancitë e saj, në nenin 1, të Protokollit nr.1, të Konventës, parashikohet se: *“Çdo person fizik ose juridik ka të drejtën që t’i respektohet pasuria e tij. Askush nuk mund të privohet nga prona e tij, përveçse për arsye të interesit publikë dhe në kushtet e parashikuara nga ligji dhe nga parimet e përgjithshme të së drejtës ndërkombëtare”.* Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë trajtimit të ankesave të ndryshme gjatë vitit 2011 ka mbajtur parasysh veç akteve të sipërcituara dhe kërkesat e tjera të parashikuara në Kodin e Procedurës Penale, dhe në Kodin e Procedurës Civile, të cilat duhen respektuar gjatë gjykimit të çështjeve gjyqësore të cilat normojnë dispozita ligjore për zhvillimin e një procesi të drejtë e të rregullt ligjor nga gjykatat.

E drejta për një proces të rregullt ligjor në thelb, nuk mund dhe nuk duhet të konceptohet si një e drejtë, e cila qëndron vetëm tek veprimtaria e organeve gjyqësore, pasi ajo fillon dhe nuk mund të përjashtohet dhe në veprimtarinë administrative, të organeve të administratës publike.

Institucioni i Avokatit të Popullit dhe organet e pushtetit gjyqësor

Ankesat që i janë drejtuar institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2011 lidhur me sistemin gjyqësor dhe administratën gjyqësore kanë patur si objekt, shkeljen e të drejtave ligjore të ankuesve gjatë gjykimit, apo shkelje të tjera nga administrata gjyqësore dhe si të tilla, ato janë verifikuar nga ana jonë në bazë të procedurave të parashikuara nga ligji, duke synuar në nxjerrjen e shkaqeve të këtyre shkeljeve nga gjykatat e të gjitha shkallëve.

Numri ankesave të ardhura për shqyrtim ndaj gjykatave gjatë vitit 2011 ka qenë **96**.

1- Nga analiza e këtyre ankesave rezulton se vendin kryesor e zënë ato për zvarritje të padrejta dhe të pajustificuara të gjykimeve, pra shkeljet në procedurat gjyqësore si për çështje civile ashtu edhe për çështje penale.

2- Në zyrën e Avokatit të Popullit vazhdojnë të vijnë ankesa ndaj vendimeve gjyqësore duke ngritur pretendime të ndryshme se ato vendime janë të padrejta dhe të pabazuara në ligj ose janë marrë nën ndikimin e veprimeve korruptive nga gjyqtarë të veçantë. Në disa raste, ankesat ndaj vendimeve gjyqësore kanë lidhje me masa dënimi të rënda me burgim që janë aplikuar nga gjykatat dhe është kërkuar prej tyre ndihma dhe ndërhyrja e institucionit tone për ndryshimin ose prishjen e tyre nga shkalla e dytë Gjykata e Apelit ose nga Gjykata e Lartë për rastet e ushtrimit të rekurseve.

3- Në raste të tjera ankesat janë bërë ndaj gjyqtarëve të ndryshëm për shkelje të ndryshme ligjore duke shprehur dyshime serioze për paanësi të gjyqtarëve në gjykime ose për zgjidhje të ndryshme të problemit të tyre dhe është kërkuar rruga ligjore që mund të ndiqej nga ankuesit për zgjidhjen e këtyre problemeve ose për heqjen dorë nga gjykimi i çështjes, kur ka shkaqe ligjore të parashikuara në ligj.

4- Nga analiza e bërë del se në disa raste ankesat kanë patur si objekt të tyre kërkimin e ndihmës dhe të ndërhyrjes ligjore të Avokatit të Popullit, për të përfaqësuar çështje të ndryshme si në Gjykatën e Apelit, ashtu edhe në Gjykatën e Lartë. Po kështu një ndihmë e tillë ligjore është kërkuar nga ankuesit për dërgimin e çështjes së tyre për gjykim dhe mbrojtje në Gjykatën Kushtetuese, ashtu edhe në Gjykatën e Europiane për të Drejtat e Njeriut në Strasburg duke pretenduar se ndaj tyre gjykatat nuk kanë zhvilluar një proces të rregullt ligjor, por ato nuk kanë të ardhura financiare për të zgjedhur dhe paguar një avokat për mbrojtje me avokat privat.

5- Edhe gjatë këtij viti kanë vazhduar të na drejtohen ankesa ndaj gjykimeve apo vendimeve gjyqësore të bëra dhe të marra në mungesë të pandehurve, ose të palëve ndërgjyqëse civile duke u pretenduar prej tyre në lidhje me shkeljen e procedurave ligjore të komunikimeve të vendimeve gjyqësore nga administrata gjyqësore sipas kërkesave të ligjit.

Rasti **nr.dok.201100853**, ku qytetarja S.K. ankohej për zvarritje gjykimi nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Tiranë. Nga verifikimi i bërë rezultoi se kjo çështje mbahej në dorë pa u përfunduar nga data 09.02.2009. Po kështu rezultoi se nga gjykata ishin zhvilluar 20 seanca gjyqësore. Duke analizuar shkaqet kryesore të shtyrjeve të seancave gjyqësore rezultoi se ato ishin shtyrë për mosformim të trupit gjykues, për mos njoftim eksperti, për përgatitjen e aktit të ekspertimit nga ekspertët, me shkakun se, “seancat gjyqësore shtyhen me kërkesën e palëve”, “seancat shtyhen për tu njoftuar

palët me aktin e ekspertimit etj. Duke patur parasysh kohën e gjatë dhe shkaqet e shtyrjes së seancave gjyqësore nga zyra e Avokatit të Popullit ju dërgua gjykatës rekomandim për shpejtim të procedurave gjyqësore, rekomandim që u pranua dhe u bë më pas përfundimi i kësaj çështje civile.

Rasti **nr.dok.201101543**, shtetësja R.R. ankohej për zvarritje pa shkaqe ligjore nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor Durrës në gjykimin e një çështje civile, e cila kishte ardhur për rigjykim në këtë gjykatë me datën 14.12.2009, mbasi ajo ishte prishur nga Gjykata e Lartë. Nga verifikimi ynë rezultoi se nga gjykata ishin zhvilluar 17 seanca gjyqësore, dhe në përfundim gjykata kishte vendosur pezullimin e gjykimit të kësaj çështje, për të marrë hartat përkatëse në rrugë zyrtare nga Arkivi Qendror Teknik Tiranë. Ankuesja pretendonte se ky pezullim i bërë nga gjykata favorizonte palën tjetër mbasi pala paditëse, i kishte paraqitur vetë këto harta në gjykatë dhe se ato ishin marrë zyrtarisht e si të tilla ishin të sakta. Në përfundim nga ana jonë u dërgua rekomandim për shpejtim të procedurave gjyqësore, i cili u pranua nga gjykata dhe u vendos përfundimi i gjykimit të kësaj çështje.

Rasti **nr.dok. 201100778**, shtetësja T.M. ankohej ndaj Gjykatës së Lartë për zvarritje gjykimi duke pretenduar se me vendim të K.M.C.A.P. të D.R.S.SH, Tiranë, ishte vendosur padrejtësisht rrëzimi i kërkesës së saj për të përfituar grup invaliditeti dhe pagesën përkatëse. Duke patur parasysh edhe zgjatjen e gjykimeve nga dy shkallët e tjera të gjykimit dhe gjendjen shëndetësore jo të mire të ankuseses, nga ana jonë ju dërgua rekomandim Gjykatës së Lartë, e cila e mori në shqyrtim dhe e pranoi atë, duke bërë gjykimin e çështjes me procedurë të përshpejtuar.

Rasti **nr.dok.201100114**, shtetasi I.L. ankohej ndaj Gjykatës Rrethit Gjyqësor Dibër, se ajo kishte zhvilluar dhe përfunduar një gjykim civil në mungesë në vitin 2007. Ankuesit nga administrata gjyqësore, nuk i ishte bërë komunikimi i vendimit të marrë në mungesë sipas kërkesave të ligjit, me qëllim që ai të ankohej ndaj këtij vendimi gjyqësor në shkallët e tjera më të larta të gjykimit. Në sqarimin që i kemi bërë ankuesit I.L. iu referuam kërkesave të nenit 316 të K.Pr.C, ku flitet për njoftimin e vendimeve në rastet kur gjykimet bëhen në mungesë të palëve, përveç rasteve kur parashikohet ndryshe në këtë Kod. Ankuesin e sqaruam gjithashtu se ky njoftim bëhej sipas rregullave të parashikuara nga nenet 130, dhe 131 të këtij Kodi dhe në përfundim ankuesi është sqaruar se për zgjidhjen e këtij problemi ai mund t'i drejtohet Gjykatës Rrethit Gjyqësor Dibër, me një kërkesë tjetër me objekt deklarimin e pavlefshëm të komunikimit të vendimit gjyqësor.

Rasti **nr.dok.201101978**, shtetasi F.B. ankohej ndaj Gjykatës Rrethit Gjyqësor Elbasan pasi me vendimin dt.13.12.2011, ishte vendosur pushimi i

gjkimit për shkak se palët nuk u paraqitën në orën e caktuar. Ankuesi pretendonte se ai ishte invalid me aftësi të kufizuara dhe vonesa e tij kishte ndodhur për shkak të ngjitjes në shkallë për të shkuar në sallën e gjykimit, por gjyqtarja e çështjes kishte pushuar gjykimin duke favorizuar në këtë mënyrë palën kundërshtare e cila kishte interes nga zvarritja e këtij gjykimi.

Nga verifikimi ynë rezultoi se ankuesi F.B. ka bërë kërkesë padi të re të cilën e ka dorëzuar për gjykim në gjykatë dhe nuk ka bërë ankim ndaj vendimit të pushimit të gjykimit.

Rasti **nr.201100058**, shtetasi R.D ankohej ndaj gjyqtarit A.J. pasi gjatë shqyrtimit të një çështje gjyqësore kishte kryer shkelje të ligjit dhe Kodit të Etikës Gjyqësore duke e fyer atë pa asnjë shkak gjatë seancës gjyqësore të zhvilluar me datën 24.01.2011. Nga ana e jonë ankesa ju dërgua për kompetencë shqyrtimi KLD-së. Nga përgjigja e kthyer nga KLD-ja rezultoi se pretendimet e ankuesit R.D. nuk janë provuar dhe se nga ana e gjyqtarit A.J. nuk janë provuar shkelje të ligjit gjatë kryerjes së detyrës apo shkelje të tjera të Kodit të Etikës Gjyqësore.

Rasti **nr.201100261**, ankuesi N.D. ankohej ndaj një vendimi të dhënë nga Gjykata e Apelit Vlorë, me të cilin është vendosur prishja e vendimit gjyqësor të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor Berat dhe pushimi i çështjes penale ndaj të pandehurit E.Xh. për mungesë provash dhe nga ana tjetër është urdhëruar lirimi i menjëhershëm i tij nga burgu. Nga verifikimi ynë rezultoi se ndaj këtij vendimi gjyqësor ka ushtruar rekurs në Gjykatën e Lartë, prokurori pranë Gjykatës Apelit Vlorë dhe dosja ndodhej për shqyrtim në Gjykatën e Lartë. Në lidhje me pretendimet e tjera se gjyqtarët e Gjykatës së Apelit Vlorë, këtë vendim e kanë marrë si pasojë e veprimeve të tyre korruptive, nga ana jonë kopja e ankesës së ankuesit N.D. ju dërgua për kompetencë dhe verifikim Këshillit të Lartë të Drejtësisë.

Rasti me **nr.201101024**, shtetasi N.A. ankohej ndaj një vendimi gjyqësor të marrë në mungesë nga gjykata duke pretenduar se ai nuk është vënë në dijeni për gjykimin dhe dënimin e dhënë në mungesë. Ankuesi u sqarua me kërkesat e nenit 410/2 të K.Pr.Penale, se brenda afatit 10 ditor nga data e komunikimit të vendimit gjyqësor, ai ka të drejtën e ankimit në shkallë të dytë në Gjykatën e Apelit dhe se për mbrojtjen e tij në gjykim ai mund të zgjedhë vetë një avokat privat, i cili mbasi të studiojë dosjen bën mbrojtjen e tij në gjykatë.

Vitin e kaluar pas raportimit në Kuvend për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2011, nëpërmjet rezolutës së Kuvendit, u kërkuar nga Institucioni i Avokatit të Popullit që për vitin 2011 të bashkëpunohej ngushtë me Inspektoratin e KLD-së dhe Inspektoratin e

Ministrisë së Drejtësisë, për referim masash administrative ndaj funksionarëve të drejtësisë kur konstatohen shkelje ligjore.

Konkretisht gjatë vitit 2011 nga ana jonë janë dërguar 5 ankesa për kompetencë shqyrtimi në Këshillin e Lartë të Drejtësisë, por pas hetimit që është bërë nga ky organ na është kthyer përgjigje se ankesat kanë qënë të pa bazuara.

- Veprimtaria e Prokurorisë

Gjatë veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, për vitin 2011, janë shqyrtuar **101** ankesa drejtuar organit të Prokurorisë.

Objekti i shqetësimeve që shtetasit i kanë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, për veprimtarinë e punës së Prokurorive të Rretheve Gjyqësore paraqiten si më poshtë:

Së pari: “Për një proces të rregullt ligjor” i cili ka konsistuar në, zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale; arrestimin dhe ngritjen e akuzës të padrejtë; në marrjen e vendimit të padrejtë për mosfillim të procedimeve penale apo pushime të çështjeve penale për vepra penale të ndryshme kryesisht; për “Falsifikim të dokumentave”; “Shkelje të rregullave të qarkullimit rrugor”; për mosnjohje të palëve në procesin penal me vendimet për zgjatjet e afatit të hetimit të procedimit penal etj.

Në ankesat e shqyrtuara nga Zyra e Avokatit të Popullit për vitin 2011, përkatësisht nr.201101199, 201100220, 201100684, 201100486 etj, shtetasit janë ankuar për zvarritje të pajustificuara në hetimin e procedimeve penale. I tillë është rasti i ankesës së shtetasit G.J.M. nga Rrësheni, i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë, për arsye se procedimi penal nr.34 i vitit 2009 që bën fjalë për veprën penale “Goditja për shkak të detyrës”, ishte zvarritur padrejtësisht dhe nuk ishte përfunduar edhe për vitin 2011. Kjo për faktin se pas shfuqizimit të vendimit të pushimit të çështjes nga Prokuroria e Përgjithshme, nuk janë kryer disa nga veprimet hetimore të domosdoshme dhe të lëna detyrë si, kryerja e aktit të ekspertimit teknik të rregjistrimit audio, e ballafaqimeve të ndryshme etj.

Në ankesën me nr.**201101199**, shtetasi H.B. nga Lushnja, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit për zvarritje të pajustificuar në hetimin e proçedimit penal nr.279 filluar në datën 09.07.2010, në ngarkim të djalit të tij O.B, akuzuar për veprat penale “Vrasja me paramendim” kryer në bashkëpunim dhe “Mbajtja pa lejë e armëve luftarake”. Hetimet e këtij proçedimi penal kanë përfunduar pas një viti prej momentit të fillimit të tij, kohëzgjatje e cila nuk ishte e përligjur.

Në ankesën me nr.**201101277** shtetasi F.K. nga Fieri, ankohej ndaj Prokurorisë Gjyrokastër, për zvarritje për më se një vit në hetimin e proçedimit penal nr.543 të vitit 2009, për veprën penale “Trafikim i mjeteve motorike”.

Në ankesën me nr.**201100684** shtetasi E.G. nga qyteti i Durrësit, ankohej për zvarritje të pajustificuara në hetimin e proçedimit penal nr.1638, filluar më datën 02.10.2010, për veprën penale “Falsifikimi i letërnjoftimeve, pasaportave, ose i vizave”. Hetimet e proçedimit penal kanë përfunduar në datën 01.07.2011 dhe, arsyet e zvarritjes në hetim kanë qënë mosmarrja e masave për përpilimin në kohë të letërporosisë drejtuar autoriteteve të huaja.

Në lidhje me ankesën me nr.**201101199** i është rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lushnje “Analiza e zvarritjeve të pajustificuara në hetimin e proçedimit penal nr.279 të vitit 2010, për veprat penale “Vrasja me paramendim” dhe “Mbajtja pa lejë e armëve luftarake”, parashikuar nga nenet 78 e 25 dhe 278/2 të Kodit Penal”. Rekomandimi është pranuar dhe ndaj prokurorit të çështjes dhe oficerëve të policisë gjyqësore është tërhequr vëmëndja për zvarritje në hetim.

Në ankesën me nr.**201100296** shtetasi J.M. nga Lezha, ankohej ndaj Prokurorisë Tiranë e cila në kuadrin e proçedimit penal nr.285, datë 21.01.2011 e ka arrestuar dhe akuzuar padrejtësisht, në një kohë që ai është keqtrajtuar nga punonjësit e policisë së shtetit. Në informacionin drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë ka sqaruar se, mbi bazën e kallëzimit të shtetasit J.M dhe personave të tjerë pjesëmarrës në protestën e datës 21 janar 2011, më datën 15.02.2011 është rregjistruar proçedimi penal Nr.286/1, për veprat penale “Shpërdorim i detyrës” dhe “Kryerja e veprimeve arbitrare”. Proçedimi penal ndodhet në fazën e hetimit.

Në ankesën me nr.**2011000735**, i është rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë “Shfuqizimi i vendimit të pushimit të proçedimit penal nr.175 e vitit 2011, për veprën penale “Shpërdorimi i detyrës”, parashikuar nga neni 248 i Kodit Penal”. Arsyeja e këtij rekomandimi ka qënë për faktin se, nga ana e Prokurorisë Tiranë, është vendosur në mënyrë

të padrejtë pushimi i proçedimit lidhur me veprime të kundraligjshme të punonjësve të Z.R.P.P Tiranë, për një sipërfaqe prone. Rekomandimi është marrë në shqyrtim dhe nga ana e Prokurorisë është kthyer përgjigje se, aktet e proçedimit penal ndodhen për studim në Prokurorinë e Përgjithshme, e për rrjedhojë pritet mendimi i saj.

Në ankesën me nr.**201100684**, i është rekomanduar Prokurores së Përgjithshme “Shfuqizimi i vendimit të pushimit të proçedimit penal nr.543 e vitit 2009 të Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Gjirokastrë, për veprën penale të “Falsifikim të vizave dhe pasaportave”, parashikuar nga neni 189 të Kodit Penal”. Arsyeja e bërjes së rekomandimit ka qënë fakti se nga organi i Prokurorisë është vendosur pezullimi i hetimit të proçedimit penal, me arsyetimin se ka patur vonesa në kthimin e përgjigjeve të letërporosive nga autoritetet e drejtësisë të shtetëve të huaja. Në fakt ky veprim nuk është shkak për pezullimin e hetimeve dhe nuk është i bazuar në asnjë nga pikat e nenit 326 të Kodit të Proçedurës Penale, që bën fjalë për Pezullimin e Hetimeve. Jemi në pritje të përgjigjes.

Në disa raste të ankesave është konstatuar se organi i Prokurorisë ka vendosur në mënyrë të padrejtë dhe të pabazuar, mosfillimin apo pushimin e proçedimit penal, sidomos për veprën penale “Falsifikimi i dokumentave” për pronësinë, “Shkaktim të vetvrasjes” etj.

Së dyti: Për të drejtën e informimit, e cila lidhet kryesisht me mosinformimin për mënyrën e zgjidhjes së çështjeve të cilat fillojnë mbi bazën e kallëzimit penal të shtetasve; moskthim të përgjigjeve ose kthim të tyre me vonesë (jashtë afatit prej 15 ditë që parashikon pika 2, e nenit 110 të Kodit të Proçedurës Penale) për kërkesa apo memorie me shkrim të paraqitura nga palët gjatë hetimit; si dhe mosdhënie të kopjeve të akteve të ekspertimeve të ndryshme si autoteknik, mjeko-ligjor, apo tekniko- grafik të nënshkrimit.

Në ankesat e shqyrtuara me nr.**201100119**, **201100260**, **201100507**, **201100648** etj, është konstatuar mosinformim i palës së interesuar për ecurinë e trajtimit dhe mënyrës së zgjidhjes të kallëzimit penal që ata i drejtojnë organit të Prokurorisë. Kjo gjë vërehet në ankesën e shtetasit XH.M. nga Herraj i Komunës Zall-Herr, i cili ankohej ndaj Prokurorisë Tiranë për moskthim përgjigje për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit të tij të datës 01.03.2011. Nga verifikimi i kryer rezultoi se, Prokuroria e Rrethit Gjyqësor Tiranë më datën 10.04.2011 kishte filluar proçedimin penal nr.1599 për “Falsifikim të dokumentave”, për të cilën shtetasi mori dijëni vetëm pas dy muajve nga paraqitja e kallëzimit penal.

Shtetasit kanë patur ankesa dhe për ngjarjen e ndodhur më 21 janar 2011. I tillë është rasti i ankesës me nr.**201101966**, i shtetasit F.X. kryetar i

Sindikatave të Minatorëve të Shqipërisë, i cili ankohej se nuk është vënë në dijeni nga Prokuroria Tiranë për mënyrën e zgjidhjes së kallëzimit penal për keqtrajtim nga punonjësit e policisë së shtetit, si dhe për vendimet e zgjatjes së afatit të hetimeve. Pas kërkesës së bërë nga Zyra e Avokatit të Popullit, Prokuroria Tiranë ktheu përgjigje se nuk ka marrë zgjatje të afatit të hetimit, pasi nuk ka emra autorësh. Mbi kallëzimin e shtetasit F.X dhe personave të tjerë, është rregjistruar procedimi penal nr.286/1, për “Shpërdorim detyre” dhe “Kryerje të veprimeve arbitrare”.

Në ankesa të tjera, shtetasit i janë drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit për mosdhënie nga organi i Prokurorisë të akteve të ndryshme si, kopje të vendimit të pushimit të çështjes penale, të aktit të ekspertimit tekniko-grafik të nënshkrimit etj. E tillë është ankesa me nr.20110004 e shtetasit S.SH. në cilësinë e kryetarit të një shoqate, drejtuar Prokurorisë për Krime të Rënda Tiranë, ndaj të cilëve ishte filluar procedimi penal nr.4 i vitit 2008 për veprën penale të parashikuar nga neni 230/a i Kodit Penal.

Në ankesën me nr.**201100071** shtetasi F.S. nga Tirana, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit për mosdhënie të kopjes së aktit të ekspertimit tekniko-grafik të vitit 2010, për arsye se kërkesën e kishte paraqitur verbalisht. Nga ana jonë ankuesi F.S. u orientua që të paraqeste në Prokurori kërkesën me shkrim për marrjen e dokumentit, sipas nenit 110 Pika 1 e Kodit të Procedurës Penale. Pas kryerjes së këtij veprimi ai mori dhe aktin e ekspertimit të kërkuar.

Moskthim të përgjigjeve ose kthim me vonesë për letrat (ankesat) drejtuar Prokurorisë së Përgjithshme.

Në ankesën me nr.**201101034**, shtetasi B.G. nga Tirana, ankohej ndaj Prokurorisë së Përgjithshme për moskthim të përgjigjeve për ankesat e drejtuara atij Institucioni përkatësisht në datat 21.04.2011 dhe 01.06.2011, për kallëzimin penal “Vjedhja e pasurisë” etj, drejtuar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Lezhë. Ankuesi B.G. është sqaruar nga punonjësit e atij institucioni, pas disa muajve dhe konkretisht më datën 07.10.2011

Në ankesën me nr.**201100683** shtetasi S.I. nga Tirana, ankohej ndaj Prokurorisë së Përgjithshme e cila nuk i ka kthyer përgjigje ankesës së tij për zvarritje të hetimeve nga Prokuroria Tiranë.

Së treti: Ka patur raste të ankesave kur prokurorët që merren me ekzekutimin e vendimeve penale, nuk kanë kryer veprimet e nevojshme me qëllim nxjerrjen e urdhërit të ekzekutimit në afatin e caktuar, çka ka sjellë për pasojë qëndrimin e të dënuarit në paraburgim ose burgim, më tepër se koha e vuajtjes së dënimit të përcaktuar në vendimin e gjykatës.

Në ankesat me nr.**201101294**, **201100132**, **201100588** shtetas të ndryshëm të dënuar, janë ankuar ndaj Prokurorive për nxjerrje me vonesë të

urdhërit për ekzekutimin e vendimeve penale që ka marrë formë të prerë. I tillë është rasti i ankesës të dënuarit H.H. që ishte duke vuajtur dënimin në I.E.V.P. Lushnje, i cili ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Tiranë për arsye se nuk kishte nxjerrë urdhërin e ekzekutimit për bashkimin e dënimeve nga gjykata. Pas dërgimit nga gjykata në datën 23.09.2011, ardhur në prokurori më datën 05.10.2011, urdhëri i është dërguar I.E.V.P. Lushnje më datën 07.10.2011. Duke zbatuar nenin 22 të Ligjit Nr. 8331, datë 21.4.1998 “Për ekzekutimin e vendimeve penale” i ndryshuar, roli i prokurorit duhet të jetë më aktiv, kjo për faktin se ai jo vetëm duhet të presë vendimet që kanë marrë formë të prerë nga gjykata, por dhe të marrë masat për tërheqjen e tyre menjëherë në gjykatë.

Së katërti: Avokati i Popullit ka filluar me inisiativë shqyrtimin dhe hetimin e rasteve kur punonjësit e policisë së shtetit apo të burgjeve, kanë kryer veprime të dhunshme ndaj shtetasve ose të dënuarve me pasoja në shëndetin e tyre, pas rekomandimit për fillimin e hetimit për veprën penale të “Torturës”, Prokuroritë e Rretheve Gjyqësore kanë ndryshuar kualifikimin e veprës në “Shpërdorim detyre” apo “Kryerje të veprimeve arbitrare”, dhe në përfundim është vendosur pushimi i çështjes penale.

Në ankesën me nr.**201100472** i është rekomanduar Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë “fillimi i hetimit për veprën penale të “Torturës”, parashikuar nga neni 86 i Kodit Penal, në ngarkim të punonjësve të policisë, të Sektorit të Operacioneve Speciale të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Vlorë dhe Forcave të Ndërhyrjes së Shpejtë Fier, të cilët më datën 25.03.2011 kanë hyrë në banesën e shtetasit R.H. duke e qëlluar me qytat e automatikëve dhe shkelma në pjesë të ndryshme të trupit, e më pas e kanë tërhequr zvarrë duke e futur në mjetet e policisë me dhunë. Rekomandimi është pranuar dhe në përgjigjen e saj Prokuroria Vlorë sqaron se ka filluar hetimin për veprën penale të “Shpërdorimit të detyrës”, i cili aktualisht ndodhet në fazën e hetimit. Këtë rast e përmendëm për pjesën e keqtrajtimit dhe prezantimin që i kemi bërë veprimtarisë së Policisë së Shtetit.

Së Pesti: Në mosrespektimin e dispozitave që bëjnë fjalë për “Disponimin e provës materiale”, parashikuar nga neni 190 i Kodit të Proedurës Penale. Evidentohet një grup ankesash të drejtuar ndaj organit të Prokurorisë, lidhur me trajtimin e sendeve prova materiale të sekuestruara gjatë hetimit, të cilat në disa raste u janë kthyer me vonesë personave të interesuar.

I tillë është rasti i ankesës me nr.**201101381** shtetasi H.Ç. nga Tirana, i cili ankohej ndaj Prokurorisë së atij rrethi për arsye se nuk i ka kthyer mjetin tip kamionçine “Cama”, me të cilin djali i tij E.Ç. bëri aksidentin automobilistik, ndonëse doli i pafajshëm sipas konkluzioneve të aktit të

ekspertimit autoteknik. Me ndërhyrjen e Zyrës tonë nga Prokuroria pati mirëkuptim dhe, pas kryerjes së riekspertimit autoteknik të kërkuar nga familjarët e viktimës, personit të interesuar H.Ç. iu dorëzua mjeti që kishte në pronësi.

Në ankesën me nr.**201100813** shtetasit D.Sh. nga Vlora, ankohej ndaj Prokurorisë së Rrethit Gjyqësor Vlorë, e cila nuk i ka kthyer shumën prej 8700 lek, bllokuar si provë materiale autorit të vjedhjes së dyqanit që kishte në pronësi dhe më pas derdhur në bankë për llogari të proçedimit penal Nr.204 të vitit 2008.

Konstatohet reagim i Prokurorisë lidhur me pranimin e kërkesave të familjarëve të viktimave apo të dëmtuarëve nga vepra penale “Shkelja e rregullave të qarkullimit rrugor”, për të caktuar ekspertin. Megjithatë në disa raste, hetimi i kësaj vepre penale le për të dëshiruar, pasi nga organi i Prokurorisë pritet më tepër hetim korrekt objektiv dhe i shpejtë për këtë vepër shqetësuese për qytetarët, dhe pasojat që vijnë nga kryerja e saj.

Veprimtaria e Zyrave të Sherbimit Përmbarrimor Shteteror

Mosekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë, si përmbushje e të drejtës për një proces të rregullt ligjor.

Një pjesë të rëndësishme të respektimit dhe mbrojtjes të së drejtës së individit për një proces të rregullt ligjor, e zë ekzekutimi i vendimeve gjyqësore të formës së prerë apo titujve ekzekutive.

Në procesin e shqyrtimit të rasteve, në të cilat ankuesit kanë ngritur shqetësimin për mosgëzimin e së drejtës të fituar në rrugë gjyqësore, mbi bazë të një vendimi gjyqësor të formës së prerë apo akteve të tjera të quajtura titull ekzekutiv, Institucioni i Avokatit të Popullit ka konstatuar se, organi i ngarkuar nga ligji me misionin e ekzekutimit të tyre, shkel parimin kushtetues të sanksionuar në nenin 42 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë si dhe nenin 6/1 të “Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore”, për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor, e drejtë e cila garantohet nga aktet ligjore dhe nënligjore në fuqi, si :

Në nenin 42, pika 1 dhe 2 të Kushtetutës së Republikës të Shqipërisë, ku sanksionohet se: “*Liria, prona dhe të drejtat e njohura me Kushtetutë dhe me ligj nuk mund të cënohen pa një proces të rregullt ligjor.*”

Kushdo, për mbrojtjen e të drejtave, të lirive dhe të interesave të tij kushtetuese dhe ligjore, ose në rastin e akuzave të ngritura kundër tij, ka të drejtën e një gjykimi të drejtë dhe publik brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme e caktuar me ligj.”

Ndërsa në nenin 142, pika 3 të Kushtetutës, parashikohet se: *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore.”*

Në nenin 6/1 të “Konventës për mbrojtjen e të drejtave të njeriut dhe lirive themelore” sanksionohet se: *“Gjithkush ka të drejtë që çështja e tij të dëgjohet drejtësisht, publikisht dhe brenda një afati të arsyeshëm nga një gjykatë e pavarur dhe e paanshme, e krijuar ligjërisht, e cila të vendosë qoftë për pretendimet që mund të shfaqen ndaj të drejtave dhe detyrimeve të tij me karakter civil, qoftë për të përcaktuar nëse është e bazuar çdo akuzë e natyrës penale e drejtuar kundër tij...”*

Veç sa sipër kemi dhe përcaktimet që bëhen në dispozitat ligjore të ligjit nr. 8116, datë 29.03.1996, (K.Pr.C.) i ndryshuar, ligjit nr. 7850, date 29.07.1994, (Kodi Civil) i ndryshuar, si dhe ligjit nr.8730, datë 18.01.2001, i ndryshuar, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror”.

Në mospërputhje me parashikimet e akteve ligjore të sipërcituara si dhe atyre të nxjerra në funksion të tyre, Shërbimi i Përmbarrimit Gjyqësor Shtetëror, në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv, me rastin e mospërmbushjes së detyrimit në mënyrë vullnetare prej palës debitore, rezulton se nuk kryen në mënyrë aktive veprimet përmbarrimore të cilat do të mund të sjellin ekzekutimin e detyrueshëm të tyre, duke mos luajtur në këtë mënyrë rolin vendimtar që i takon në procesin e ekzekutimit. Në shumicën e ankesave të depozituara pranë Institucionit të Avokatit të Popullit, konstatohet lehtësisht se, shteti nuk ka marrë përsipër në mënyrë vijuese dhe rast pas rasti, detyrimin për të siguruar palët pjesëmarrëse në procesin e ekzekutimit se, do të kenë mundësi reale të ekzekutojnë titujt ekzekutiv, qëndrim i cili, të drejtën për të pasur akses në gjykatë, për subjektet ankues, e ka shndërruar në iluzion, për faktin e pazbatueshmërisë së titullit ekzekutiv për një kohë tepër të gjatë.

I këtij vlerësimi ka qënë Gjykata Kushtetuese gjatë vitit 2011, kur ka gjykuar dhe pranuar kërkesat e tetë subjekteve të ndryshëm, me objekt të njëjtë: *“Konstatimin e cënimit të parimit për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë nga autoritetet e ngarkuara nga ligji, brenda afatit të arsyeshëm, në kuptim të nenit 42 të Kushtetutës dhe nenit 6/1 të Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut”.*

Tre nga tetë kërkuesit, përpara se t'i drejtoheshin Gjykatës Kushtetuese me objektin e sipërcituar, kanë kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit pranë organeve kompetente të ngarkuara nga ligji për ekzekutimin e titujve ekzekutiv, për rivënien në vend të së drejtës së shkelur, si; rasti me nr.doc. **201000052**, ankues shtetasi S.Gj., rasti me nr.**201100086** ankues shtetësja A.L. dhe rasti me nr.**201100802**, ankues shtetasi V.A. Edhe pse Gjykata Kushtetuese ka konstatuar në këto raste shkeljen e parimit për një proces të rregullt ligjor si pasojë e mosekzekutimit të vendimit gjyqësor të formës së prerë, nga autoritetet e ngarkuara nga ligji për ekzekutimin e tij brenda afatit të arsyeshëm, ende dhe sot nuk është bërë i mundur realizimi i së drejtës për subjektet gjyqfitues.

Në kuptim dhe zbatim të sanksionimit të nenit 142/3 të Kushtetutës, se: *“Organet e shtetit janë të detyruara të ekzekutojnë vendimet gjyqësore”*, qytetari apo subjekti nuk mund të presë pa kufi për realizimin e së drejtës, pasi ekzekutimi i titullit ekzekutiv përbën një element thelbësor të së drejtës e të vetë nocionit të gjykimit të drejtë, pra çdo organ shtetëror detyrohet të marrë masat përkatëse për zbatimin e tyre.

Në shqyrtimin e rastit me nr. doc. **201000052**, të krijuar mbi bazë të ankimit nga shtetasi S.Gj, i është rekomanduar palës gjyqbjerrëse, Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit, marrja e masave për ekzekutimin e detyrimit për rikthimin e ankuesit në vendin e mëparshëm të punës si dhe pagimin e pagës për kohën e qëndrimit pa punë, sikurse ishte vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me Vendimin Gjyqësor nr. 6708, datë 30.11.2009. Pa asnjë shkak të ligjshëm, pala debitore, nuk ka kryer dhe nuk kryen përmbushjen e detyrimit të vendosur, duke shkelur në këtë mënyrë detyrimin e sanksionuar në dispozitën kushtetuese, neni 142/3 të Kushtetutës.

E njëjta situatë paraqitet dhe në rastet me:

- **nr. Doc. 201001682**, në të cilin shqyrtohet ankesa e shtetases L.L. për mospërmbushjen e detyrimit të vendosur nga Komisioni i Shërbimit Civil (KSHC) me Vendimin nr. 187, datë 21.11.2002, për:

“Anullimin e Urdhërit nr.123, datë 22.08.2002 të Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë si të pabazuar në ligj, kthimi i ankueses në detyrën e mëparshme etj.

Në procesin e shqyrtimit të këtij rasti i është rekomanduar palës debitore, METE, marrja e masave për ekzekutimin e detyrimit të vendosur. Deri më sot nuk është bërë e mundur shprehja e qëndrimit rreth rekomandimit të dhënë.

- **nr. Doc. 201001792**, lidhur me ankesën e shtetasit N.B. për mospërmbushjen e detyrimit të vendosur nga KSHC me Vendimin nr. 223,

datë 04.04.2006, për : *”Detyrimin e Sekretarit të Përgjithshëm t’i ofrojë ankuesit N.B. pozicionin Përgjegjës Sektori në Drejtorinë e Përgjithëshme të Emergjencave Civile”*, për të cilën i kemi rekomanduar me shkresë nr. K2/N17-3 Prot, datë 29.12.2010, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme kryerjen e veprimeve për ekzekutimin e detyrimit të vendosur sipas Vendimit nr. 223, datë 04.04.2006, të KSHC. Deri më sot nuk është bërë e mundur kthimi i përgjigjes për këtë rekomandim.

- **nr. Doc. 201001594**, në të cilin shqyrtohet ankesa e shtetasit I.H. për mospërbushjen e detyrimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me Vendimin nr. 6642, datë 24.11.2006, për:

“Anullimin e Urdhërit nr.20, datë 28.03.2006 të Prefektit të Qarkut, Tiranë, për lirim nga detyra të paditësit I.H.

Detyrimin e palës së paditur Prefektura e Qarkut, Tiranë, t’i paguaj paditësit I.H. si dëmshpërblim, pagën e 8 muajve pune si dhe t’i paguaj pagën që duhet të përfitojë për lejen e zakonshme që i takon për vitin 2006, në bazë të punës së kryer për këtë vit”. Në vijim i kemi rekomanduar me shkresën nr. K2/I14-7 Prot, datë 08.02.2011, Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, vendosjen e masës së sekuestros mbi llogarinë e palës debitore, pranë Degës së Thesarit, Tiranë. Deri më sot shprehja e qëndrimit prej Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë apo DPShPGjSh për rekomandimin e dhënë nuk është kryer, megjithëse Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 3983/1 Prot, datë 21.06.2011, i ka kërkuar këtij Shërbimi që të informohet Institucioni i Avokatit të Popullit.

- **nr. Doc. 201001445**, lidhur me ankesën e shtetasit A.P. për mospërbushjen e detyrimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me Vendimin nr. 1144, datë 16.07.2007, për të cilin i është rekomanduar Ministrisë së Brendshme marrja e masave ligjore për përbushjen e detyrimit të vendosur. Në përgjigje të rekomandimit, pala debitore shprehet se likuidimi do të kryhet me krijimin e mundësive financiare. Deri më sot nuk është bërë e mundur përbushja e detyrimit në favor të gjyqfituesit.

- **nr. Doc. 201001311**, lidhur me ankesën e shtetasit H.P. për mospërbushjen e detyrimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me Vendimin nr. 10006, datë 19.11.2008, për:

“Detyrimin e palës së paditur, Ministria e Brendshme për të nxjerrë aktin administrativ përkatës të tij për shqyrtimin dhe mënyrën e zgjidhjes së çështjes së 168 familjeve të Fshatit Bicaj, Rrethit Kukës, të cilët kanë mbajtur dhe strehuar familjet kosovare gjatë muajit Prill-Maj të vitit 1999, sipas listës bashkëngjitur Vendimit nr.89, datë 21.06.2005 të Këshillit të Komunës Bicaj”, për të cilin i kemi rekomanduar me shkresën nr. K2/H17-9

Prot, datë 03.03.2011, Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Brendshme kryerjen e veprimeve për ekzekutimin e detyrimit të vendosur sipas Vendimit nr. 10006, datë 19.11.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Deri më sot nuk është bërë e mundur kthimi i përgjigjes për këtë rekomandim.

- **nr. Doc. 201001115**, në të cilin kemi shqyrtuar ankesën e shtetasit B.F. për mospërmbushjen e detyrimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me Vendimin nr. 2080, datë 07.03.2008, për:

“Detyrimin e palës së paditur Drejtoria nr.3 e Punëtorëve të Qytetit Tiranë t’i paguaj paditësit B. F. pagën e 1 (një) viti pune, në masën e pagës së fundit që paditësi ka marrë pranë palës së paditur”. Për këtë rast kemi rekomanduar me shkresën nr. K2/B26-8 Prot, datë 10.11.2010, titullarit të palës debitore marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e Vendimit nr. 2080, datë 07.03.2008, të Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Tiranë. Në vijim është kthyer përgjigje prej palës debitore, duke bërë të ditur se respektimi i detyrimit të vendosur do të kryhet me miratimin e buxhetit për vitin 2011. Rezulton se gjatë vitit 2011 nuk është bërë e mundur përmbushja e detyrimit të vendosur.

- **nr. Doc. 201000736**, lidhur me ankesën e shtetasit S.K. për mospërmbushjen e detyrimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Kukës, me Vendimin nr. 102, datë 09.05.2001, me objekt:

“Anullimin e Urdhërit nr.46/1, datë 17.01.2001 të Drejtorisë së Policisë, Qarku Kukës, për përjashtimin nga Policia e Shtetit të paditësit S. K., duke i kthyer të gjitha të drejtat e cënuara nga ky vendim.

I është rekomanduar Ministrit të Brendshëm marrja e masave për zbatimin e Vendimit nr.102, datë 09.05.2001, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Kukës. Deri më sot nuk ka asnjë përgjigje për këtë rekomandim.

- **nr. Doc. 201000274**, lidhur me ankesën e shtetasit Z.D. për mospërmbushjen e detyrimit të vendosur nga KSHC me Vendimin nr. 38, datë 20.02.2002, me objekt:

“Pranimin e ankesës së Z.D., duke shfuqizuar Vendimin nr.6208 prot, datë.03.12.2001 të Ministrit të Punëve Publike dhe Turizmit, për moskonfirmimin si nëpunës civil, në postin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Punëve Publike dhe Turizmit, dhe kthimin e tij në vendin e mëparshëm të punës.

Pagimin e pagave për gjithë kohën e qëndrimit pa punë, padrejtësisht”.

I është rekomanduar me shkresën nr. K2/S12-6 Prot, datë 23.06.2010, Ministrit të Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit marrja e

masave për zbatimin e Vendimit nr.38, datë 20.02.2001, të dhënë prej K.SH.C. Deri më sot megjithëse ka kaluar më shumë se një vit nuk është bërë e mundur kthimi i përgjigjes për këtë rekomandim.

- **nr. Doc. 201100543**, lidhur me ankesën e shtetasit F.B. për mospërbushjen e detyrimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me Vendimin nr. 2283, datë 13.03.2008, me objekt:

“Detyrimin e palës së paditur Dega e Policisë së Ndërtimit Tiranë, sot Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar Tiranë, të dëmshpërblejë dëmin e shkaktuar palës paditëse F. B., në masën 13.171.410 lekë.

Detyrimin e Inspektoriati Ndërtimor Urbanistik Kombëtar Tiranë, të paguaj shpenzimet gjyqësore”, i është rekomanduar Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, vendosja e masës së sekuestros mbi gjithë zërat (artikujt) e llogarisës së palës debitore pranë Degës së Thesarit, Tiranë, si dhe kërkimi pranë palës debitore për deklarimin e gjendjes pasurore, si dhe sendeve ose kredive që personat e tretë i detyrohen asaj. Pranuar rekomandimi por deri më sot nuk është bërë e mundur përmbushja e detyrimit të vendosur.

- **nr. Doc. 201101884**, për ankesën e shtetasit R.I. për mospërbushjen e detyrimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me Vendimin nr. 4544, datë 03.06.2010, për:

“Detyrimin e AKKKP-së të paditurit për të shqyrtuar kërkesën për subjektet e shpronësuar H e R.I., kërkesë e datës 23.07.2008 në lidhje me njohjen e së drejtës së pronësisë si edhe kthimin dhe/ose kompesimin e pronës së pretenduar, prej 170 dy ndodhur në Kamëz, Tiranë”. Për këtë rast kemi rekomanduar titullarit të AKKKP, Tiranë, marrjen e masave të menjëhershme për përmbushjen e detyrimit të vendosur. Qëndrimi i mbajtur rreth rekomandimit vlerësohet pengim ekzekutimi titulli ekzekutiv. Gjithashtu i është rekomanduar Zyrës së Përmbarrimit, Tiranë, vendosja e sanksionit të gjobitjes ndaj titullarit të palës debitore si dhe çdo personi tjetër i cili nuk ka kryer dhe nuk kryen veprimet e parashikuara në urdhërin e ekzekutimit ose në ligj. Pa përgjigje deri më sot, rezulton ky rekomandim.

- **nr. Doc. 201101920**, lidhur me ankesën e shtetasit P.G. për mospërbushjen e detyrimit të vendosur nga Gjykata e Rrethit Gjyqësor, Tiranë, me Vendimin nr. 172, datë 17.02.2004, për:

“Detyrimin e të paditurit B. P. të prishë ndërtimin e bërë në parcelën paditësit P.G.”. Për këtë i është rekomanduar Inspektoriatit Ndërtimor Urbanistik Kombëtar marrja e masave të menjëhershme për mbështetjen e Zyrës së Përmbarrimit, Lezhë, në procesin e ekzekutimit të detyrueshëm të titullit ekzekutiv. Deri më sot nuk është bërë e mundur shprehja e qëndrimit prej INUK-së.

Për të gjithë rastet e sipërpërmendura, pas marrjes së shpjegimeve dhe informacionit, rast pas rasti prej palës debitore apo zyrave të përmbarimit, është konstatuar se mosrespektimi i të drejtave dhe lirive të garantuara me ligj, për palët në procesin e ekzekutimit të titullit ekzekutiv, vjen si rezultat i:

1- Mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë dhe objektivitetit, nga ana e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror (ShPGjSh), përmbaruesit gjyqësor të çështjes, parime të cilat janë të sanksionuara në nenin 2 të Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror”, i ndryshuar. Shkelja e parimeve në fjalë, në rastin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv me objekt, “Detyrim për pagim në të holla prej institucioneve buxhetore”, apo “Detyrim për kryerjen e një veprimi të caktuar”, vjen si rezultat i: a) Moskryerjes së veprimtarisë nga ana e DPShPGjSh në përputhje të plotë dhe konsekuente me parashikimet e bëra në nenet 517, paragrafi dytë, 527, 583, 589 dhe 606 të K.Pr.C., b) Ushtrimi në mënyrë të padrejtë e të parregullt prej zyrave të përmbarimit, përmbaruesve gjyqësor të çështjes, i së drejtës për të refuzuar kryerjen e veprimeve përmbarimore në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv (rasti me nr.doc. 201000697, nr.201000697) pa u ndodhur në kushtet e parashikuar në dispozitën ligjore, neni 610, c) Pushimi i ekzekutimit të titujve ekzekutiv (rasti me nr.doc. 201001284, rasti me nr.doc. 201101285, nr. 201100365, nr.201100365) pa u ndodhur në kushtet e parashikuara në dispozitën ligjore, neni 616 të K.Pr.C., d) Shfaqja e mungesës së aftësive profesionale në procesin e ekzekutimit (rasti me nr. doc. 20100697, nr.201101032, nr.201100802, nr.201100715, nr.201100365.)

2- Mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë prej titullarëve të institucioneve buxhetore debitore apo organeve eprore financiare të tyre, sikurse parashikohet në nenet 20 dhe 21 të Ligjit nr.8510, datë 15.07.1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”, në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv.

3- Mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë prej titullarëve të degëve të thesarit në rrethe, siç sanksionohet në nenin 581, 589 të K.Pr.C. në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv, sipas të cilëve rezultojnë debitor institucione buxhetore.

4- Mosrespektimit të parimit të ligjshmërisë prej titullarëve të palëve të treta në procesin e ekzekutimit, sikurse është sanksionuar në nenin 523 të K.Pr.C. (rasti me nr.doc. 201101920).

Në procesin e shqyrtimit të rasteve të sipërcituara, Institucioni i Avokatit të Popullit, për situatat në të cilat janë ndodhur dhe ndodhen çështjet në procesin e ekzekutimit, i ka rekomanduar zyrave të përmbarimit, përmbaruesve gjyqësor të çështjes, palës debitore si dhe personave të tjerë,

kryerjen e veprimeve të caktuara të cilat bëjnë të mundur materializimin e së drejtës për subjektet gjyqfitues, si dhe rivënien në vend të së drejtës për zhvillimin e një procesi të rregullt ligjor. Nisur nga qëndrimet e mbajtura prej ShPGjSh, në procesin e ekzekutimit të titujve ekzekutiv me objekt: “Detyrim për pagim në të holla prej institucioneve buxhetore”, apo “Detyrimin e tyre për kryerjen e një veprimi të caktuar” të krijohet bindja e dorëzimit të këtij Shërbimi në kryerjen e procedurave për ekzekutim të detyrueshëm ndaj organeve dhe institucioneve shtetërore si dhe lënien e misionit të ekzekutimit në vullnetin e institucioneve buxhetore debitoare, kjo për faktin se ShPGjSh, ose nuk kryen rast pas rasti veprimet e parashikuara në ligj për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, ose kryen në mënyrë të përsëritur, të panevojshme e të padetyruar, veprime përmbartimore lajmëruese ose urdhëruese (rasti me nr.doc. 201001089, nr.201000736, nr.201100729, 201100109.)

Në procesin e shqyrtimit të rasteve të sipërpërmendura, Institucioni i Avokatit të Popullit, rast pas rasti, ka rekomanduar, ose marrjen e masave ligjore prej organeve dhe institucionet debitoare për përmbushjen e detyrimit të vendosur, ose i ka rekomanduar ShPGjSh-së kryerjen e veprimeve të caktuara përmbartimore për ekzekutimin e detyrueshëm të titujve ekzekutiv, si, vendosjen e masës së sekuestros mbi të gjithë zërat (artikujt) e llogarisë në thesar të palës debitoare, gjobitjen e titullarëve të palës debitoare ose çdo personi tjetër, të cilët në procesin e ekzekutimit kanë refuzuar, kryer në mënyrë të parregullt, mosrespektuar afatet, si dhe kanë kryer të kundërtën e asaj që me vendim të gjykatës ose ligjit janë detyruar.

Reagimi i institucioneve buxhetore ndaj rekomandimeve për marrjen e masave në përmbushjen e detyrimit të vendosur, për rastet në fjalë, ka qenë ose premtim për ekzekutimin e tij në të ardhmen (si në rastin me nr.doc. 201001445), ose është heshtur për kthimin e përgjigjes, duke shkelur në këtë mënyrë detyrimin për t’iu përgjigjur rekomandimeve të Avokatit të Popullit, në respektim të parashikimit të kryer në nenin 22 të Ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Përkundër qëndrimit të mbajtur prej institucioneve buxhetore debitoare në procesin e ekzekutimit të detyrimeve në të holla ndaj palëve gjyqfituese, Institucioni i Avokatit të Popullit, referuar parashikimit të nenit 589 të K.Pr.C., ku thuhet se:

“...Këshilli i Ministrave nxjerr udhëzim për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”, ka nisur në muajin Dhjetor 2010 (rasti me nr. doc. 201001754) me inisiativë, çështjen për nxjerrjen e aktit nënligjor prej Këshillit të Ministrave. Në përmbushje të detyrimit ligjor, Këshilli i Ministrave, nxorri Udhëzimin nr.

02, datë 18.08.2011, “Për mënyrën e ekzekutimit të detyrimeve monetare të institucioneve buxhetore në llogari të thesarit”, i cili në vlerësim të Institucionit të Avokatit të Popullit nuk vjen në funksion të parashikimeve të kryera në nenin 517, 529 dhe 581, paragrafi i dytë, i K.Pr.C., si dhe nenin 20 dhe 21 të Ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999, “Për përgjegjësinë jashtëkontraktore të organeve të administratës shtetërore”. Në referim të parashikimit të nenit 20 dhe 21 të Ligjit nr. 8510, datë 15.07.1999, institucionet buxhetore debitorë duhet të kishin kryer apo të kryejnë veprimet për futjen si zë i veçantë në ligjin e buxhetit të shtetit të vitit pasardhës të detyrimit të vendosur sipas titujve ekzekutivë, veprime të cilat, ose nuk janë kryer, ose dhe kur janë kryer nuk janë marrë dhe nuk merren në konsideratë rast pas rasti prej organeve eprore financiare.

Më shqetësuese paraqitet situata në bashkëpunimin e Avokatit të Popullit me zyrat e përmbarimit në rrethe dhe në mënyrë të veçantë me Drejtorinë e Përgjithshme të Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror, e cila për hir të së vërtetës, duhet thënë se nuk ekziston. Ky organ (DPSHPGjSh), në procesin e shqyrtimit të rekomandimeve të dërguara prej Institucionit të Avokatit të Popullit, apo kërkesave për të bërë të mundur dhënien e shpjegimeve dhe informacionit nga zyrat e përmbarimit, nuk ka shprehur vullnet për bashkëpunim, qëndrim i cili jo vetëm ka shkelur detyrimin ligjor, të përcaktuar në nenin 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, por ka krijuar dhe premisat për mosushtrimin nga ana e tij të përgjegjësisë, sikurse parashikohet në nenin 8 të Ligjit nr. 8730, datë 18.01.2001, “Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor”, i ndryshuar. Qëndrimi mosbashkëpunues prej DPSHPGjSh-së, vjen ndesh me parashikimin e nenit 22 të Ligjit nr.8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, të ndryshuar. Ndër raste e trajtuara përmendim:

1- **Nr. 201001594 Doc.** Në këtë rast i është kërkuar me shkresën nr. K2/I14-9 Prot, datë 09.03.2011, DPSHPGjSh të bëjë të mundur kthimin e përgjigjes për rekomandimin e dhënë Zyrës së Përmbarimit, Tiranë, me shkresën nr. K2/I14-7 Prot, datë 08.02.2011. Nuk kemi asnjë përgjigje dhe prezantim të shkaqeve për mospërmbushjen e saj. Gjithashtu, për qëndrimin e mbajtur në këtë rast si dhe gjashtë rastet e prezantuara në shkresën nr.K/G12-12 Prot, datë 06.01.2011, është njoftuar me shkresën nr. K2/I14-13 Prot, datë 16.05.2011, drejtori i DPSHPGjSh-së, për t’u paraqitur në datën dhe orën e përcaktuar pranë zyrave tona. Përsëri nga ana e tij mbahet i njëjti qëndrim refuzues për bashkëpunim, megjithëse Ministria e Drejtësisë me shkresën nr. 3983, datë 21.06.2011, i ka tërhequr vëmendjen atij për të informuar Avokatin e Popullit, për rastet e bëra prezent.

2- **Nr. 201001466 Doc.** Në këtë rast është kërkuar me shkresën nr. K2/A66-11 Prot, datë 22.07.2011, që DPSHPGjSh-ja, të kthejë përgjigje për rekomandimin dërguar Zyrës së Përmbartimit, Tiranë, me shkresën nr. K2/I14-7 Prot, datë 08.02.2011. Nuk kemi akoma asnjë përgjigje dhe prezantim të shkaqeve për mospërmbushjen e saj.

3- **Nr. 201000736 Doc.** Në këtë rast i është rekomanduar me shkresën nr. K2/S12-7 Prot, datë 23.06.2010, Zyrës së Përmbartimit, Kukës, për dijëni DPSHPGjSh-së, të marrë masat ligjore për ekzekutimin e detyrueshëm të Vendimit Gjyqësor nr. 102, datë 09.05.2001, por deri më sot nuk kemi kthim përgjigjeje nga ana e organeve në fjalë.

4- **Nr. 201000666 Doc.** Në këtë rast i është rekomanduar me shkresën nr. K2/H10-7 Prot, datë 06.09.2010, DPSHPGjSh-së marrja e masave të menjëhershme për rikthimin e dosjes përmbartimore Zyrës së Përmbartimit, Gjirokastër, krijuar me rastin e kërkimit të ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor nr. 1311/T-52, datë 15.07.2008, prej shtetasit H.Sh. Nuk kemi asnjë përgjigjeje nga ana e DPSHPGjSh-së.

5- **Nr. 201100567 Doc.** Në këtë rast i është rekomanduar me shkresën nr. K2/B7-9 Prot, datë 23.06.2011, DPSHPGj-së të bëjë të mundur marrjen e nismës për fillimin e procedimit disiplinor ndaj përmbartuesit gjyqësor i cili nuk ka kryer dhe nuk kryen veprimet përmbartimore të parashikuara në ligj në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor nr. 2798, datë 18.04.2007. Dhe ky rekomandim rezulton pa përgjigje.

Veç rasteve të cituara më sipër, vlen të përmendet qëndrimi i mbajtur prej Zyrës së Përmbartimit, Tiranë, në procesin e ekzekutimit të Vendimit Gjyqësor nr.392, datë 24.08.1995, të dhënë prej Gjykatës së Rrethit Gjyqësor, Gramsh, me objekt: “Shpërblim dëmi për shkak të mosushtrimit të rregullt të drejtësisë”.

Zyra e Përmbartimit, Tiranë, në procesin e ekzekutimit të këtij Titulli Ekzekutiv, në mënyrë të paligjshme e të pajustificueshme, në vlerësimin e Institucionit të Avokatit të Popullit, me Vendimin nr. 10932 Prot, datë 02.11.2007, ka vendosur për refuzimin e kryerjes së veprimeve përmbartimore për ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor nr. 392, datë 24.08.1995, duke u bazuar në Udhëzimin e Përbashkët të Ministrisë së Financave dhe Ministrisë së Drejtësisë, “Për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore që njohin dhe kompensojnë burgimin e padrejtë”, i cili në pikën 2 përcakton se:

“Kërkesa për kompensim duhet bërë pranë Ministrisë së Financave nga vetë i interesuari duke evituar kështu pagimin e taksës përmbartimore”.

Akti nënligjor, të cilit i referohet Zyra e Përmbartimit, Tiranë, për justifikimin e refuzimit të kryerjes së veprimeve përmbartimore në

ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor nr.392, datë 24.08.1995, nuk është detyruar për Zyrën e Përmbartimit Tiranë dhe për më tej, të shërbejë si shkak për moskryerjen e veprimeve përmbartimore në ekzekutimin e Titullit Ekzekutiv nr.392, datë 24.08.1995. Në trajtimin e këtij rasti, Zyra e Përmbartimit Tiranë, si shkak ligjor për moskryerjen e veprimeve për ekzekutim, duhet të referonte parashkrimin e së drejtës për të kërkuar ekzekutimin e Vendimit Gjyqësor nr. 392, datë 24.08.1995 dhe jo, përcaktimin e kryer në aktin nënligjor të nxjerrë prej Ministrisë së Financave.

Për të gjithë rastet e prezantuara, në të cilat përcaktohet detyrimi i institucioneve apo organeve shtetërore të kryejnë një veprim të caktuar, duke përjashtuar detyrimin për pagimin e të hollave, është e pajustificueshme mbajtja e qëndrimit pengues prej tyre në përmbushjen e detyrimeve të vendosura.

Tjetër veprim i parregullt i kryer prej zyrave të përmbartimit në rrethe është pranimi i kërkesave të organit të prokurorisë për vënien në ekzekutim të urdhrave të ekzekutimit, lëshuar prej prokurorëve të çështjes penale, për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore penale, sipas të cilave është vendosur dënimi me gjobë i subjekteve. Ky veprim vjen ndesh me parashikimin e bërë në nenin 510/e, 511/ç të K.Pr.C. (rasti me nr.doc. **201100230**, nr.**201100572**.)

- Ndhimja ligjore falas

Legjislacioni ynë njih të drejtën e shërbimit ligjor falas, por ky shërbim tek ne vërehet se ka akoma probleme serioze, sidomos në lidhje me kërkesat për rishikim vendimi në Gjykatën e Lartë, si për çështje penale ashtu dhe për çështje të tjera në fushën civile. Për shkak të vështirësive ekonomike shumë qytetarë nuk kanë mundësi financiare për të siguruar një avokat privat për mbrojtjen e të drejtave të tyre përpara organeve të prokurorisë ose gjykatës. Klinikat ligjore që ofrojnë këtë mundësi janë të pakëta. Kuvendi i Shqipërisë plotësoi boshllëkun ligjor me nxjerrjen e ligjit nr.10039, date 22.12.2008 “Për ndihmë juridike”, ku parashikohen kushtet, lloji i ndihmës ligjore, mënyra dhe procedura që duhet të ndiqet për dhënien e ndihmës juridike, i profesionalizmit të personave që japin ndihmë juridike, cilësia, efica dencia dhe efektiviteti i kësaj ndihme, i ruajtjes së konfidencialitetit dhe të papranueshmërisë së konfliktit të interesit. Edhe në këtë ligj parashikohet shprehimisht se ndihma juridike nga shteti jepet nga avokatë të autorizuar sipas ligjit, dhe në kushtet e parashikuara në ligj.

Të drejtën për të përfituar ndihmë juridike e kanë personat të cilët kërkojnë të mbrohen me avokat në procedime penale, në të gjitha fazat e tij dhe për shkak të pamundësive financiare, pasi nuk kanë mundësi të zgjedhin vet një avokat mbrojtës ose që kanë mbetur pa të. Të drejtën për ndihmë juridike nga shteti e kanë edhe personat që kanë për gjykim një çështje civile, ose administrative, që nuk kanë mjete të mjaftueshme për të paguar një avokat, ku futen personat që përfshihen në programet e mbrojtjes sociale.

Ndihmë juridike nga shteti përfitojnë edhe të miturit për të cilët mbrojtja e tyre është e detyrueshme me ligj, dhe ajo mund të kërkohej si para, gjatë ose pas procesit gjyqësor. Në lidhje me zbatimin në praktikë të këtij ligji pranë Ministrisë së Drejtësisë, është krijuar Komisioni Shtetëror, është emëruar Kryetari këtij komisioni dhe janë caktuar edhe anëtarët e tij, por komisioni nuk ka bërë akoma asnjë mbledhje, pasi për funksionimin e këtij komisioni duhet më parë të dalin aktet nënligjore në zbatim të tij, të cilat nuk rezultojnë të kenë dalë akoma dhe për të cilat gjatë vitit 2012 do përgatishim rekoamdnimin përkatës.

6. E drejta e Pronës

Objektivi kryesor i veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit është që të hetojë dhe të krijojë mundësi për rivënien në vend të ankesave të justifikuar të individëve, ndërsa qëllimi i dytë duhet të jetë ai i ndryshimit ose përmirësimit të sistemit të administrimit që kanë realizuar shkeljen, pra, thënë ndryshe, që gabimet ose padrejtësitë të mos përsëriten në të ardhmen.

Në këtë kontekst, një nga të drejtat themelore të njeriut mbetet ajo e mbrojtjes së pronës nga cënimet e mundshme, nga zbatimi i gabuar i ligjit, nga ndryshimet e shpeshta legjislative me ose pa fuqi prapavepruese apo nga veprimet e të tretëve, e drejtë e cila garantohet, si nga ajo ndërkombëtare e detyrueshme për Republikën e Shqipërisë, ashtu dhe nga Kushtetuta, nga Kodi Civil dhe një mori aktesh të tjera ligjore ose nënligjore.

Neni 1 i Protokollit Shtesë nr. 1 të Konventës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, mbetet dispozita e vetme që trajton të drejtat ekonomike, ku garantohet e drejta e gëzimit të pacenueshmërisë së pronës. Në të përfshihet parimi i respektimit të pronës të çdo personi fizik apo juridik, rastet e privatizimit, privimit apo shpronësimit të pasurisë në kushte të caktuara dhe disiplinimi e përdorimi i pronës në lidhje me interesin e përgjithshëm.

Gjatë vitit 2011, pranë institucionit janë protokolluar **221** ankesa, kërkesa apo njoftime, me objekt verifikimin dhe rivendosjen e shkeljeve së të drejtës së pronës nga veprimet dhe mosveprimet e parregullta apo të

paligjshme nga organe të tilla të administratës publike, si AKKP-ja, Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme, Agjencia e Legalizimit dhe Urbanizimit të Zonave Informale, organet e pushtetit vendor apo Komisionet Vendore të Verifikimit të Ligjshmerisë së Titujve të Pronësisë.

Pjesa më e madhe e ankesave, që si objekt të tyre kanë të drejtën e pronës, lidhen direkt me Ligjin 9235 datë 29.07.2004, “Për kthimin dhe kompesimin e pronave”, i ndryshuar dhe me veprimtarinë e Agjencisë të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, organi administrativ i ngarkuar me rregullimin sipas kriterëve të nenit 41 të Kushtetutës, të rivendosjes të një të drejte të shkelur të çështjeve të pronësisë që kanë lindur nga shpronësimet, shtetëzimet ose konfiskimet.

E drejta për të gëzuar, poseduar apo disponuar pronën respektohet së pari nga organi ligjvënës, i cili me hartimin e ligjeve garanton tagrat e pronarëve legjitimë dhe parandalon në të njëjtën kohë, cënimet nga organet e administratës publike gjatë vendimmarrjes së tyre, qoftë normative apo individuale, vendimmarrje e cila prek dhe pengon subjektet në përdorimin lirisht të pronës.

Praktika që ne do të prezantojmë më poshtë, flet për qëndrime jo konseguente të procesit ligjvënës në relacion me ligjin themeltar të shtetit.

Në raportet e viteve të kaluara kemi informuar lidhur me kërkesat që Institucioni i Avokatit të Popullit i kishte drejtuar Gjykatës Kushtetuese për shfuqizime të dispozitave ligjore që binin ndesh me Kushtetutën. Kjo e fundit, me Vendimin e saj nr.17, datë 23.04.2010, deklaroi “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të paragrafit të dytë dhe të tretë të nenit 10 dhe të paragrafit të dytë të nenit 39/ “a” të Ligjit nr. 7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”, të shtuar me Ligjin nr.9701, datë 02.07.2007, “Për disa ndryshime në Ligjin nr.7843, datë 13.07.1994 “Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme”. Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën të Udhëzimit të Këshillit të Ministrave nr.4, datë 21.11.2007 “Për miratimin e procedurës së fshirjes së regjistrimeve të kryera në kundërshtim me ligjin dhe të atyre që krijojnë mbivendosje në zyrën e regjistrimit të pasurive të paluajtshme”, ndërsa me vendimin me numër 27, datë 26.05.2010, vendosi: “Shfuqizimin si të papajtueshëm me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 15 pika 1, gërmat “c”, “ç”, “d”, “dh” dhe 16 të Ligjit nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës”, të ndryshuar me Ligjin nr. 10207, datë 23.12.2009, “Për disa ndryshime në Ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës” i ndryshuar.

Normat e shfuqizuara me vendimin e fundit, kishin të bënin me kompetencat dhënë Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Kthimin dhe

Kompensimin e Pronës, që mbi bazën e një kërkesë për rishikim të shqyrtonte vendimet e ish zyrave rajonale të AKPP-së në qarqe, rrethe apo bashki, dhe nëse konstatonte të meta, t'i shfuqizonte ato.

Kuvëndi i Shqipërisë më pas, miratoi Ligjin nr.10.308, datë 22.07.2010, ku Drejtorit të Përgjithshëm të Agjencisë për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës i jepej përsëri e drejta për rishikimin dhe shfuqizimin e vendimeve të subjekteve të shpronësuara, për njohjen, kthimin apo kompensim e pronës.

Nënvizojmë faktin, që pavarësisht, se kërkesa e Komisionit të Ligjeve të Kuvendit, drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit për të dhënë vlerësimin e tij paraprak mbi kushtetutshmërinë e këtyre ndryshimeve, mori vlerësim negativ, Kuvëndi i miratoi ato.

Ishte kërkesa për anti-kushtetutshmërinë e Ligjit nr.10.308, datë 22.07.2010 “Për ndryshime në Ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për Kthimin dhe Kompensimin e Pronës”, të ndryshuar, e Shoqatës Kombëtare e të Shpronësuarve “Pronësi me Drejtësi” dhe e Komitetit Shqiptar të Helsinkit, që vuri përsëri në lëvizje Gjykatën Kushtetuese, e cila me vendimin e saj nr. 43, datë 06.10.2011 vendosi: “Shfuqizimin, si të papajtueshme me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë të neneve 2, 3 dhe 5 të Ligjit nr.10.308, datë 22.07.2010 “Për disa shtesa dhe ndryshime në Ligjin nr. 9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës” i ndryshuar.

Institucioni i Avokatit të Popullit, asnjëherë nuk ka qenë dhe nuk do të jetë pro shkeljeve ose deformimeve të çfarëdo natyre qofshin dhe do reagojë institucionalisht për rivendosjen e të drejtave të cënuara, por gjithnjë me rrugë dhe procedura ligjore. Nuk mund të lejohet riparimi i një praktike antiligjore, po me praktikë apo ndërhyrje antiligjore.

Kanë ekzistuar dhe ekzistojnë organe, struktura dhe mjete të tilla juridike, si për parandalimin ashtu dhe për normalizimin e situatave të tilla.

Pjesa më e madhe e ankesave për të drejtën e pronës, ashtu siç përmendëm më sipër, kanë lidhje me veprimtarinë e Agjencisë Qëndrore të Kthimit dhe Kompensimit të Pronave. Ka shumë të shpronësuar që ende nuk kanë marrë një vendim për kërkesën e depozituar e protokolluar prej vitesh pranë ish-AKKP-ve vendore.

Një pjesë e tyre janë ankesa për kundërshtimin e vendimeve të AKKP-së, që për arsye të ndryshme, nuk i ka njohur aplikuesit si të shpronësuar dhe si të tillë j'u kemi sugjeruar të ndjekin rrugën gjyqësore

Problematike mbetet ngadalësia dhe mjetet e pamjaftueshme të rezervuara për kompensimin financiar të ish pronarëve. Neni 23 i Ligjit nr.9235, datë 29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave”, i

ndryshuar, parashikonte krijimin e Fondit të Kompensimit të Pronave nga të ardhurat buxhetore, i cili do administrohej nga ish Komiteti Shtetëror i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, sot Agjencia Qëndrore e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, proces që pritet të përfundojë në vitin 2015. Nisur nga ritmet e deritanishme të pagesës dhe nga ndryshimet e përvitshme të procedurave të përcaktuara në vendimet përkatëse të Këshillit të Ministrave, perspektiva nuk duket shumë optimiste. Afati i njohjes, përgatitjes dhe paraqitjes së dokumentacionit të përcaktuar në aktin nënligjor vlerësohet si i pamjaftueshem, si dhe mungesë transparence në listat, aktet e të cilave pranohen ose jo dhe e përfituesve të kompensimit.

Mos respektimi i afateve procedurale për dhënien e informacionit, për përfundimin e procedimit administrativ dhe marrjen e vendimeve, të njoftimit të vendimeve të interesuarve, të sqarimit apo venien dijeni të të shpronësuarve për mangësitë që mund të ketë dosja e kerkimit të pronës e të tjera afate të parashikuara në Kodin e Procedurave Administrative, janë një objekt tjetër i ankimeve apo kërkesave për ndërmjetësim.

Po ashtu, lë për të dëshiruar bashkëpunimi i administratës së AKKP-së Qëndrore me aplikuesit, duke mos ju krijuar realizimin e kontakteve për informacion, sqarime apo sugjerime, e mundësive të subjekteve për t'u shprehur ose marrja pjesë personalisht apo me përfaqësues ligjor në shqyrtimin administrativ të rastit të tyre.

Lidhur me këtë të fundit, në shumë praktika të trajtimit të kërkesave kemi konstatuar, se Agjencia Qëndrore e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, shmanget nga kryerja e funksioneve të saj, përfshirë dhe procesin e hetimit të plotë administrativ për të marrë dhe vlerësuar prova, si dhe për të kryer ekspertime me qëllim dhënien e vendimit përfundimtar dhe të mos kërkojë nga ankuesit t'u drejtohen gjykatave për formimin e provave.

Përsa i takon bashkëpunimit të institucionit tonë me AKKP-në gjatë vitit 2011, i vlerësojmë më të mira se vitet e kaluara dhe si impenjim i dyanshëm i dukshëm e në kufijtë e normalitetit për trajtimin në kohë të pretendimeve të ankuesve.

Një pjesë e shtetasve që s'kanë aplikuar ende për njohjen e së drejtës për kthimin dhe kompesimin e pronës, pas skadimit të afatit dhe që kanë kërkuar ndihmë nga Avokati i Popullit, janë këshilluar për rivendosjen në afat për dorëzimin e kërkesës, nëpërmjet gjykatës. Të tjerë janë ankuar, se nuk ju njihet vërtetimi gjyqësor i faktit juridik të pronësisë së palujtshme. Roli aktiv i Institucionit të Avokatit të Popullit në mbrojtje të të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve nuk do ishte i kompletuar pa ofrimin e ndihmës juridike për të gjitha shqetësimet që ankuesit parashetrojnë tek ne.

Duke parë, se afati ligjor i veprimtarisë së AKPP-së Tiranë ka përfunduar në datën 31.12.2011 dhe numrin e dosjeve të pa trajtuara, është apeluar jo vetëm për një rishtyrje të tij, por edhe në ndryshime të normave të veçanta brenda ligjit apo mbështetjen me akte nënligjore për shpejtimin e dhënies fund të procesit të tejzgjatur, shoqeruar me efekte dhe ndikime favorizuese për rritjen e investimeve, fuqizimin e biznesit dhe futjen në qarkullimin civil të pasurive të paluajtshme.

Konstatohet, se e drejta e gëzimit lirisht të pronës, e cila vazhdon të çenohet, si nëpërmjet ndërtimeve informale, ashtu edhe e atyre me leje ndërtimi me mosrespektim të kondicioneve urbanistike kundrejt objekteve ekzistuese, përbën një shqetësim tjetër, të cilin Avokati i Popullit, nëpërmjet trajtimit të ankesave individuale ka tentuar ta minimizojë sadopak.

Gjithashtu, është konstatuar shkelje e së drejtës mbi pronën, nëpërmjet mosrespektimit të neneve 1 dhe 2 të Ligjit nr. 8651, dt. 22.12.2009 “Për shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”.

Konkretisht, shkelja vërehet në trajtimin e rasteve të ndryshme në lidhje me moskryerjen e procedurave të shpronësimit, me deklaratimet publike për sipërfaqe me të vogla se sa janë shpronësuar në fakt në terren dhe për vonesa në dhënien e dëmshpërblimit.

Ndërhyrjet e Institucionit të Avokatit të Popullit kanë qenë, si në drejtim të përmbajtjes, të identifikimit të normave që çenojnë të drejtën e gëzimit lirisht të pronës, në drejtim të përmirësimit të akteve administrative individuale dhe të shqyrtimit të ankimeve, akte të cilat, në përmbushje të interesit publik të ngarkuar nga ligji, duke ushtruar kompetencat e tyre, duhet të garantojnë mbrojtjen e të drejtës së pronës. I nënvizojmë keto fakte, se në shumë raste, njësitë bazë të qeverisjes vendore krijojnë komisione për verifikimin e konflikteve të pronësisë midis personave fizikë dhe mbi “ekspertizën” e tyre marrin vendime duke marrë kompetencat dhe juridiksionin e pushtetit gjyqësor.

Një grup tjetër ankesash, gjatë vitit 2011, që kishin të bënin me veprimtarinë e Komisioneve Vendore të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të çdo Qarku, struktura të ngritura në bazë të Ligjit nr.9948, dt.07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, i ndryshuar, me të cilin përfundonte procesi i ndarjes dhe rindarjes së tokës bujqësore, i krijimit të titujve të rinj të pronësisë dhe mbaronte funksionimi i veprimtarisë së komisioneve të ndarjes së tokës. Kjo gjë solli fluks ankimesh dhe ndjeshmërinë e shumë familjeve bujqësore që nuk kanë gjetur zgjidhje përfundimtare, që nga mosmarrja e aktit përkatës të fitimit të pronës, deri tek mosregjistrimi e

pajisja me çertifikatë nga Zyrat Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme. Objekti i tyre fillon nga kërkesat për këshilla ligjore, për mosdhënie të tokës bujqësore në pronësi, moskalim të tyre nga përdorimi në pronësi, mosregjistrim në ZRPP-të e rretheve, për ndërhyrje në zgjidhjen e konflikteve kufitare që kanë lindur midis ankuesve dhe personave të tjerë fizike apo juridikë privatë, mes tyre dhe ish komisioneve të tokave, për pasaktësi të hartografisë, për mos plotësim sipas ligjit të Akteve të Marrjes së Tokës në Pronësi apo të dokumentacionit tjetër nga komunat dhe bashkitë, mosdërgimin e tyre në ZRPP-të, mbivendosje parcelash, pajisje me Aktin e Pronësisë për troje brënda vijave të verdha, për dhenien e të njëjtës sipërfaqe dy ose më shumë subjekteve, për mosmarrje të tokës sipas frymëve, për zvarritje në shqyrtimin e ankesave të paraqitura pranë Komisionit Vendor të Verifikimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefektit të Qarkut apo ankesa ndaj vendimeve për fshirje të pasurive të subjekteve përfitues dhe regjistrimin në emër të të tjereve pa argumentim, problemet që priten të lindin nga përfundimi i gjykimeve për shqetesimet dhe konfliktet e larpërmëndura, etj.

Në dy raste ankuesit pretendonin me të drejtë, se Komisionet Vendore, pas mbarimit të afatit të veprimitarisë se tyre, që korrespondon me në datën 16.08.2011, ju dhanë fund shqyrtimit administrativ të nisur pa u shprehur me vendim përfundimtar për themelin.

Veprime të tilla, pavarësisht shkaqeve, janë të pabazuara në nenin 5 të Kodit të Proçedurave Administrative, që parashikon parimin e rëndësishëm të marrjes së vendimit për të gjitha çështjet brënda juridiksionit të tyre të ngritura nga personat fizikë, që do të thotë dhe pranuar nga praktika, se pavarësisht afatit prekluziv të ushtrimit të detyrimeve ligjore, organi administrativ vazhdon hetimin dhe i jep fund proçedimit me vendim përfundimtar, për sa i takon objektit të ankimit.

Ankesat kanë vijuar edhe pas përfundimit të afatit, për mos pasje dijëni të këtij fakti nga qytetarët, përfshirë edhe bashkëatdhetarë me banim në Itali.

Kërkesa ka edhe nga zona të caktuara, si nga banorët e fshatrave të Himarës, nga Komuna Ksamil e të tjera dhe nga Shoqata të ish Pronarëve të Tokave në Bregdet, për mos përfundimin e proçesit të ndarjes së tokave bujqësore të ish kooperativave bujqësore dhe ish N.B.-ve.

Ndihmë kërkojnë dhe një grup ish banorësh të rretheve verilindore për kompensimin e tokës bujqësore dhe truallit të përmbytur nga ndërtimi i H/C Fierzë, në Komunën Katund i Ri, Durrës bazuar në VKM nr.360, datë 30.06.1994 “Për masat që do të merren për zonat e përmbytura nga ndërtimi i H/C në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë”.

Avokati i Popullit, gjatë vitit 2011, ka trajtuar dhe **76** ankesa, një numër i konsiderueshëm individësh me pretendime ndaj **Zyrave Vendore të Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme**, të cilat me veprimet dhe mosveprimet e tyre janë bërë premise për shkeljen e të drejtës së pronës. Këto organe, në shumë raste nuk janë veçse një pengesë burokratike artificiale ndaj qytetarëve të thjeshtë për kryerjen e veprimeve të ndryshme të parashikuara nga Ligji.

Veçanërisht kërkesat e individëve për informacion të plotë lidhur me tjetërsimet e pronave të paluajtshme nëpërmjet kontratave të shitjes, dhurimit apo testamenteve ose për efekte gjyqësore, janë nga më të shpeshtat dhe nga ato që i lodhin qytetarët. Duhet ndërhyrje të përsëritura nga Avokati i Popullit, që t'u jepet dokumenti që kërkojnë. Shpesh detyrimet ligjore anashkalohen nga nëpunësit e Zyrave, duke shkaktuar sorollatje të individëve, mohim të të drejtave të tyre të njohura dhe garantuara në aktet normative në fuqi.

Një pjesë e ankesave të vlerësuara jashtë kompetencave tona u takojnë pretendimeve, që ZRPP-të kanë tjetërsuar pronën në favor të personave të tretë. Në këto raste nuk rezultojnë gjë tjetër, veçse bllokimi me të drejtë të pasurisë, pasi me vendim të KKK të Pronave, të ish komisioneve të tokave ose me vendime gjyqësore të formës së prerë, janë krijuar mbivendosje pronash. Këto pasoja janë rrjedhim i veprimeve të nxituara dhe jo profesionale të organeve të ngarkuara nga ligji për kalimin e pronësisë, të cilat pa bërë verifikimet e duhura japin, kthejnë në pronësi apo pjestojnë prona që pjesërisht apo tërësisht janë të regjistruara në emër të pronarëve të tjerë, duke krijuar në fakt një konflikt të ri pronësie.

Gjatë trajtimit të ankesave lidhur me veprimet e ZRPP-ve, më të pakta se një vit më parë, pretendimi kryesor mbetet mosrespektimi i afateve administrative dhe ligjore për dërgim informacioni, për shqyrtimin e ankimeve administrative dhe informimi për urdhërin e marre dhe përpunimin e tyre në regjistrimin e kërkesave të parashtruara si dhe mos ekzekutimi i vendimeve gjyqësore. Me një fjalë, në pergjithësi nuk zbatohen afatet dhe kërkesat e Kodit të Proçedurave Administrative. Një dukuri tjetër mbetet hermetizimi, zyra dhe dyer që nuk hapen, të mbyllura për komunikim me ankuesit, avokatët dhe përfaqësuesit e tyre.

Qëndrime të tilla dhe sugjerimi ndaj aplikuesve për t'iu drejtur gjykatës, jo në pak raste, janë të gabuara, pasi zgjidhen dhe shqyrtohen administrativisht brënda normave dhe parashikimeve të Ligjit nr.7843 datë 13.07.1994 "Për regjistrimin e pasurive të paluajtshme".

Zyrat vendore ende nuk na kanë dhënë me performancën e tyre, mundësinë, të konludojmë, se janë organe administrative në funksion dhe

shërbim të individëve pronarë, të transaksioneve të tyre dhe bartësve të të drejtave reale mbi to.

Rezultoni se një pjesë e madhe e pronave, sidomos në zonat urbane, mbeten të pafutura në sistem për mungesë fondesh, gjë që përbën një nga shqetësimet kryesore të qytetarëve.

Për një informacion më të detajuar të problematikes së prezantuar më lart parashtrijme disa raste dhe rekomandime:

Gjatë vitit 2011, qytetarët kanë adresuar ankesa dhe problematika të ndryshme, të cilat pavarësisht organit për të cilit ankohen, si për AKKP-në, ZVRPP-të, organeve të tjera të administratës publike, njësitë e qeverisjes vendore, prefektët, personat juridikë apo fizikë privatë, prokurorisë, gjykatave apo grupeve të interesit që janë pas tyre, të përbashkët kanë shqetësimin, mbrojtjen e të drejtës së pronës nga cënimet.

Nga to, bëjmë një paraqitje përmbledhëse të disa prej tyre nisur nga interesi ligjor që paraqesin.

Me ankesën **nr.201101012**, qytetarja, pas një kohë relativisht të gjatë qëndrimi jashtë vendit, kërkonte informacion për sasinë maksimale të tokave që njeh, kthen apo kompenson KKKP-ja për trashëgimlenësin e saj, ish pronar i madh trojesh. Në përputhje me kuadrin ligjor ekzistues, sqaruar që në Nenin 6, pika 1 të Ligjit nr.9235, dt.29.07.2004 “Për kthimin dhe kompensimin e pronës”, i ndryshuar, parashikohet, se: “Subjekteve të shpronësuara u njihet e drejta e pronësisë dhe u kthehen pa kufizime pronat e paluajtshme, me përjashtim të tokës bujqësore, e cila kthehet apo kompensohet deri në 100 ha, në rast se subjekti i shpronësuar (trashëgimtarët e tij) nuk kanë përfituar nga zbatimi i ligjit nr.7501, datë 19.07.1991 “Për tokën”.

Problematike është ankesa me **nr. 201001390**, me të cilën familja ankuese, kreditore, parashtronte pretendimet për zvarritje të pamotivuara në ekzekutimin e vendimit nr.10508, dt.23.07.2007 të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut, ku detyrohet KKKP-ja të nxjerrë vendim në formën e kërkuar nga ligji dhe kthimin e një sipërfaqe trualli, ndërkohë që është ekzekutuar vetëm pagimi nga qeveria shqiptare i dëmit moral. Nga shqyrtimi i rastit rezultoni, se ish-Komisioni Rajonal i Kthimit dhe Kompensimit të Pronave, me vendimin nr. 109, dt. 26.08.1996, nga prona e kërkuar prej 146 ha ose 1100 vretenësh, u njohu ankuesve sipërfaqen brënda vijës së verdhë të qytetit dhe ktheu 2 ha, sipas kufizimit të ligjit të kohës dhe j’u dorëzoi vendimin të interesuarve me mangësi materiale (mungonin firmat e tre antarëve të komisionit), të cilat në bazë të nenit 120 të Kodit të Procedurave Administrative, duhet të korrigjoheshin nga vetë institucioni, organi administrativ, pa prekur përmbajtjen e tij.

Meqë rruga administrative nuk funksionoi, ankuesit, ju drejtuan procesit gjyqësor me objekt padie: “Dhënien e formës së kërkuar vendimit nr. 109, datë 27.08.1996 të KKK të Pronave.... Kundërshtimin e vendimit nr.63, datë 09.10.1997 të KKK të Pronave... dhe detyrimin e Komisionit të rishikojë dokumentat, shpërblimin e dëmit jo pasuror”; proces që përfundoi me Vendim të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr 502.dt 6.3.2003, që vendosi: “Prishjen e vendimit nr.295, dt.25.05.2001 të Gjykatës së Apelit...., në këtë mënyrë: *Detyrimin e KKP të Pronave të nxjerrë vendim në formën e kërkuar nga ligji, në lidhje me kërkesën e paditësit..... Prishjen e vendimit nr.295, dt.25.05.2001 të Gjykatës së Apelit.... dhe vendimit nr.195, datë 06.02.2001 të Gjykatës së Shkallës së Parë....., për pjesën që rrëzon padinë me objekt: kundërshtim vendimi nr.63, datë 07.10.1997 të KKK të Pronave..... dhe pushimin për e gjykimin për këtë pjesë” me arsyetimin se: “...KKK e Pronave..... ka nxjerrë aktin administrativ, vendimin nr.109, datë 27.09.1996, me të cilin i njihet dhe i kthehet trashëgimlënësve të paditësit.....një sipërfaqe toke-truall me sipërfaqe 6 100 m² në vendin e quajtur..... Vendimi i sipërm i KKK të Pronave është një akt administrativ, të cilit i mungon forma, ka mungesë të nënshkruesve të anëtarëve të të komisionit, etj. Me padinë objekt shqyrtimi kërkon nga KKK të Pronave..... dhënien e formës ligjore të vendimit, duke ju përgjigjur kërkesave së tij drejtuar KKK të Pronave, për pronën objekt kërkimi.....Vendimi i Gjykatës së Rrethit dhe e Apelit që ka rrëzuar padinë e paraqitur nga....., janë në zbatim të keq të dispozitave të K.Pr.Civile që parashkojnë gjykimin e mosmarrëveshjeve Administrative... nuk janë zbatuar dispozitat ligjore të Kodit të Proçedurës Administrative që bëjnë fjalë për aktet administrative, formën e tyre, qëllimin e aktit, arsyetimin e tij, nenet 105, 106 e vijues. Këto dispozita janë të detyrueshme për tu zbatuar nga organi administrativ, që nxjerr aktin administrativ dhe vërteton përfundimin e proçedimit administrativ, i cili sipas nenit 99 të Kodit të Proçedurave Administrative përfundon me marrjen e vendimit nga organi përkates... Sa më sipër, kolegji çmon se me të drejtë pala paditëse i është drejtuar gjykatës për zgjidhjen e mosmarrëveshjes, meqënëse nuk ka mundur të realizojë të drejtat e tij në rrugë administrative. Sipas nenit 339 të K.Pr.Civile e neneve 105, 106, etj, të Kodit të Proçedurave Administrative, organet e adminstratës të caktuara me ligj për nxjerrjen e vendimeve sipas ligjit nr. 7698, datë 15.04.1993 “Për kthimin dhe kompensimin e pronave..” janë të detyruar të nxjerrin vendim në formën e kërkuar nga ligji, në lidhje me kërkesën e paditësit....., për padinë objekt kërkimi”.*

Ankuesit inicuan fillimin e proçedurave për ekzekutimin e titullit ekzekutiv, vendimit të Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë dhe në kushtet e

qëndrimeve refraktare nga debitori, shfrytëzuan të drejtën e ankimit në Gjykatën Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, e cila vlerësoi, se pala Shqiptare duhet të sigurojë nëpërmjet mjeteve të përshtatshme dhe me shpejtësi, ekzekutimin e vendimit përfundimtar të gjykatës vendase.

Në kundërshtim me sa më lart, me shkresën nr. 3224/1 datë 13.07.2011, AKKP-ja Qëndrore njofton Avokatin e Popullit, se vendimi i Kolegjit Civil të Gjykatës së Lartë nr. 502 datë 06.03.2003, është ekzekutuar me vendimet përkatëse të AKKP-së Tiranë, sipas të cilave është vendosur: "...të mos njohë të drejtën e pronësisë subjektivit të shpronësuar...".

Në kushtet kur vendimet e sipërcituara nuk janë ekzekutim i vendimit të Kolegjit Civil Gjykatës të Lartë dhe as i Gjykatës së Strasburgut dhe interpretojnë gabim vendimin e Kolegjit Civil, faktikisht kanë rrëzuar një vendim të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në favor të ankuesve dhe vendimin administrativ nr.109, datë 27.09.1996 të ish-KKKP-së rajonale; Institucioni i Avokatit të Popullit i rekomandoi kësaj të fundit: "Ekzekutimin e Vendimit nr.10508/02, 23.10.2007 të Gjykatës Evropiane të të Drejtave të Njeriut në Strasburg, në favor të ankuesit.....".

Mos reagimi pozitiv i Agjencisë dhe urdhërimi i Zyrës së Përmbarimit për ta pushuar ekzekutimin e titullit ekzekutiv, na obligon në respektim të të drejtës dhe dinjitetit të shtetit, ndjekjen e mëtejshme gjatë vitit në vijim, duke shfrytëzuar të gjitha hapësirat ligjore.

Me ankesën me **nr.201101166** dhe të tjera, të shpronësuarit nga ndërtimi i H/C Fierzë, kërkojnë në bazë të VKM nr.360, datë 30.06.1994 "Për masat që do të merren për zonat e permbytura nga ndërtimi i H/C në rrethet Kukës, Has, Tropojë dhe Pukë" ndërhyrje institucionale për kompensimin e tokave bujqësore dhe trojeve të permbytura, në Komunën Katund i Ri, Durrës, ku dhe janë strehuar prej 10 vjetësh. Me përgjigjen tonë u shpjeguan këtyre, se pas ndryshimeve të vitit 2006 në Ligjin nr.9235, datë 29.07.2004 "Për kthimin dhe kompensimin e pronës", në nenin 6 u shtua pika 2, ku përcaktohet, se: "Subjektet e shpronësuara, pronat e të cilave janë permbytur nga ndërtimi i hidrocentraleve, trajtohen sipas dispozitave të këtij ligji, me përjashtim të rasteve kur kanë përfituar sipas Ligjit "Për shpronësimet për interes publik", toka do të vlerësohet si truall industrial" dhe është Agjencia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave organi administrativ kompetent për këtë problem. Ky orientim ishte i domosdoshëm me qëllim, që ata të vazhdojnë të ndjekin rastin pranë organit përkatës, për të bërë të mundur rivendosjen e të drejtës së pretenduar të shkelur.

Një qytetar nga Tirana, me ankesën e protokolluar **me nr. 201101944**, pretendon, si shumë të tjerë, se me vendim gjyqësor të faktit, të vitit 1997, është vendosur vërtetimi i faktit juridik të pronësisë të trashëgimlënesit, mbi

një pronë të ndodhur në fshatin Herraj, Tiranë. Ky truall i pa trajtuar nga AKKP-ja dhe i pa regjistruar në ZRPP-në e rrethit Tiranë në emër të ndonjë pronari, përfshirë dhe ankuesin, me vendim të Këshillit të Komunës Zall-Herr i është dhënë për shfrytëzim një subjekti juridik privat kundrejt një qiraje në favor të organit të pushtetit vendor. Qytetari, meqë e konsideronte veten pronar legjitim mbi truallin nga vërtetimi i faktit, kërkonte, që vlera e qirasë të kalonte në favor të trashëgimtarëve të trashëgimlënësit.

Ankuesi u sqarua, se nuk legjitimohej as në gjykatë për të ngritur padi për detyrim pagim qiraje, pasi nuk ishte pronar i tokës bujqësore, se vendimi gjyqësor i faktit juridik po ashtu nuk e bën pronar; se këto lloj vendimesh gjyqësore nuk marrin formë të prerë, kanë karakter deklarativ, nuk zgjidhin mosmarrëveshjet civile në themel, nuk janë tituj ekzekutiv, nuk ekzekutohen nga zyrat e përmbarimit, nuk kanë fuqi detyruese për personat e tretë, nuk regjistrohen për efekte pronësie në ZRPP-në e rrethit pranë Komisionit të Kthimit të Pronave dhe të mund të përdoren, si provë në një gjykim tjetër civil ose në një procedim tjetër administrativ, së bashku me prova të tjera.

Problematike është dhe ankesa me **nr.201001568** e një qytetari nga Vlora, lidhur me mos ekzekutimin e një vendimi gjyqësor të formes së prerë të vitit 2001 nga Drejtoria e Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, privatizimi i një objekti, ish menci e N.B.-së

Drejtuesit e kësaj Agjencie në mënyrë të pakuptimtë dhe të pabazuar në ligj e kanë zvarritur ekzekutimin e titullit ekzekutiv, pa shkaqe ligjore, megjithëse Drejtoria e Shërbimeve Juridike në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës, ka përcjellë interpretimin ligjor Drejtorisë të Administrimit të Pronës Publike pranë të njëjtës Ministri, ku thekson, se: *“...siç konstatohet nga praktika bashkalidhur zoti.....bazon kërkimin e tij në vendime gjyqësore të cilat kanë marrë formë të prerë dhe janë të detyrueshme për t’u zbatuar. Përsa i përket rivlerësimit që kërkohet t’i bëhet objektit të kërkimit, mendojmë se s’duhet bërë, pasi e drejta e privatizimit të objektit..... i ka lindur që nga momenti kur ishte kryer ky vlerësim i objektit të kërkuar, por që në kundërshtim me ligjin u është shitur personave të tjerë dhe jo zotit.... Për këto arsye mendojmë se nuk duhet të realizohet rivlerësimi i objektit në fjalë. Për sa më sipër mendojmë që t’i jepet përgjigje z. Drejtor i Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike që të realizojë me paditësin ... veprimin juridik të shitblerjes së objektit të kërkuar nga ky i fundit me çmimin që ka pasur ky objekt, që në momentin kur i ka lindur kjo e drejtë, ashtu siç e cituam dhe më sipër”.*

Edhe pasi debitori u vu në dijeni të interpretimit juridik nga organi kompetent, konstatuam, se nuk po vepronte në zbatim të detyrimit kushtetues për ekzekutimin e vendimeve gjyqësore nga organet shtetërore.

Institucioni i Avokatit të Popullit në kuadër të përmbushjes së detyrave të tij kushtetuese dhe ligjore, ku ndër prioritetet e tij ka edhe monitorimin e ekzekutimit të titujve ekzekutivë ndaj gjyqfituesve, i rekomandoi Drejtorisë së Administrimit dhe Shitjes së Pronave Publike në Ministrinë e Financave, marrjen e masave për ekzekutimin e menjëhershëm të vendimit gjyqësor të formës së prerë për privatizimin e dy pjesëve të tjera të mencës të ish N.B-së ankuesit.

Në ankesën me **nr. 201100774** qytetari nga Tirana, i kërkonte Avokatit të Popullit, për të ndërhyrë institucionalisht pranë organeve kompetente për ushtrimin e kontrollit, verifikimit dhe marrjen e masave për pezullimin e aktiviteteve të pesë pikave të karburantit në Rrugën “Demokracia”, që sipas tij, ushtronin veprimtarine e tyre në mënyrë të paligjshme, pa dokumentacion dhe lejet përkatëse për ruajtjen dhe tregtimin e karburanteve.

Për sa më lart kërkuam sqarime nga Inspektoriati Qëndror Teknik pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës. Në përgjigjen që ktheu Kryeinspektori, na bënte të ditur, se u organizua kontroll me një grup inspektorësh në rrugën Kamëz-Bathore-Zallher dhe pas ballafaqimit të dokumentacionit tekniko-ligjor që dispononin në secilin stacion me kërkesat ligjore që normojnë ushtrimin e aktivitetit privat në fushën e tregtimit të karburanteve, janë mbajtur Akt Kontrolle dhe Akt Inspektime me detyra konkrete dhe me masa ndëshkuese për shkeljet e konstatuara.

Po me iniciativën e Avokatit të Popullit nisi procedura me nr.201100863 prot. para stinës së shirave dhe faktit të përmbytjeve të përsëritura që kaloi zona fushore e Qarkut të Shkodrës dhe pjesërisht e Lezhës shoqëruar me dëme materiale në pronën private, shtetërore dhe publike, për informacion dhe sqarime nga Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes së Konsumatorit; nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjetikës dhe nga Komiteti Kombëtar i Digave të Larta, për investimet dhe masat e marra në garantimin e normave, kushteve teknike dhe të sigurisë në Digat e Ujëmbledhësave të Sistemit të Ujitjes dhe Kullimit dhe Digave e Dambave.

Edhe në këtë rast, përgjigjet ish-in të shpejta dhe të argumentuara, se pavarësisht disa problemeve teknike që kërkojnë kohë dhe mjete financiare, garantohej ajo që është me kryesore, siguria e tyre.

7. E drejta e mbrojtjes shoqërore të punës

Institucioni i Avokatit të Popullit duke qënë se ka si mision kryesor mbrojtjen dhe promovimin e të drejtave të njeriut, në vazhdimësi i ka kushtuar një rëndësi të veçantë të drejtës për mbrojtjen shoqërore të punës, e drejtë e cila duke ju referuar dhe numrit të ankesave rezulton të jetë mjaft e cënuar në shoqërinë tonë.

Kushtetuta, Kodi i Punës, Ligji Nr. 8549 datë 11.11.1999 “*Për statusin e nëpunësit civil*” si dhe dispozita të tjera ligjore e nënligjore përbëjnë një bazë ligjore për rregullimin e marrëdhënieve të punës dhe për t’i mbrojtur punëmarrësit nga largimet abuzive nga puna.

Për sa më sipër, në nenin 49 të Kushtetutës është parashikuar se:

1. Secili ka të drejtë të fitojë mjetet e jetesës së tij me punë të ligjshme, që e ka zgjedhur pranuar vetë. Ai është i lirë të zgjedhë profesionin, vendin e punës si dhe sistemimin e kualifikimit të vet profesional.

2. Të punësuarit kanë të drejtën e mbrojtjes shoqërore të punës.

Gjatë vitit 2011, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur rreth **200** ankesa në të cilat është pretenduar shkelje e marrëdhënieve të punës nga ana e administratës publike. Problematika që është konstatuar nga trajtimi i ankesave për këtë vit ka të bëjë kryesisht me:

1. Mosrespektimin e pikës 3 të nenin 146 të Kodit të Punës, për zgjidhjen e kontratës së punës pa shkaqe të arsyeshme ku është parashikuar e drejta e dëmshpërblimit të punësuarit deri në një vit page. Në rastet e punëmarrësve që kanë patur statusin e nëpunësit civil, është konstatuar mosrespektimi i detyrimeve të përcaktuara në vendimet gjyqësore të formës së prerë për kthimin në vendin e mëparshëm të punës e për të cilën punëdhënësi është i detyruar të zbatojë atë;

2. Zgjidhjen e kontratës së punës për shkak të suprimimit të vendit të punës si rrjedhojë e ristrukturimit të institucionit;

3. Largimin nga puna për shkak të mospërputhjes të shkallës së arsimit të punëmarrësit me atë të vendit të punës, paaftësinë e përkohshme fizike të punëmarrësit, plotësimin e kushteve për pension etj;

4. Problematikë tjetër që vazhdon të mbartet nga viti në vit vazhdon të ngelet ajo e statusit të personelit arsimor parauniversitar. Marrëdhëniet e punës së personelit arsimor parauniversitar rregullohen me Kontratën Kolektive që Ministria e Arsimit ka lidhur me përfaqësuesit e Sindikatave që aderojnë në këtë fushë. Ajo çfarë vazhdon të konstatohet nga ana jonë, krahas rregullimit pozitiv në disa aspekte sikundër janë procedurat e marrjes në punë, procedura e transferimit, të ndryshimit të vendit të punës etj, është se këto dispozita nuk kanë gjetur zbatim në vendimmarrjen individuale të Drejtorive Arsimore apo të Zyrave Arsimore. Nga vendimet të cilat ne kemi shqyrtuar, konstatojmë se ato janë të paarsyetuara, çka pengon realisht

subjektet të informohen lidhur me arsyet e vendimit dhe për rrjedhojë të parashtrajnë kundërargumentet e tyre. Realisht, kjo shkelje ka një pasojë finale që bie pikërisht mbi buxhetin e shtetit, pasi shumica e këtyre individëve i fitojnë proçeset gjyqësore. Për këtë arsye jemi të mendimit se përgjegjësia për nxjerrjen e një vendimi, i cili ka për pasojë shkeljen e të drejtës për punë, nuk duhet të bjerë mbi organin e administratës publike që e ka nxjerrë atë, por duhet të jetë individuale e titullarit të organit, pasi ky i fundit e ka detyrimin ligjor për zbatimin e ligjit. Në kushtet, kur moszbatimi sjell një efekt pasuror kuptohet që përgjegjësia duhet të jetë pasurore dhe disiplinore për këtë titullar.

Ndër ankesat e trajtuara me problematikat e mësipërme përmendim disa raste konkrete e rekomandime:

1. Ankesa e një grupi metrologësh me Nr. Doc. **201101502**, të cilët ankohen ndaj Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë për ndërprerje të marrëdhënieve të punës për shkak të mungesës së arsimit të lartë. Pas shqyrtimit të kësaj ankese u konstatua se vendimi i largimit nga puna për këtë grup ankuesish ka ardhur për shkak se nga Kontrolli i Lartë i Shtetit është konstatuar shkelje në pagesën e tyre si specialistë. Sipas këtij organi, këta të fundit nuk duhet të paguheshin si specialistë, por si punonjës mbështetës. Faktikisht në strukturën dhe organikën e Institucionit, këta të fundit nuk ishin kategorizuar si punonjës mbështetës, por specialistë. Në referencë të këtij problemi të konstatuar më sipër nga ana jonë u ndërmor hartimi i një rekomandimi ku kërkohet zgjidhja e kësaj situatë ligjore lidhur me zbatimin e drejtë të akteve që rregullojnë kriteret e punësimit të metrologëve të autorizuar. Në përgjigje të rekomandimit tonë drejtuar Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës jemi vënë në dijeni se metrologët e autorizuar, referuar strukturës dhe organikës së Drejtorisë së Përgjithshme të Metrologjisë, kategorizohen si specialistë dhe jo si punonjës mbështetës.

Specialistët referuar V.K.M-së Nr. 622 datë 08.07.2010, “*Për miratimin e strukturës dhe të niveleve të pagave të nëpunësve të disa institucioneve, në varësi të ministive të linjës*”, duhet të kenë si kriter minimal pajisjen e diplomës së nivelit 1, 2 dhe 3 e për pasojë këta metrologë janë larguar nga puna pasi nuk plotësonin nivelin arsimor të kërkuar.

2. Ankesa me Nr. Doc. **201100807**, në të cilën është konstatuar ndërprerja e marrëdhënieve të punës së ankueses si mesuese definitive pranë Shkolles 9-vjeçare në Lubonjë. Më datë 08.06.2011, ankuesja ka marrë njoftim për ndërprerje të marrëdhënieve të punës, pa ndonjë shkak të arsyeshem ligjor. Pas verifikimit të këtij rasti, nga Drejtoria Arsimore

Rajonale Vlorë, u vumë në dijeni se në bazë të Udhëzimit nr.22 datë 29.07.2010, të Ministrit të Arsimit dhe Shkencës, *“Mësuesit definitivë, të cilët nuk plotësojnë kriteret e punësimit për të gjitha ciklet e sistemit të arsimit parauniversitar, duhet të konsiderohen pa arsim përkatës”*.

Gjithashtu edhe nga Auditi i Ministrisë së Arsimit dhe Shkencës në vijim të këtyre rasteve është kërkuar që mësuesit, të cilët nuk japin mësim në profilin përkatës, të konsiderohen jashtë profilit. Në këto kushte, Drejtoria Arsimore në Vlorë ka njoftuar për ndërprerje të marrëdhënieve të punës ankuesen. Megjithatë, pas përcjelljes së kësaj përgjigje tek ankuesja e pas kontakteve që kemi patur me të në një letër falenderimi u vumë në dijeni se pas ndërhyrjes tonë institucionale ankuesja është sistemuar në një vend pune, mësuese definitive pranë një shkolle 9 vjeçare sipas profilit të saj.

3. Ankesa me Nr. Doc. 201100562, në të cilën është konstatuar ndërprerja e marrëdhënieve punës gjatë kohës që ankuesja ka qënë me leje barrëindje (e vertetuar edhe me raport mjekësor), nga Njësia Bashkiake Nr.6. Pas trajtimit të këtij rasti, pas konstatimit se ndërprerja e marrëdhënieve të punës ka ardhur në kundërshtim me dispozitat ligjore të nenit 107/1 të Kodit të Punës, ku citohet se: *“Është e pavlefshme zgjidhja e kontratës së punës e njoftuar nga punëdhënësi në periudhën gjatë së cilës gruaja pretendon për të fituar të ardhura nga sigurimet shoqërore në rast lindjeje”*, si dhe në shkelje të nenit 105/2 të Kodit të Punës ku citohet se: *“Pas periudhës 42 ditore të paslindjes, gruaja vendos vetë nëse dëshiron të punojë ose të përfitojë nga sigurimet shoqërore.”*, pasi ankuesja ka kërkuar edhe ndërprerjen e barrëindjes dhe fillimin e punës, i kemi rekomanduar Njesisë Bashkiake nr.6 marrjen e masave për t'i njohur ankueses të drejtën e rikthimit në vendin e punës në përputhje të plotë me Kodin e Punës së Republikës së Shqipërisë .Në përgjigje të këtij rekomandimi ndër të tjera jemi vënë në dijeni se në kushtet aktuale është e vështirë lëvizja e personelit në zyrën e gjëndjes civile. Megjithatë në mundësinë e parë të krijuar, rasti në fjalë do të jetë në përparësinë e kësaj zyre duke mbajtur në konsideratë edhe rekomandimin e ndërmarrë nga ana jonë.

4. Ankesa me Nr. Doc. 20110147, në të cilën është konstatuar zvarritja dhe mosekzekutimi i një vendimi gjyqësor të formës së prerë si dhe akti i emërimit nga Departamenti i Administratës Publike për rikthimin në vendin e mëparshëm të punës për ankuesin.

Konkretisht, Komisioni i Shërbimit Civil nëpërmjet vendimit Nr. 161 datë 07.03.2006, ka vendosur ndër të tjera detyrimin e Sekretarit të Përgjithshëm të Ministrisë së Ekonomisë, Tregëtisë dhe Energjitikës për t'i ofruar ankuesit vendin e punës *“Specialist në Sektorin e Standarteve dhe*

Sigurimit Teknik, Drejtoria e Mbikëqyrjes së Tregut në Drejtorinë e Përgjithshme Rregullatore pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës”.

Vendimi i mësipërm i Komisionit të Shërbimit Civil është lënë në fuqi edhe nga Vendimi Nr. 99 datë 08.09.2006, i Gjykatës së Apelit Tiranë si dhe Vendimi Nr. 874 datë 09.07.2007, i Gjykatës së Lartë.

Pas kësaj, ankuesi me cilësinë e kreditorit ka kërkuar nga Gjykata e Apelit Tiranë lëshimin e urdhërit të ekzekutimit, kërkesë e miratuar nga kjo gjykatë me anë të Vendimit Nr.14 datë 12.01.2007.

Ndodhur në kushtet kur vendimi gjyqësor i mësipërm nuk ishte ekzekutuar, ankuesi ka kërkuar ndërhyrjen e Institucionit të Avokatit të Popullit, duke argumentuar se edhe ky qëndrim i Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës është në kundërshtim me ligjin.

Institucioni i Avokatit të Popullit pasi mori në shqyrtim këtë ankesë, i është drejtuar me një kërkesë për shpjegime M.E.T.E-s, lidhur me shkaqet e mosekzekutimit të vendimit të Komisionit të Shërbimit Civil të parashtruar më sipër. Në shkresën me Nr. 3607/1 prot; datë 18.04.2008, nga ana e Drejtorisë së Shërbimeve Juridike pranë Ministrisë së Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës, u vumë në dijeni se: *“Ekzekutimi i vendimit gjyqësor dhënë në favor të ankuesit ka qenë i pamundur të ekzekutohet pasi nuk ka vende pune për sistemimin e tij. Kjo kërkesë do të mbahet në konsideratë e do t'i jepet prioritet për sistemimin në një vend pune brenda një kohe sa më të shkurtër të pëlqyeshme e të pranueshme nga vetë ankuesi”.*

Në vijim të kësaj ankese në vitin 2011, ankuesi na është ridrejtuar përsëri duke na bërë me dije mosekzekutimin e vendimit gjyqësor të mësipërm si dhe aktin e nxjerrë nga D.A.P-i (në prill të vitit 2011), për emërimin e tij në pozicionin e punës *“Përgjegjës në sektorin e projekteve Minerare e Industriale në Drejtorinë e Projekteve Minerare e Industriale në Ministrinë e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjistikës”.* Pasi u riverifikua ankesa, në përgjigje të kësaj ministrie në shkresën Nr. 8483/2 Prot; datë 19.12.2011, nga Drejtoria e Shërbimeve Mbështetëse pranë M.E.T.E jemi vënë në dijeni se nga ana e ankuesit është refuzuar vendi i punës të ofruar.

Në vijim të procedurave të punës tonë, këtë përgjigje ja përcollëm bashkëngjitur ankuesit, të cilin e orientuam se nëse do të kishte ndonjë kundërshtim lidhur me përgjigjen që na është dhënë nga M.E.T.E, mund të na ridrejtohej përsëri duke na bashkëngjitur një kopje të dokumentacionit që provojnë pretendimet e tij.

Ankuesi pas përgjigjes së dhënë na është ridrejtuar përsëri duke na sqaruar se nga M.E.T.E nuk i është ofruar ndonjë vend pune sikundër pretendohet në përgjigjen e tyre, pasi në të kundërt tashmë do të ishte i

sistemuar në vendin e punës së ofruar. Në këtë kontekst, duke qënë se ankuesi me të drejtë ka ngritur pretendimet dhe duke e çmuar këtë ankesë të drejtë e të bazuar në ligj, pasi në ministri ka patur vende pune të lira (këto të konfirmuara nga kërkesat që M.E.T.E i ka bërë D.A.P-it për shpallje vende pune të lira), kemi çmuar dërgimin e një rekomandimi me qëllim marrjen e masave të menjëhershme për zbatimin e një vendimi gjyqësor e të një akti emërimi të nxjerrë nga D.A.P.-i, sipas pozicionit të punës të përcaktuar sipas ligjit “Për nëpunësin civil”, ose në pamundësi ofrimin e një vendi në një nivel më të ulët. Për këtë rekomandim jemi ende në pritje të një përgjigje zyrtare nga Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës lidhur me sistemin e ankuesit në vendin e punës.

Krahas problematikave të mësipërme të dala gjatë trajtimit të ankesave, Institucioni i Avokatit të Popullit gjatë vitit 2011 hartoi disa pyetësorë me synim krijimin e një panorame të përafërt lidhur me respektimin e të drejtave të punës nga ana e punëdhënësve të Administratës Publike.

Synimi ynë është të studiojmë problemet në këndvështimin e zbatimit të garancive kushtetuese lidhur me marrëdhëniet e punës.

Në pyetësorët që shpërndamë për punëmarrësit e administratave vendore dhe punëdhënësit e këtyre administratave arritëm në disa konkluzione paraprake:

1. Shkak për largimet nga puna si për personat që janë nëpunës civil ashtu edhe për ata që trajtohen me kod pune në shumicën e rasteve kanë qënë reformat institucionale, ristrukturimi apo edhe motivet politike për t’i lënë vendin personave të tjerë;
2. Në shumicën e rasteve kur zgjidhja e marrëdhënieve të punës është bërë objekt shqyrtimi gjyqësor, nuk është respektuar ekzekutimi i tyre, duke shkelur në këtë mënyrë të drejtën për një process të rregullt ligjor;
3. Në shumicën e rasteve ndërhyrjet e strukturave shtetërore nuk kanë munguar duke u bërë kështu pengesë e duke influencuar në vendimmarrjen e tyre;
4. Pengesa të shumta të vënë re në rekrutimin e personelit të administratës shtetërore si për nëpunësit civil ashtu edhe për personelin teknik e ndihmës, është mungesa e kualifikimit të personave që rekrutohen;
5. Shpesh herë nga ana e Administratës Publike vihet re se konkurset nuk janë transparente e shpesh herë bëhen fiktive

Për sa më sipër, ajo çka Institucioni i Avokatit të Popullit ka insistuar dhe do të insistojë me tepër në të ardhmen, do të jetë:

1. Respektimi i marrëdhënieve të punës nga administrata shtetërore, nxjerrja e përgjegjësive personale të punonjësve përgjegjës në rastet kur me vendim gjyqësor të formës së prerë rezulton se nuk janë zbatuar procedurat ligjore për largimin nga puna dhe punëdhënësi është detyruar të paguajë dëmshpërblim për shkeljet e të drejtave të punëmarrësit, problematikë e cila është e mbartur me vite të tëra e që rëndon më tepër buxhetin e shtetit. Tek ndryshimet e Ligjit Nr. 8549 datë 11.11.1999 “*Për statusin e nëpunësit civil*”, i cili pritet gjatë vitit 2012 të miratohet, një gjë e tillë duket të ketë gjetur rregullim.

2. Ndjekja e procedurës të rekrutimit apo largimit nga puna me qëllim që të realizohet kuptimi dhe zbatimi i drejtë i procedurave të parashikuara në ligj dhe garantimin e punëmarrësve për të drejtat e tyre të sanksionuara me ligj.

3. Respektimi i parimit të përgjegjshmërisë nga organet e administratës publike për faktin se e drejta e gjyqfituesve nuk përfundon me fitimin e dëmshpërblimit deri në një vit pagë, por edhe me insistimin për zbatimin e ligjit në të gjitha aspektet.

8. E drejta për të përfituar nga sistemi i sigurimeve shoqërore

Sigurimi shoqëror është një skemë e ngritur për t’u mbrojtur ndaj kushteve të caktuara sociale, si: pleqëria, invaliditeti, aksidentet në punë, etj. E drejta për të përfituar nga kjo skemë në vendin tonë garantohet nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, e cila në pikën 1 të nenit 52, nënvizon se:

“Kushdo ka të drejtën e sigurimeve shoqërore në pleqëri ose kur është i paaftë për punë, sipas një sistemi të caktuar me ligj”.

Parimi bazë mbi të cilin funksionon skema është ai i solidaritetit të brezave, sipas të cilit, brezi aktiv kontribuon për brezin pasiv. Pikërisht Ligji nr.7703, date 11.05.1993 “Për sigurimet shoqërore në Republikën e Shqipërisë”, i ndryshuar, si dhe aktet nënligjore të dala për zbatim rregullojnë marrëdhëniet në fushën e sigurimeve shoqërore.

Edhe në raportet e mëparshme kemi theksuar se sistemi publik i sigurimeve shoqërore ka ardhur duke u reformuar dhe duke iu përshtatur zhvillimeve ekonomiko-sociale, por përsëri nga ana e Institucionit tonë janë konstatuar shkelje të të drejtave të individëve për përfitime të ndryshme nga sigurimi shoqëror.

Më poshtë prezantojmë rekomandimet e bëra nga ana jonë, të cilat janë paraqitur edhe në raportet vjetore të mëparshme, por që nuk janë zbatuar akoma.

- Rekomandim drejtuar Ministrit të Financave, për ndryshim të gurmës “dh”, të pikës 3 të VKM-së nr.787 datë 21.11.2003 “Për zbatimin e fazës së katërt të ngushtimit të diferencave në masën e pensioneve” si dhe të tabelës “C.f”. Megjithëse ky akt normativ në dispozitën e tij ka parashikuar shtesë në masën e pensionit të plotë të pleqërisë për kategorinë e pensionistëve, të cilëve e drejta e pensionit të pleqërisë iu ka lindur në periudhën 01.04.1996-31.04.1996, nuk e kishin përfituar këtë shtesë. Ministria e Financave na vuri në dijeni se ka kërkuar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore që të paraqesin shpjegimet përkatëse për këtë çështje si dhe propozimet lidhur me Rekomandimin tonë.

Pavarësisht kërkesave tona të përsëritura, ende nuk na është dërguar asnjë përgjigje.

- Rekomandim drejtuar Ministrit të Financave për marrjen e masave për ngritjen e një grupi pune për realizimin e një studimi për të bërë ndryshimet e nevojshme ligjore për të ndryshuar kushtet e daljes në pension të grupit të pensionistëve që kanë dalë në pension në periudhën 01.01.1994 – 31.12.1995. Kategoria e pensionistëve që, si datë fillimi të pensionit, kishin datën 01.01.1994 e në vazhdim, u ishte shkelur e drejta e rritjes së masës së pensionit të pleqërisë, pasi nuk kishin përfituar nga VKM-ja nr.605 datë 31.12.1993 “Për rritjen e pensioneve dhe të ardhurave nga papunësia”. Nga Ministria e Financave na u kthye përgjigje se ky rekomandim i është dërguar për kompetencë Institutit të Sigurimeve Shoqërore.

Së fundmi, në muajin Shkurt 2012, Instituti i Sigurimeve Shoqërore, na bën me dije se mbështetur në Rekomandimin e Avokatit të Popullit, ai institucion ngriti grupin e punës dhe me datë 30.09.2010 kishte dërguar pranë Ministrisë së Financave një Projekt-Vendim të Këshillit të Ministrave “Për ngushtimin e diferencave në masën e pensioneve të punonjësve buxhetorë të caktuara gjatë vitit 1994”.

Për problematikat në fushën e sigurimeve shoqërore, gjatë vitit 2011, janë depozituar dhe trajtuar **143** ankesa, ku shtetas të ndryshëm kanë pretenduar për shkelje të të drejtave të tyre të ligjshme, kryesisht për mosllogaritje të drejtë të masës së pensioneve të pleqërisë apo për datën e lidhjes së pensionit të pleqërisë.

Disa nga rastet, ku kemi konstatuar shkelje të së drejtës së përfitimit nga skema e sigurimeve shoqërore :

Gjate trajtimit të ankesës me nr.**201100520**, ku një shtetasi me banim në Gjirokastër nuk i jepej e drejta e përfitimit të pensionit shtetëror

suplementar për titullin “Mjeshtër kërkimesh” nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Gjirokastër, konstatuam se i ishte shkelur kjo e drejtë, e njohur me Ligjin nr.10139 date 15.05.2009 “Për Pensionet Shtetërore Suplementare të Punonjësve të Universiteteve, të Shkollave të Larta, Qendrës së Studimeve Albanologjike, Akademisë së Shkencave dhe të gjitha institucioneve të tjera kërkimore publike në Republikën e Shqipërisë, të cilët kanë tituj shkencorë”. Pasi iu drejtua me Rekomandim Drejtorit të asaj drejtorie për dhënien e pensionit shtetëror suplementar për titullin “Mjeshtër kërkimesh”, ankuesit iu lidh pensioni shtetëror suplementar me të drejtë përfitimi që nga data e depozitimit të kërkesës së tij.

Ankesa me nr.**201100458**, e cila bënte fjalë për një shtetas nga qyteti i Tiranës, lidhur me mosllogaritje të drejtë të masës së pensionit të pleqërisë nga Drejtoria Rajonale e Sigurimeve Shoqërore në Tiranë. Pas shqyrtimit të dokumentacionit të paraqitur pranë nesh, bëme verifikimet përkatëse në dosjen e pensionit pranë asaj drejtorie dhe rezultoi se ankuesi nuk e merrte të plote masën e pensionit.

Pas kësaj procedure, u bë rillogaritja e masës së pensionit dhe ankuesi përfitoi shtesën e mohuar, gjithashtu edhe diferencat e lekëve për tre vite.

Ankesa me nr. **201101638**, e një shtetasi me banim në komunën Xibër të rrethit të Matit, i cili ankohej ndaj Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Peshkopi për ndërprerjen e pensionit të invaliditetit. Gjatë shqyrtimit të kësaj ankese, konstatuam se shkaku i kësaj ndërprerjeje ishte mosllogaritja e masës së pensionit të invaliditetit pas përfundimit të procesit gjyqësor të ankuesit.

Pas ndërhyrjeve tona institucionale pranë Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore Peshkopi si dhe pranë Institutit të Sigurimeve Shoqërore, ankuesit iu bë rillogaritja e masës së pensionit, duke përfituar edhe shtesat përkatëse.

Ankesa me nr.**201101723**, e një shtetasi me banim në Ersekë, e cili ankohej për mosnjohjen e tre viteve të punës nga ana e Drejtorisë Rajonale të Sigurimeve Shoqërore në Korçë të ankuesit. Nga mosnjohja e viteve të punës, masa e pensionit që ai gëzonte ishte më e ulët nga sa i takonte të përfitonte. Megjithëse në vite e kishte kërkuar këtë të drejtë, nuk kishte mundur dot ta zgjidhte këtë çështje.

Pas ndërmjetësimit tonë Institucional, kjo drejtori mori parasysh periudhën tre vjeçare për efekt vjetërsie, duke bërë edhe rillogaritjen e masës së pensionit të ankuesit.

Lidhur me problematikat në fushën e sigurimeve shoqërore duhet të theksojmë faktin se nga trajtimi i mjaft ankesave, të cilat pas shqyrtimit kanë

rezultuar të pabazuara, është bërë punë për sqarimin ligjor të problemeve të parashtruara nga ankuesit.

Në bazë të të gjitha evidentimeve, statistikave dhe observimeve të nxjerra si dhe bazuar në rolin e Institucionit të Avokatit të Popullit që ndikon dhe përçon vizionin e mirëqeverisjes, është arritur në konkluzionin se Qeveria Shqiptare së bashku me institucionet e tjera përkatëse, me gjithë arritjet e deritanishme, duhet të jetë më efektive në politikat që lidhen me fushën e sigurimeve shoqërore, pasi disa çështje mbeten tepër të ndjeshme në opinionin publik, siç janë:

- Pensionet minimale, masa e të cilave është e pamjaftueshme për përballimin e një jetese normale;

- Ulje drastike e masës së pensioneve të parakohshme për vjetërsi shërbimi dhe pensioneve suplementare për një kategori të caktuar, si pasoje e rillojaritjes së këtyre pensioneve në bazë të ligjit nr.10142 date 15.05.2009 “Për sigurimin shoqëror suplementar të Ushtarakëve të Forcave të Armatosura, të Punonjësve të Policisë së Shtetit, të Gardës së Republikës, të Shërbimit Informativ të Shtetit, të Policisë së Burgjeve, të Policisë së Mbrojtjes nga Zjarri dhe të Shpëtimit e të Punonjësve të Shërbimit të Kontrollit të Brendshëm në Republikën e Shqipërisë”;

- Masa më të ulëta të pensionit të pleqërisë nga sa u takon, si pasoje e mosllogaritjes së drejtë nga ana e inspektorëve përkatës pranë Drejtorive Rajonale të Sigurimeve Shoqërore, etj.

Institucioni ynë do të jetë gjithmonë në vazhdimësi të proceseve të rishikimeve dhe analizave të legjislacionit në fushën e sigurimeve shoqërore, proces i cili do të pasohet me rekomandimet përkatëse në këtë fushë.

Duhet të theksojmë se bashkëpunimi ndërmjet Institucionit tonë me administratën qendrore dhe lokale të sigurimeve shoqërore ka qenë rezultativ, por ka patur disa raste të moskthimeve të përgjigjeve brenda afateve ligjore.

9. E drejta për arsimim

E drejta për arsimim është e garantuar nga Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë si dhe nga një kuadër i plotë ligjor. Avokati i Popullit ka treguar sensibilitet në trajtimin e rasteve të ndryshme, të paraqitura nga shtetas të ndryshëm, ku janë konstatuar veprime në kundërshtim me dispozita ligjore në fuqi, të cilat çënojnë të drejtën për arsimim.

Gjatë vitit 2011 janë regjistruar **15** ankesa në të cilat individë të ndryshëm kanë ngritur pretendimet e tyre ndaj Ministrisë së Arsimit si dhe

drejtorive Rajonale Arsimore në qarqe për cënim të të drejtës dhe interesit të tyre të ligjshëm për t'u arsimuar.

Nga ankesat e parashtruara, 5 janë zgjidhur në favor të ankuesve, 4 kanë qenë jashtë kompetencave të Avokatit të Popullit si dhe 3 ankesa kanë rezultuar të pabazuara. Ndërkohë që 4 ankesa kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2012.

Lidhur me ushtrimin dhe përmbushjen brenda standarteve ligjore të së drejtës për arsimim, Avokati i Popullit ka ushtruar të drejtën e tij të iniciativës për verifikimin dhe inspektimin e institucioneve arsimore në qytete të ndryshme (**201101365**, **201101362**, **201100959** dhe **201100300**). Lidhur me rezultatet dhe shkeljet e konstatura gjatë inspektimeve tona, janë dërguar edhe rekomandimet përkatëse në institucionet që i kanë në varësi direkte objektet e inspektuara, si dhe në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe mbetemi në pritje të qëndrimit të tyre institucional për masat që do ndërmerren për përmbushjen e standarteve, më qëllim që nxënësit që frekuentojnë këto shkolla apo kopshte, të mund të përfitojnë të paktën standartin minimal për t'u arsimuar.

Njëkohësisht, janë ndjekur edhe zhvillimet e projektligjit "Për sistemin arsimor parauniversitar, i cili duhet të mbështetet në parashikimet e Kushtetutës dhe Konventës Europiane të të Drejtave të Njeriut, si pjesë e legjislacionit të brendshëm. Kemi konstatuar se ky ligj ka ngelur ende në fazën e shqyrtimit në Ministrinë e Arsimit dhe Shkencës dhe ende nuk janë ndërmarrë procedurat ligjore për miratimin e Ligjit të ri "Për sistemin arsimor parauniversitar", duke azhurnuar në këtë mënyrë legjislacionin e këtij cikli me standartet bashkëkohore dhe risitë e vendeve europiane.

Nga ankesa të zgjidhur në favor të ankuesve, mund të veçojmë rastin me nr. Doc. **201101822** ku ankuesi shprehte gjendjen e tij të vështirë familjare dhe ekonomike për tu blerë tre fëmijëve të tij librat që të mund të shkonin në shkollë dhe kërkonte angazhimin tonë institucional pranë organeve kompetente për të përfituar ndihmë shtetërore, pasi vetë duhet të angazhohej me punë të rënda më qëllim që të mund të siguronte jetesën.

Avokati i Popullit inicioi menjëherë një procedurë administrative, duke ndërmjetësuar kryesisht me Drejtorinë Rajonale Arsimore, e cila me shkresën e saj na ktheu një përgjigje ku na sqaronte se për të tre fëmijët e ankuesit, në bazë të VKM-së nr 107 datë 10.02.2010 do të bëhej subvencionimi në masën 100%.

Gjithashtu mund të theksojmë edhe ankesën e shqyrtuar me iniciativë nga Avokati i Popullit lidhur me problematikën e ngritur në një prej mediave të shkruara lidhur me ndryshimet e Rregullores së Maturës Shtetërore.

Nga konstatimet e parashtruara në këtë artikull, Institucioni ynë, me qëllimin e vetëm të përmirësimit të standarteve të mirëadministrimit, vlerësoi dhe ndërhyri duke nxjerrë në pah dhe tërhequr vëmendjen njëkohësisht se nga pagesa e tarifës nuk kishte asnjë përjashtim, si për kategoritë në nevojë, si invalidë, fëmijët e tyre, të verbërit, fëmijë të policëve të vrarë, të cilët nuk ishin përjashtuar nga pagesa.

Në përgjigje të ndërhyrjes tonë, konstatoam se sugjerimet tona u reflektuan në miratimin e aktit të ri.

10. Plotësimi i nevojave të shtetasve me strehim

Ashtu siç kemi prezantuar ndër vite lidhur me këtë çështje, strehimi përsëri mbetet një problem madhor dhe jetik, por praktikisht ende i pazgjidhshëm. Numri i familjeve të pastreha është i destinuar të rritet. Nëse ky numër do të ulet si efekt i projekteve të realizuara, do të rritet si efekt i rritjes demografike dhe krijimit të familjeve të reja.

Gjatë vitit 2011 janë regjistruar rreth **72** ankesa të cilat kanë si objekt çështjen e strehimit. Duke shpresuar se aktet ligjore dhe nënligjore që kanë dalë nga Qeveria për zgjidhjen e strehimit, do të zgjidhin hap pas hapi këtë problem kombëtar dhe madhor, besojmë se dhe kategoritë e tjera të pastreha do të përfitojnë nga këto politika sociale të shtetit.

Gjatë trajtimit të këtyre ankesave kemi konstatuar zvarritje të procedurave për trajtimin me strehim të individëve që, megjithëse gëzojnë statusin e të pastrehut prej vitesh, përsëri nuk kanë gjetur asnjë mundësi të trajtohen me strehim nga ana e organeve të pushtetit vendor. Nga korrespondenca e mbajtur me Bashkitë si në Tiranë, apo edhe në rrethe të tjera, ka rezultuar se emrat e individëve ankues që i janë drejtuar Avokatit të Popullit, janë në listat përkatëse për t'u trajtuar me strehim, por zvarritja e procedurave ka ardhur si rezultat i mungesës së fondeve që kanë Bashkitë për trajtimin me strehim, për t'u ardhur në ndihmë të qytetarëve.

Gjithashtu një numër i konsiderueshëm ankesash kanë si objekt mungesën e transparencës në përzgjedhjen e kategorive apo në vendimmarrjet për zgjidhjen e këtyre çështjeve dhe sidomos në vendimet që marrin këshillat bashkiake, për të cilat pretendohet se asnjëherë nuk dihen kriteret vlerësuese e radha e trajtimit të shtetasve, probleme të cilat janë prezantuar dhe në raportet e mëparshme. Për më tepër për shkak të zgjedhjeve vendore në maj 2011, këshillat bashkiakë për një kohë të gjatë nuk funksionuan në disa prej bashkive kryesore.

Ajo që është vënë re në trajtimin e këtyre ankesave ka të bëjë me mangësinë e informimit publik për ditën e mbledhjeve, apo dhe rendin e

ditës të mbledhjeve të këshillave bashkiake, të cilat duhet të jenë publike dhe të njohura, me qëllim që personat e interesuar të jenë pjesë e kësaj procedure, për të cilët janë direkt të interesuar dhe për të cilat duhet të vihen në dijeni, qoftë dhe se kur praktikisht mund të zgjidhen shqetësimet e tyre.

Çështja e trajtimit me strehim të banoreve në qytete të ndryshme të vendit që jetojnë në banesat e ish-pronareve akoma nuk ka marrë një zgjidhje. Ndonëse sipas skemës ligjore për kreditë, norma e interesit për ta është 0 për qind, për shkak të të ardhurave familjare të pamjaftueshme mbeten jashtë skemës së përfitimit.

Gjatë vitit 2010 nëpërmjet Rekomandimit **nr. 201001070/2** datë 08.09.2010 Avokati i Popullit kërkoi rritjen e fondit të kredisë për strehim për ushtarakët e Forcave të Armatosura si dhe gjetjen e formave të tjera duke bashkëpunuar me organet lokale të pushtetit për të bërë të mundur zgjidhjen e problemeve të strehimit. Kjo çështje është trajtuar nga Avokati i Popullit edhe përgjatë vitit 2011, por nga ana e Ministrisë së Mbrojtjes ende nuk është gjetur një zgjidhje përfundimtare për të.

Ndër rastet e trajtuara për këtë problematikë përmendim:

Ankesa **nr.201000315**, e paraqitur nga një banor i qytetit të Rrëshenit i cili pretendonte se nuk ishte trajtuar me strehim nga kjo Bashki pavarësisht faktit që gëzonte statusin e të pastrehut. Gjithashtu në të ankuesi shprehte kundërshtimin e tij në lidhje me Vendimin e Këshillit Bashkiak Rrëshen, i cili kishte miratuar listën e personave që përfitonin kredi strehimi, por pa përfshirë emrin e tij edhe pse plotësonte të gjitha e kriteret e përcaktuara në ligjin nr.9232, datë 13.5.2004 “Për Programet Sociale Për Strehimin e Banorëve të Zonave Urbane”. Pas shqyrtimit të ankesës, rezultoi se pretendimet e ankuesit ishin të bazuara në ligj dhe Institucioni i Avokatit të Popullit rekomandoi shqyrtimin e pretendimeve të ankuesit dhe verifikimin e procedurave të miratimit të vendimit të Këshillit Bashkiak Rrëshen për miratimin e listës së përfituesve të kredive për shtëpi. Nga përgjigja e paraqitur për këtë rekomandim, u informuam se pas kryerjes së një verifikimi të plotë të procedurave dhe vendimeve respektive të Këshillit Bashkiak Rrëshen, rezultoi se është miratuar një listë e dytë e shtetasve që përfitonin kredi me kushte lehtësuese strehimi ku përfshihej edhe ankuesi në fjalë.

Ankesa me **nr.201000893**. Ankuesja, një qytetare e Beratit, ankohej se nuk ishte trajtuar me strehim nga kjo Bashki, pavarësisht faktit se gëzonte statusin e të pastrehut. Në përgjigjen dërguar institucionit tonë nga ana e këtij organi të administratës publike rezultoi se, kjo Bashki pavarësisht

marrjes së masave për trajtimin e kësaj kërkesë nuk kishte asnjë mundësi reale financiare për të trajtuar ankesën e saj. Megjithatë Kryetari i Bashkisë na informoi se ankuesja ishte akomoduar përkohësisht në Konviktin e Vajzave deri në gjetjen e një zgjidhje përfundimtare të këtij problemi.

Ankesa me **nr.201100338**. Ankuesi, një banor në qytetin e Burrelit, ankohej se nuk ishte trajtuar me strehim nga kjo Bashki, pavarësisht faktit se gëzonte statusin e të pastrehut. Në përgjigjen dërguar institucionit tonë nga ana e këtij organi të administratës publike rezultonte se, kjo Bashki i kishte marrë të gjitha masat për të trajtuar kërkesën e tij brenda mundësive ligjore dhe financiare, por zvarritja e procedurave kishte ardhur për arsye se në qytetin e Burrelit nuk ishte ndërtuar asnjë pallat i ri që nga viti 1994 dhe aktualisht Bashkia nuk dispononte apartamente të lira për lëshim me qera ose banesa me kosto të ulët. Në këto kushte ndonëse i drejtë dhe i bazuar në ligj pretendimi i ankuesit, çështja e tij nuk mund të zgjidhej brenda vitit 2011.

11. Ndihma ekonomike

Ankesat drejtuar Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2011 lidhur me ndihmën ekonomike, kanë konsistuar në pretendime për masën e përfitimit të ndihmës ekonomike, ndërprerjen e ndihmës ekonomike, si dhe ankesa për mundësim të përfitimit të pagesës së ndihmës ekonomike, për ata persona që nuk e përfitojnë atë.

Përsa i përket legjislacionit rregullator të këtij problemi janë bere disa ndryshime të cilat parashikojnë përdorimin e një forme të re vlerësimi, me synimin e përfshirjes në këtë skemë të çdo familjeje që jeton në varfëri. Risia e këtyre ndryshimeve, e konkretisht me hyrjen në fuqi të Ligjit nr.10399 date 17.03.2011 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.9355 date 10.3.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, është përfshirja në skemën e ndihmës ekonomike të viktimave të trafikut, pas daljes nga institucionet e pritjes dhe të rehabilitimit përkatës, e fëmijëve jetime të cilët nuk janë në institucione si dhe viktimat e dhunës në marrëdhëniet familjare, për periudhën e vlefshmërisë së urdhrimit të mbrojtjes.

Sfida që do të shmange të gjitha rastet e abuzimeve që kanë ndodhur në këtë sistem, do jete krijimi i regjistrimit elektronik kombëtar për të gjithë skemën e ndihmës ekonomike.

Disa nga ankesat e përmendura më poshtë pasqyrojnë më qartë, pretendimet e shtetasve të ndryshëm, lidhur me skemën aktuale të ndihmës ekonomike.

Ne ankesën me **nr.dok. 201100329**, një banor në Komunën Velipojë, Shkodër, ankohej se nuk trajtohej me ndihme ekonomike nga kjo Komunë, pavarësisht faktit se nuk kishte asnjë lloj te ardhure nga shteti për te jetuar.

Nga korrespondenca me Kryetarin e kësaj Komune rezultoi se, ankuesi ishte përfitues toke bujqësore në bazë të Ligjit nr.7501 date 01.08.1991 dhe të ardhurat që nxirrte nga toka, ishin më të mëdha se vetë ndihma ekonomike. Ndaj rezultoi se ankesa ishte e pabazuar dhe ankuesi u sqarua lidhur me përcaktimet ligjore ku bazohej trajtimi i tij.

Ne çështjen me **nr. dok. 201100082**, një banor i Njësisë Bashkiake Nr.5 Tirane, ankohej së familjes së djalit të tij (të vdekur) i ishte ndërprerë ndihma ekonomike.

Në përgjigjen qe Njësia Bashkiake na dërgoi, rezultonte se pas vdekjes së djalit, familja e tij ka vazhduar të trajtohej me ndihmë ekonomike, si një familje me pesë anëtare me kryefamiljare, deri në momentin kur është marrë konfirmimi zyrtar nga Instituti i Sigurimeve Shoqërore së fëmija i djalit te tij përfiton pension familjar nga skema e Sigurimeve Shoqërore, Tiranë. Ndaj, ankuesi u sqarua lidhur me pretendimin.

Ankesa me **nr. dok. 201100325** e një banori te Bashkisë Laç, për mosërfitim te ndihmës ekonomike.

Në përgjigjen dërguar institucionit tonë, nga ana e këtij organi te administratës publike rezultonte se familja e tij përbëhej nga gjashtë anëtare, tre nga te cilët ishin në emigracion Itali.

Në bazë të Ligjit Nr.9335 datë.10.03.2005 “Për Ndhmën Ekonomike dhe Shërbimet Shoqërore”, neni 9/1, si dhe VKM-se 787 dt.14.12.2005 “Për përcaktimin e Kritereve, të Proçedurave dhe të Masës së Ndhmës Ekonomike” pika 10/c, (Përjashtohen nga përfitimi i ndihmës ekonomike familjet që kanë në përbërje edhe një anëtar të vetëm, që plotëson kushtet e mëposhtme, i cili (c) Eshtë jashtë shtetit për çdo arsye me përjashtim të personave, që kryejnë studime ose janë për kurim dhe të personave pjesëtar të familjeve, të caktuar me punë pranë përfaqësive tona diplomatike dhe organeve ndërkombëtare), familja e tij nuk mund të trajtohej me ndihmë ekonomike.

Ne çështjen me **nr. dok. 201100318**, një banore e Bashkisë Kurbin, ankohej se me Vendim te Këshillit Bashkiak Kurbin, i ishte akorduar asistenca sociale prej 3000 lekësh, por ajo nuk e kishte perfituar ende për shkak të neglizhencës të Sektorit të Financës pranë kësaj Bashkie.

Çështja u zgjidh pozitivisht, pas ndërhyrjes se Zyrës sonë.

Ne ankesën me **nr. dok. 201101613**, një banore e Bashkisë Ura-Vajgurore Berat ankohej për mostrajtim me ndihmë ekonomike nga kjo Bashki.

Në përgjigjen dërguar institucionit tonë, rezultoi se familja e saj ka përfituar tokë bujqësore nga Ligji nr.7501 date 01.08.1991.

Duke u mbështetur në legjislacionin aktual për ndihmën ekonomike dhe shërbimet shoqërore, të ardhurat nga toka bujqësore në bazë të përllogaritjeve të bëra (me tre anëtare ne moshë madhore), janë më shumë se masa e ndihmës ekonomike, ankuesja nuk plotësonte një nga kriteret e dhënies së ndihmës ekonomike, pra nuk mund ta përfitonte atë. Duke parë gjendjen ekonomike të familjes së saj, nga ana e kësaj Bashkie ishin dhënë çdo fund viti me pako ushqimore dhe në varësi të fondeve që ka për raste emergjente edhe financiarisht.

Kjo bazuar në nenin 29 të ligjit nr.9355 dt.10.03.2005 “Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore”, Këshilli i Bashkisë / Komunës ka këto përgjegjësi: (pika 7) *“Vendos në përputhje me legjislacionin në fuqi të drejtën dhe masën e përfitimit të ndihmës ekonomike për familjen si dhe ofrimin e përfitimeve të veçanta të parashikuara me ligj”*, dhe në (pikën 9), të ligjit nr.9355 dt.10.03.2005 “Për Ndihmën dhe Shërbimet Shoqërore”, ku thuhet se: *Me fondet e veta në bazë të kriterëve specifike mbështet me ndihmë ekonomike apo forma të tjera ndihme e menjëhershme, familjet e varfra.*

Po kështu duhet të theksojmë faktin se nga trajtimi i mjaft ankesave, të cilat pas shqyrtimit kanë rezultuar të pabazuara, është bërë punë për sqarimin ligjor të problemeve të parashtruara nga ankuesit. Nga ankesat e trajtuara del qartë se një numër i konsiderueshëm i popullsisë jeton në kushte mjaft të vështira jetese. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve të Barabarta, duhet të vazhdojë punën e nisur për përsosjen e këtyre politikave në fushën e ndihmës dhe përkujdesit shoqëror, për përmirësimin e legjislacionit dhe përshtatjen me standartet më të larta të vendeve të përparuara demokratike

12. Mbrojtja e konsumatorit

Në mbrojtje të interesave të konsumatoreve zyra e Avokatit Popullit, përgjate vitit 2011 në trajtimin e ankesave të prezantuara i është referuar serisht Ligjit Nr.9902, date 17.04.2008 “Për mbrojtjen e konsumatorit”, por dhe dispozitave të Kontratave Tip në fuqi ndërmjet paleve, të miratuara nga Entet mbikqyrese të operatoreve tregtare. Duke qene se nga trajtimi i

ankesave, konsumtoret kane prezantuar dhe shkelje te se drejtes per informim per shkak te mungeses se transparences ne marredheniet konsumatore-furnizues, per pasoje shume nga rastet e trajtuara jane bazuar dhe ne te drejten e informimit, por ne kontekst te interesave te konsumatorit, i cili ka pretenduar abuzim dhe shperdorim nga operatore te ndryshem furnizues ne treg.

Numri i ankesave te cilat na jane adresuar dhe per te cilat eshte pretenduar shkelje e te drejtes se konsumatorit gjate ofrimit te sherbimeve, eshte **160**.

Fillimisht theksohet se eshte vene re qe ne drejtim te trajtimit nga ana jone te ankesave te prezantuara, pergjate vitit 2011 shpesh ka rezultuar zvarritje administrative te tejzgjatuara nga organet pergjegjese, gje qe na ka detyruar per inerci ne zgjatjen e trajtimit te ankesave tej limiteve te parashikuara.

Nevoja e komunikimit nderinstitucional, e drejta e informimit te konsumatoreve, por dhe Institucionit te Avokatit te Popullit, trajtimi, verifikimi dhe konstatimi brenda nje afati kohor te arsyeshem te ankesave, u ngrit me force gjate fillim vitit 2012 nga Institucioni yne, gje qe u pasqyrua ne seancat e zhvilluara me operoret pergjegjes te publikuara dhe ne media.

Kryesisht edhe gjate vitit 2011, konsumtoret ne ankesat e tyre kane paraqitur pretendime kundrejt kompanise CEZ Shperndarje sh.a, Ndermarrjeve te Ujesjelles Kanalizimeve (duke kryesuar me Drejtorine e Tiranes, por dhe te rretheve), si dhe shoqerise e telefonise fikse ALBtelecom sh.a.

1. Keshtu jane trajtuar pretendime per mosfaturim te rregullt dhe total mujor te energjise ne baze te Kontrates Tip ne fuqi ndermjete paleve nga ana e Kompanise CEZ Shperndarje sh.a, per disa muaj duke e faturuar sasine gjendje ne nje muaj te vetem. Konkretisht konsumtoret te ndryshem, kane pretenduar se prej 4-5 muajsh pas vendosjes se matesit ne banese, kur behej fjale per hapjen e nje kontrate te re, nuk faturoheshin prej 4-5muajsh.

Per kete gje iu dergua rekomandim Entit Rregullator te Energjise, si dhe iu ngrit si problem vet kompanise CEZ Shperndarje sh.a, ne seancen mediatike te zhvilluar prane ambjenteve tona. Lidhur me kete shqetesim, perfaqesuesit e CEZ Shperndarjes, pasi pranuan ekzistencen e ketij problemi, si dhe pasi kishin konstatuar ankesat konkrete te derguara nga zyra e Avokatit te Popullit, na informuan se ishin marre masat per shperndarjen propocionale te gjendjeve se energjise se pafaturuar, duke e shperndare ate ne menyre analoge per çdo muaj pararendes. Ne perfundim, na u premtua rregullimi i situates per marrjen e masave te nevojshme ne drejtim te ndalimit te ketyre fenomeneve abuzuese.

Nje problematike tjeter ka qene ne vijim, faturimi i takses vjetore per Radio-Televizionin Shqiptar, si dhe tarifen fikse te sherbimit, per kontratat e konsumoreve qe kane parashtruar kerkese per “pezullim te perkohshem te energjise ne banese, dhe nderprerje te energjise”. Ne kete kontekst ka pasur dhe ankesa per faturim te padrejte nga CEZ Shperndarje sh.a, mbi taksen e Radio-Televizionit Shqiptar per garazhet e mjeteve levizese.

Lidhur me kete gje, nga trajtimi i rasteve konkrete u informuam nga CEZ Shperndarje sh.a. se per konsumatorët qe kishin ushtruar te drejten e pezullimit te perkohshem te kontrates, me pasoje nderprerjen e energjise ne banese, faturimi i takses se Radio-Televizionit, ishte bere per nje afat te perkohshem duke pershkruar nje periudhe tranzitore afatshkurter, deri ne figurimin ne sistemin “billing system” te pezullimit te energjise per konsumatorët perkates.

Per sa i perket faturimit te takses se Radio-Televizionit per ambjentet e garazheve, Institucioni yne iu drejtua me rekomandim te veçante Ministrit te Financave, dhe Entit Rregullator te Energjise, per te rregulluar ligjerisht perjashtimin e ketyre ambjenteve. Ne pergjigje te rekomandimit tone, Ministria e Financave nxorri ne fund te Dhjetorit 2011 udhezimin perkates, ne te cilin percaktohej perjashtimi i ketyre ambjenteve te mjeteve levizese, nga taksa vjetore.

Ne drejtim te mungeses e transparences per ballafaqim me matesat nga abonentët qe prezantuan shqetesimin per mbifaturim te energjise per muaj te caktuar nga CEZ Shperndarje sh.a., u komunikua rast pas rasti me vete perfaqesuesit e kompanise furnizuese, por dhe me ndermjetesimin e Entit Rregullator te Energjise. Ky i fundit nepermjet seancave degjimore qe kryen ne baze te kompetencave, zhvilloi seanca degjimore te pretendimeve te ankuesve, ne prezence te perfaqesuesve te kompanise furnizuese, duke nxjerre konkluzione ne baze te dokumentacionit te paraqitur nga palet.

Megjithate situata ngelet problematike dhe ne kete kuptim, Institucioni i Avokatit te Popullit iu drejtua dhe kompanise CEZ Shperndarje sh.a. per tëu informuar mbi menyren se si do te zbatohet e drejta e transparences per konsumatorët ne drejtim te gjendjes ne matesa, e percaktuar ne Kontraten e re te hyre ne fuqi ne baze te nenit 7. Nga ana e kompanise u premtua qe deri ne fund te vitit 2012, do te krijohen kushtet per vendosjen ne bokse transparente te matesave, nga ku do te konstatohet lirshem nga çdo abonent i interesuar gjendja ne vend. Deri ne perfundim te ketyre procedurave, do te operohet ne baze te kerkesave individuale qe paraqet çdo konsumator i intersuar per tëu ballafaquar me matesin e tij.

Ne vijim, te problematikave te prezantuara ka qene dhe ajo ne drejtim te masave administrative te gjobave per demtim matesi, te konstatuara nga

vetë CEZ Shperndarje. Megjithese edhe per kete gje u veprua nepermjet seancave degjimore ne ambientet e Entit Rregullator te Energjise, pritet qe gjate vitit 2012 te permiresohet situata duke qene se per analizen laboratorike te matesave te “prekur” do te licensohen subjekte private dhe keto te fundit do te kene pergjegjesine e konsatimit, verifikimit dhe informimit te te interesuarve mbi demtimin e mundshem te matesave. Pra, duke qene se, supervizimi per analize laboratorike dhe kolaudimi i matesave i eshte hequr kompanise CEZ Shperndarje, kjo gje do te sensibilizojë dhe ndergjegjesoje dhe konsumatorët dyshues mbi gjendjen e aparateve te konstatuar si “te prekur”.

Ne raste sporadike u prezantua problemi i mosdorezimit te faturave te energjise ne kohe, per periudha te ndryshme. Per kete problem, nga ana jone u orientuan ankuesit per informimin dhe printimin “on line” te faturave, si sherbim i ofruar nga CEZ Shperndarje. Megjithate me interesimin tone ne drejtim te ketij problemi, nga CEZ Shperndarje sh.a. u sqaruam se mosdorezimi ne kohe i faturave, nuk ishte per shkak te neglizhences se kompanise, pasi kjo e fundit bente dergesat ne kohe, por mbetej si shqetesim ne sherbimin e ofruar nga Sherbimi Postar, me te cilen operohej per dergimin e faturave ne banesa. Me hapjen e shume Zyrave te Kujdesit ndaj Klientit, u be e mundur qe ne nje kohe te shpejte dhe pa zvarritje, te printohen faturat e energjise per çdo konsumator te interesuar qe nuk i kishte mberritur fatura ne adresen e deklaruar.

Nje problem tjetër ne vijim i prezantuar prane zyres tone, ka qene lidhur me deklarimin debitor nga ana e CEZ Shperndarjes, te qytetareve qe realisht kishin paguar energjine me pare. Per kete gje, pas interesimit tone dhe komunikimit me perfaqesues te kompanise na u premtua permiresimi i situates, qe kishte ardhur si pasoje e rakordimit me vonese nga vetë kompania e pagesave qe benin konsumatorët ne bankat e nivelit te dyte.

Krahasuar me ankesat e trajtuara gjate vitit 2010 ne drejtim te operatorit qe ben shitjen me pakice te energjise, nga zyra jone u vu re se me gjithë perpjekjet qe kishte bere kompania CEZ Shperndarje sh.a. ne drejtim te permiresimit te sherbimeve te ofruara (me hapjen e shume pikave te quajtura “Zyra e Kujdesit ndaj Klientit”, uljen e ankesave ne drejtim te mbifaturimit abuziv te faturuesve, informimin “on line” te faturave, furnizimin pa nderprerje te theksuar te energjise, njoftimin paraprak per nderprerjet per shkaqe teknike, si dhe marredhenieve me konsumatorët e saj, ende gjate vitit 2011 u prezantuan dhe u perseriten pretendimet per: mbifaturim te energjise per muaj te caktuar nga ankues te ndryshem, dhe mosballafaqim me matesin nga CEZ Shperndarje sh.a..

2. Ne mbrojtje te interesave te konsumatoreve, Institucioni i Avokatit te Popullit gjate vitit 2011 trajtoi nje numer te konsiderueshem ankesash nga qytetaret, drejtuar sherbimit te Ndermarrjeve te Ujesjelles Kanalizimeve. Kryesisht ankesat e prezantuara kane qene ne drejtim te Ndermarrjes se Ujesjellesit Tirane, dhe me pak per ato te rretheve.

Ne kete kuptim, u prezantuan ankesa per mungesen e informimit lidhur me pretendime per mbifaturim te ujit dhe keqperdorim te marredhenieve furnizues-konsumatore nga Ndermarrja e Ujesjelles-Kanalizimeve.

Per kete gje, nga ana jone shpesh iu vu ne dukje UKT-se qe kishte vepruar ne shkelje te se drejtes per informim nga ana e saj, ne baze te nenit 11/3 dhe 4 te Kontrates se Ujit, si dhe ne shkelje te nenit 51 te Kodit te Procedurave Administrative, qe percaktonte te drejten e informimit per kerkesat e parashtruara brenda afatit 10 ditor nga administrata.

Nje problematike tjeter u prezantua lidhur me faturime dukshem te larta nga ana e UKT-se, pasi ishte bere nderrimi i matesit te vjeter qe nuk kishte funksionuar rregullisht, megjithate ishte faturuar sasia e ujit te gjendur ne mates ne nje muaj te vetem.

Theksojme dhe gjykojme gjithashtu se mbetet problematike situata per faturim te ujit ne nivele te konsiderueshme edhe per persona qe nuk banonin ne apartamente. Ne kete kuptim u nderhy prane UKT-se duke vene ne dukje shkeljen e se drejtes se transparences per konsumatorin, bazuar ne nenin 4.2 pika 3 te Kodit te Ujit.

Lidhur me kete gje, megjithese Institucioni i Avokatit te Popullit eshte investuar disa here, duke i bere te ditur konstatimin ne vend UKT-se me qellim vertetimin nese sasia e ujit ishte konsumuar dhe ekzistonte apo jo gjendje ne matesa me abonentet qe nuk jetonin perkohesisht ne banesat e tyre, detyrimi mbetej ne fuqi dhe kerkohej nga Ndermarrja e Ujesjellesit.

Ne disa raste, prane zyres tone u paraqiten ankesa me ane te cilave konsumatorin pretendonin se nuk ishin respektuar detyrimet e furnizuesit ne baze te detyrimeve kontraktuale (Neni 4 i Kontrates se Ujit), per lajmerimin lidhur me “Nderprerjen e perkoheshme te sherbimeve nga operatori”, ku konsumatori duhej njoftuar nepermjet medias te pakten 3 dite perpara. Nga ana e UKT-se u mohuan ne vijimesi praktika te tilla, pasi ne çdo rast nderprerja ishte proceduar paraprakisht me njoftimin ne median vizive, por dhe ate te shkruar.

Ne perfundim, Institucioni i Avokatit te Popullit gjykon se gjate vitit 2011 komunikimi me UKT-ne u paraqit problematik dhe ne nivel institucional, per shkak te zvarritjeve te tejzgjatura kohore per informimin dhe sqarimin tone, ne drejtim te ankesave qe duheshin trajtuar nga UKT.

Edhe per kete furnizues, ne fillim te vitit 2012, u zhvillua nje takim me pjesëmarrjen edhe te medias vizive, gjate te cilit u kerkua nje bashkepunim me i ngushte ndermjet dy Institucioneve tona per informim ne kohe, u kerkua transparence me e larte ne drejtim te ballafaqimit te matesave te qytetareve qe i drejtohen UKT-se me kerkese-ankese, mosaplikimi i kamatvonesave per faturat qe ankimohen nga konsumatorët deri ne shqyrtimin nga ana e furnizuesit dhe informimin e qytetarit me shkrim apo procesverbal, si dhe informimi serioz dhe i shkruar i konsumatorit mbi ankesat e parashtruara prane Zyrate te Ankesave.

3. Nje operator tjetër problematik ne kete aspekt ka qene dhe operatori i telefonise fikse ALBtelecom sh.a., me sherbimet qe ka ofruar.

Institucioni i Avokatit te Popullit u investua ne kete drejtim duke marre shkas nga shkrimet e ndryshme ne media, por dhe nga disa ankesa konkrete te prezantuara prane zyres tone, lidhur me situaten kritike te prezantuar per faturat e derguara nga shoqeria ALBtelecom sh.a. ne drejtim te abonenteve te saj, te cilet kishin lidhur kontrate per perdorimin e internetit.

Konkretisht nga ana e ALBtelecom sh.a. gjate vitit 2011 u hodhen ne treg ne formen e ofertes, dy opsione per perdorim nga pajtimtaret e saj, te quajtuara "Fol Fiks" ne shumen 1.999leke dhe 2.999 leke. Qytetaret te joshur nga kjo oferte kishin nenshkruar kontratat perkatese ne baze te preferencave, te cilat iu jepnin mundesine e perdorimit te internetit dhe telefonise fikse neper banesa. Megjithate, ne faturat e muajve pasardhes, ishte vene re se detyrimet mbartese per çdo perdorues, nuk pershkruanin vetem vleren e ofertes, por dhe detyrime shtese qe kalonin dyfishin e vleres se kontrates se nenshkruar.

Ne keto kushte, dhe pas investigimeve te situates prane sporteleve te shoqerise ALBtelecom sha. dega Tirane, nga ana jone u dergua rekomandimi perkates Auroritetit te Komunikimeve Elektronike dhe Postare, ne te cilin argumentuam hollesisht domosdoshmerine e marrjes se inspektimeve ne drejtim te shoqerise ALBtelecom sh.a. per keqperdorim te marredhenieve operator-pajtimar lidhur me detyrime abuzive te faturuara nga ana e shoqerise per perdorimin internetit.

Ne pergjigje te ketij rekomandimi, nga ana e Autoritetit te Komunikimeve Elektronike dhe Postare u informuam zyrtarisht se ishte kryer inspektimi ne drejtim te shoqerise ALBtelecom sh.a dhe se, referuar informacioneve operative te disponueshme, sipermarresi Altelecom reflektoi dhe ndermorri masa konkrete per eliminimin e mundesive qe mund te çonin ne perseritjen e situatave te ngjashme ne te ardhmen.

Problematiken e prezantuar me siper, e bejme prezente ne rastet e meposhtme:

1. Me Nr. Doc. 201100772 u trajtua ankesa e qytetarit D. M., i cili prezantonte shqetesimin se nga ana e shoqerise Albtelecom sh.a ishte faturuar per muajin Maj 2011 me shumen 5848leke te reja, nderkohe qe kishte lidhur kontrate me kete kompani per oferten telefon fiks plus internet ne shumen 1500leke e quajtur fol fiks.

Ankuesi sqaronte se 2 muajt e pare ishte faturuar dhe kishte paguar shumen e ofertes, dhe per muajin maj ishte faturuar me shumen e 5848lekeve te reja, shume e cila tejkalonte dukshem oferten ndermjet paleve dhe te nenshkruar si te tille.

Per sa me siper u konkludua se kontrata e nenshkruar, ishte hartuar me paqartesi te medha dhe boshlleqe te dukshme, si ne sqarimin e termave per klientin ashtu dhe kushtet per te cilat ai kishte rene dakort te paguante. Po ashtu konstatuam paqartesi per detyrimet e operatorit furnizues ne drejtim te sherbimit te ofruar, kushteve qe percillte ky sherbim, limiteve te perdorimit te tij, si dhe vlerave konkrete per kalimin e ketyre limiteve. Operatori nga njera ane kishte detyruar ne formen e kontrates, qe klienti te pranonte oferten dhe te gjitha detyrimet rrjedhese, por nuk sqaronte ne asnje paragraf se tejkalimi i ofertes dhe shkarkimit te materialeve te ndryshme nga interneti, mbarte detyrime plus te cilat duheshin paguar mbi vleren e ofertes.

Ne kete kuptim, abonenti ne padijenine e nje informacioni te plote per kete problem, kishte nenshkruar per marrjen persiper te ketyre detyrimeve, dhe ishte gjendur i detyruar te paguante vleren e plote te fatures se ardhur. Per rastin ne fjale, ankuesi kishte nenshkruar per perdorimin e internetit deri ne 1 Gbyte, nderkohe qe nga download-imi i materialeve te ndryshme nga interneti, kishte tejkaluar limitin, duke shkuar ne vleren e 2Gbyte, diference e cila duhej paguar.

Per sa me siper, megjithese ankuesit i kemi sqaruar se fatura duhej paguar pasi ai qendronte i lidhur nga nenshkrimi qe i kishte bere, i kemi bere te ditur gjithashtu se Institucioni yne do te investohej ne vijim per kete problem.

2. Po keshtu u trajtua me Nr. Doc. 201101993 dhe ankesa e qytetarit me inicialet N. D, i cili pretendonte se kishte nenshkruar nje kontrate me shoqerine Albtelecom sh.a per instalim te internetit deri ne 2 Gbyte, sherbim i ofruar me oferten prej 999.00 leke ne muaj. Sipas sqarimeve ne ankese qe prej muajit Maj 2010 ai kishte paguar fatura teper te larta.

Ankuesi u informua mbi proceduren qe duhet te ndiqte edhe ne kete rast.

Megjithate, sikunder kemi referuar me siper, nga ana jone u ndermorren inspektive ne sportelet e shoqerise ALBtelecom sha. dega Tirane, dhe u konstatua se kishte disa dhjetra qytetare qe pretendonin te njejtin objekt ankese.

Ne kete kuptim, u ndermorr me inisiative rekomandimi drejtuar AKEP-it, si organi publik qe bente kontrollin e veprimtarise se kompanise Albtelecom sha., per rregullimin e termave, specifikimin e kushteve te kontrates, informimin e detajuar te abonenteve.

13. E drejta për kujdes shëndetësor

Kujdesi shëndetësor është tërësia e masave dhe veprimtarive të ndërmarra nga institucionet e kujdesit shëndetësor, punonjësit shëndetësor dhe shtetasit me qëllim përmirësimin e mirëqenies fizike, mendore e sociale, siç përcaktohet në Kushtetutën e Organizatës Botërore të Shëndetësisë. Shërbimet e kujdesit shëndetësor përfshijnë ndërhyrjet mjekësore, për të rritur mbrojtjen dhe trajtimin shëndetësor nëpërmjet parandalimit, diagnostikimit, masave kurative dhe rehabilituese të siguruara nga ana e ofruesve të regjistruar të kujdesit shëndetësor. E drejta për kujdes shëndetësor është një e drejtë themelore e njeriut ku rolin themelor e luan shteti si garantues i sigurisë së pacientit bazuar në mosdiskriminimin.

Kuadri ligjor, mbi bazën e të cilit Avokati i Popullit ka ushtruar veprimtarinë e tij në këtë fushë të drejtave të njeriut, me qëllim mbrojtjen dhe garantimin e saj, ka të bëjë me Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, Ligjin Nr.3766, datë 17.12.1963 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.8092, datë 21.03.1996 “Për Shëndetin Mendor, Ligjin Nr.7870, datë 13.10.1994 “Për Sigurimet Shëndetësore në Republikën e Shqipërisë”, Ligjin Nr.7895 datë 27.01.1995 neni 97, “Kodi Penal i Republikës së Shqipërisë” etj.

Duke vlerësuar këtë të drejtë, si një prej çështjeve më të rëndësishme të një shteti social, si dhe element të rëndësishëm të së drejtës që ka çdo individ për të jetuar i shëndetshëm, veprimtaria e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2011, është fokusuar në inspektive në Qendrat Spitalore të Shëndetit Mendor, të Shërbimit Parësor të Kujdesit Shëndetësor në të gjithë vendin si dhe Qendrën Spitalore të Burgjeve.

Rëndësia e këtij procesi qëndron jo vetëm në evidentimin e gjendjes së respektimit dhe zbatimit të ligjit, i cili reflekton respektimin e të drejtave dhe lirive të individit në këto institucione, por dhe për vlerësimin e funksionimit të strukturës institucionale, të përshtatur me profesionalizëm,

sipas standardeve të kërkuara konform ligjit, si dhe vlerësimit të kushteve infrastrukturore ekzistuese në ambientet e këtyre institucioneve.

Nga 8 inspektimet e kryera ne këtë fushe, si dhe nga **21** rastet e trajtuara nga ana jonë që lidhen me të drejtën për kujdesin shëndetësor, është arritur në konkluzionin se, në përgjithësi, shërbimet shëndetësore dhe sociale që u ofrohen individëve në këto qendra kanë nevojë për më shumë fonde investimi, plotësim organike, shpejtësi në realizimin e projekteve, përqendrim dhe vëmendje më të madhe në trajtimin human të të sëmurëve. Inspektimet dhe vizitat e kryera ne këto institucione, kanë patur një rol të madh në evidentimin e problematikave që ekzistojnë në këto institucione, lidhur me kushtet dhe mënyrën e trajtimit të shtetasve në përputhje me dispozitat ligjore sipas fushës përkatëse.

Avokati i Popullit duke ju referuar edhe statistikave të mëparshme vlerëson si të pamjaftueshëm angazhimin institucional, fondet e vëna në dispozicion dhe masat e marra për përmirësimin e situatës në shërbimet spitalore. Kjo vihet re edhe pasi ne shumë prej inspektimeve të përsëritura problematika mbetet e njëjtë dhe mbartet nga viti në vit. Krahas kësaj, Ministria e Shëndetësisë është treguar jo serioze në vlerësimet e rekomandimeve të bëra nga ana e Avokatit të Popullit. Kjo vihet re nga mos kthimi i përgjigjeve brenda afatit që e detyron ligji rast pas rasti.

Raste të evidentuara gjatë inspektimeve dhe të trajtuara nga ana jone:

1. Në Shtëpinë e Foshnjës 0-6 vjeç Tirane

Nga inspektimi në këtë shtëpi foshnje u konstatua problemi lidhur me kujdesin shëndetësor për fëmijët që strehohen ne këtë institucion. Konkretisht rezultonte problemi i regjistrimit të tyre ne një prej qendrave shëndetësore, (mundësisht me te afërt me pozicionin gjeografik te këtij institucioni), ne Sauk apo Qendrën Shëndetësore nr.1, Tirane. Nuk është e drejte që për kontrollin periodik te këtyre foshnjave si dhe vaksinimin e tyre, te mos ekzistojnë kartela përkatëse ne një qendër shëndetësore, siç mundësohet edhe për fëmijët me prindër. Ky është nje detyrim ligjor dhe i sanksionuar ne Konventën “Për te Drejtat e Fëmijës” te O.K.B, ratifikuar edhe nga vendi ynë.

Kjo çështje është filluar “Ex officio” dhe është regjistruar me pas për shqyrtim nga ne me **nr.201100939**. Pas konstatimeve të bëra nga ana jone është rekomanduar: marrja e masave te menjëhershme për regjistrimin e këtyre fëmijëve ne Qendrën Shëndetësore më te afërt, dhe angazhimi i strukturave shëndetësore për kujdesin e tyre maksimal, për foshnjat dhe fëmijët që strehohen ne Shtëpinë e Fëmijës 0-6 vjeç, Tirane.

Ministria e Shëndetësisë në përgjigjen e saj sqaron procedurën që do të ndjekë vetë ky institucion deri në regjistrimin e këtyre fëmijëve pranë një qendre shëndetësore.

2. Në *Spitalin Psikiatrik Shkodër* u konstatua se godina e re e cila duhet të kishte përfunduar, akoma nuk ishte dorëzuar dhe si rezultat pacientet vazhdonin të strehoheshin ne godinën e vjetër. Gjendja e saj ishte përsëri e amortizuar, pasi ne te nuk ishte investuar ne pritje te kalimit ne spitalin e ri. Gjithashtu nevojat e pacienteve për medikamente nuk plotësoheshin tërësisht dhe kishte mungesa. Cilësia e detergjenteve sanitare, e konstatuar edhe ne vitin 2011 ishte e njëjtë si një vit më parë, dhe linte shumë për të dëshiruar. Stafi kujdestar nuk kishte mundësira trajnimi te domosdoshme këto për natyrën e tyre te shërbimit.

Kjo çështje u fillua “Ex officio” dhe u regjistrua me pas për shqyrtim nga ne me **nr.201100622**. Pas konstatimeve të bëra nga ana jonë është rekomanduar: përsheptimi i punimeve për kalimin e pacientëve të këtij spitali në ambientet e godinës së re brenda afatit te përcaktuar, plotësimi i gamës se medikamenteve aq te nevojshëm për këtë kategori të sëmurësh, si dhe përmirësimi i cilësisë së detergjenteve sanitare si produkte të domosdoshme për një higjienë brenda standardeve të kërkuara në këto institucione duke trajnuar periodikisht dhe stafin kujdestar.

Në përgjigje të rekomandimit tone, Drejtoria e Spitalit Psikiatrik Shkodër është shprehur se brenda vitit 2011 do bëhet kalimi fizik i pacientëve në godinën e spitalit të ri, gjë që u realizua ne dhjetor te vitit 2011. Edhe plotësimi i nevojave me medikamente është kryer dhe nuk ka më mungesa, ndërsa trajnimi i stafit do shikohet si një mundësi e realizueshme në të ardhmen.

3. Në *Spitalin Psikiatrik Vlorë* është konstatuar se kushtet ku strehohet pjesa më e madhe e pacientëve të këtij spitali, vazhdojnë te jenë jashtë standartit. Ka pamjaftueshmëri të stafit mjekësor dhe personelit ndihmës në këtë institucion, për të ofruar një shërbim dhe përkujdesje ndaj pacientëve, sipas kërkesave të përcaktuara në ligj. Gjithashtu mungon trajnimi i stafit te mesëm kujdestar dhe infermier.

Kjo çështje është filluar “Ex officio” dhe është regjistruar më pas për shqyrtim nga ne me **nr.201100801**. Pas konstatimeve të bëra nga ana jonë është rekomanduar: lëvrimi i fondeve për ndërtimin e godinës së re; shtimi i numrit të mjekëve dhe personelit ndihmës në organikë si dhe krijimi i personelit task-forcë për rastet specifike në urgjencën e këtij institucioni. Mundësia e vazhdueshme të trajnimeve afatgjata për stafin mbështetës.

Sa më sipër, Ministria e Shëndetësisë nuk ka kthyer përgjigje për sa kemi rekomanduar, ndonëse rekomandimi ynë daton që në 14.09.2011

4. Në Spitalin Psikiatrik Elbasan është konstatuar se, kishte mangësira në organikën e stafit mjekësor, infermier dhe kujdestar, në raport me numrin e pacientëve të shtruar në këtë institucion sipas standarteve të kërkuara. Pacientët e këtij spitali vuajnë ndjeshëm mungesën e mosfunksionimit të sistemit të ngrohjes, të drejta ligjore këto të parashikuara në nenin 7 të Ligjit Nr.8092 dt.21.03.1996, “Për Shëndetin Mendor”. Nuk ishin kryer investime dhe lagështira mbizotëron në të gjitha ambientet. Në të njëjtën gjendje ndodhej përsëri edhe rrjeti i furnizimit me ujë të pijshëm. Në lavanterinë e këtij spitali u konstatua se kishte mungesa të pajisjeve larës e profesional.

Kjo çështje është filluar “Ex officio” dhe është regjistruar më pas për shqyrtim nga ne me **nr.201101346**. Pas konstatimeve të bëra nga ana jonë është rekomanduar marrja e masave urgjente për plotësimin dhe shtimin e stafit infermier në organikën e Spitalit Psikiatrik Elbasan, kryerja e hidroizolimit të tarracës së këtij spitali për evitimin e lagështirës nëpër pavione, si dhe marrja e masave urgjente për rikonstruksionin e sistemit të ngrohjes për të gjitha ambientet e këtij institucioni. Përmirësimi i kushteve të rrjetit të furnizimit me ujë të pijshëm, si dhe mundësia e blerjes së një paisjeje lavanderike profesionale, është pjesë në vazhdim e këtij rekomandimi.

Sa më sipër, Ministria e Shëndetësisë nuk ka kthyer përgjigje për sa kemi rekomanduar që ne 28.10.2011.

5. Në Spitalin Infektiv pranë QSUT-së është konstatuar pamjaftueshmëri e ambienteve të shtrimit referuar numrit të pacienteve që trajton ky spital. Gjithashtu nga inspektimi u konstatua se duset nuk funksionojnë në të gjitha pavionet. Kishte gjithashtu edhe mungesa të paisjeve që shërbejnë për mbajtjen e serumeve.

Kjo çështje është filluar “Ex officio” dhe është regjistruar më pas për shqyrtim nga ne me **nr.201101807**. Pas konstatimeve tona, është rekomanduar marrja e masave për rikonstruksionin e ambjenteve të veçanta për raste epidemish me qëllim zgjerimin e ambjenteve të këtij spitali, paisjen me dushe dhe funksionimin e tyre në të gjitha pavionet si dhe shtimin e aparateve që shërbejnë për mbajtjen e serumeve.

Sa më sipër, Ministria e Shëndetësisë nuk ka kthyer përgjigje për sa kemi rekomanduar që ne 22.12.2011.

6. Një nga çështjet e filluara me iniciative, ka qenë edhe riinspektimi i kryer në **Repartin Infektiv të Spitalit Ushtarak (nr.201101806)**. Objekti i këtij inspektimi ka qenë verifikimi i kushteve, në të cilat sigurohet kujdesi shëndetësor për pacientet, bazuar në përcaktimet e Ligjit Nr.3766, datë 17.12.1963 “Për Kujdesin Shëndetësor në Republikën e Shqipërisë”.

Në këtë inspektim konstatuam pamjaftueshmëri të stafit te mesëm konkretisht infermier ne raport me nevojat e këtij spitali. Gjithashtu u evidentua dhe mosfunksionimi i sistemit te ngrohjes ne te gjitha ambientet, mosfunksionimin e dusheve për pacientët. Një shqetësim tjetër që na u prezantua ishte edhe mbështetja financiare e punonjësve të stafit mjekësor, të cilët punojnë në repartin infektiv (mjek dhe infermier) dhe konkretisht, dhënia e shtesës për kushte pune të diferencuar nga kategoritë e tjera siç e përfitojnë koleget e tyre në QSUT.

Për sa më sipër, përgatitëm rekomandimin përkatës për Ministrinë e Mbrojtjes dt.01.12.2011 e cila nuk ka kthyer përgjigje lidhur me këtë çështje.

7. Nga inspektimi i kryer ne **Qendrën Spitalore te Burgjeve** janë konstatuar problematikat, te cilat janë referuar në çështjen **nr. 201100712**, lidhur me marrjen e masave për lyerjen e dhomave të pacientëve në sektorin e femrave dhe meshkujve, me qëllim përmirësimin e higjienës së ambientit ku ato qëndrojnë më së shumti përgjatë kurimit të tyre. Marrjen e masave për rikonstrukcionin sa më parë të dhomave në sektorin e femrave, pasi qëndrimi i gjatë në ato ambiente me lagështirë të theksuar, përbën rrezik serioz për shëndetin e tyre. Krijimi i menjëhershëm i një dhome të veçantë observimi për rastet e diagnostikuara me probleme të shëndetit mendor me masa izolimi, pasi mungesa e një të tilla përbën problem serioz për stafin mjekësor i cili nuk disponon mjetet e duhura të shtrëngimit sipas standarteve të kërkuara. Marrjen e masave për mundësimin e të gjitha aparateve dhe mjeteve dentare në ambjentin e shërbimit stomatolog, si dhe vendosjen e një strehe në ambjentet e ajrimit, me qëllim eliminimin e pasojave të dëmshme nga rrezet diellore, pasi të gjithë të dënuarit dhe të paraburgosurit janë nën trajtime mjekësore me specifika të ndryshme. Shtimin në organikë të stafit rehabilitues dhe kryesisht atë kujdestar, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit kundrejt pacientëve me probleme të shëndetit mendor, si dhe zgjerimin e ambjentit të edukimit dhe mundësimin e të gjitha mjeteve për kryerjen e aktiviteteve brenda këtij ambjenti, me qëllim përmirësimin e kushteve për rehabilitimin dhe ndikimin pozitiv në nivel psiko-social, për të dënuarit dhe të paraburgosurit dhe specifikisht të rasteve që trajtohen me mjekim të detyruar. Po kështu rekomanduam të merren masat mbrojtëse për stafin mjekësor kundrejt rasteve me sëmundje infektive, si dhe kërkuam zbatimin e Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim mundësimin në kohë të të gjitha ekzaminimeve mjekësore me specifikë të profilizuar nga institucionet spitalore palë të këtij Memorandumi, për persona me liri të kufizuar.

Me shkresën nr.5491/1 K4/02-3 Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, lidhur me problematikat e konstatuara në Qendrën Spitalore të Burgjeve në Tiranë, na informoi se kishte përfunduar lyerja e dhomave të pacienteve në sektorin e femrave dhe meshkujve, me qëllim përmirësimin e higjienës së ambientit ku mbahet kjo kategori gjate kurimit të tyre. Gjithashtu ishte vënë prioritet marrja e masave për rikonstruksionin e dhomave në ambientin e femrave, për eliminimin e lagështirës. Me transferimin e personave me probleme të shëndetit mendor me mase mjekësore “mjekim i detyruar” nga Spitali i Burgut në I.E.V.Penale Kruje, do të fillonte menjëherë projektimi për krijimin e një dhome të veçantë observimi për rastet e diagnostifikuara me probleme të shëndetit mendor dhe masa izolimi. Përsa i përket mjeteve shtrënguese, sipas studimit të tregut dhe informimit nga institucione spitalore, mjete shtrënguese me standarte të larta nuk gjenden në tregun mjekësor. Për këtë ata i kanë kërkuar bashkëpunim institucioneve dhe organizatave bashkëpunuese për këto aksesore, por akoma nuk është bërë i mundur ofrimi i këtyre mjeteve.

Lidhur me shërbimin stomatologjik për rastet e paraqitura, u sqaruam se ofrohet asistencë në ambientet e I.E.V.Penale 325.

Shtimi në organikë i stafit rehabilitues dhe kryesisht ai kujdestar, do të shihet si mundësi në hartimin e strukturave të reja organike për vitin 2012, ndonëse miratimi përfundimtar i strukturave të propozuara nuk është atribut i Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

Në lidhje me marrjen e masave mbrojtëse për stafin mjekësor kundrejt rasteve me sëmundje infektive, u siguruam se do të hartohet një udhëzim lidhur me këto masa. Për këtë çështje institucioneve penale në vend, i është ushtruar kontroll nga Specialistet e Institutit të Shëndetit Publik të cilët në baze të disa kriterëve kanë përcaktuar për çdo pozicion pune, shkallen e vështirësisë dhe rrezikshmërisë së infeksionit. Nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, është kërkuar edhe njëherë rishikimi i përcaktimit të kriterëve dhe përjasja sa më reale dhe konkrete në lidhje me masat që duhet të merren.

Për zbatimin e Memorandumit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë, është në fazën e përpunimit të të dhënave të ofruara nga Sektori Shëndetësor, si dhe përcaktimin e udhëzimeve për implementimin e marrëveshjes.

8. Një tjetër çështje e filluar me iniciativë në fund të vitit 2011 ishte marrë shkas nga media vizive dhe shtypi i shkruar, është një inspektim në të gjithë strukturën e QSUT-se “Nene Tereza”, në Tiranë. Ky inspektim zgjati për një periudhë tre mujore duke marrë parasysh shtrirjen e shërbimeve dhe volumin e çështjeve të konstatuara, problematika këto që do të pasqyrohen

në mënyrë të detajuar ne raportin e vitit 2012, pasi akoma jemi duke hetuar lidhur me konstatimet e rezultuara nga inspektimi.

14. Synimi për një mjedis të shëndetshëm

Institucioni i Avokatit të Popullit edhe gjatë vitit 2011 ka vijuar trajtimin e ankesave të paraqitura ndaj organeve të ngarkuara me ligj për mbrojtjen e mjedisit nga ndotja, kryesisht që kanë lidhje me ndotjen e ambientit nga agjentë të ndryshëm apo aktiviteteve të paligjshme e të paliçesuara, ndotjen e ajrit nga djegiet e lëndëve të rrezikshme, hedhjen e mbeturinave në vende publike, vibrimet akustike, të cilat në tërësinë e tyre dëmtojnë cilësinë e shëndetit dhe jetës së banorëve që jetojnë në këto zona të prekura nga këto ndotje.

Avokati i Popullit ka treguar sensibilitet në trajtimin e rasteve të ndryshme, të paraqitura nga shtetas të ndryshëm, ku janë konstatuar veprime në kundërshtim me dispozita ligjore në fuqi, të cilat çenojnë të drejtën për një ambient të pastër e të shëndetshëm, duke ndjekur parimin se ambienti u përket të gjithëve, i shërben jo vetëm këtij brezi por edhe brezave të ardhshëm, dhe të gjithë duhet të jenë të ndërgjegjshëm që të japin kontributin e tyre në këtë aspekt.

Gjatë vitit 2011 janë regjistruar **58** ankesa në të cilat individë të ndryshëm kanë ngritur pretendimet e tyre për cënim të së drejtës së tyre të ligjshme për një ambient të pastër, si dhe për mosveprim të organeve shtetërore të ngarkuar me ligj ndaj subjekteve të ndryshme që shkaktonin ndotje ambientale.

Nga ankesat e parashtruara, 29 janë zgjidhur në favor të ankuesve, 4 kanë qenë jashtë kompetencave të Avokatit të Popullit, si dhe një ankese ka rezultuar jashtë juridiksionit tonë. Ndërkohë që 23 ankesa kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2012.

Duke marrë në konsideratë numrin e ankesave, Avokati i Popullit konstaton se ka një sensibilizim më të madh të individëve për të kërkuar mbrojtjen dhe reagimin e institucioneve shtetërore përsa u përket çështjeve mjedisore.

Nga ana tjetër, numri i ankesave të parashtruara pranë institucionit të Avokatit të Popullit, tregon edhe për një mosveprim të strukturave rajonale për të ushtruar kompetencat e njohura atyre me ligj. Shpesh individët janë të paqartë apo nuk kanë dijeni për ekzistencën e strukturave mjedisore të krijuara me ligj dhe kërkojnë ndërhyrjen direkte të Avokatit të Popullit për verifikimin dhe zgjidhjen e problemeve të tyre.

Përsa i përket zhvillimeve dhe risive në legjislacion, gjatë vitit 2011 janë miratuar dy ligje mjaft të rëndësishme, Ligji 10440 datë 07.07.2011 “Për vlerësimin e ndikimit në mjedis” dhe Ligji nr. 10463 datë 22.09.2011 “Për menaxhimin e integruar të mbetjeve”. Avokati i Popullit, gjykon se zbatimi me rigorozitet i dispozitave të këtyre ligjeve, krahas atyre ekzistuese, do të ndikojë në përmirësimin e situatës mjedisore në Shqipëri si dhe rritjen e standarteve të ofrimit të shërbimeve ndaj qytetarit, në përputhje me kërkesat dhe standartet e jetës së qytetarëve të vendeve europiane, në kuadër të proceseve integruese që ka ndërmarrë Shqipëria.

Lidhur me ushtrimin dhe përmbushjen brenda standarteve ligjore të së drejtës për ambient të shëndetshëm, Avokati i Popullit ka ushtruar të drejtën e tij të iniciativës për verifikimin dhe inspektimin e ruajtjes dhe respektimit të standarteve mjedisore në dy raste të ndryshme. Konkretisht në ankesën me nr. Doc. **201100865**, Avokati i Popullit hetoi dhe shqyrtoi mbi informacionin e dhënë në mediat e shkruara, në bazë të të cilit raportohej për mungesën e dezinfektimeve të nevojshme për t’u kryer gjatë periudhës së verës, në disa bashki dhe institucione të ndryshme në rang lokal. Pas korrespondencave zyrtare dhe shqyrtimit të pretendimeve të ngritura, rezultoi se u kontrolluan të gjitha subjektet tregtare lidhur me kushtet higjeno-sanitare si dhe pajisjen e punonjësve me libreza shëndetësore, dhe leje higjeno-sanitare. Po ashtu, nga Institutet e Higjenës dhe Shëndetit publik u ushtruan inspektime të vazhdueshme në Bashkitë e përmendura në artikull, ku krahas vlerësimit të gjendjes higjeno-sanitare, u lanë dhe detyra konkrete lidhur me investime në fushën e rrjetit të kanalizimeve të ujrave të bardha dhe të zeza, evadimit të tyre, si dhe mbetjeve urbane të zonave të populluara.

Gjithashtu me iniciativë u ndoq edhe rasti i djegies së mbeturinave urbane në qytetin e Patosit me nr. Doc. **201100914**, dhe u ndërmorrën të gjitha procedurat ligjore rreth verifikimit dhe shqyrtimit të këtij rasti. Në përfundim të hetimit Avokati i Popullit i rekomandoi Bashkisë Patos, Prefekturës së Qarkut dhe ARM të Qarkut Fier që të ushtrojnë kotrolle të vazhdueshme në zbatim të kompetencave të njohura me ligj, me qëllim që të evitoheshin raste të tilla, të dëmshme për jetën dhe shëndetin e banorëve të këtij qyteti. Në përgjigje dhe përmbushje të rekomandimit tonë, Kryetarja e Bashkisë Patos, na vuri në dijeni mbi masat që ka marrë kjo Bashki, duke theksuar mes të tjerash rritjen e inspektimeve e kontrolleve, evadimin më të shpeshtë të mbetjeve, angazhimin e rojeve private për parandalimin e djegieve dhe bashkërendimin e veprimeve edhe me organe të tjera që janë të interesuara për ndjekjen e këtij problemi, duke i dhënë një zgjidhje të përshtatshme problemit në fjalë, falë ndërgjegjësimit të organeve të ndryshme për rëndësinë e ruajtjes dhe mbrojtjes së ambientit.

Problemi i djegies dhe grumbullimit jashtë kriterëve ekologjike të mbetjeve urbane po përbën tashmë një rrezik serioz për komunitetin e zonave përreth tyre. Është vënë re një reagim pozitiv nga Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujrave, si dhe Agjencitë Rajonale të Mjedisit në Qarqe për të reaguar dhe ndëshkuar subjektet që kanë përgjegjësi ligjore për disiplinimin e një veprimtarie të tillë. Gjithsesi është konstatuar një reagim joproporcional dhe i pabarabartë me vendosjen e këtyre masave administrative, duke qenë se një problematikë e tillë haset pothuajse në të gjitha njësitë e qeverisjes vendore.

Duke iu referuar numrit të ankesave të depozituara pranë Avokatit të Popullit, si dhe problematikave të ngritura shpesh në median e shkruar dhe atë vizive lidhur me çështjet e mjedisit, Avokati i Popullit gjatë vitit 2011 filloi një studim lidhur me mënyrën e trajtimit të problemeve mjedisore nga ana e organeve të pushtetit lokal. Për këtë qëllim, hartuam disa pyetësor të cilët ia drejtuam si përfaqësuesve të organeve të pushtetit lokal, ashtu edhe komunitetit.

Përgjithësisht, perceptimi i shfaqur reflekton në mangësi të shumta në ushtrimin e detyrave minimale për çështje mjedisore të qyteteve si dhe një mungesë serioze për të bashkërenduar punën me të gjithë faktorët dhe aktorët që veprojnë në këtë fushë. Përgjithësisht, individët janë të mënjanuar nga procesi vendimmarrës në organet kolegjiale të pushtetit lokal dhe nuk kanë të paktën mundësi informimi mbi çështjet që diskutohen dhe vendimet që merren. Në këtë kuadër, duhet theksuar edhe fakti se mungon një bashkërendim dhe koordinim i strukturave lokale dhe qendrore në çështjet mjedisore. Ky është një element mjaft i rëndësishëm, aplikimi i të cilit do t'i jepte zgjidhje të përshtatshme disa problemeve dhe zonave të nxehta mjedisore si dhe do të përmirësonte cilësinë e jetës së individëve të ndryshëm. Kështu p.sh mund të përmendim ngritjen dhe hapjen e landfillit në Durrës, vënia në funksionim e të cilit do të zgjidhte edhe problemin e djegies së mbeturinave urbane dhe spitalore edhe në qytetin e Krujës, i cili për nga vetë natyra dhe karakteristikat e tij turistike, kërkon një vëmendje të veçantë në ruajtjen e vlerave që ai mbart.

Avokati i Popullit ka verifikuar edhe ankesa të banorëve lidhur me ndotjen akustike dhe cënim të jetës dhe shëndetit të tyre nga vepra publike si në rastin e banorëve të zonës së Lurës, që shpreheshin për rrezikshmëri potenciale nga linjat e tensionit të lartë që kalonin afër pronave të tyre, si rezultat i ndërtimit të hidrocentraleve të vogla në këtë zonë. Pas hetimit të pretendimeve të ngritura, rezultoi se nga ana teknike, ishin respektuar të gjitha normat për të mos rrezikuar absolutisht jetën e banorëve, pasi distanca e vijës së linjës së tensionit të lartë, në këtë segment ishte e barazlartuar në

një distancë të sigurtë, duke kaluar në pikën më të largët nga shtëpitë me referim aksin e lumit që rridhte në këtë fshat.

Problem mjaft shqetësues i prezantuar nga individë të ndryshëm, sidomos gjatë sezonit të verës, janë ndotjet akustike në vijën bregdetare si dhe zona të banuara, por që shfrytëzohen në mënyrë të padrejtë dhe të pakontrolluar nga subjekte të ndryshme për qëllime përfitimi personale.

Avokati i Popullit ka konstatuar se ndërmerren aksione të përkohshme për verifikimin apo pezullimin e aktiviteteve të ndryshme, por që gjithsesi nuk japin një zgjidhje afatgjatë dhe të qëndrueshme të problemit ekzistues prej vitesh dhe që përsëritet në vazhdimësi.

Konstatime të tilla mjaft shqetësuese janë vënë re sidomos gjatë vijës bregdetare dhe kryesisht për largimin e ujrave të zeza të hoteleve dhe shtëpive të banimit, të cilat janë ndërtuar jashtë çdo kriteri urbanistik dhe ekologjik, fare pranë vijës së ujit. Avokati i Popullit gjykon se zgjidhja e këtij problemi kërkon një angazhim serioz dhe afatgjatë të strukturave shtetërore në përgjithësi, për planifikimin, financimin dhe zbatimin e projekteve konkrete, me qëllim që veprimtaria e ARM-ve të qarqeve apo strukturave ad-hoc të MMPAU të mos fokusohet vetëm në ndërprerjen e përkohshme të kanalizimeve dhe lejimin e rrjedhjes së lirë të ujrave të zeza, pikërisht në vendin ku shtetas shqipar apo edhe turistë të huaj ndodhen për të kaluar ditët e tyre të pushimit.

Avokati i Popullit do të vijojë të ndjekë me një prioritet abosolut çështjet mjedisore, duke trajtuar jo vetëm ankesat e parashtruara nga subjekte të ndryshme publike apo private, por duke inspektuar edhe me iniciativën e vet zona potencialisht të rrezikshme mjedisore, me qëllim të rritjes së cilësisë së jetës dhe shendetit të individëve dhe shmangies së rreziqeve të tilla nga mosveprime të organeve të administratës shtetërore të ngarkuara me këtë mision.

15. Problematikat e pushtetit vendor gjatë ushtrimit të veprimtarisë së organeve të tij

Reformimi i administratës publike në kuadrin e aplikimit të vëndit tonë për antarësim në Bashkimin Evropian mbetet sfidë aktuale jo vetëm në përshtatjen e legjislacionit me standartet e Komunitetit, por dhe në zbatimin e saj.

Në këndvështrimin e detyrimeve të tij kushtetuese, institucioni i Avokatit të Popullit monitoron veprimtarinë e njësisve të qeverisjes vendore

për sigurimin e mirëqeverisjes në nivel sa më afër shtetasve dhe në zgjerimin e gamës dhe cilësisë së shërbimeve të ofruara komunitetit.

Por kjo mbetet një lidhje e dyfishtë dhe ndërvarur nga gadishmëria e shtetit në delegimin e kompetencave nga njëra anë dhe, nga presioni, gadishmëria, aftësitë manaxheriale dhe resurset, veçanërisht atyre financiare dhe ekonomike të organeve vendore. Proçesi permanent i transferimit të pronave të paluajtshme publike tek njësitë vendore ka patur ndikimin e saj pozitiv në përmirësimin e vazhdueshëm të cilësisë së jetës së shtetasve në aspektin ligjor, ekonomik dhe social.

Legjislacioni aktual që rregullon funksionimin dhe kompetencat e pushtetit vendor, pavaresisht nevojës për nderhyrje legjislative, perben baze të shëndoshe për funksionimin korrekt të organeve të administratës vendore dhe në forcimin e bashkëpunimit dhe frymës së mirëkuptimit me qytetarët.

Megjithatë, niveli i zbatimit të legjislacionit në veprimtarinë ekzekutive, në veçanti të komunave, lë shumë për të dëshiruar, në krahasim me performancën e bashkive dhe këshillave bashkiake të kryeqytetit dhe qyteteve të tjera të mëdha.

Niveli i përgjegjshmërisë, si koncept i mospërrjashtimit nga dëmshpërblimi ndaj personave privatë në rastet e marrjes së vendimeve apo refuzimit të paligjshëm për të marrë vendime, nga një pjesë e administratës nuk është në lartësinë e duhur.

Në administratën e shumë prej organeve të qeverisjes vendore mungon juristi, prania e të cilit pa dyshim do ketë ndikim pozitiv në cilësinë e jetës administrative. Mënyra e formulimeve të akteve administrative, mungesa e referencave ligjore, mënyra e procedimit administrativ, mosrespektimi i afateve ligjore, shkelja e parimeve të tilla si bashkëpunimi i administratës me personat private, përgjegjshmëria e organeve dhe nepunesve të tyre, përfundimi i procedimit me marrjen e një vendimi, ai i sigurisë juridike, e drejta për të informuar individët, konflikti i interesave në vendimmarrje, rezultojnë të kenë sjellë pasojat e tyre në dëm të interesave të qytetarëve.

Në rastet kur kërkesa për revokim apo ankimi administrativ nuk pranohen, arsyetimi i aktit merr një rëndësi të veçantë. Akti administrativ në kësi rastesh duhet të ketë koherencë midis të drejtës për kërkesë ose ankim dhe kundërshtisë me legjislacionin e fushës përkatëse.

Ndihet mungesa e njohjes së kompetencave, të drejtave dhe detyrave të administratës vendore, ka cënime të të drejtave dhe lirive themelore të shtetasve nga mënyra e zbatimit të Kodit të Procedurave Administrative dhe Ligjit nr,8652, datë 31.07.2000 “Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore”, i ndryshuar. Problem mbetet ndërhyrja e titullarëve të komunave dhe e këshillave të komunave në zgjidhjen administrative të

mosmarrëveshjeve të pronësisë midis personave privatë, duke marrë juridiksionin dhe kompetencat e pushtetit gjyqësor. Ngritja e komisioneve me urdhër të kryetarëve të komunave, rrallë dhe të bashkive, për verifikimin e konflikteve dhe zgjidhjen e tyre, vazhdon pavaresisht rekomandimeve dhe sugjerimeve tona për t'i adresuar tek pushteti gjyqësor.

Mendojmë, se prania e mendimit juridik të kualifikuar duhet rregulluar me një akt nënligjor të veçantë, qoftë për punësim të përhershëm, ashtu dhe me kontrata për kohë pune të kufizuar.

Në rastet e paraqitura pranë Avokatit të Popullit, por dhe në ato të shqyrtuara me iniciativë, vihen re një sërë problematikash, që lidhen direkt me çështje të keqadministrimit, pra me organe publike vendore të cilat nuk veprojnë në përputhje me rregullat apo parimet kushtetuese dhe ligjore të lartpërmendura, të detyrueshme për zbatim.

Problem i veçantë i qytetarëve, prezantuar nëpërmjet ankesave, rezulton ai i detyrimit të komunave dhe bashkive për mbrojtjen e mjedisit, funksion i parashikuar në nenin 10, pika 2/ "f" të Ligjit nr. 8652, datë 31.07.2000 "Për organizimin dhe funksionimin e qeverisjes vendore", i ndryshuar, për grumbullimin, largimin dhe përpunimin e mbeturinave, si dhe Ligji nr. 8934, datë 5. 9.2002 "Për mbrojtjen e mjedisit" që disiplinon marrëdhëniet ndërmjet individit, komunitetit dhe mjedisit.

Mendojme se në kuadrin e decentralizimit të pushtetit dhe afrimit drejt zgjidhjes së problemeve ambientaliste do të ndikonte dhe transferimi i dhenieve të lejeve me impakt në mjedis nga qendra në periferi.

Po ashtu, mungesa e bashkëpunimit të shumë njësive të qeverisjes vendore me komisionet vendore të vlerësimit të titujve të pronësisë pranë prefektëve të qarqeve, sipas Ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 "Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore" ishte një nga shkaqet për efektshmërinë e ulët të Komisioneve, mandati i të cilëve përfundoi në datën 16.08.2011.

Mirëfunksionimi nëpërmjet ushtrimit të kompetencave kushtetuese dhe ligjore të Insitucionit të Avokatit të Popullit, në mbrojtje të lirive dhe të drejtave të njeriut nga veprimet apo mosveprimet e paligjshme të administratës, në këtë rast vendore, detyrimisht sjell impakt pozitiv për mirëqeverisje nga ana e këtyre organeve.

- E drejta për informim gjatë procedimit administrativ

Kushtetuta e Republikës së Shqipërisë, në nenin 23 parashikon se: "E drejta e informimit është e garantuar". Kjo normë e gjen veten dhe në Ligjin nr.8503, datë 30.06.1999 "Për të drejtën e informimit për dokumenta zyrtarë", në nenin 18 të të cilit parashikohet kompetenca e Avokatit të

Popullit për zbatimin e këtij ligji, që siguron dhe garanton transparencën e organeve të administratës publike në marrëdhënie me shtetasit.

Kodi i Proçedurave Administrative e parashikon të drejtën e informimit si një nga parimet bazë të funksionimit të Administratës Publike, në nenin 20 të tij ku sanksionohet shprehimisht e drejta për informim si një parim baze i funksionimit të administratës publike, e duke vazhduar me nenet 51-55, duke ia njohur këtë të drejtë subjekteve që janë palë në një procedim administrativ, ose atyre që kanë një interes të ligjshëm në lidhje me këtë proces.

Në parim, të gjithë pjesëmarrësit në një procedurë administrative kanë të drejtë të marrin informacion dhe të njihen me dokumentet e përdorura në këtë procedurë, përveç rasteve kur me ligj janë vendosur kufizime.

Lidhur me rregullimin që i bën Kodi i Proçedurave Administrative të drejtës për informim, nga çështjet e marra në shqyrtim rezulton, se nga ana e administratës vendore nuk respektohet dhe nuk zbatohet e drejta për informim gjatë zhvillimit të një procedimi administrativ, ndaj atyre subjekteve të së drejtës administrative që kanë një interes të drejtëpërdrejtë ose të ligjshëm në këtë procedim. Palët nuk njoftohen për fillimin apo përfundimin e gjykimit administrativ dhe thirrjen për marrjen pjesë si palë, kur çënohen interesat e tyre.

Kjo dukuri negative, ka qenë e shprehur gjatë vitit 2011, gjatë zbatimit të kërkesave të Ligjit nr. 9948, datë 07.07.2008 “Për shqyrtimin e vlefshmërisë ligjore të krijimit të titujve të pronësisë mbi tokën bujqësore”, gjatë hetimit të mosmarrëveshjeve të evidentuara midis individëve dhe ish komisioneve të tokave në komuna dhe bashki nga Komisionet Vendore të Vlerësimit të Titujve të Pronësisë pranë Prefekteve të qarqeve. Të interesuarit direkt në këto procedura, njoftimin për menyren e zgjidhjes së konfliktit e kanë marrë vetëm pas ndërhyrjes të institucionit të Avokatit të Popullit, siç ka ndodhur psh. në qarqet e Elbasanit, Tiranës apo Vlorës.

- Shkelje e së drejtës për informim gjatë procedimit administrativ nga Këshillat e Rregullimit të Territorit pranë Bashkive apo Komunave

Fillimisht duhet theksuar se ankesat e paraqitura pranë Avokatit të Popullit, i përkasin periudhës kur në fuqi ishte Ligji nr. 8405 dt. 17.09.1998, “Për urbanistikën”, i cili me hyrjen në fuqi dt. 30.09.2011 të Ligjit 10116 dt. 23.04.2009 “Për planifikimin e territorit”, është shfuqizuar.

Gjithsesi në secilën prej tyre, janë shprehur pretendime lidhur me dhënie leje ndërtimi jashtë distancave urbane përcaktuar në rregulloren e urbanistikës si akt nënligjor në zbatim të ligjit në fjalë, nga shtetas, pronarë

të trojeve ngjitur me ndërtimin e objekteve miratuar me vendim të K.Rr.T-ve respektive.

Në këtë kontekst, duhet theksuar se ankesat e paraqitura rezultojnë të ishin jashtë afateve ligjore për ankimim të vendimeve përkatëse në rrugë administrative.

Sa i përket pretendimeve të parashtruara për një vendim të caktuar të K.Rr.T-së, nga shtetas pronarë të trojeve ngjitur me truallin në të cilin do të ndërtohej, kanë të bëjnë me moskonsiderimin e nenit 120 të rregullores së urbanistikës (tashmë shfuqizuar), në të cilën parashikohej shprehimisht detyrimi i aplikantit që në dokumentacionin ligjor të detyrueshëm për t'u paraqitur pranë K.Rr.T-së., të siguronte leje nga kufitari/rët, për leje ndërtimi faqe kallkan, pozicioni ligjor i ankuesve fare qartë rezultojnë të jetë ai i palës së interesuar përgjatë procedimit administrativ. Sigurisht që si e tillë, moszbatimi i nenit 51 të K.Pr.Ad. nga K.Rr.T.-të, shkaktuar nga mosvënia në dijeni e kësaj kategorie shtetasish, drejtëpërdrejtë të interesuar në vendimmarrje të kësaj natyre, shkel të drejtën e shtetasve për t'u ankimuar në rrugë administrative.

Gjithsesi, krahas evidentimit në përgjigjen drejtuar ankuesit të pamundësisë së trajtimit të këtyre rasteve në rrugë administrative nga Avokati i Popullit, pas shqyrtimit të dokumentacionit që ka shoqëruar ankesën, jemi investuar në konsulencë ligjore, sigurisht kur është konstatuar dhënie leje ndërtimi në kushtet e mospërbushjes apo anashkalimit të kriterëve ligjore, për dhënien e një leje të tillë.

Në ankesën me nr. **201101118**, një shtetas ka paraqitur ankesë pranë institucionit të Avokatit të Popullit në të cilën ishte parashtruar pretendimi ndaj një vendimi të marrë në muajin tetor 2010 nga K.Rr.T. e Bashkisë Elbasan, miratim leje ndërtimi për ndërtimin e një godine banimi 2 kat + një kat nën tokë, pranë banesës së tij.

Sigurisht që në vëmendje të afateve për ankimim administrativ, përcaktuar në nenet 21 dhe 44, të Ligjit Nr.8405 datë 17.09.1998 "Për urbanistikën", ndaj vendimit të K.Rr.T-së, për të cilin si dhe në raste të tjera të kësaj natyre, ankuesi është orientuar të ndjekë rrugën gjyqësore, për shkak të pamundësisë për ndjekjen e kësaj çështje në rrugë administrative, në këtë rast nga Avokati i Popullit.

- Shkelje e së drejtës për informim gjatë procedimit administrativ nga A.L.U.I.Z.N.I. në Qarqe

Një pjesë e konsiderueshme shtetasish kërkojnë të informohen zyrtarisht, për ecurinë e procedurës së legalizimit të objekteve të ndërtuara prej tyre pa leje ndërtimi, por që kanë paraqitur brenda afateve ligjore

formularin e vetëdeklarimit. Edhe pse i konsideruar në kuptimin klasik si organ i centralizuar, në varësi të pushtetit qendror sa i përket politikave të ndjekura në kryerjen apo afatet e ushtrimit të kompetencave ligjore, organi i A.L.U.I.Z.N.I.-t në qark ka ndikim të drejtëprdrejtë në mirëqeverisjen e pushtetit vendor.

Përgjatë shumë inspektimeve të kryera në bashki apo komuna, është konstatuar një fluks i madh kërkesash për informim lidhur me aplikimin e paraqitur nga shtetas pranë organeve vendore, e më tej përcjellë pranë A.L.U.I.Z.N.I.-t të qarkut për legalizim të ndërtimeve informale, pronë të tyre, pa marrë asnjë përgjigje. Duhet theksuar se përveç individëve të cilët kërkojnë të ushtrojnë të drejtën e informimit, konstatohet vështirësi në komunikimin zyrtar, deri dhe midis pushtetit vendor dhe A.L.U.I.Z.N.I.-t të qarkut.

Pjesa tjetër e ankesave i referohet p.sh. mospublikimit të emrave në listat e subjekteve prona e të cilave po legalizohet, të cilët pasi nuk kanë marrë përgjigje për kërkesën e paraqitur, i drejtohen Avokatit të Popullit.

- Shkelje e së drejtës për informim gjatë procedimit administrativ nga I.N.U.V.-të. në bashki/komunë

Shkelja e së drejtës për informim gjatë procedimit administrativ zhvilluar nga ky organ, në kuptimin klasik, përgjithësisht konstatohet në bashki apo komuna të kategorive të vogla, ku subjekti i konsideruar si kundërvajtës, nuk vihet në dijeni paraprakisht për fillimin e procedurës administrative të parashikuar, por vetëm gjatë ekzekutimit të vendimit për prishje, duke mos i mundur ndjekjen e rrugës së apelimit ndaj aktit administrativ në gjykatë.

Mosveprim i organit të administratës vendore

Mosveprimi i organit të administratës vendore, në raport me ankesa të paraqitura pranë Avokatit të Popullit, i referohet veprimtarive të I.N.U.V.-ve të bashkisë/komunës si dhe në një rast të ndërmarrë me inisiativë ndaj Këshillave Bashkiakë/Komunalë. Ndër të tjera konstatohet gjithashtu mosveprim i administratës vendore, në kryerjen e procedurave të shpronësimit përkundrejt përdorimit të pronës për interes publik, në raste kur kjo e fundit ndodhet në pozicionin e organit shtetëror të interesuar.

Kryesisht mosveprimi i i.N.U.V. ve, si dhe në vitë të kaluara ka si mburojë hapësirat ligjore të Ligjit 9780 dt. 16.07.2007 , “Për inspektimin e ndërtimit”, ku rezulton të ekzistojë mundësia për të shmangur marrjen e më tej ekzekutimin e vendimeve për prishje, të objekteve të ndërtuara pa leje ndërtimi tashmë të përfunduara. Sigurisht që Avokati i Popullit referuar nenit 24/a, të Ligjit nr.8454 datë 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i

ndryshuar, ka ushtruar të drejtën legislative për ndryshime në nenin 12, të Ligjit nr. 9780 dt. 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit” si dhe në nenin 1, pika “2”, të Ligjit nr. 10240 dt.25.02.2010, “Për disa shtesa në Ligjin nr. 9780 dt. 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”.

Sa i përket moskryerjes së procedurave të shpronësimit përkundër përdorimit të pronës për interes publik, pranë Avokatit të Popullit janë paraqitur ankesa me objekt përdorim të pronës për interes publik pa inicuar procedura shpronësimi. Në të gjitha rastet e paraqitura kemi të bëjmë me rrugë lokale kur bashkia apo komuna, në pozicionin e organit publik të interesuar, nuk ka filluar procedura shpronësimi nisur nga interesi sipas tyre i komunitetit të territorit në administrim të saj, si dhe nga sipërfaqja relativisht e vogël e pronës private përdorur për interes publik.

Në ankesën me nr. 201100094 Doc., ankuesi parashtronte shqetësimin dhe pretendimin e tij, në lidhje me përdorim të pronës së tij, disponuar gjithashtu me certifikatë pronësie të lëshuar së fundi nga Z.V.R.P.P., për interes publik pa inicuar aspak procedurat e shpronësimit.

Pra ishte e qartë se në kushtet kur titulli i pronësisë në favor të ankuesit provohej nga certifikata e pronësisë lëshuar nga Z.V.R.P.P., në një kohë kur punimet për ndërtimin e rrugës lokale ishin në fillim e sipër, referuar dispozitave përkatëse të Ligjit Nr.8561 datë 22.12.1999 “Për Shpronësimet dhe marrjen në përdorim të përkohshëm të pasurisë pronë private për interes publik”, e konkretisht parashikmive të neneve 7 “Objekte të Shpronësimit”, nenit 13 “Pranimi i kërkesës” dhe nenit 17 “Vlerësimi i objekteve që shpronësohen”, sipas të cilave nuk mund të cënohet një pronë e ligjshme për interes publik, pa përfunduar më parë shpronësimi i pronarit, i kemi rekomanduar bashkisë fillimin dhe përfundimin e procedurave të shpronësimit në favor të ankuesit, për shkak të përdorimit të pronës së tij private për interes publik.

Lidhur me mosfiunksionimin si duhet në disa raste të Këshillave Bashkiakë, në vijim të përmbushjes së detyrave kushtetuese dhe ligjore, në mbrojtje të të drejtave të njeriut dhe në veçanti, të fëmijëve që frekuentojnë kopshtet dhe çerdhet, në territorin e Republikës së Shqipërisë, Avokati i Popullit u informua nga media e shkruar, në lidhje me mbylljen në muajin Korrik 2011 të disave prej tyre në kryeqytet.

Në kushtet kur gjëndja higjeno-sanitare e këtyre institucioneve konsiderohej nga shtypi si një rrezik për shëndetin e fëmijeve që strehoheshin në to, ndërkohë që për shkak të mungesës së një mbledhjeje të Këshillit Bashkiak prej dy vjetesh, Avokati i Popullit në vëmendje të interesave më të larta të fëmijëve, si një nga parimet bazë që duhet të udhëheqë të gjithë veprimtarinë e institucioneve shtetërore, puna e të cilave

ndikon drejtpërdrejtë në cilësinë e jetës dhe mirërritjen e fëmijëve, i ka rekomanduar Këshillit Bashkiak Tiranë, shqyrtimin sa më parë të këtij problemi për rikonstruksionin e objekteve në të mirë dhe interes të fëmijëve, që frekuentojnë këto institucione shtetërore.

- Respektimi i afateve ligjore

Mosrespektimi i afateve ligjore, si në trajtimin e ankesave apo kërkesave të personave fizikë dhe juridikë privatë nga organet e administratës vendore, ka qenë dhe mbetet një problem mjaft i mprehtë.

Në vëmendje të ankesave të paraqitura pranë Avokatit të Popullit, për vitin 2011, mosrespektimi i afateve ligjore i referohet ndjeshëm veprimtarisë së I.N.U.V.-vë në Bashki Komuna.

Në këtë kontekst mund të thuhet lirisht se tashmë mosekzekutimi i vendimeve për prishje të marra nga I.N.U.V.-të brenda afateve ligjore, është kthyer në një realitet mjaft shqetësues. Sidomos në bashki të mëdha, është tipik rasti kur I.N.U.V.-ja funksionon deri në momentin e konstatimit të objektit të kundërligjshëm, nxjerrjen e akteve përkatëse për pezullim të punimeve, si dhe vendimeve për prishje, e përfundimisht mosekzekutimin e tyre në tejkalim të afateve ligjore, parashikuar në Ligjin 9780 dt. 16.07.2007, “Për inspektimin e Ndërtimit”, i ndryshuar, neni 14 “*Dhënia e vendimeve administrative dhe afatet*”, paragrafi “3”, ku përcaktohet “*Vendimet e I.N.U. të bashkisë/komunës/qarkut/kombëtar parashikojnë afate për zbatimin e tyre deri në 60 ditë. Përjashtimisht vendimet për prishjen e ndërtimit të kundraligjshëm kanë afat deri në 30 ditë*”.

Marrëdhëniet e punës

Siç dhe dihet, përgjatë vitit 2011 u zhvilluan zgjedhjet e pushtetit vendor, pas përfundimit të të cilave pranë Avokatit të Popullit janë paraqitur një numër i konsiderueshëm ankesash, për ndërprerje të marrëdhënieve të punës nga ana e punëdhënësit, në pothuaj të gjitha rastet, nga kandidati fitues i mandatit për kryetar bashkie/komune, në këto zgjedhje.

Në të gjitha rastet e adresuara, pretendimi kryesor i paraqitur nga ankuesit ishte përkatësia, apo simpatia për subjektin politik, kuptohet, i ndryshëm nga ai i funksionarit aktual, si dhe pretendimi për thjeshtë zëvendësim të të pushuarve me militantë partiakë. Sigurisht që në ankesat e paraqitura, pretendohet gjithashtu se niveli i performancës së punonjesve të larguar përgjatë kryerjes së detyrës, nuk kishte luajtur asnjë rol në vendimin e marrë për ndërprerje të marrëdhënieve të punës.

Strehimi

Sigurisht që problemi i strehimit përbën një problem të mprehtë, serioz dhe shqetësues për shtetin dhe shoqërinë tonë. I shprehur në formën e një objekti social për t'u përmbushur, parashikuar në nenin 59, kreu V, të Kushtetutës së Shqipërisë :

1-a-... shteti brenda kompetencave kushtetuese dhe me mjetet që disponon synon punësimin në kushte të përshtatshme të të gjithë personave të aftë për punë...

b-...plotësimin e nevojave të shtetasve për strehim. etj,"

2- Përmbushja e objektivave sociale nuk mund të kërkohej drejtpërdrejtë në gjykatë.", Avokati i Popullit në të gjitha rastet ka orientuar të interesuarit të regjistruhen pranë bashkive respektive për përfitimin e statusit të të pastrehit, me qëllim që më pas, sipas kapaciteteve financiare që disponohen prej tyre, të mund të përfitohet nga fondi i banesave sociale apo programet e ndryshme që aplikojnë organet e pushtetit lokal për zgjidhjen e këtij problemi serioz për shoqërinë shqiptare, i cili natyrisht ndikohet edhe nga lëvizjet e theksuara demografike drejt qendrave urbane.

Përsa i përket problemit të strehimit, është miratuar Ligji nr. 9232 datë 13.05.2004, "*Për programet sociale për strehimin e zonave urbane*" dhe në zbatim të tij V.K.M. nr. 814, datë 03.12.2004, "*Për caktimin e normave të strehimit*" si dhe vendimi "*Për dokumentat dhe procedurat që duhet të ndjekin përfituesit nga ky ligj.*"

Sipas këtyre akteve, por edhe sipas informacioneve të marra paraprakisht për këtë problem, megjithëse baza ligjore e lartpërmendur synon të mbrojë shtetasat në nevojë, ndër të tjera përcakton gjithashtu detyrimin e të intersuarve për të disponuar një nivel të caktuar të ardhurash financiare, me qëllim dhënien e garancisë së nevojshme për shlyerje të kredisë që i akordohet aplikantit për sistemimin me banesë.

Lidhur me këtë fakt, mund të thuhet se përgjatë takimeve të zhvilluara në qendra urbane me ankues të ndryshëm, në pjesën më të madhe të rasteve një asistencë të tillë e kërkojnë pikërisht kategori shtetasish që nuk kanë mundësi të sigurojnë të ardhura në nivelin e kërkuar. Në këto kushte, trajtimi i tyre, edhe se janë konstatuar raste ekstreme e tepër të dhimbshme, pushteti vendor e kishte të pamundur të shyrtonte kërkesën e paraqitur.

Ndihma ekonomike

Në Ligjin 9355 dt. 10.03.2005 "Për ndihmën dhe shërbimet shoqërore", i ndryshuar, parashikohet ndihma për individët dhe grupet në nevojë, të cilët nuk mund të sigurojnë plotësimin e nevojave bazë jetike,

zhvillimin e aftësive dhe të mundësive personale dhe ruajtjen e integritetit për shkak të aftësive dhe mundësive të kufizuara ekonomike, fizike, psikologjike e shoqërore., si dhe zbutja e varfërisë dhe përjashtimin shoqëror për individët dhe familjet, si dhe të krijojë mundësi për integrimin e tyre, nëpërmjet sigurimit të një sistemi ndërhyrjesh e shërbimesh për përmirësimin e jetesës së tyre.

Sigurisht që përgjatë konstatimit të çështjeve të kësaj natyre, Avokati i Popullit nga njëra anë ka mbajtur gjithmonë në vëmendje vështirësitë financiare të shtetit, por nga ana tjetër një vështirësi e tillë ka si pasojë përfitimin e shumave gjithmonë e më të pamjaftueshme nga ajo që përfiton nga këto ndihma. Në pjesën përkatëse të këtij raporti, do të gjeni mënyrën e trajtimit nga Avokati i Popullit të këtij problemi.

Vazhdon të mbetet shqetësim problemi i mosdhënies së shpërblimit për nenat e reja që rregjistrojnë femijet në zyrat e gjendjes civile, bazuar në parashikimet e neni 41/4 të ligjit nr. 10129, datë 11.05.2009. Perfaqësuesit e organeve të pushtetit vendor kanë rezultuar t'ua kene të pamundur realizimin e këtij shpërblimi, për mungesë të fondeve të nevojshme të cilat duhet t'i alokohen atyre nga pushteti qendror e perkatesisht, nga Ministria e Financave. Për këte çështje, gjatë vitit 2011, i kemi derguar rekomandim Ministrise së Financave dhe akoma nuk kemi marrë një përgjigje lidhur me të.

Zyrat e Gjëndjes Civile

Ligji Nr. 10129 datë 11.05.2009 “Për gjëndjen civile”, përbën bazën ligjore e që ka për objekt kryesor përbërësit e gjëndjes civile të shtetasve shqiptarë, shtetasve të huaj dhe të personave pa shtetësi, me banim të përkohshëm apo të përhershëm në Republikën e Shqipërisë, ku përcaktohen rregullat për heqjen, ruajtjen dhe ndryshimin e tyre si dhe organizimin e funksionimin e shërbimit të Gjëndjes Civile në Republikën e Shqipërisë.

Gjatë vitit 2011, pranë Institucionit të Avokatit të Popullit janë paraqitur 13 ankesa ndaj zyrave të gjëndjes civile në Tiranë e rrethe lidhur me moskryerjen e veprimeve procedurale nga nëpunësit e zyrës së gjëndjes civile për korrigjimin e përbërësve të gjëndjes civile si dhe me pengesat ligjore nga përfaqësuesit e Z.Gj.C-ve për dhënien e çertifikatave familjare e personale.

Arsyetimi i një akti administrativ.

Një element i domosdoshëm i aktit administrativ është arsyetimi i qartë dhe i bazuar në rregullime ligjore i tij. Nga ankesat e trajtuara gjatë vitit 2011 ka rezultuar se nëse akti administrativ nuk arsyetohet nga organi

që e nxjerr atë, atëherë krijohen premisa për shkelje të të drejtave të individëve. Konkretisht në rastin rregjistruar me **nr. 201100686**, Institucioni i Avokatit të Popullit në përmbushje të kompetencave të tij kushtetuese dhe ligjore, shqyrtoi me inisiativë çështjen që lidhet me miratimin nga ana e disa njësive vendore të Bashkisë Tiranë, të kërkesave të paraqitura nga shtetas të ndryshëm, sa i përket kryerjes së punimeve për restaurim apo meremetim tërësor/pjesshëm të banesave në pronësi të tyre.

Si indicie e shqyrtimit të problematikës në fjalë, kanë shërbyer dhjetra ankesa të paraqitura pranë Avokatit të Popullit ndaj I.N.U.V-së. Tiranë, ku dhe është konstatuar se subjekti ndërtues dispononte një shkresë lëshuar nga Kryetari i Njesisë Bashkiake përkatëse, në të cilën pas evidentimit të gjëndjes së amortizuar në të cilën ndodhej godina, në disa raste direkt e në disa të tjera shprehur nëpërmjet mendimit apo gjykimit nga verifikimi i situatës në terren, subjekti ndërtues lejohej të vijonte me punime restauruese.

Në fazën hetimore të kësaj çështje, organet në fjalë justifikoheshin me pretendimin se në këtë rast kishim të bënim me thjesht korrespondencë zyrtare dhe jo me akte administrative të lëshuara në favor të kërkuarve.

Sigurisht që në rekomandimin dërguar Njësive Bashkiake të Bashkisë Tiranë, evidentoheshin pasojat juridike lindur si pasojë e këtyre praktikave, të cilat detyrimisht referuar nenit 105 dhe 116 Kodit Procedurave Administrative, konsiderohen akte administrative, të lëshuara për më tepër në kushtet e pavlefshmërisë absolute për shkak të tejkalimit flagrant të kompetencave. Gjithashtu në rekomandim është kërkuar mosdhëna në të ardhmen të lejeve të ndërtimit nga Njësitë Bashkike të Bashkisë Tiranë, si dhe ndërprerjen e menjëhershme të praktikave të tilla, që në atë moment ishin në proces shqyrtimi.

Në përgjigje të këtij rekomandimi, organet e pushtetit vendor, kanë shprehur impenjimin e tyre institucional në përmbushje të kërkesave të parashtruara në të. Gjithashtu impakti pozitiv i këtij rekomandimi u reflektua në interesimin e medias së shkruar dhe vizive, e cila e trajtoi gjerësisht këtë çështje.

Veprimtaria e organeve të administratës vendore, përkundër zhvillimit të procesit të decentralizimit.

Për sa më sipër, është e qartë se veprimtaria e organeve të pushtetit vendor, sigurisht në raport me frymën kushtetuese dhe ligjore të procesit të decentralizimit, lë shumë për të dëshëruar. Në jo pak raste, kompetencat gati ekskluzive kaluar pushtetit vendor në emër të kryerjes së këtij procesi mjaft delikat, por të domosdoshëm për mirëfunksionimin e këtyre organeve, në jo pak raste kanë rezultuar të dështuara në produktivitetin e pritur.

Shëmbull mjaft i qartë në këtë rast shërben veprimtaria e I.N.U.V. –ve në bashki/komuna, ku siç dihet me Ligj 9780 dt. 16.07.2007, “Për inspektimin e Ndërtimit”, kalimi i kompetencave nga një organ i centralizuar në varësi të pushtetit qendror, në një organ të krijuar e të varur nga pushteti vendor, kishte si qëllim të përgjithshëm respektimin e autonomisë vendore, në funksion të kryerjes së procesit të decentralizimit.

Në aspektin praktik, ligji pretendohet të realizonte ekzistencën e një institucioni më të ndjeshëm dhe gjithmonë në korrent të veprimtarisë së paligjshme në fushën e ndërtimeve, për vetë afërsinë me qytetarët që ka pushteti lokal. Në të vërtetë, tashmë pas gati katër vjetësh nga dalja e këtij ligji, mund të thuhet se qëllimi për të cilin ai u miratua, ka sjellë rezultat vetëm në aspektin e kontrollit, sa i përket zbatimit të ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, brenda territorit administrativ të bashkisë/komunës. Ndërsa në aspektin konkret, atë të ndërhyrjes fizike ndaj objekteve të ndërtuara pa leje ose jashtë lejes së ndërtimit, funksionimi i I.N.U. vendore, lë shumë për të dëshëruar.

Përgjithësisht, ankesa që paraqitet pranë Avokatit të Popullit nga shtetas të ndryshëm është mosekzekutimi i vendimeve për prishje të marra nga I.N.U.V. brenda afateve ligjore. Sidomos në bashki të mëdha, është tipik rasti kur I.N.U.V. funksionon deri në momentin e konstatimit të objektit të kundraligjshëm, marrjen e vendimit për prishje, e përfundimisht mosekzekutimin e tij jo vetëm brenda afateve, por dhe në periudha kohe të cilat të krijojnë përshtypjen se ai vendim nuk do të ekzekutohet asnjëherë.

Rezultati negativ i deritanishëm, me pasojë keqpërdorimin në vazhdimësi të kompetencave gati ekskluzive të organit të pushtetit vendor në zbatimin e ligjshmërisë në fushën e ndërtimit, është tentuar të minimizohet sadopak me Ligjin nr. 10240 dt. 25.02.2010, “Për disa shtesa në Ligjin nr. 9780 dt. 16.07.2007, “Për inspektimin e ndërtimit”, ku I.N.U.K. ndër të tjera mund të ndërhyjë në rast se I.N.U.V. nuk ka ekzekutuar brenda afatit ligjor vendimin për prishje.

Në këtë kontekst, është e qartë se procesi i decentralizimit nuk do të mund të përfundojë asnjë herë në rast se në emër të tij prodhohen institucione aspak rezultative sa i përket zbatimit të ligjit, duke detyruar legjislativin një herë të miratojë ligje me efekte decentralizuese, e më vonë për shkak të mosefektivitetit të pritur të bëjë të kundërtën.

Procesi i decentralizimit të Pushtetit Vendor, si pjesë jetike e proceseve të tjera integruese, pashmangshmërisht duhet të vazhdojë të përafrohet me standardet e kërkuara nga BE, pra gjithmonë e më shumë përgjegjësi dhe kompetenca, me më shumë autoritet fiskal dhe burime njerëzore, më shumë pasuri publike dhe burime financiare.

Në këtë kontekst, mund të përmendim transferimin e pronave publike të paluajtshme, pyjeve dhe kullotave drejt Pushtetit Vendor, transferimin e furnizimit me ujë të pijshëm në vartësi të pushtetit vendor, konsolidimin e financave vendore në fushën e regjistrimit të biznesit, planifikimit territorial, etj.

Por të tilla hapa duhet të ndërmerren me synim thellimin e procesit të transparencës dhe luftës kundër korrupsionit, si elementë bazë, të cilët ulin keqpërdorimin e kompetencave, tashmë e në të ardhmen ekskluzive të këtij pushteti.

Në një vështrim të përgjithshëm, të problematikave të shqyrtuara më lart, mund të konkludohet se pjesa më e madhe e ankesave paraqitur pranë Avokatit të Popullit ka patur të bëjnë me shkelje të elementëve të ndryshëm nga pushteti vendor të cilat garantojnë parimin e mirëadministrimit, respektimin e të drejtave dhe lirive themelore kushtetuese, me ushtrimin efektiv të funksioneve, kompetencave dhe realizimit të detyrave, realizimin e shërbimeve në forma të përshtatshme, të shpejta, etj.

16. Veprimtaria e Zyrës Rajonale në Shkodër

Raporti Vjetor 2011 i Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Shkodër, përbën raportin e peste të përshkrimit të aktiviteteve që nga krijimi dhe ngritja e kësaj Zyre në nivel Qarku.

Zyra rajonale e Avokatit të Popullit vazhdon të jetë e vetmja që mundëson marrjen e trajtimin e ankesave të qytetareve të Qarkut Shkodër, duke krijuar mundësinë e lehtësimit të procedurave dhe udhëtimit në institucionin qendror. Në këtë pjesë të raportimit i është kushtuar një rendësi e veçante gjithë aktiviteteve specifike të realizuara në përmbushje të respektimit të të drejtave të fëmijëve.

Qëllimi i këtyre aktiviteteve ka qenë puna për përmbushjen e të drejtave të fëmijëve kryesisht në nivel Qarku Shkodër sipas standarteve që parashikohen në Konventën e të Drejtave të Fëmijëve.

Raporti i peste i Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit Shkodër ndryshe nga raportet e tjera, vjen me një risi këtë vit në promovimin e politikave favorizuese në rang Qarku për kategoritë me të margjinalizuara të fëmijëve duke theksuar bashkëpunimin e frytshëm ndërmjet Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit, Observatorit për të drejtat e Fëmijëve dhe Këshillit të Qarkut Shkodër, në procesin e mbledhjes dhe shkëmbimit të të dhënave me baze mirëqënien e fëmijëve në formulimin dhe hartimin e Strategjisë

Rajonale për Fëmijë dhe Planin përkatës të Veprimit 2011-2013 në nivel Qarku.

Gjate vitit 2011 Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit Shkodër ka operuar reciprokisht me institucionet rajonale dhe organizatat e shoqërisë civile me fokusin e monitorimit të drejtave të fëmijëve në nivel Qarku.

Në bashkëpunim me Observatorin e drejtave të fëmijëve në nivel Qarku (projekt i Aleancës së Fëmijëve në Shqipëri, financuar nga Zyra UNICEF Shqipëri), është bërë e mundur ngritja dhe fuqizimi i mekanizmit institucional për mbledhjen e të dhënave lidhur me mirëqenien e fëmijëve në Qarkun Shkodër, informacioni i cili zbritet deri në nivel të çdo Komune të Qarkut Shkodër.

Nga asistencat e shumë organizatave/shoqatave të shoqërisë civile si “Maddonna della Grappa”, “Acli-IPSIA në Shqipëri”, “I Care”; “Word Vision”, por edhe OJF të tjera, janë ofruar modele dhe praktika të mira në fushën e shërbimeve sociale dhe drejtave të njeriut.

Gjithashtu vlen të përmendet se Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit Shkodër në rolin e koordinuesit, ka mbështetur dhe mbështet çdo nismë të ardhur si nga organizmat qeveritare, ashtu dhe organizata që fokusohen në çështjet e fëmijëve në fushën e mbrojtjes së drejtave të fëmijëve dhe që premtojnë për një ndryshim pozitiv të situatës së zbatimit të këtyre të drejtave.

Në këtë kontekst disa nga aktivitetet që kjo Zyrë ka koordinuar gjatë vitit 2011 me partnerë të ndryshëm janë fokusuar në:

- Promovimin dhe ndërgjegjësimin për realizimin e drejtave të fëmijëve sipas standarteve ;

- Bashkëpunime ndërinstitucionale në zbatim rigoroz të drejtave të fëmijëve;

- Promovim dhe mbështetje institucionale për “Observatorin e Drejtave të Fëmijëve” në nivel Qarku;

- Monitorim i drejtave të fëmijëve në nivel Qarku, rreth zbatimit të drejtave të fëmijëve sipas Konventës së Drejtave të Fëmijëve dhe Strategjisë Kombëtare të Fëmijëve;

- Aksesim të dhënash që lidhen drejtpërdrejtë me mirëqenien e fëmijëve për Këshillin e Qarkut Shkodër lidhur me Strategjinë Rajonale të Fëmijëve dhe Planin përkatës të Veprimit 2011-2013 në nivel Qarku.

1. Pritje të ankesave të drejtuara pranë Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit:

Veçoria e Zyrës Rajonale të Avokatit të Popullit qëndron në faktin se qytetaret, në çdo njësi administrative të Qarkut Shkodër, përveç pritjes së popullit ditëve të premtë, kanë tashmë mundësinë për drejtimin e ankesave

individuale, kolektive (përmes instalimit të kutisë postare pranë ambienteve të jashtme të institucionit) lidhur me pretendimet e shkeljes së të drejtave të tyre. Zyra Rajonale u ka ardhur në ndihmë qytetarëve duke ofruar mundësinë e përpilimit të ankesës ose kërkesës që ato parashtrajnë, ashtu edhe nëpërmjet orientimeve e këshillimeve ligjore, adresimit kur kërkesat e qytetarëve nuk përbejnë objekt për veprimtarinë e zyrës etj.

Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit numëron 103 ankesa të përpiluara nga qytetarët dhe 56 këshillime ligjore për çështje të caktuara përgjatë vitit 2011.

Theksohet se me se shumti, ankesat e qytetarëve kanë qene të fokusuara në:

- Ankesa individuale dhe kolektive mbi dëmshpërblimet financiare të familjeve e bizneseve të përmbytura;
- Ankesa kolektive të banoreve mbi ndërtimin e By pass –it Shkodër;
- Ankesa ndaj ndërmarrjeve KESH e Ujësjiellës Sh.a Shkodër, mbi faturime të padrejta të qytetarëve ankues.

Gjithashtu karakteristike mbetet fakti se ankesat me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve janë bërë kryesisht nga prindërit ose kujdestarët ligjore të të miturve. Ankesat me objekt shkeljen e të drejtave të fëmijëve janë kryesisht mbi verifikimet e pagesave të ndihmës ekonomike, pagesa të kujdestarisë etj .

- Veprimtaria në fushën e të Drejtave të Fëmijëve

Zyra Rajonale Shkodër që në vitin 2006 ka funksionuar si pjesë e Nënseksionit për të Drejtat e Fëmijëve.

- Mandati i Nënseksionit për të Drejtat e Fëmijëve është *“të shërbejë si një avokat, një katalizator dhe një organ monitorues i të drejtave të fëmijëve sipas Konventës së të Drejtave të Fëmijëve në Shqipëri”*.

Gjatë vitit 2011 është fokusuar në pjesëmarrje në aktivitete lobuese e advokuese; promovim të praktikave pozitive të bashkëpunimit ndërsektorial; aksesim të dhënash në lidhje me treguesit e mirëqenies së fëmijëve në bashkëpunim me Observatorin e fëmijëve etj. Disa nga shtyllat e punës së Nënseksionit për të Drejtat e Fëmijëve në këtë aspekt mund të përmendim:

Pjesëmarrje në disa nga aktivitetet më të rëndësishme gjatë vitit 2011

- Seminarin “Konventa e OKB-se për të drejtat e personave me aftësi të kufizuara. Aftësia e kufizuar në kontekstin e të drejtave të njeriut” organizuar nga FSHDPAK;

- Takimin “Mbi kapacitetet e partnereve kryesorë në nivel lokal për të hartuar, zbatuar dhe monitoruar ndërhyrje për përmirësimin e ushqyerjes dhe sigurimin e ushqimit në Qarkun Shkodër”, organizuar nga Partneret për Zhvillim;
- Seminari trajnues “Forcimi i kapacitetit të shoqërisë civile për përdorimin e instrumenteve ligjorë në mbrojtje të të drejtave dhe lirive të shtetasve” organizuar nga Qendra për Nisma Ligjore Qytetare;
- Trajnimi me temë: “Institucionalizimi i mbrojtjes së të drejtave të Fëmijëve” organizuar nga Këshilli i Qarkut Shkodër dhe UNICEF;
- Konferencën Kombëtare për Fëmijët: “Unë Sot Njoh, Guxoj dhe Mbrohem” organizuar nga MPÇSSHB;
- “Open day” organizuar nga Qendra e Informimit të Bashkimit Europian;
- Takim mbi “Diskutimin e Draft Planit të Veprimit 2011-2015 të Strategjisë Kombëtare për Fëmijë” organizuar nga MPÇSSHB;
- Lancimi i raportit të Observatorit Kombëtar për Fëmijë: “Gjendja e Fëmijëve në Shqipëri” organizuar nga Aleanca për Fëmijët në Shqipëri e UNICEF.

Gjithashtu Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit ka mbështetur dhe shkëmbyer informacionin e nevojshëm edhe me organizata të shoqërisë civile si “Alci-IPSIA” në Shqipëri; “I Care”; “Madoninna dell Grappa”, “World Vision” etj në fushën e zbatueshmërisë së drejtave të njeriut dhe shërbimeve sociale me qëllim promovimin e praktikave më të mira në fushën e të drejtave të njeriut në Qarkun Shkodër.

Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit ka qenë gjithmonë promotore e të drejtave të fëmijëve në aktivitete të tilla, që kanë për qëllim lobimin dhe avdokimin që të drejtat e fëmijëve të respektohen.

- Mbështetje institucionale dhe bashkëpunimi reciprok me Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve në nivel Qarku

Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit Shkodër ka vazhduar të mbështesë institucionalisht Observatorin për të Drejtat e Fëmijëve në nivel Qarku.

“Observatori i të drejtave të Fëmijëve” është një projekt i Aleancës Shqiptare për Fëmijë mbështetur financiarisht nga Zyra e UNICEF në Shqipëri, e ngritur tashme si strukture edhe në Qarkun Shkodër që në Maj të vitit 2009. Observatori është strukturë e shoqërisë civile, që shërben për ndërgjegjësimin e aktorëve (administratë publike qendrore e vendore), si edhe të vetë shoqërisë civile, për detyrimet dhe përgjegjësitë në raport me të

drejtat e fëmijëve. Duke konsideruar të rëndësishëm faktin se *të drejtat e fëmijës duhen respektuar dhe përmbushur, pavarësisht qytetit apo fshatit që ai/ ajo jeton*, Observatorët mbledhin dhe shpërndajnë informacion, analizojnë problemet kritike dhe hartojnë raporte mbi realizimin e të drejtave të fëmijëve në çdo bashki e komunë të qarkut.

Edhe përgjatë vitit 2011 këto dy struktura bashkëvepruan së bashku në procesin e monitorimit të drejtave të fëmijëve në Qarkun Shkodër, evidentimin dhe referimin e çështjeve problematike të plotësimit të të drejtave të fëmijëve dhe promovimin e praktikave më të mira drejt zbatimit të të drejtave të fëmijëve.

Sistemi i monitorimit të situatës së zbatimit të drejtave të fëmijëve në nivel Qarku.

Duke qenë promotore e iniciativave të reja edhe të shoqërisë civile në fushën e mbrojtjes dhe monitorimit të drejtave të fëmijëve, kjo Zyre ka dhënë ndihmesën e saj në aksesimin e të dhënave dhe treguesve që lidhen me të drejtat e fëmijëve. Tashmë është ngritur mekanizmi i mbledhjes dhe analizimit të të dhënave lidhur me mirëqenien e fëmijëve gjer në nivel të çdo Komune të Qarkut Shkodër, administruar bashkërisht me Observatorin e të Drejtave të Fëmijëve. Nga informacioni i mbledhur lidhur me treguesit specifik të mirëqenies së fëmijëve është arritur analizimi i të dhënave përkatëse dhe Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit Shkodër pas vlerësimit ka dhënë disa rekomandime përkatësisht sipas fushave ku më të spikaturat citojmë:

- Krijimin e pikave koordinuese në nivel të çdo komune për të raportuar dhe koordinuar rastet e shkeljes së drejtave të fëmijëve.
- Shtimin e stomatologëve dhe shtrirjen e shërbimit falas të stomatologut edhe për nxënës të zonave rurale;
- Identifikimin dhe ofrimin e shërbimeve për rastet e fëmijëve me HIV/AIDS.
- Arsim gjithëpërfshirës për fëmijët me Aftësi të Kufizuar në kopshte shkolla të integruara;
- Mbështetjen e fëmijëve me Aftësi të Kufizuar me shërbime komunitare dhe veçanërisht në zonat rurale të Qarkut Shkodër.
- Alternim të pagesës së Ndihmës Ekonomike me shërbime sociale në mënyrë që fëmijët e përfshirë në skemën e pagesës së ndihmës ekonomike të jenë përfitues të shërbimeve të caktuara të nevojshme për to.
- Ngritjen e një strehëze në nivel Qarku për viktimat e dhunës në familje dhe koordinim më i mirë ndërsektorial lidhur me çështjet e dhunës në familje.

- Nxitjen e pavarësisë së strukturave të Qeverisë së Nxënësve dhe fuqizimi i mëtejshëm i tyre për të raportuar rastet e shkeljes së drejtave të tyre në strukturat përkatëse.

Konsulentë ne shkëmbimin e të dhënave që u përkasin të drejtave të fëmijëve lidhur me Strategjinë Rajonale të Fëmijëve në Qarkun Shkodër.

Gjatë vitit 2011 Këshilli i Qarkut Shkodër për here të parë publikoi Strategjinë Rajonale për Fëmijët dhe Planin e Veprimit për Fëmijët 2011-2013. Një Strategji e tillë u iniciua falë lobimit të Observatorit të Drejtave të Fëmijëve në nivel Qarku dhe u hartua nga Këshilli i Qarkut Shkodër përmes financimit dhe ekspertizës së Zyrës së UNICEF Shqipëri. Hartimi i një dokumenti të tillë strategjik që përfshihet në politikat sociale dhe dëshmon angazhimin serioz që Qarku Shkodër vazhdon të ndër marr në fushën e të drejtave të fëmijëve vjen si një risi për Rajonin tonë.

Ne këtë kuadër Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit në rolin e mediatorit dhe mbështetësit institucional ka qenë shumë bashkëpunues dhe në të njëjtën kohë ka shkëmbyer të dhënat që lidhen me fëmijët, kryesisht ato të dhëna të cilat janë marrë në bashkëpunim të ngushtë me Observatorin e të Drejtave të Fëmijëve Shkodër. Një procedurë e tillë ka ndihmuar ekspertet e hartimit të strategjisë jo vetëm me të dhëna sasiore, por edhe cilësore duke qenë i vetmi Institucion për të Drejtat e Fëmijëve i cili ka tagrin e monitoruesit të të drejtave të fëmijëve në Rajonin e Veriut në nivel institucioni kushtetues. Të dhënat e ofruara janë kryesisht për të drejtën për arsim, të drejtën për kujdes shëndetësor, të drejtën për mbrojtje shoqërore, sipas kërkesave të ardhura nga ekspertet e hartimit të kësaj Strategjie.

Zyra Rajonale e Avokatit të Popullit do të japë ndihmesën e saj jo vetëm në promovimin e modeleve që sjellin ndryshime pozitive lidhur me zbatueshmërinë e drejtave të fëmijëve, por do kontribuojë në ndërgjegjësimin për të nxitur përmbushjen e të drejtave të fëmijëve nga autoritetet përgjegjëse përmes një dialogu pozitiv e proaktiv.

17. Trajtimi i ankesave të të përndjekurve politikë

Gjatë vitit 2011 pranë Institucionit të Avokatit të Popullit kanë paraqitur ankesat e tyre 20 shtetas të cilët kanë pretenduar se Ministria e Drejtësisë ka zvarritur procedurat për dhënie statusi të të përndjekurit politik si dhe miratimin e kompensimeve që ata duhet të përfitojnë në bazë të dispozitave ligjore.

Nga ankesat e parashtruara, 9 të tilla janë akoma në shqyrtim. Nga ankesat e përfunduara, 3 kanë qenë jashtë kompetencave tona (201100978,

201100024 dhe 201100039), pesë kanë rezultuar të pabazuara, një është zgjidhur në favor të ankuesit (201100052), ndërsa një njoftim i QSHTR (201100116) ka rezultuar jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit.

Ajo që duam të vëmë në dukje me këtë rast, është zvarritja nga ana e Ministrisë së Drejtësisë në dërgimin e shpjegimeve zyrtare për sa u kemi parashtruar në shkresat tona. Ky ka qenë edhe shkaku kryesor i tejkalimit të afateve ligjore në trajtimin e ankesave që individët kanë parashtruar në institucionin tonë.

Nga ankesat e shqyrtuara, veçojmë ankesën me **nr. 201100052** në të cilën parashtroheshin pretendime ndaj Ministrisë së Drejtësisë lidhur me zvarritje të procedurës për shqyrtimin e kërkesës për përfitim të dëmshpërblimit financiar, pasi gjatë periudhës 1974-1991 ankuesi dhe familja kishin qenë të internuar në qytetin e Fierit. Konkretisht ankuesi shprehej se kishte bërë kërkesën përkatëse që në vitin 2008 pranë ata që kishin marrë dënim kapital apo dhe ato që ishin dënuar pa gjyq. Për këtë fakt si dhe për gjendjen ligjore të dosjes së tij për dëmshpërblim, ankuesi u sqarua dhe u vu në dijeni se do të ishte në pritje të daljes së një vendimi përkatës për kategorinë e personave të internuar apo të dëbuar gjatë regjimit komunist.

Institucioni i Avokatit të Popullit ka vijuar shqyrtimin me përparësi të ankesave dhe kërkesave të shoqatave të ndryshme apo atyre të të persekutuarve politikë gjatë regjimit komunist, siç është një Kërkesë-Deklaratë e Qendrës Shqiptare të Rehabilitimit të Traumës dhe Torturës drejtuar personaliteteve më të larta të shtetit dhe politikës shqiptare si dhe disa prej përfaqësuesve më të rëndësishëm të diplomacisë perëndimore që ndodhen në Republikën e Shqipërisë, në të cilën parashtroheshin mjaft kërkesa dhe bëhej thirrje për mbështetje në plotësimin e tyre.

Po ashtu, janë trajtuar me kujdes dhe vëmendje të veçantë edhe ankesat e familjarëve të personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist, të cilët kanë kërkuar ndërhyrjen tonë institucionale pranë organeve kompetente shtetërore për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve, por që akoma nuk ju është gjetur vendvarrimi. Këshilli i Ministrave ka miratuar Vendimin Nr.133, datë 24.02.2010 “Për Krijimin e Task-Forcës për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist” duke përcaktuar edhe strukturën e saj si dhe mënyrat e procedimit. Në këtë kuadër, Avokati i Popullit ndërmori me iniciativë hetimin e kësaj çështje (201100459) duke iu drejtuar me shkresë zyrtare Zv.Ministrit të Brendshëm, në cilësinë e Kryetarit të kësaj Task-Force, për t’i kërkuar informacion të detajuar në lidhje me ngritjen, funksionimin, aktivitetin dhe arritjet e kësaj Task-Force,

për kërkimin, gjetjen dhe identifikimin e personave të ekzekutuar gjatë viteve të regjimit komunist. Me keqardhje kemi konstatuar se nuk ka patur asnjë qëndrim zyrtar mbi parashtrimet tona.

Gjithsesi shprehim angazhimin tonë institucional për të ndjekur në vazhdimësi këtë çështje, e cila përbën një plagë të pashërueshme për shumë familje shqiptare, të cilat nuk kanë një varr për të afërmit e tyre.

Kreu III

Veprimtaria e Institucionit të Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar kundër Torturës

1. Mandati ligjor dhe veprimtaria monitoruese

Gjatë vitit 2011 roli i Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës (MKPT) është shndërruar në një detyrë funksionale të konsoliduar duke u mbështetur me prioritet të veçantë. Në një hark kohor prej tre vjetësh Institucioni i Avokatit të Popullit ia ka arritur të ngrejë dhe vërë në funksionim një strukturë efektive për t`ju përgjigjur me profesionalizëm çdo fenomeni që mbart brënda tij shkelje të të drejtave të njeriut, torturë, trajtim çnjerëzor dhe degradues. Gjatë vitit 2011 kjo veprimtari ka vijuar të shënojë rritje cilësore në parandalimin e fenomeneve të mësipërme, promovimin e praktikave pozitive dhe forcimin e dialogut me autoritetet.

Funksioni i Mekanizmit të Parandalimit të Torturës i është atribuar Institucionit të Avokatit të Popullit që në Janar të Vitit 2008. Ashtu siç kemi përmendur edhe në raportimet e mëparshme, kësaj ngjarje i paraprinë propozimet zyrtare të Institucionit tonë mbi mënyrën se si duhet të vihej në zbatim Ligji Nr.9094 dt.03.07.2003 “Për Ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerezore dhe Degraduese (OPCAT)”. Me anë të këtij propozimi, synohej që krijimi dhe vënia në punë e një strukture kombëtare për parandalimin e torturës, siç kërkonte (OPCAT), të atashohej pranë Avokatit të Popullit, i cili përfaqësonte një profil institucional të përshtatshëm. Pranimi i këtij propozimi nga Qeveria Shqiptare, duke shtuar kapacitetet financiare dhe njerëzore për vitin 2008 e vijim, shënoi dhe fillimin e aktivitetit tonë në këtë fushë.

Në punën tonë, si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, zbatojmë një sërë aktesh kombëtare dhe ndërkombëtare që normojnë dhe mandatojnë veprimtarinë tonë të përditshme. Konkretisht, sipas pikës 1 të

nenit 60 të Kushtetutës së Shqipërisë, Avokati i Popullit mbron të drejtat, liritë dhe interesat e ligjshëm të individit nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike”. Nisur nga nevoja për të përmbushur një monitorim më të madh të institucioneve ku liria e personave është e kufizuar, ku dhe probabiliteti për shkelje është më i lartë, janë paraparë të rëndësishme për zbatim edhe dispozitat e Protokollit Opsional të Konventës kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerezore dhe Degraduese (OPCAT)” miratuar me Ligjin Nr. 9094, dt.03.07.2003.

Këto dispozita parashikojnë parimet bazë të inspektimeve në institucionet e mësipërme dhe garantojnë një aktivitet konform standarteve kombëtare në këtë drejtim.

Gjithashtu, neni 19/1, i Ligjit Nr.8454, date 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar, autorizon një veprimtari monitoruese dhe hetimore të pavarur, të gjithanshme dhe të plotë për çdo rast torture, trajtimi çnjerezor dhe degradues, duke garantuar akses te madh në çdo ambjent apo zyrë, ndaj çdo zyrtari pa imunitet dhe mbi çdo dokumentacion, qofte dhe të klasifikuar të organeve të administratës publike.

Edhe ndryshimet e kryera në Mars 2010, në Ligjin Nr.8328 datë 02.04.1998, “Për të drejtat dhe trajtimin e të denuarve me burgim dhe të paraburgosurve”, bën të mundur shfrytëzimin e një hapësire më të madhe të Avokatit të Popullit në funksionin e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës (MKPT) për të kryer detyrat e tij gjatë kontrollit të shërbimeve penitenciare. Në Nenin 74 të këtij ligji, Avokatit të Popullit në rolin e MKPT-së, i njihet e drejta si subjekt i veçante për mbikëqyrjen e zbatimit dhe realizimit të ligjit për të denuarit dhe paraburgosurit. Ai gëzon kompetenca për të vëzhguar rregullisht trajtimin e individëve, që u është hequr liria në vendet e ndalimit, arrestimit ose burgosjes, me qëllim që të forcohet, kur është e nevojshme, mbrojtja e individëve nga tortura, trajtimi ose dënimi i egër, çnjerezor ose poshtëruës. Gjithashtu, në këtë dispozitë njihet e drejta që ky Institucion të paraqesë në mënyrë specifike raporte dhe rekomandime për organet përkatëse, me qëllim që të përmirësohen trajtimi dhe kushtet e individëve që u është hequr liria dhe të parandalohet tortura dhe trajtimi ose dënimi i egër, çnjerezor ose poshtëruës.

Inspektimet, vizitat dhe çdo kontroll tjetër i kryer në Institucionet e Policisë së Shtetit, në Institucionet e Ekzekutimit të Vendimeve Penale (burgje dhe paraburgime), në Spitale Psikiatrike dhe Infektive, në baza dhe reparte ushtarake, në Drejtoritë Rajonale të Kufirit dhe Migracionit si dhe në qendrat e tjera të strehimit të emigrantëve të paligjshëm dhe personave të trafikuar, ka patur si objektiv të sigurojë një mbulim të plotë monitorues mbi

situatën e të drejtave të njeriut në këto organe, të parandalojë shkeljet, si dhe të artikulojë një qëndrim realist zyrtar mbi situatën në terren.

Gjatë vitit 2011, Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer **161** inspektime, ri-inspektime, kontrole me tematikë të veçantë dhe vizita në të gjitha vendet e privimit të lirisë dhe institucionet e tjera të përmendura më sipër. Krahas kësaj, kjo strukturë ka trajtuar edhe rreth **266 ankesa** të individëve të marra gjatë kontakteve direkte në inspektimet e kryera. I gjithë aktiviteti i mësipërm është shoqëruar me **97 rekomandime** dhe me një korrespondencë zyrtare të dendur për të sqaruar shumë detaje dhe fenomene të konstatuara gjatë inspektimeve.

Rekomandimet dhe ndërhyrjet e mësipërme janë prezantuar kryesisht për respektimin e të drejtave të të dënuarve dhe paraburgosurve, në plotësimin e nevojave të tyre jetësore, shëndetësore dhe arsimore.

Gjithashtu, janë propozuar edhe një sërë masash të tjera për kryerjen e investimeve të brendshme infrastrukturore, në plotësimin e efektivit punonjës me qëllimin mbulimin e plotë të shërbimeve të kërkuara nga këto qendra. Përveç kësaj është mbajtur në konsideratë veprimtaria promovuese e të drejtave të njeriut në bashkëpunim me administratën e burgjeve për të cilën do flitet gjerësisht në vijim. Avokati i Popullit ka vijuar të ndjekë me përparësi cilësinë e komunikimit nëpërmjet numrit pa pagesë që ofron zyra jonë ndaj të dënuarve dhe paraburgosurve si dhe të funksionimit të kutive të posaçme postare që hapen vetëm nga personeli i Avokatit të Popullit në çdo burg dhe paraburgim. Ky projekt, falë dhe ndihmës dhe mbështetjes së dhënë nga Misioni i OSBE-së në Tiranë, vazhdon të jetë efektiv dhe tepër i dobishëm. Për vitin 2011, Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka realizuar rreth 187 telefonata me të dënuar dhe paraburgosur, nga të cilat janë marrë njoftime dhe janë rregjistruar ankesa konkrete për zgjidhje. Ndërkohë, nga kutitë postare të instaluar në të gjitha qendrat e burgjeve dhe paraburgimit janë marrë edhe 59 ankesa apo kërkesa të cilat janë shqyrtuar me përparësi dhe në shumicën e rasteve ju është dhënë zgjidhje.

Avokati i Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka vijuar të kryejë veprimtarinë e tij në inspektimin e ambjenteve të Policisë së Shtetit, duke u ndalur dhe kontrolluar veçanërisht ligjshmërinë dhe rregullsinë e shoqërimit, ndalimit apo arrestimit të individëve, kushtet dhe trajtimin e tyre brenda Komisariateve, problematikat infrastrukturore dhe materiale të tyre etj.

Gjatë vitit 2011, janë kryer sondazhe në shërbimet policore, mbi mënyrën e trajtimit administrativ të rasteve të shoqërimit të shtetasve, për

mbajtjen e objekteve të dyshimta në zyrat e hetimit që mund të provokojnë dhunë psikologjike tek individët, si dhe për rolin e psikologut të policisë në trajtimin e personave të mitur dhe të efektive që mund të shfaqin probleme psikologjike gjatë shërbimit. Për të gjitha rastet e konstatuara janë prezantuar edhe vërejtjet përkatëse në rekomandimet që u janë dërguar organeve eprore të Policisë së Shtetit. Në bashkëpunimin dhe kryerjen e detyrave të tij në Policinë e Shtetit, Avokati i Popullit vijon të kërkojë zbatimin e legjislacionit në fuqi dhe të dokumentit të miratuar gjatë vitit 2009 për Metodologjinë e Inspektiveve në Organet e Policisë së Shtetit. Ky dokument ka vazhduar të udhëheqë mbi baza profesionale dhe ligjore punën e bere në këtë fushë, duke dhënë rezultate shumë pozitive.

Një tjetër fushë ku është fokusuar gjatë vitit 2011 aktiviteti i Avokati i Popullit si Mekanizem Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka qenë edhe monitorimi i standarteve të të drejtave të njeriut në Forcat e Armatosura të Republikës së Shqipërisë. Kjo veprimtari ka qenë e përqëndruar veçanërisht në trajtimin e të drejtave të ushtarakëve, respektimin e statusit të tyre, kontrollin për masat disiplinore dhe kushteve të dhomave të ndalimit disiplinor. Për këtë qëllim, janë organizuar inspektive të shpeshta në bazat dhe repartet ushtarake, ku janë marrë kontakte me ushtarakët dhe është bere njohja nga afër me kushtet e trajtimit të tyre dhe nivelin e zbatimit të akteve nënligjore që normojnë jetesën e tyre, brenda institucioneve ushtarake.

Produkt i aksesit tonë në këto baza kanë qenë prezantimi i rekomandimeve të veçanta të Avokatit të Popullit, të cilat kanë ngritur veçanërisht probleme mbi hartimin dhe miratimin e rregulloreve të reja për izolimin disiplinor, trajtimin me të drejta të barabarta të efektivit ushtarak sipas statusit ligjor që ata gëzojnë, realizimin e procedurave transparente në rastet e izolimit të tyre, përmirësimin e kushteve të ambjenteve etj.

Për të gjitha këto problematika flitet më gjerësisht në rubrikën përkatëse të këtij raporti.

Gjatë vitit 2011, Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer rreth **32** inspektive, ri-inspektive, vizita dhe kontrole tematike në Qendrat Spitalore të Shëndetit Mendor, Qendrat Spitalore Infektive pranë QSUT-së dhe Spitalit Ushtarak, Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, Ambientet e të Deportuarve në Komisaratin e Policisë Kufitare Rinas-Tiranë, Institutin e të Miturve Kavajë, Qendrën Kombëtare të Viktimave të Trafikut në Linzë dhe Qendrën Kombëtare të Pritjes së Azilkërkuesve Babrru-Tiranë. Për të gjithë këtë veprimtari janë hartuar **16** rekomandime për përmirësimin e shërbimeve spitalore në respekt të të drejtave të individëve.

Inspektimet kanë patur një rol të madh në evidentimin e problematikave që ekzistojnë në këto institucione lidhur me kushtet dhe mënyrën e trajtimit të shtetasve në përputhje me dispozitat ligjore sipas fushës përkatëse.

Rëndësia e këtij procesi qëndron jo vetëm në respektimin dhe zbatimin e ligjit për të drejtat dhe liritë e individit në këto institucione, por dhe për mënyrën funksionale të strukturës institucionale të përshtatur me profesionalizëm sipas standarteve të kërkuara konform me ligjin, si dhe kushtet infrastrukturore në ambientet e këtyre institucioneve.

Gjatë vitit 2011 Mekanizmi Kombëtar për Parandalimin e Torturës, ka kryer rreth 16 inspektime dhe kontrole tematike në Qendrat Spitalore të Shëndetit Mendor në Vlorë, Shkodër dhe Elbasan, Qendrat Spitalore Infektive pranë QSUT-së dhe Spitalit Ushtarak, Qendrën Spitalore të Burgjeve Tiranë, Ambientet e të Depërtuarve në Komisaratin e Policisë Kufitare RINAS-Tiranë, I.E.V.Penale Tropoje, I.E.V.Penale Kukes, I.E.V.Penale 313, në Sektorin e Femrave dhe të Miturve, Qendrën Kombëtare të Viktimave të Trafikut në Linzë dhe Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve Babrru-Tiranë.

Inspektimet në Qendrat Spitalore, Qendrat Sociale, Burgjet dhe Paraburgimet për meshkuj, femra dhe të mitur, kanë një rol të madh në evidentimin e problematikave në këto institucione lidhur me kushtet dhe mënyrën e trajtimit të shtetasve në përputhje me dispozitat ligjore sipas fushës përkatëse.

Rëndësia e këtij procesi qëndron jo vetëm në respektimin dhe zbatimin e ligjit për të drejtat dhe liritë e individit në këto institucione, por dhe për mënyrën funksionale të strukturës institucionale të përshtatur me profesionalizëm sipas standarteve të kërkuara konform me ligjin, si dhe kushtet infrastrukturore në ambientet e këtyre institucioneve.

Gjithashtu për arritjen e këtij procesi një rol specifik ka trajtimi me rigorozitet i ankesave të shtetasve në lidhje me të gjitha institucionet e lartpërmendura.

Tematikat e inspektimit gjatë vitit 2011 vijnë si me poshtë:

- Plotësimi i të gjitha kushteve sipas dispozitave ligjore për personat me probleme të shëndetit mendor dhe trajtimi i tyre me profesionalizëm nga stafi mjekësor, dhe kryesisht rehabilitimit i tyre me terapi psiko-sociale, si specifike për këto funksione. Monitorimi i segmenteve të caktuara në këto institucione ku aplikohet terapia intensive si procedurë për rastet e veçanta në lidhje me kufizimin fizik, mënyrat e përdorimit të forcës me mjetet e standartizuara si dhe ambientet në të cilat praktikohet kjo procedurë, si dhe

forma e shtrimit të detyrueshem konform ligjit dhe procedurave të ndjekura. Përmirësimi i kushteve në ambientet e rikreacionit për fëmijët me prapambetje mendore, me të gjitha mjetet e nevojshme për rehabilitim psiko-social intensiv, me qëllim përshkallëzimin e gjendjes së mëparshme dhe ndryshimin gradual të tyre në raport me diagnoztikimin fillestar.

- Sigurimi i ambienteve karantinë në spitalet infektive, mbajtjes të personave të infektuar në raste epidemie masive dhe kushtet që ofrohen për pacientët, respektimi i formës së shtrimit të pacientëve me sëmundje infektive të përcaktuar, nëpër dhoma të kategorizuara në bazë të diagnozave mjekësore si domosdoshmëri për të evituar çdo lloj risku në rikontaminimin e tyre përgjatë rehabilitimit në këto spitale.

- Respektimi me korrektësi të dispozitave ligjore në Institucionet e Ekzekutimeve të Vendimeve Penale për meshkuj, femra dhe të mitur, në lidhje me kushtet dhe trajtimin e tyre të parashikuar në ligjin Nr.8328 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve”, për kujdesin shëndetësor, kuotat financiare në shërbim të nevojave personale të kesaj kategorie në këto institucione, riaftësimin në jetën sociale me forma punësimi brenda institucionit, angazhimin total në aktivitete shoqërore, shkollimin me arsim për kategori të ndryshme, liçensimin nëpërmjet kurseve profesionale, ndikimin e stafit përgatitor kujdestar për të mundësuar rehabilitimin shoqëror të tyre.

- Trajtimi i veçantë për personat viktimë të trafikut të qënive njerëzore, kushtet që ofrohen në institucionin përkatës, kujdesi shëndetësor, ndjekja e vazhdueshme nga specialistët për gjendjen e tyre psikologjike, angazhimi në aktivitete sociale, riaftësimi dhe rehabilitimi si kusht themelor për riadaptimin në shoqëri, nga stafi përkatës në këto institucione.

- Kushtet në Qendrën Kombëtare të Pritjes së Azilkërkuesve, trajtimi i azilantëve, shërbimi që ofrohet ndaj tyre dhe zbatimi i të drejtave të tyre në përpuethshmëri me ligjin.

- Gjendja e ambienteve dhe mënyra e trajtimit të personave të deportuar në Komisaratin e Policisë Kufitare RINAS në Tiranë. Sigurimi i ndihmës së detyrueshëm juridik dhe psikologjik, si dhe ndarja nëpër ambiente të përcaktuara në Ligjin e Policisë së Shtetit, sipas gjinisë dhe moshës.

Rastet e trajtuara me iniciativë nga Avokati i Popullit, në funksion të Mekanizmit për Parandalimin e Torturës përgjatë vitit 2011, sipas tematikave të lartpërmendura janë ezauruar nëpërmjet inspektimeve, dhe problematikat e konstatuara kanë qenë në fusha të ndryshme dhe janë pasuar me rekomandime për subjektet përkatëse.

- Në Qendrat Spitalore të Shëndetit Mendor është konstatuar nevoja për rikonstruksione në infrastrukturën e godinës aktuale për eliminimin e lagështirës, mosfunksionimi i sistemit të ngrohjes dhe rrjetit të ujit të pijshëm, mungesa e personelit mjekësor dhe personelit socialo-edukativ në raport me numrin e pacientëve, mungesa e veshmbathjes dhe e paisjeve hotelerik për pacientët, si dhe pamundësia për trajtimet afat-gjata për stafin infermier-kujdestar në shërbim të kësaj kategorie.

- Në Qendrat Spitalore Infektive është konstatuar pamjaftueshmeria e pavioneve në raport me kapacitetet e shtrimit për këtë sektor, sidomos në raste epidemish, mungesa e mjeteve akomoduese në disa pavione dhe prezencë të lagështirës në dhomat e pacientëve dhe magazinës së medikamenteve, pamjaftueshmeria e stafit infermier në raport me rastet e trajtuara etj.

-Në Institucionet Ekzekutive të Vendimeve Penale për meshkuj, femra dhe të mitur është konstatuar se ka nevojë për ambiente sipas standarteve të kërkuara, sidomos në institucionet për femra (I.E.V.P 325, I.E.V.P. 313) pasi kushtet mjedisore lënë për të dëshiruar. Gjithashtu është vënë re se aktivizimi i kësaj kategorie (femra dhe të mitur) në aktivitete sociale dhe arsimore ka qenë në rritje me pjesëmarrje të konsiderueshme, por është konstatuar mungesa e mjeteve kompjuterike, mungesa e mjetit të transportit me parametra sigurie bashkëkohore, mungese personeli për disa sektorë në këto institucione, mungese të sistemit ventilues, mosfunksionimin e sistemit të ngrohjes etj.

- Në Qendrën Kombëtare të Viktimave të Trafikut është konstatuar prezenca e lagështirës, mungesa e paisjeve vetjake (triko, kepucë etj), moskryerja në kohë e rikonstruktimit të godinës aktuale, prezenca e 3 (tre) të miturve të pa regjistruar në sistemin shkollor.

- Në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve është konstatuar prezenca e lagështirës në ambiente të ndryshme, mungesa me ndihmë financiare mujore për azilantët e parashikuar në ligjin nr.1060, datë 26.01.2009 “Për disa shtesa dhe ndryshime në ligjin nr.8432, datë 14.12.1998 “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, si dhe mungesa e personelit kujdestar, mjek ose infermier me kohë të plotë. Gjithashtu është konstatuar se trajtimi i azilantëve është i kënaqshëm dhe se aktivitetet sociale janë të shumtë në këtë institucion, por nuk ekziston një ambjent ambulator për rastet emergjente.

Rekomandimet për vitin 2011 janë bazuar në kuadrin ligjor me të cilin punohet për të gjitha subjektet e trajtuara nga Avokati i Popullit, me qëllim respektimin edhe zbatimin e ligjit kundrejt veprimeve dhe problematikave të konstatuara.

1- Çështje e filluar me inisiativë në Spitalin Psikiatrik Shkodër **nr. dok.201100622**

Bazuar në konstatimet nga inspektimi në Spitalin Psikiatrik Shkodër është rekomanduar:

- Marrja e masave për përshejtimin e punimeve me qëllim kalimin e pacientëve të këtij spitali në ambjentet e godinës së re brenda afatit të parashikuar;

- Marrja e masave për mbulimin e menjëhershëm të rrjetit elektrik me parametra protektiv dhe teknik, me qëllim eliminimin e rrezikut që paraqet ky rrjet përgjatë qëndrimit të pacientëve dhe stafit mjekësor në këtë institucion, si dhe eliminimin e situatave të padëshiruara që mund të shkaktohen në këtë godinë deri në mbarimin e plotë të godinës së re;

- Marrja e masave për plotësimin e të gjithë gamës së medikamenteve të munguara, si dhe përmirësimin e cilësisë së detergjentëve sanitare për këtë spital, me qëllim mundësimin e një higjene brenda standarteve, për vetë specifikën e pacientëve që kuron ky institucion;

- Marrja e masave për t'i mundësuar stafit kujdestar trajnime periodike lidhur me rolin e rëndësishëm që kryen ky staf në funksion të kësaj kategorie, me qëllim përmirësimin dhe kualifikimin e profesionit të tyre sipas standarteve të kërkuara, përgjatë ushtrimit të detyrës.

2- Çështje e filluar me inisiativë në Spitalin Psikiatrik Vlorë **nr. doc. 201100801**

Bazuar në konstatimet nga inspektimi në Spitalin Psikiatrik Vlorë është rekomanduar:

- Marrja e masave për lëvrimin e fondeve për ndërtimin e godinës së re, pasi kushtet aktuale në godinën e vjetër ku strehohet edhe pjesa më e madhe e pacientëve të këtij spitali, lënë për të dëshiruar;

- Marrja e masave për shtimin e numrit të mjekëve në organike dhe krijimin e personelit task-forcë për rastet specifike në urgjencën e këtij institucioni, me qëllim ofrimin e një shërbimi dhe përkujdesjeje ndaj pacientëve brenda standarteve të kërkuara;

- Marrja e masave për mundësimin e vazhdueshëm të trajnimeve afatgjata për stafin kujdestar dhe infermier, me qëllim përmirësimin e këtij stafi në nivel profesional dhe mundësimin e një shërbimi me përkujdesje të kualifikuar gjatë ushtrimit të detyrës, kundrejt pacientëve të këtij institucioni.

3- Çështje e filluar me inisiativë në Spitalin Psikiatrik Elbasan nr. doc. 201101346

Bazuar në konstatimet nga inspektimi në Spitalin Psikiatrik Elbasan është rekomanduar:

- Marrja e masave për shtimin e infermierëve në organikën e Spitalit Psikiatrik Elbasan, sipas standarteve të kërkuara dhe nevojave të këtij institucioni;

- Marrja e masave për vënien në funksion të sistemit ngrohës në të gjitha ambientet e Spitalit Psikiatrik Elbasan, me qëllim përmirësimin e kushteve jetësore të pacientëve me probleme të shëndetit mendor, si dhe eliminimin e situatave të padëshiruara gjatë stinës së dimrit me pasoj negative në shëndetin e tyre;

- Kryerja e hidroizolimit të tarracës së këtij spitali për evitimin e lagështirës nëpër pavione, si dhe marrja e masave për rikonstruksionin e rrjetit të ujit të pijshëm, me qëllim përmirësimin e kushteve të pacientëve në këtë institucion;

- Blerja e një paisje të re lavanterie profesionale me qëllim përmbushjen e nevojave të pacientëve;

- Marrja e masave urgjente për plotësimin dhe shtimin e mjekëve në organikën e Spitalit Psikiatrik Elbasan, sipas standarteve të kërkuara dhe nevojave të këtij institucioni, si dhe shtimi me personel kujdestar dhe socialo-edukativ në shërbimin e veçantë, si specifik për këto funksione.

4- Çështje e filluar me inisiativë në Qendrën Spitalore të Burgjeve nr.doc. 201100712

Bazuar në konstatimet nga inspektimi në Qendrën Spitalore të Burgjeve është rekomanduar:

- Marrja e masave për lyerjen e dhomave të pacientëve në sektorin e femrave dhe meshkujve, me qëllim përmirësimin e higjenës së ambientit ku ato qëndrojnë më së shumti përgjatë kurimit të tyre;

- Marrja e masave për rikonstruksionin sa më parë të dhomave në sektorin e femrave, pasi qëndrimi i gjatë në këto ambiente me lagështirë të theksuar, përbën rrezik serioz për shëndetin e tyre;

- Krijimi i menjëhershëm i një dhome të veçantë observimi për rastet e diagnostikuara me probleme të shëndetit mendor me masa izolimi, pasi mungesa e një të tilla përbën problem serioz për stafin mjekësor i cili nuk disponon mjetet e duhura të shtrëngimit sipas standarteve të kërkuara;

- Marrja e masave për mundësimin e të gjitha aparateve dhe mjeteve dentare në ambientin e shërbimit stomatolog, si dhe vendosjen e një strehe në ambientet e ajrimit, me qëllim eliminimin e pasojave të dëmshmesh nga

rrezet diellore, pasi të gjithë të dënuarit dhe të paraburgosurit janë nën trajtime mjekësore me specifika të ndryshme;

- Shtimi në organikë të stafit rehabilitues dhe kryesisht atë kujdestar, me qëllim përmirësimin e cilësisë së shërbimit kundrejt pacientëve me probleme të shëndetit mendor, si dhe zgjerimin e ambjentit të edukimit dhe mundësimin e të gjitha mjeteve për kryerjen e aktiviteteve brenda këtij ambjenti, me qëllim përmirësimin e kushteve për rehabilitimin dhe ndikimin pozitiv në nivel psiko-social, për të dënuarit dhe të paraburgosurit dhe specifikisht të rasteve që trajtohen me mjekim të detyruar;

- Marrja e masave mbrojtëse për stafin mjekësor kundrejt rasteve me sëmundje infektive, si dhe të kërkohet zbatimi i Memorandumit të Bashkëpunimit ndërmjet Ministrisë së Shëndetësisë dhe Ministrisë së Drejtësisë, me qëllim mundësimin në kohë të të gjitha ekzaminimeve mjekësore me specifike të profilizuar nga institucionet spitalore palë të këtij Memorandumi, për persona me liri të kufizuar.

5- Çështje e filluar me inisiativë në Spitalin Infektiv pranë QSUT- së **nr.doc.201101807**

Bazuar në konstatimet nga inspektimi në Spitalin Infektiv pranë QSUT-së, është rekomanduar:

- Marrja e masave për kryerjen e rikonstruksionit të ambjentit të veçantë për raste epidemish, me qëllim zgjerimin e ambjenteve të Spitalit Infektiv, pasi me afrimin e stinës së verës ky institucion mund të përballlet me situata të padëshiruara;

- Marrja e masave për paisjen e dusheve me mjetet e nevojshme për funksionimin e tyre, si dhe paisja e pavioneve me aparate për mbajtjen e serumeve, me qëllim përmirësimin e kushteve të pacientëve përgjatë qëndrimit të tyre në këtë spital.

6- Çështje e filluar me inisiativë në Repartin Infektiv të Spitalit Ushtarak **nr. doc. 201101806**

Bazuar në konstatimet nga inspektimi në Repartin Infektiv të Spitalit Ushtarak, është rekomanduar:

- Marrja e masave për shtimin e infermierëve në organikën e Repartit Infektiv pranë Spitalit Qëndror Ushtarak në Tiranë, sipas standarteve të kërkuara dhe nevojave të këtij institucioni;

- Marrja e masave për vënien në funksion të sistemit ngrohës në të gjitha ambjentet e Repartit Infektiv, si dhe vënia në funksion të dusheve dhe mundësimi i tyre me ujë të ngrohtë, me qëllim përmirësimin e kushteve jetësore të pacientëve përgjatë qëndrimit të tyre në këtë institucion dhe kryesisht gjatë stinës së dimrit.

- Kryerja e procedurave administrative konform ligjit për përcaktimin e vështirësisë për punonjësit e Repartit Infektiv në një zë të veçantë financiar.

7- Çështje e filluar me inisiativë në I.E.V.Penale 313 (regjimi i të miturve) **nr. doc. 201100595**

Nga inspektimi në IEV Penale 313 bazuar në konstatimet lidhur me gjendjen në këtë institucion, është rekomanduar:

- Marrja e masave për lyerjen e qelive dhe ambienteve në tërësi në regjimin e të miturve në Institucionin e Paraburgimit 313, riparimin e dusheve dhe furnizimin me kosha mbeturinash dhe produkte higjeno-sanitare të çdo qelie, me qëllim përmirësimin e cilësisë jetike dhe higjenes vetjake të personave që gjenden në këto ambiente;

- Marrja e masave për përshejtimin e procesit për paisjen e qelive të të miturve me mjete akomoduese të reja si dhe paisja e këtij regjimi me një sistem qëndror ventilues, me qëllim evitimin e temperaturave të larta përgjatë stinës së verës, paisja e shërbimit stomatologjik me produktet e nevojshme për mjekime dentare me qëllim përmirësimin e cilësisë së këtij shërbimi në regjimin për të mitur;

- Marrja e masave për vënien sa më parë në funksion të ambientit për shërbimin social edukativ dhe paisja e këtij regjimi me mjetet e nevojshme kompjuterike, me qëllim përmirësimin e shërbimit social edukativ dhe ndikimit pozitiv në rehabilitimin e të miturve në jetën sociale.

8- Çështje e filluar me inisiativë në Qendrën Kombëtare Pritëse të Azilkërkuesve nr. doc. 201100147

Bazuar në konstatimet nga inspektimi në këtë qendër është rekomanduar:

- Lëvrimi i fondeve për rikonstrukcionin e godinës gjithpërfshirëse për të cilën kjo qendër gëzon mbështetjen e UNCHR-së, me qëllim përmirësimin e kushteve të jetesës dhe largimin e personave të strehuar në këtë qendër sa më parë nga ambientet ekzistuese, në të cilat prezenca e lagështirës është në nivel shqetësues për shëndetin e tyre;

- Trajtimi i ndihmës financiare mujore të personave që strehon qendra siç përcakton ligji nr. 1060, datë 26.01.2009, “Për disa ndryshime dhe shtesa në ligjin nr. 8432, datë 14.12.1998, “Për Azilin në Republikën e Shqipërisë”, neni 13/b, përcakton se: “Azilkërkuesit do ti garantohet e drejta e strehimit, e ushqimit, e ndihmës financiare për nevoja ngutësisht vetjake, të ofruara në Qendrën Kombëtare Pritëse për Azilkërkuesit”;

- Krijimi i kushteve financiare për shtimin e numrit të punonjësve me psikologë, kujdestar, mjek ose infermier, si dhe marrjen e masave për

krijimin e një ambienti ambulator me qëllim ofrimin e ndihmës së parë mjekësore në këtë qendër.

9- Çështje e filluar me inisiativë në Qendrën Kombëtare të Viktimave të Trafikut Linzë Tiranë **nr. doc. 201100386**

Mbi bazë të konstatimeve nga inspektimi i kryer në këtë qendër kemi rekomanduar:

- Marrjen e masave për lëvrimin e fondit të miratuar për këtë qendër, me qëllim kryerjen sa më shpejtë të rikonstruksionit të godinës ekzistuese;

- Marrjen e masave për lidhjen e një marrëveshje me Drejtorinë Rajonale Arsimore Tiranë, për të mundësuar rregjistrimin e 3 minoreneve, me qëllim rikthimin e tyre sa parë në procesin mësimor dhe vazhdimin e ciklit përkatës, për të mos humbur vitin shkollor;

- Marrjen e masave për paisjen e personave të strehuar me veshmbathjet e munguara (triko, kepuçë, pantollona etj) si dhe mundësimin e një kursi profesional, brenda ambienteve të kësaj qendre.

10- Çështje e filluar me inisiativë në Komisaratin e Policisë Kufitare RINAS Tiranë **nr. doc. 201100471**

Bazuar në konstatimet nga inspektimet në këtë komisarati kemi rekomanduar marrjen e masave për krijimin e ambientit të minoreneve brenda standarteve të kërkuara, me qëllim përmirësimin e kushteve përgjatë qëndrimit të tyre si të pranuar në Komisaratin e Policisë Kufitare RINAS Tiranë;

- Marrjen e masave për hapjen e një dritareje në ambientin e femrave me qëllim hyrjen e ndriçimit natyral dhe ajrosjen e plotë të tyre përgjatë qëndrimit të tyre në këtë ambient.

11- Çështje e filluar me inisiativë në I.E.V.Penale 313 (regjimi i grave) në Tiranë **nr. doc. 201100501**

Bazuar në konstatimet nga inspektimet e kryera në I.E.V.P. Penale 313 kemi rekomanduar:

- Mbajtjen në konsideratë dhe zgjidhjen e të gjitha problematikave të konstatuara në regjimin e femrave në Burgun 313 në Tiranë.

- Marrjen e masave për përsheptimin e projektimit dhe ndërtimit të burgut të ri për femra në I.E.V.Penale 313, i parashikuar për vitin 2011-2013 me projekt buxhetin afat mesëm, me qëllim përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e femrave përgjatë qëndrimit të tyre në këtë institucion.

- Marrjen e masave për dizinfektimin periodik të ambienteve të këtij regjimi, me qëllim zhdukjen e brejtësve dhe insekteve, gjë e cila do të ndihmonte në evitimin e ndonjë epidemie të mundshme në sezonin e verës.

- Marrjen e masave për instalimin e ventilatorëve të brendshëm me qëllim lehtësimin e temperaturave të larta dhe përmirësimin e cilësisë së ajrit

gjatë periudhës së nxehtë të verës, si dhe shtimin e një mjeti lavanterik brenda këtij regjimi dhe paisjen e çdo dhome me kosha mbeturinash me qëllim përmirësimin e kushteve higjienike për të paraburgosurat e këtij institucioni.

12- Çështje e filluar me inisiative ne I.E.V.Penale 325 (sektori i grave) ne Tirane **nr. doc. 201100536**

Mbas konstatimeve nga inspektimet në I.E.V.Penale 325 në sektorin e grave kemi rekomanduar:

- Marrjen e masave për shtimin e organikës me personel sigurie në lidhje me seksionin e sigurisë së veçantë të ngritur posaçërisht për të dënuarat me probleme të shëndetit mendor, si dhe sigurimin për një ndarje më të mirë të niveleve të sigurisë në këtë institucion.

13- Çështje e filluar me inisiative ne I.E.V.Penale 325 (sektori i grave) **nr. doc. 201100671**, lidhur me shqetësimin e ngritur nga te denuarat femra per mostransferimin e tyre ne Rrogozhine

Jemi informuar lidhur me pretendimet dhe shqetësimin e ngritur nga të dënuarat femra në I.E.V.Penale 325, pasi organizatat jo-fitimpruese të cilat në bazë të shërbimit me objektiv rehabilitues dhe riintegrues për këtë kategori, e kanë të pamundur të shpërngulen jashtë territorit të Tiranës, pasi ka një kosto të lartë financiare. Aktivitetet e licensuara, kurset profesionale dhe aktivitetet e ofruara nga shoqatat civile në këtë institucion kanë kontribut kundrejt të dënuarave në drejtim te rehabilitimit social, riaftësimit shoqëror dhe jetësorë, ndihmës ekonomike ndaj tyre, aktiviteteve të shumëllojshme kulturore-artistike dhe përkujdesjes ndaj fëmijëve të tyre të mitur. Pikërisht ky trajtim human dhe me shumëllojshmëri vlerash, ndikojnë në shqetësimin dhe pretendimin e ngritur nga të dënuarat femra në I.E.V.Penale 325, pasi kjo mbeshtetje nuk mund te ofrohet e njejte nese transferohen në Rrogozhinë. Lidhur me këtë shqetësim është informuar Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

14- Çështje e filluar me inisiative ne I.E.V.Penale ne Bajram Curri Tropoje **nr. doc. 201101693**

Bazuar në konstatimet nga inspektimi pranë I.E.V.Penale në Bajram Curri kemi rekomanduar:

- Marrjen e masave për përfundimin sa më parë të ambjenteve të reja në I.E.V.Penale Bajram Curri, me qëllim rehabilitimin e të paraburgosurve në këto ambjente para stinës së dimrit.

-Marrjen e masave të menjëhershëm për paisjen e këtij institucioni me një mjet transporti me parametra bashkëkohor sigurie, me qëllim eliminimin e situatave të padëshiruara përgjatë transportimit të të paraburgosurve, që vë në rrezik personelin e sigurisë përgjatë ushtrimit të detyrës.

-Marrjen e masave për mundësimin me personel në sektorin e lavanterisë dhe në sektorin sanitar, me qëllim përmirësimin e shërbimit të ofruar në këtë institucion sipas standarteve të kërkuara.

15- Çështje e filluar me inisiativë në I.E.V.Penale Kukës **nr. doc. 201100717**

Në përfundim të inspektimeve kemi rekomanduar:

- Marrjen e masave për krijimit e menjëhershëm të dhomës së takimit të paraburgosurve me familjarët e tyre, me qëllim respektimin dhe zbatimin e legjislacionit në fuqi për të drejtat e personave me liri të kufizuar, duke marrë një ambient nga Policia e Shtetit për këtë qëllim;

- Marrjen e masave për zhvendosjen e aparatit të telefonisë në një vend konfidencial, larg monitorimit dhe ambienteve të personelit të këtij institucioni, si dhe paisjen e dhomës së edukimit me të gjitha mjetet akomoduese dhe rehabilituese, me qëllim mundësimin dhe konkretizimin e programeve edukativo-social për këtë kategori;

- Marrjen e masave për paisjen e punonjësve të guzhinës me libreta shëndetësore të rinovuara, si dhe plotësimin periodik të kartelave mjeksore të paraburgosurve sipas parametrave të kontrollit shëndetësor, me qëllim ofrimin e një shërbimi shëndetësor sipas standarteve të kërkuara;

- Marrjen e masave për vendosjen e dymëve në ambientin e tualeteve dhe dusheve, vendosjen e një frigoriferi në shërbim të nevojave të paraburgosurve, si dhe lmyerjen dhe paisjen e shesh-ajrimit me tendën mbrojtëse;

- Instalimin e sistemit të ngrohjes dhe sistemit të ventilimit të ajrit në qeliet e këtij institucioni që ndodhen nën nivelin e tokës, me qëllim përmirësimin e kushteve gjatë qëndrimit të paraburgosurve në këto qeli, si dhe etiketimi i vakteve ushqimore përgjatë afatit të ruajtjes së tyre.

16- Çështje e filluar me inisiativë në I.E.V.Penale Rrogozhinë **nr. doc. 201101122**

Jemi informuar nga punonjës të I.E.V.P Rrogozhinë se kërkohen një sërë të dhënash për ekzekutimin ligjor dhe financiar të tyre, në lidhje me përfundimin e shpërblimit mbi pagën për demtim shëndeti, konform me kuadrin ligjor ekzistues. Në bazë të një urdhrit të brendshëm nga ky institucion mbi bazën e rekomandimit dërguar drejtuesve të këtij institucioni, është përfituar masa prej 5% shtese mbi pagën e punonjësve të administratës.

Përgjatë inspektimeve të pasuara me rekomandime mbi problematikat e konstatuara gjatë vitit 2011, shumë institucione i janë përgjigjur

rekomandimeve dhe kanë kontribuar në realizimin e zgjidhjeve të tyre, ndonëse disa herë në mënyrë të pjesshme.

1-Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, në përgjigje të rekomandimit për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e femrave dhe të miturve në I.E.V.Penale 313, shprehet se, lidhur me infrastrukturen jashtë standarti në këtë institucion, projekti për investimin e ri është në fazë tenderimi. Kanë realizuar dizenfektimin periodik, lyejen e krevateve, zëvendësimin e mjeteve akomoduese me të reja, si dhe kanë vënë 4 ventilatorë dhe pritjet paisja me mjete logjistike.

2-Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, lidhur me rekomandimin për trajtimin dhe kushtet e të paraburgosurve në I.E.V.Penale Kukës, shprehet se lidhur me krijimin e një ambjenti takimi me familjarët, do të kryhet rakordimi me Policinë e Shtetit dhe procedurat e nevojshme për projektimin dhe planifikimin e fondeve. Është realizuar zhvendosja e aparatit të komunikimit me qëllim ruajtjen e privatësisë, vendosja e dymve në tualete dhe dushe, si dhe rifreskimi i titujve të librave në bibliotekën e këtij institucioni. Gjithashtu është realizuar aplikimi i stafit shëndetësor për rinovimin e librezave shëndetësore, si dhe për sistemin ngrohës është hartuar detyra e projektimit dhe pritjet shpallja e tenderit për realizimin e këtij investimi.

3- Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, lidhur me rekomandimin për të gjitha problematikat e konstatuara në I.E.V.Penale Tropojë, shprehet se punimet për ambjentet e reja do të realizohen brenda pak muajsh. Në lidhje me mjetin e transportit për të paraburgosurit, me miratimin e buxhetit për vitin 2012 dhe planifikimin e fondeve për “Mjete Transporti”, do të parashikohet paisja e institucionit me një mjet transporti me elementë sigurie. Është propozuar nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve për strukturën shtesë në këtë institucion, por nuk ka përfunduar procedura e miratimit.

4-Drejtuuesi i Spitalit Psikiatrik Shkodër, lidhur me rekomandimin për problematikat e konstatuara në Spitalin Psikiatrik Shkodër, shprehet se gjendja aktuale e godinës së re është në fazën përfundimtare dhe pritjet transferimi në godinën e re brenda një kohe të shkurtër. Është realizuar furnizimi me të gjitha medikamentet e munguara, si dhe mendohet se së shpejti do të kryhen trajnime të herë pas herëshme për stafin kujdestar.

5-Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve, lidhur me shqetësimet e ngritura nga të dënuarat femra në I.E.V.Penale 325, sqaron se nuk ka ndonjë parashikim afat-shkurtër për lëvizjen dhe zhvendosjen e të dënuarave femra apo stafit të I.E.V.Penale 325, për 2-3 vitet e ardhëshme, pasi edhe nëse

investimi do të fillojë në vitin 2012, përfundimi i tij do të kërkojë minimumi 2(dy) vjet kohë

6-Drejtorja e Pergjithshme e Burgjeve, ne pergjigje te rekomandimit tone për I.E.V.Penale 325, regjimi i grave, shprehet se lidhur me shtimin e personelit të sigurisë po punohet nga Drejtorja e Policisë në kuadër të rishikimit të organikave. Për sa i përket sigurimit të një ndarje më të mirë të niveleve të sigurisë në këtë institucion, infrastruktura e I.E.V.Penale 325, nuk mundëson ndarje të sigurisë për të dënuarit.

7-Ministria e Punës,Çeshtjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta, lidhur me problematikat e hasura në Qendrën Kombëtare Pritëse të Viktimave të Trafikut në Linzë Tiranë, ne pergjigje te rekomandimit drejtuar asaj, shprehet se është realizuar miratimi i fondeve për rikonstruksionin e godinës ekzistuese, si dhe janë marrë masat për regjistrimin e 3 (tre) të miturve në sistemin arsimor. Është realizuar paisja me veshmbathjet e munguara për personat e strehuar në këtë qendër.

8-Drejtorja e Pergjithshme e Burgjeve, lidhur me problematikat e konstatuara në I.E.V.Penale 313, në Regjimin e të Miturve, ne pergjigje te rekomandimit tone, shprehet se është realizuar lysterja e ambienteve për të mitur dhe rregullimi i defekteve të dusheve brenda datës 10.06.2011, është paisur çdo qeli me kosha mbeturinash dhe mjete ventiluese. Gjithashtu, për paisjen e qelive me mjete akomoduese të reja, do të shfrytëzohen krevatet metalike që janë gjendje në I.E.V.Penale 313, ndërsa do të furnizohen nga magazinat e DPB me komodina, batanije, çarçafë etj.

9-Drejtorja e Pergjithshme e Burgjeve, lidhur me problematikat e konstatuara në Qendrën Spitalore të Burgjeve në Tiranë, ne pergjigje te rekomandimit tone, shprehet se ka përfunduar lysterja e dhomave të pacienteve në sektorin femra dhe meshkuj, si dhe është vënë në prioritet marrja e masave për rikonstruktimin e dhomave në ambientin e femrave për eliminimin e lagështirës. Për rastet me mjekim stomatologjik ofrohet asistencë në ambientet e I.E.V.Penale 325, si dhe do të shihet si mundësi hartimi i strukturave të reja në organikë për stafin rehabilitues në vitin 2012. Lidhur me masat mbrojtëse të stafit shëndetësor për rastet infektive, do të hartohet një udhëzim i posaçëm, si dhe nga DPB-ja është kërkuar rishikimi i përcaktimit të kriterëve në lidhje me zbatueshmërinë e Memorandumit midis Ministrisë së Drejtësisë dhe Ministrisë së Shëndetësisë.

10-Drejtorja e Pergjithshme e Burgjeve, lidhur me trajtimin financiar të personelit në I.E.V.Penale Rrogzhinë, për shpërblimin mbi pagën për dëmshëndetin, shprehet se me urdhrin nr 5835/2, datë 06.12.2010, të Ministrisë së Drejtësisë, punonjësit që kanë përfituar dëmshmeri shëndeti

janë 2(dy) veta në masen 5%. Për punonjësit e tjerë pritet konfirmimi për pagesën e dënshëndetit.

2. Njësia për Parandalimin e Torturës në kryerjen e veprimtarisë monitoruese në burgje dhe paraburgime

Sipas referimeve në legjislacionin tonë, brenda termit administratë publike janë të përfshira edhe institucionet shtetërore që mbulojnë sistemin penitenciar (burgjet dhe paraburgimet). Brenda këtyre institucioneve, individit gëzon realisht statusin e personit të privuar nga liria. Kjo kategori e ambjenteve të mësipërme është konsideruar dhe trajtuar gjatë vitit 2011 si objekt monitorimi të punës tonë.

Gjatë vitit 2011 janë trajtuar ankesa e kërkesa nga persona ku përfshihen të burgosur, familjarë të tyre apo personel i administratës së burgjeve për çështje që lidhen me administratën dhe trajtimin e të paraburgosurve dhe të dënuarve në I.E.V.P.

Problematikat e sistemit penitenciar dalë nga ankesat dhe konstatimet e kryera gjatë inspektimeve në vitin 2011.

1. Gjatë vitit 2011 shumë prej burgjeve dhe paraburgimeve në vend vijnë të vuajnë nga probleme të amortizimit dhe kushteve të papërshtatshme të tyre, veçanërisht të lagështirës (Burgjet 325 Tiranë, Rogozhinë, Tepelenë, Lezhë, Kosovë e Lushnjes, Burrel, Paraburgimet Berat, Sarandë, 313 dhe 302 Tiranë), mungesës së ujit, sidomos gjatë periudhës së verës (Burgjet Rogozhinë, Krujë), kushteve jashtë standarteve të tualeteve, dusheve, ambienteve të ajrimit, dhomave të izolimit, mungesës së ambjenteve të edukimit, ushtrimit të rriteve fetare, veprimtarisë sportive etj (Burgjet Burrel, Lezhë, Tepelenë, Kosovë e Lushnjes dhe Paraburgimet Sarandë, Berat, 313 dhe 302 Tiranë). Ne insistojmë të mbyllet burgu i Burrelit, të transferohen të sëmuret mendore nga Burgu Krujë, në një institucion të specializuar shëndetësor, sepse nuk plotësojnë standartet përkatëse. Gjatë inspektimeve dhe ri-inspektimeve të kryera gjatë vitit 2011, ne te gjitha keto institucione është perseritur nevoja urgjente për investime kryesisht të pjesshme që do të përmirësojnë ndjeshëm kushtet ekzistuese. Keto probleme janë adresuar pranë Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve.

2. Një nga problematikat kryesore që vijon të mbetet shqetësuese për

Avokatin e Popullit është mosgjatja e një zgjidhjeje përfundimtare për strehimin në një ambient spitalor jashtë sistemit të burgjeve të personave që kanë marrë masë nga gjykata për mjekim të detyruar me gjithë hapjen e një sektori të veçantë në paraburgimin e Durrësit. Avokati i Popullit e ka ngritur çdo vit këtë çështje dhe nuk është pajtuar me situatën në të cilën ende këta persona mjekohen brenda ambienteve të sistemit të burgjeve. Gjatë vitit 2011 kemi vënë në dijeni se nga ana e Ministrisë së Shëndetësisë po merren masat që të kalojë në administrimin e tyre Burgu Krujë, apo të ndërtojnë një institucion të veçantë për të trajtuar këta persona sipas ligjit, ashtu siç ka rekomanduar edhe Avokati i Popullit, zgjidhje kjo e konsideruar si jo e pershtatshme nga ana e institucionit tone për pozicionin gjeografik dhe amortizimit total të këtij burgu.

3. Një problem tepër serioz që vazhdon të ngrihet në mjaft komunikime konfidenciale me të denuarit dhe paraburgosurit është ai i korrupsionit në segmente të administratës së burgjeve. Ky korrupsion ka bërë që të pretendohet për cenim të rëndë të të drejtave dhe trajtimit të individëve brenda këtyre institucioneve. Avokati i Popullit megjithatë është përpjekur të verifikojë disa raste të denoncuar për korrupsion, e ka patur mjaft të vështirë të mundesoje zbardhjen e së vertetës. Nisur nga gjetja periodike e sendeve të ndaluara në qeli të veçanta, apo nga trajtimi i pabarabartë që ju bëhet disa të denuarve dhe paraburgosurve në vend, në mënyrë indirekte lihet të kuptohet se korrupsioni në sistemin penitenciar është prezent dhe përben kërcënim për mbarevajtjen e trajtimit të të drejtave të individëve të denuar ose të paraburgosur.

4. Gjatë vitit 2011 shërbimi shëndetësor në sistemin penitenciar u konstatua se kreu me përmirësime të dukshme aktivitetin e tij. Por në disa raste u vënë re mangësi, kryesisht në mungesën e ilaçeve të trajtimit të patologjive jo të zakonshme, mjeteve të transportit (ambulanca) në disa burgje, në mungesën e shtimit të personelit mjekësor të specializuar, në moskrijimin e ambienteve optimale të shërbimit shëndetësor, etj.

5. Vijon të mbetet problem edhe gjatë vitit 2011, llogaritja e kohës së paraburgimit të të denuarve të ekstraduar nga shtete të tjera, gjithashtu dhe qëndrimi në këtë rregjim edhe mbasi vendimet gjyqësore kanë marrë formë të prerë. Në këtë drejtim është kërkuar nga të denuarit që ndaj tyre të zbatohen kërkesat e nenit 57, të K.Penal, ku 1 ditë paraburgim t'u njihet e barabartë me 1 ditë e gjysëm burgim.

6. Megjithatë hapjen e institucioneve të reja të vuajtjes së dënimit dhe konsolidimit të funksionimit të Shërbimit të Proves, mbipopullimi vijon të mbetet një problem kryesor në burgje dhe sidomos në paraburgime. Avokati i Popullit e ka nënvizuar shpesh rëndësinë e uljes së numrit të të

denuarve ne keto institucione, duke respektuar standartet e hapesires per jetese.

7. Eshte konstatuar se burgjet dhe paraburgimet ne vend nuk plotesojne kushtet minimale per te strehuar dhe per te trajtuar persona me aftesi te kufizuar. Rast perjashtimor jane vetem kushtet qe ofrohen ne Qendren Spitalore te Burgjeve Tirane dhe se fundmi seksioni i veçante ne Paraburgimin e Durresit. Ky konkluzion ka dale per shkak te mungeses se personelit per t'ju pergjigjur te gjitha nevojat e kesaj kategorie personash, si dhe mungeses se pajisjeve per te mundesuar nje trajtim sa me te pershtatshem te paaftesise se tyre. Ne keto kushte del si detyre emergjente qe Drejtoria e Pergjithshme e Burgjeve te mundesoje blerjen e pajisjeve te posaçme dhe shtimin e personelit per te trajtuar sipas standarteve kete kategori sidomos ne seksionin e veçante te Paraburgimit Durres.

Inspektime me inisiative 2011

1. Paraburgimi 313 Tirane dok. 201101855

Nga inspektimi në këtë institucion konkludam me këto rekomandime:

1. Mbajtjen në konsideratë dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të konstatuara në Institucionin e Paraburgimit 313 Tiranë;

2. Paisja e dentistit të institucionit me mjetet e domosdoshme të punës në mënyrë që të realizohet shërbimi dentar në institucion.

3. Paisjen e këtij Institucioni me ambulancë të përshtatshme si mjetin e domosdoshëm të transportit të të semureve.

4. Marrjen e masave për riparimin sa më të shpejtë të banjove të sektorëve të izolim-observim etj, duke riparuar rrjedhjen e ujrave të zeza nga tubacionet e prishura, kokat e dusheve, ndriçuesat dhe lidhjet elektrike brenda standarteve të sigurimit teknik.

5. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e lagështirës dhe lyerjen e njollave të saj në ambjentet e përbashkëta të institucionit dhe sidomos në sektorin 3/3.

6. Marrjen e masave të menjëhershme për plotësimin e dhomave të tranzitit dhe të veçimit me rrobat e domosdoshme të fjetjes (dysheke, çarçafe, jasteke, batanie) dhe lyerjen periodike të tyre.

7. Marrjen e masave per krijimin e kushteve të përshtatshme të ajrosjes sipas parashikimeve të Rregullores së Pergjithshme të Burgjeve.

8. Marrjen e masave të menjëherëshme për përdorimin e uniformave, dorezave, gjatë shperndarjes së ushqimit për te paraburgosurit, si dhe

kontrollin e vazhdueshëm nga ana e personelit përgjegjës të normave të ushqimit në vakte.

Ne pergjigje te Rekomandimit te Avokatit te Popullit lidhur me permiresimin e kushteve dhe trajtimit ne Paraburgimin 313, Tirane D.P.Burgjeve pranoi konstatimet tona dhe na informoi se jane duke u marre te gjitha masat per riparimet dhe permiresimet e konstatuara.

2. I.E.V.P Krujë nr. dok. 201100609

Nga organizimi i disa inspektimeve dhe vizitave të kryera nga Zyra e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2011 konstatuam një sërë problemesh, të cilat janë prezantuar me rekomandimet e mëposhtme:

1. Të planifikohen dhe sigurohen fonde për rikonstrukcionin sa më të shpejtë të disa elementeve kryesorë të godinave të burgut, tejet të amortizuar, për të eliminuar lagështirën në dhoma, në ambientet dusheve dhe tualeteve dhe për të krijuar kushte të përshtatshme jetese për të dënuarit kryesisht me probleme shëndetësore dhe të moshuar.

2. Marrjen e masave urgjente për eliminimin e telave të ekspozuar dhe përmirësimin e kushteve në dushe, gjithashtu adaptimin e banjove sipas standardit për të paralizuarit dhe krijimin e kushteve logjistike që t'i sigurohet ajrimi sipas rregullores.

3. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të higjienës në kuzhinë, duke përdorur dorashka dhe uniforma gjatë shpërndarjes së ushqimit, si dhe sigurimin e ruajtjes së kampionëve të vakteve të ushqimit në kushte frigoriferike .

4. Marrja e masave për përmirësimin e furnizimit me një ujë të institucionit dhe vendosjen në ruajtje të depozitave të ujit.

5. Pajisjen e institucionit me një ambulancë të përshtatshme me parametra normal për të transferuar të sëmurët dhe sigurimin e shërbimit me oksigjen.

6. Planifikimin dhe sigurimin e fondeve për adaptimin e ambienteve të paraburgimit, (tashmë të transferuara) në ambiente të një pavioni të veçantë spitalor, ku të mundësohet shtrimi dhe mbajtja nën observacion e të sëmurëve me mjekim të detyruar.

7. Përgatitjen e propozimeve përkatëse pranë Qeverisë për përmirësimin e infrastrukturës rrugore që mundëson lidhjen e këtij burgu me qytetin e Krujës.

8. Planifikimin dhe sigurimin e fondeve për ndërtimin e një linje sekondare të furnizimit të institucionit me energji elektrike.

9. Planifikimin dhe sigurimin e fondeve për adaptimin e ambienteve të institucionit me mundësi infrastrukturore për lëvizje të lirë të karrigeve me rrota për të sëmurë të pamundur (me aftësi të kufizuara lëvizjeje).

10. Marrja e masave për vendosjen e hidratantëve kundër zjarrit në çdo kat dhe riparimin e disa pajisjeve në lavanderi dhe kuzhinë.

D.P.Burgjeve pasi u njoh me rekomandimin e Avokatit të Popullit na bën me dije se: Lidhur me planifikimin dhe sigurimin e fondeve për rikonstrukcionin e I.E.V.P Kruje do vendoset se afermi, pasi është në diskutim kalimi i këtij institucioni Ministrise së Shëndetsise dhe transformimi i tij në një spital psikiatrik të veçantë.

3. I.E.V.Penale Rrogozhinë nr. dok. 201100148

Nga organizimi i disa inspektimeve dhe vizitave të kryera nga zyra e Avokatit të Popullit gjatë vitit 2011 konstatoi një sërë problemesh, të cilat janë prezantuar me rekomandimet e mëposhtme:

1. Mbajtjen në konsideratë dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të konstatuara në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogozhinë;

2. Plotësimin e organikës me mjek me kohë të plotë në Insitucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Rrogozhinë, në raport me kërkesat dhe numrin e të dënuarve që strehon ky insitucion;

3. Planifikimin dhe sigurimin e fondeve për të rikonstruktuar qelitë, paradhomat dhe banjot përgjithësisht, por në mënyrë urgjente në sektorin e veçimit për të eliminuar lagështirën dhe ato mangësi infrastrukturore që përbëjnë mospermbushje serioze në trajtimin human dhe jo degradues për të dënuarit e këtij seksioni.

4. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e shtrirjes së telave dhe kabllave dhe lidhjeve elektrike jashtë kushteve të sigurimit teknik në dhomat e të dënuarve.

5. Planifikimin dhe sigurimin e fondeve për plotësimin e bazës materiale edukative-sportive dhe krijimin e kushteve për një zhvillim normal të aktiviteteve rekreative për seksionet e ndryshme të institucionit.

6. Marrjen e masave për përshtatjen e ambjenteve të takimit të të paraburgosurve me familjarët sipas standartit të kërkuar nga Rregullorja e Përgjithshme e Burgjeve.

7. Paisjen e lavanderisë së institucionit me lavatriçe industriale dhe vënien në efikasitet të këtij shërbimi.

D.P.Burgjeve pasi u njoh me rekomandimin e Avokatit të Popullit, bën me dije se: Lidhur me planifikimin dhe sigurimin e fondeve për rikonstrukcionin e qelive të I.E.V.P. Rrogozhinë, do investojë në

rikonstrukcionin e këtij institucioni fondet e investimit 2012. Gjithashtu janë marrë masa të menjëhershme brenda pak muajve, lidhur me eliminimin e shtrirjes së telave dhe kabllove në dhomat e të burgosurve, eliminimin e lagështirës në dhomat e veçimit dhe riparimin e lavatriçes industriale të institucionit.

4. I.E.V.Penale Durrës nr. dok. 201100981

Pas inspektimit në këtë institucion, i rekomandua I.E.V.Penale Durrës dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve, sa më poshtë vijon:

- Lëvrimin e fondeve për kryerjen e investimeve për të mundësuar sa më parë përshtatjen e seksionit të veçantë sipas parametrave mjekësor dhe atyre të sigurisë;

- Vënien në punë të dhomave të observimit dhe takimeve me familjarët për të denuarit në seksionin e veçantë;

- Marrjen e masave për miratimin e një organike të re për personelin e specializuar mjekësor të cilët do shërbejnë në seksionin e veçantë sipas protokolleve mjekësore në këtë fushë;

- Marrjen e masave urgjente për riparimin e dhomave të veçimit në institucion, duke i risjellë këto ambiente në parametrat e parashikuar në Rregulloren e Brendshme të Burgjeve.

- Planifikimin e përgjithshëm të fondit të blerjes së ushqimeve të institucionit, duke parashikuar edhe të denuarit që strehohen tranzit në ambientet e IEVP. Durrës.

Në përgjigje të “Rekomandimeve për përmirësimin e kushteve dhe trajtimin e të paraburgosurve në Institucionin e Ekzekutimit Vendimeve Penale Durrës”, D.P.Burgjeve na informoi se:

Rekomandimet janë marrë në konsideratë, janë analizuar, dhe me plane pune është planifikuar realizimi i tyre.

5. I.E.V.P. Fushë-Krujë nr. dok. 201100632

Nga inspektimi në këtë Institucion, i rekomandua Drejtorit të I.E.V.P Fushë Krujë dhe Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve si më poshtë vijon:

1. Mbajtjen në konsideratë dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të konstatuara në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Fush-Krujë duke filluar me evitimin e mbipopullimit.

2. Plotësimin e organikës së institucionit me personelin mjekësor të domosdoshëm.

3. Plotësimin e inventarit të farmacisë së institucionit me ilaçe si ato të përgjithshmet ashtu dhe ato të urgjencës.

4. Plotësimin e inventarit të sektorit të stomatologjisë me medikamente dhe lëndën e domosdoshme për këtë shërbim përfshirë dhe autoklavën.

5. Marrjen e masave të nevojshme për instalimin dhe vënien në punë të aparaturës së ECG-së dhe paisjen e ambulancës me aparaturën e oksigjenit.

6. Marrjen e masave për plotësimin me rigorozitet të kartelave mjeksësore duke përmirësuar përshkrimin e shërbimeve mjekësore.

7. Marrjen e masave të nevojshme për riparimin dhe eliminimin e njollave të lagështirës në mure, dhe rrjedhjeve të ujit në mure në sektorë.

8. Marrjen e masave të nevojshme që sektori i edukimit të dokumentojë dhe administrojë me përgjegjësi marrjen e ankesave nga të denuarit dhe të plotësojë inventarin e bibliotekës dhe bazën materiale sportive.

9. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e ekspozimit të telave dhe kabllave jashtë kushteve të sigurimit teknik në dhomat e të dënuarve në përgjithësi dhe në sektorin e trajtimit të sëmurëve mendorë në veçanti.

10. Marrjen e masave për shpalljen e listave të çmimeve të ushqimeve në sektorët e paraburgimit dhe sigurisë së zakonshme të institucionit.

11. Marrjen e masave për lejimin e të dënuarve të komunikojnë në telefon me familjarët edhe pasditeve, kohe kjo e përshtatshme për disponibilitetin e familjarëve.

12. Marrjen e masave të menjëhershme për përdorimin e uniformave, dorezave, në shpërndarjen e ushqimit për të burgosurit në institucion.

13. Marrjen e masave për etiketimin e kampionëve të ushqimit sipas vakteve dhe mbajtjen e tyre në ambjent frigoriferik dhe vendosjen në funksion të lavastoviljes në kuzhinë.

14. Marrjen e masave që kontrolli i ushqimeve nga ana e policisë së burgut të bëhet duke përdorur dorashka.

15. Marrjen e masave për riparimin sa më të shpejtë të lavamanëve të dëmtuar, sigurimin e ujit të ngrohtë dhe lysterjen e dhomave në sektorët e paraburgimit dhe sigurisë së zakonshme.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në përgjigje të Rekomandimit tone na informoi se vazhdimisht është përpjekur të minimizojë problemet që lidhen me kushtet e jetesës për të burgosurit, si dhe në trajtimin e tyre duke bashkëpunuar në vazhdimësi me institucione dhe organizata të ndryshme jo qeveritare, për zgjidhjen e këtyre problemeve duke e pasur në konsideratë edhe bashkëpunimin me Institucionin e Avokatit të Popullit.

6. I.E.V.P Vaqarr nr. dok. 201100035, 201100711

Nga inspektimi në këtë Institucion i rekomandum Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve si më poshtë vijon:

1. Plotësimin e inventarit të ndihmës së shpejtë më medikamente dhe lëndën e domosdoshme për këtë shërbim.

2. Marrjen e masave të nevojshme për riparimin dhe eliminimin e njollave të lagështirës në mure, lysterjen dhe mirëmbajtjen e korridoreve të sektorëve si dhe në ambjentet e takimit të të dënuarve me familjarët.

3. Marrjen e masave të nevojshme që sektori i edukimit të dokumentojë dhe administrojë me përgjegjësi marrjen e ankesave nga të dënuarit dhe të pasuroje me programe të reja kompjuterat, inventarin e bibliotekës dhe bazën materiale sportive.

4. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e ekspozimit të telave dhe kabllave jashtë kushteve të sigurimit teknik në dhomat e takimeve të veçanta.

5. Marrjen e masave për shpalljen e listave të çmimeve të ushqimeve në sektorët e paraburgimit dhe sigurisë së zakonshme të institucionit.

6. Marrjen e masave të menjëhershme për përdorimin e uniformave, dorezave, në shpërndarjen e ushqimit për të burgosurit në institucion.

7. Marrjen e masave për etiketimin e kampionëve të ushqimit sipas vakteve dhe mbajtjen e tyre në ambjent frigoriferik.

8. Marrjen e masave për zvendësimin e hidrantëve të shuarjes së zjarrit që kane tejkaluar afatin e skadencës.

9. Marrjen e masave për krijimin e një dhome me ambiente miqësore për femijët për takimet e të dënuarve me familjarët.

10. Marrjen e masave për krijimin e kushteve të përshtatshme të ajrosjes dhe paisja e këtij ambjenti me tenda mbrojtëse në mënyre që të behet e frekuentueshme dhe në stinën e nxehtë të verës.

Rekomandimi u pranua nga DPB, e cila ka filluar zbatimin e rekomandimit.

Avokati i Popullit është njoftuar më datë 16.01.2011, për një grevë urie që po kryhej nga një grup të dënuarish në Burgun Vaqarr Tiranë. Në vijim të kësaj situate, në rolin e Mekanizmit Kombëtar të Parandalimit të Torturës, Trajtimit Çnjerëzor dhe Degradues, Institucioni ynë dërgoi më datë 17.01.2011 një grup pune për të verifikuar në vend pretendimet e të dënuarve. Krahas mbledhjes që është zhvilluar me autoritetet drejtuese të Burgut Vaqarr për situatën e mësipërme, grupi inspektues kryeu edhe një takim ballafaques me një pjesë të të dënuarve që kishin refuzuar ushqimin, duke marrë prej tyre një sërë të dhënash mbi problematikat që i shqetësonin si dhe iu dhanë shpjegime të hollësishme mbi legjislacionin që normon të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve.

Grupi inspektues ka kontrolluar dhe verifikuar dhe nëpërmjet stafit të burgut të gjitha pretendimet e parashtruara nga të dënuarit. Në përfundim të kësaj procedure ka rezultuar se disa prej ankesave të të dënuarve janë të drejta, dhe ato kërkojnë ndërhyrje nga autoritetet e Burgut Vaqarr dhe nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve.

Konkretisht konstatimet e Avokatit të Popullit për këto rast janë si vijon:

1. Kërkesa kryesore e të dënuarve kishte të bënte me ndërprerjen e lejeve shpërblyese nga Drejtoria e Burgut Vaqarr, për një periudhë kohore të pacaktuar sipas një urdhëri të Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve. Të dënuarit kërkonin sqarime lidhur me këtë urdhër dhe pretendonin se po privoheshin nga një e drejtë e ligjshme. E drejta e të dënuarve me burgim për të kërkuar leje shpërblyese ose të veçantë dhe kriteret për të përfituar, përcaktohen në nenet 59 dhe 60, të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998, i ndryshuar. Sipas dispozitave të këtij ligji, mosdhënia e lejeve shpërblyese motivohet vetëm si mase disiplinore, në përputhje me shkronjen “dh” të nenit 53, si dhe në rastet e një shtate të jashtëzakonshme. Në rast refuzimi, i dënuari mund të ankohet në gjykatë, e cila vendos për kërkesën për dhënien e lejes. Për këtë arsye, duke qenë se kërkesa dhe refuzimi i lejeve shpërblyese përshkruhet në ligj si një e drejtë e bazuar dhe e shoqëruar me akte proceduriale duhet të gjendet një formë zyrtare transparente për të shpallur qëndrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve lidhur me kushtet e pezullimit të përkohshëm të lejeve shpërblyese, duke dhënë në çdo rast edhe arsyet ligjore të një veprimi të tillë.

2. Burgu Vaqarr prej shumë kohësh ka bërë përpjekje për përmirësimin e një sërë ambjentesh të amortizuara. Ndërhyrjet me investime kanë qenë të pjesshme dhe nuk janë përfunduar tërësisht. Të gjitha këto investime të kryera janë bërë shkak që Burgu Vaqarr të prezantojë një situatë të përmirësuar shërbimi, por jo të mjaftueshme për respektimin e plotë të të drejtave dhe trajtimit human të të dënuarve.

3. Burgu Vaqarr duhet të kujdeset për përmirësimin e kushteve të takimit të të dënuarve me familjarët. Ambjenti i takimit me familjarët është shumë i vogël, dhe nuk ka ndarje për secilin të dënuar dhe familjarët qendrojnë në këmbë pasi mungojnë karriget apo stolat. I dënuari është i pamundur të kryejnë një bisedë konfidenciale me familjarët pasi në një ambjent shumë të vogël kryejnë takime tre të dënuar njëherazi. Një situatë e tillë është në kundërshtim me nenet 41, 59, të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, në të cilat përcaktohet konfidencialiteti i takimeve me përfaqësuesit ligjorë dhe familjarët.

4. Nisur dhe nga ankesat e të dënuarve, Burgu Vaqarr duhet të marrë masa për të përmirësuar cilësinë e ushqimit dhe mënyrën e shpërndarjes së tij tek të dënuarit. Duhet të zbatohen masa të tilla higjene si pajisja e shpërndarësve të ushqimit me dorashka sterile dhe uniformë guzhine, blerja e enëve të reja të shpërndarjes së ushqimit, si dhe sigurimin e larmisë së përbërjes së vakteve.

5. Duhet marrë masa të menjëhershme për përmirësimin e shërbimit të shitjes dhe funksionimit të dyqanit në plotësimin e kërkesave të të dënuarve, pasi sipas pretendimit të të dënuarve ky shërbim nuk funksionon rregullisht dhe të dënuarit duhet të presin një herë në javë për të porositur materiale dhe produkte konsumi.

Në përfundim të konstatimeve të mësipërme, Avokati i Popullit rekomandoi:

- Marrjen e masave emergjente në përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve në Burgun Vaqarr Tiranë me anë të investimeve dhe blerjeve të reja në këtë institucion.

- Sigurimin e një mënyre transparente për të shpallur qëndrimet e Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve lidhur me kushtet e pezullimit të përkohshëm të lejeve shpërblyese duke dhënë në çdo rast edhe arsyet ligjore të një veprimi të tillë ndaj çdo të dënuari.

D.P.Burgjeve pranoi rekomandimin duke rivendosur dhënien e lejeve sipas kriterëve.

7. I.E.V.P. Sarande nr. dok. 01100762

Nga inspektimi në këtë institucion, konkludua në këto rekomandime:

1. Plotësimin e organikës së institucionit me personel mjeksor me kohë të plotë si domosdoshmëri për një shërbim shëndetsor sipas standarteve.

2. Plotësimin e inventarit të farmacisë së institucionit me ilaçe si ato të përgjithshmet, ashtu dhe ato të urgjencës.

3. Marrjen e masave për plotësimin me rigorozitet të kartelave mjeksore duke përmirësuar përshkrimin e shërbimeve mjeksore dhe krijimin e regjistrit të vizitave mjeksore ditore.

4. Plotësimin me staf mjeksor stomatolog qoftë dhe me kohë të pjesshme.

5. Paisjen e sektorit të stomatologjisë me personelin dhe paisjet materiale bazë për mbushje dhe mjekime dhëmbësh, në mënyrë që të realizohet shërbimi dentar në institucion.

6. Marrjen e masave për zgjerimin dhe krijimin e hapësirave shtesë për dyfishimin e duшеve dhe banjove dhe riparimin sa më të shpejtë të ambjenteve ekzistuese.

7. Marrjen e masave për krijimin e ambjenteve të përshtatshme për shërbime kulturi dhe aktiviteteve të ndryshme kulturore.

8. Marrjen e masave për zgjerimin dhe krijimin e kushteve të përshtatshme të ajrosjes për të paraburgosurit.

9. Planifikimin e fondeve për fillimin e rikonstruksionit të elementeve kryesore të godinës së paraburgimit, për të krijuar kushte të përshtatshme jetese për të paraburgosurit.

D.P. Burgjeve u përgjigj pozitivisht duke marrë në konsideratë rekomandimet tona lidhur me plotësimin e kushteve të jetesës dhe planifikimin e fondeve për krijimin e ambjenteve të reja të ajrimit.

8. I.E.V.P Tepelene nr. dok. 201100713

Pas inspektimit në këtë institucion rekomanduam:

1. Plotësimin e organikës së institucionit me mjek dhe stomatolog me kohë të plotë si domosdoshmëri për një shërbim shëndetësor sipas standarteve.

2. Plotësimin e inventarit të farmacisë së institucionit me ilaçe si ato të përgjithshmet ashtu dhe ato të urgjencës.

3. Marrjen e masave për plotësimin me rigorozitet të kartelave mjeksore duke përmirësuar përshkrimin e shërbimeve mjeksore.

4. Paisjen e sektorit të stomatologjisë me paisjet bazë si turbina, autoklava, llampa e polimerizimit si dhe materiale për mbushje dhe mjekime në mënyrë që të realizohet shërbimi dentar në institucion.

5. Paisjen e këtij Institucioni me ambulance si mjetin e domosdoshëm të transportit të sëmurëve.

6. Marrjen e masave për eliminimin lagështirës dhe mirëmbajtje strukture në muret e godinës.

7. Marrjen e masave për riparimin sa më të shpejtë të kokave të dusheve në banjot e përbashkëta në sektor dhe heqjen e menjëhershme të zgarave të hekurit në kabinat e dusheve.

8. Marrjen e masave për përdorimin e uniformave, dorezave, në shpërndarjen e ushqimit për të denuarit.

9. Marrjen e masave për etiketimin e kampionëve të ushqimit sipas vakteve në ambjentin frigoriferik.

10. Marrjen e masave për krijimin e ambjenteve të përshtatshme për guzhinën e institucionit dhe kompletimin e saj me paisje gatimi industriale sipas standartit.

11. Nxitjen e bashkëpunimit me institucionet lokale për rehabilitimin e rrugës lidhëse të institucionit me rrugën automobilistike.

DPBurgjeve pranoi rekomandimet duke na vënë në dijeni se po bëhen përpjekje për plotësimin e sektoreve të shërbimit me personel, plotësimin e inventarit me mjetet e nevojshme dhe riparimet e domosdoshme

9. I.E.V.P. Berat nr. dok. 201100523

Nga inspektimi në këtë institucion rekomanduam:

1. Marrjen e masave për plotësimin e stafit mjekësor me mjek me kohë të plotë.

2. Marrjen e masave për shpalljen dhe përditësimin e listave të çmimeve të ushqimeve në institucion.

3. Planifikimin dhe marrjen e masave për lyerjen me gelqere të ambjenteve të ajrimit dhe dhomave të palyera të të paraburgosurve.

4. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të higjienës në guzhinë, duke përdorur dorashka dhe uniforma gjatë shpërndarjes së ushqimit, si dhe të stafit policor gjatë kontrollit të ushqimeve.

5. Marrjen e masave për sigurimin e frigoriferit të ruajtjes së kampioneve të vakteve të ushqimit.

6. Marrjen e masave dhe planifikimin për paisjen e institucionit me ambulancë për transportin e të dënuarve të semurë.

7. Marrjen e masave për dizinfektimin periodik të ambienteve të këtij institucioni, duke kërkuar prezencën e Inspektoriatit Sanitar Shtetëror sipas ligjit.

10. I.E.V.P. Vlore nr. dok. 201100475

Pas inspektimit në këtë institucion rekomanduam:

1. Paisjen e dentistit me llampen e polimerizimit si mjet i domosdoshme i punës, në mënyrë që të realizohet shërbimi dentar në institucion.

2. Paisjen e këtij Institucioni me ambulance si mjetin e domosdoshme të transportit të sëmurëve.

3. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e lagështirës në muret e godinës.

4. Marrjen e masave për riparimin sa më të shpejtë të kokave të dusheve në banjot e përbashkëta në sektorë.

5. Marrjen e masave të menjëhershme për përdorimin e uniformave, dorezave, në shpërndarjen e ushqimit për të paraburgosurit.

6. Marrjen e masave për etiketimin e kampioneve të ushqimit sipas vakteve në ambjentin frigoriferik.

7. Nxitjen e bashkëpunimit me institucionet lokale për rehabilitimin e rrugës lidhëse të institucionit me rrugën automobilistike.

8. Marrjen e masave për riparimin e kaldajës së ngrohjes qendrore në institucion.

11. I.E.V.P 302 nr. dok. 201100689

Pas inspektimit në këtë institucion rekomanduam:

1. **Mbajtjen në konsiderate dhe zgjidhjen e problemeve të konstatuara ne institucionin e paraburgimit 302 në Tiranë.**

2. Marrjen e masave për krijimin e kushteve të ajrimit të mjaftueshëm si në dhomat e të paraburgosurve ashtu dhe koridoret e rregjimit, duke vendosur zgara hekuri dhe paisje ventilimi.

3. Vendosjen e aparateve telefonik në pozicion të përshtatshëm i cili të garantoje aksesin dhe privatsinë e të drejtës për telefonim të të paraburgosurve me familjet e tyre.

4. Planifikimin dhe sigurimin e fondeve për prishjen e qelive të mbyllura dhe jashtë përdorimit në periferi të objektit dhe përshtatjen e hapsirës së krijuar për ambiente të zgjeruara ajrimi për të paraburgosurit.

12. I.E.V.P Peqin nr. dok. 201100151

Pas inspektimit në këtë institucion, kemi rekomanduam:

1. Mbajtjen në konsideratë dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të konstatuara në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Penale Peqin;

2. Planifikimin dhe sigurimin e fondeve për të përfunduar rikonstruktimin e tualeteve të sektorit të sigurisë së lartë.

3. Marrjen e masave të menjëhershme për sigurimin e shërbimit sanitarë për të denuarit me aftësi të kufizuar me qëndrim afatgjatë në ambulancën e institucionit në mënyrë që të sigurohet një trajtim human dhe jodegradues për të denuarit e këtij seksioni.

4. Marrjen e masave për vendosjen në punë të laboratorit mjekësor dhe aparatures së EKG .

5. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e shtrirjes së telave dhe kablllove dhe lidhjeve elektrike jashtë kushteve të sigurimit teknik në dhomat e të denuarve.

6. Marrjen e masave për venien në punë të ashensorëve në seksione të domosdoshëm për cilësinë e shërbimeve ndaj të denuarve.

7. Plotesimin e disa ambienteve me paisje hidrante kunder zjarrit.

8. Planifikimin dhe marrjen e masave për eliminimin e lagështires lyerjen e mureve riparimin e banjove në sektorin e observim/veçimit.

9. Marrjen e masave të menjëhershme për riparimin e aparateve telefonik ne sektorin A dhe B.

10. Marrjen e masave per sigurimin e ngrohjes dhe ujit te ngrohtë për larje në menyre të barabartë për të gjith të denuarit sipas Regullores së Përgjithshme të Burgjeve.

13. I.E.V.P Lushnje

Pas inspektimit në këtë institucion, rekomanduam:

1. Mbajtjen në konsideratë dhe zgjidhjen e të gjitha problemeve të konstatuara në Institucionin e Ekzekutimit të Vendimeve Kosovë Lushnje;

2. Planifikimin e kohes për fillimin sa me parë të zbatimit te projektit të rikonstruksionit tërësor me qëllim për të eliminuar lagështiren dhe ato mangësi infrastrukturore në institucion.

3. Marrjen e masave për plotësimin e stafit mjekësor me personel me kohë të plotë

4. Marrjen e masave të menjëhershme për eliminimin e ekspozimit të telave dhe kablllove jashtë kushteve të sigurimit teknik në dhomat e takimeve speciale të të denuarve.

5. Marrjen e masave për shpalljen e listave te çmimeve te ushqimeve në sektorin B te institucionit.

6. Marrjen e masave të menjëhershme për riparimin e aparatit telefonik ne sektorin A.

7. Planifikimin dhe marrjen e masave për përmiresimin e paisjeve të fjetjes në dhomat e veçimit.

8. Marrjen e masave të menjëhershme për përmirësimin e kushteve të gatimit në guzhinë dhe sistemimin e bombulave të gazit.

10. Marrjen e masave për sigurimin e frigoriferit të ruajtjes se kampioneve të vakteve të ushqimit.

11. Marrjen e masave për riparimin e kaldajes së ngrohjes qendrore në institucion.

12. Marrjen e masave për sigurimin e ambjenteve të kultit dhe aktiviteteve të tjera të edukimit.

13. Marrjen e masave dhe planifikimin për paisjen e institucionit me ambulancë për transportin e të denuarve të semurë.

14. Marrjen e masave për dizinfektimin periodik të ambienteve të këtij institucioni, me qëllim zhdukjen e brejtësve dhe insekteve, gjë e cila do të ndihmonte në evitimin e ndonjë epidemie të mundshme në sezonin e verës.

Rast hetimi me inisiativë 2011 nr. dok. 201100018

Rast me inisiativë ishte hetimi administrativ në Institutin e Ekzekutimeve Penale 313, gjatë së cilit u hetua lidhur me informacionin se ndaj të paraburgosurit Ardit Skëndaj është ushtruar dhunë fizike nga policia e burgut.

Konkretisht pranë Zyrës së Avokatit të Popullit i paraburgosuri A.S., paraqiti ankesën ku pretendonte se më datë 08.01.2011, rreth orës 13.30 në Burgun nr. 313 Tiranë, ndaj tij është ushtruar dhunë fizike nga punonjësit e Policisë së Paraburgimit.

Në bazë të kësaj ankese, Avokati i Popullit vendosi kryerjen e një hetimi administrativ, procedurë e cila është zhvilluar në datën 11.01.2011 në ambjentet e këtij Burgu.

Në përfundim të administrimit të deklarimeve dhe dokumentacionit përkatës, si dhe pas një analize të përgjithshme mbi këtë ngjarje, Avokati i Popullit konstaton se:

1. Mungesa e raportit të shërbimit për ngjarjen e datës 08.01.2011, bie në kundërshtim me nenin 43, pika 3, të Ligjit nr.10032, datë 11.12.2008 “Për Policinë e Burgjeve“, në të cilën parashikohet se “ Në të gjitha rastet e hyrjeve dhe kontroleve në mjedise, punonjësi i policisë harton një raport, ku jepen arsyet e hyrjes, të kryerjes së kontrollit dhe rezultati i tij“.

2. Dhuna e ushtruar ndaj të paraburgosurit A. S. bie në kundërshtim edhe me nenin 54 pika 1, të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve, në të cilën thuhet se “Personeli i IEVP ndalohet të kryejë ndaj të burgosurit veprime të kundërligjshme, ndëshkime, tortura, trajtime çnjerëzore, poshtruese, diskriminuese si dhe çdo lloj tjetër dhune”.

Në përfundim të konstatimeve të mësipërme, Avokati i Popullit rekomandoi:

1. Analizimn me objektivitet të ngjarjes, marrjen në konsideratë të masave disiplinore ndaj punonjësve të policisë, që kanë kryer shkeljet objekt i rekomandimit të mësipërm.

2. Kjo ngjarje të përgjithësohet me të gjithë efektivat e Policisë së Burgjeve, me qëllim që raste të tilla të mos përsëriten në të ardhmen.

Te gjitha këto rekomandime kanë marë përgjigje nga DPBurgjeve, ku përgjithësisht janë marrë masa për zbatimin e tyre dhe në rastet e pamundësisë për efekt fondesh janë planifikuar ndërhyrje për vitin 2012.

- Inspektim në I.E.V.Penale Burrel nr. dok. 201100592

Nga inspektimi në këtë institucion, paraqitëm këto rekomandime për Drejtorinë e Përgjithshme të Burgjeve:

1. Shtrirjen e sistemit të mbikqyrjes me kamera në mënyrë që të mbulojë të gjithë ambjentet e ajrimit dhe vënien në funksion të kamerave ekzistuese, krijimin e një salle qëndrore monitorimi dhe rregullimin e shkallëve të kullave vrojtuese;

2. Përdorimin e dorashkave nga punonjësit e policisë gjatë kontrollimit të ushqimit të familjarëve. Mbajtjen e kampionëve të ushqimeve në kushte

frigoriferike. Vënia në funksion e sobës së gatimit dhe sistemit të aspirimit në guzhinë. Kontrolli në mënyrë të rregullt i cilësisë së ushqimit;

3. Vendosjen e një frigoriferi të përbashkët në sektorin e sigurisë së lartë për mbajtjen e ushqimeve të të dënuarvë që nuk kanë frigorifer në dhomë;

4. Ndarjen e dhomave të *veçimit* me dhomat e të dënuarve ose vendosjen e tyre në një sektor të veçantë si dhe lysterjen dhe disifektimin e këtyre dhomave;

5. Rregullimin e ambjenteve të dusheve dhe mbulimin e lidhjeve elektrike;

6. Shpalljen e listës së çmimeve të artikujve që shiten në dyqanin e institucionit dhe mbajtjen hapur e dyqanit gjatë javës;

7. Të verifikohen shkaqet e harxhimit të shpejtë të impulsve në aparatet e telefonisë fikse duke bashkëpunuar me Albtelekom sh.a., Filiali Burrel;

8. Të eliminohet lagështia në disa dhoma të sigurisë së lartë dhe të paraburgimit. Të investohet për hidroizolim e tarracës së paraburgimit;

9. Të krijohet një dhomë e veçantë për takimin e të dënuarve me fëmijët e mitur;

10. Të vendosen në çdo sektor hidrantë kundër zjarrit;

11. Të vihet në përdorim lavatriçja profesionale;

12. Të investohet për sigurimin e ngrohjes në sektorin e sigurisë së zakonshme;

13. Të zëvendësohen në kohë barnat e skaduara të emergjencës;

14. Shfrytëzimin e terrenit të jashtëm sportiv për organizimin e veprimtarive të përbashkëta sportive.

Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve në përgjigje ka shpjeguar masat që janë marrë për zbatimin e rekomandimeve, të cilat kanë të bëjnë kryesisht me organizimin e brendshëm të institucionit dhe mund të mbulohen me shpenzimet e vetë institucionit, e informohemi se ato janë zbatuar. Ndërsa për sa i përket çështjes së lagështirës që kërkon fonde investimesh për hidroizolim, pritet të zgjidhet me investimet që janë për vitin 2012.

Inspektim ne I.E.V.Penale Kukës nr. dok. 201101694

Veçanti e Institucionit të Ekzekutimit të Vendimeve Penale Kukës është se ai ndodhet brenda ambjenteve të Drejtorisë së Policisë të Qarkut Kukës, ambjente të cilat administrohen nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve. Ky institucion është inspektuar dy herë gjatë vitit 2011. Në inspektimin e dytë u konstatua se ishin zbatuar pothuaj të gjitha

rekomandimet e lëna. Problem mbetet për tu zgjidhur krijimi i një ambjenti të përshtatshëm për takimin e të paraburgosurve me familjarët.

Inspektim ne I.E.V.Penale “Mine Peza” nr. dok. 201101778

Nga inspektimi në këtë institucion i rekomanduam Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve:

1. Caktimin e një afati për planifikimin e fondeve për zbatimin e rekomandimeve të ngritura;

2. Përmirësimin e gjëndjes duke eleminuar sa më parë mbi popullimin me anë të transferimit të paraburgosurve në I.E.V.Penale nr. 313, Tiranë;

3. Vendosjen e një ndarjeje në dhomat e takimit me familjarët për të krijuar privatësi gjatë bisedës.

Në përgjigje të rekomandimit të dytë, Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve sqaron se, brenda 6 mujorit të parë të vitit 2012, do të planifikohen fondet për zbatimin e rekomandimeve të ngritura. Për uljen e mbipopullimit të paraburgosurve, bazuar në urdhërin e Drejtorit të Përgjithshëm të Burgjeve, janë transferuar 10 të paraburgosur nga ky institucion për në I.E.V.Penale “*Jordan Misja*” dhe pritet të transferohen rreth 10 të paraburgosur të tjerë.

Ankesa dhe kërkesa të paraqitura nga të dënuarit dhe të paraburgosurit.

Nga trajtimi i 58 ankesë-kërkesave kanë rezultuar: 20 raste të pabazuara; 15 raste jashtë juridiksioni dhe jashtë kompetence; 15 raste janë zgjidhur në favor gjatë procesit të shqyrtimit; për 2 raste është bërë rekomandim; 6 raste janë duke u ndjekur.

Objekti i rasteve të ndjekura për vitin 2011 kryesisht ka të bëjë me të drejtat që gëzojnë të burgosurit gjatë vuajtjes së dënimit në institucionet e privimit të lirisë dhe që i drejtohen administratës të burgut ose Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve. Ankesat kanë qenë për përmirësimin e kushteve materiale në burg, për refuzim të padrejtë të kërkesave për leje, për dhënie mase disiplinore të padrejtë, për veprime të kundraligjshme të punonjësve të policisë (dhunë fizike ose psikologjike, veprime poshtëruese, shkleje e privatësisë etj.), refuzim të kërkesës për transferim në një burg tjetër dhe ankesa për shërbimin shëndetësor. Ka pasur edhe kërkesa për të dhënë shërbim ligjor falas, për moskthim përgjigje kërkesës për falje nga Ministria e Drejtësisë, ndaj organit të prokurorisë për mosllogaritje në dënim të kohës së paraburgimit si dhe ankesë për vendimin e gjykatës.

Rekomandimet e bëra pas përfundimit të hetimit të ankesave.

1. Rekomandimi nr. dok. **201100589/5** për transferimin e të dënuarit së bashku me sendet vetjake sipas legjislacionit në fuqi.

Në zyrën e Avokatit të Popullit janë paraqitur disa ankesa nga të dënuar, të cilët janë transferuar në I.E.V.P. të ndryshme. Këta të dënuar u ankuan se disa sende të tyre personale (si frigorifer, televizor, etj.) nuk janë marrë në dorëzim nga grupi i transferim-shoqërimit dhe janë transferuar në institucionin e ri ku ata janë dërguar me shumë vonesë.

Në pretendimet e tyre bëhet e ditur se shpesh sendet personale nuk pranohen të merren nga automjeti shoqërues pasi nuk ka vend. Ndërkohë që I.E.V.P nuk ka një mjet tjetër në dispozicion për një transport të tillë.

Në përgjigjen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve sqarohet se: Janë dhënë udhezimet e nevojshme që këto raste të mos përsëriten. Megjithatë raste të tilla kanë qenë sporadike dhe kanë ndodhur për arsye objektive, si zotërimi i një sasive të madhe sendesh personale, gjë e cila, pavarësisht kostos ekonomike, ka rezultuar në vënien në dispozicion të dy automjeteve për transferimin e një të dënuari.

2. Rekomandimi nr. dok. **201100589/2** për transferimin e të dënuarit X në I.E.V.Penale Fushë-Krujë Referuar nenit 31, të ligjit nr. 8328, datë 16.04.1998 “Për të drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim” dhe nenit 74 të Rregullores së Përgjithshme të Burgjeve (miratuar me V.K.M Nr.303, datë 25.03.2009), kërkesa e të dënuarit X për t’u transferuar në Burgun e Fushë-Krujës duhet të merret në shqyrtim, sepse ekzistojnë shkaqet ligjore për t’u transferuar (rrezikimi i shëndetit dhe qëndrimi në një institucion afër vendbanimit të familjarëve).

Në përgjigjen zyrtare të Drejtorisë së Përgjithshme të Burgjeve sqarohet se për momentin nuk mund të realizohet për shkaqe sigurie, si dhe D.P.Burgjeve në bashkepunim me I.E.V.Penale Burrel, ka marrë masat e nevojshme për trajtimin e gjendjes së tij shëndetësore duke monitoruar dhe ofruar shërbimin e nevojshëm.

3. Rekomandimi nr. dok. **201100591** për transferimin e të dënuarit Y në I.E.V.Penale Krujë.

Nga konstatimi në vënd u vu re se ky i dënuar shfaqte shenja të dukshme të çrregullimit mendor. Qëndrimi i mëtejshëm i të dënuarit Y në I.E.V.Penale Burrel mund të rrezikonte jetën ose shëndetin e tij apo të personave të tjerë të dënuar. Avokati i Popullit duke e konsideruar të rënduar gjendjen shëndetësore të të dënuarit të mësipërm, dhe emergjente nevojën për një trajtim më të specializuar mjeksor ndaj tij, sugjeroi transferimin sa më parë të të dënuarit në I.E.V.Penale Krujë i kategorizuar si institut i veçantë, i cili ka një seksion për të dënuar me shqetësime mendore.

Rekomandimi u pranua nga Drejtoria e Përgjithshme e Burgjeve e cila filloi procedurat për transferimin e të dënuarit për në Burgun e Krujës.

Rekomandime legjislative

Shkelje e konstatuar pas hetimit te ankeses te mjekëve te sistemit te burgjeve, që pretendonin se ngarkoheshin pa te drejte me detyrimin per te dhene mendim per dhenien ose jo te lejes se veçante te denuarit ne rastet kur nje familjar i tij vuante nga nje semundje e rende qe i rrezikonte jeten.

Rekomandimi Nr. Dok. 201001541 per revokimin e pikes 13 dhe 14 të Udhëzimit Nr. 7087, datë 10.09.2009 “*Për Rregullimin e disa Çështjeve që kanë të bëjnë me Procedurën e dhënies së Lejeve Shpërblyese apo të Veçanta Personave të Burgosur*” te Ministrit te Drejtesise.

Ky rekomandim iu drejtua Ministrise se Drejtesise ne vitin 2010. Ministria e Drejtesise fillimisht nuk e pranoi duke paraqitur argumentat e saj per kete qendrim. Zyra e Avokatit te Popullit pasi mori ne shqyrtim argumentat e Ministrise se Drejtesise vleresoi se ato nuk ishin te bazuara ne Kushtetute dhe ligj. Per kete arsye, ne vitin 2011, iu drejtuam perseri Ministrise se Drejtesise me nje shkrese ku i kerkuam rishikimin e qendrimit të mbajtur. Ne rekomandimin e dyte jo vetem u ngriten argumenta ligjore qe vertetonin shkeljen por, u bene edhe sugjerime per permiresime ligjore. Ministria e Drejtesise, ne pergjigjen e dyte ne lidhje me kete rast, sqaroi se eshte duke analizuar te gjitha procedurat e dhenies se lejeve personave te burgosur dhe gjate ketij procesi do te mbahen ne konsiderate rekomandimet e shprehura nga ana jone.

Inspektime ne Repartet Ushtarake të cilat kanë dhoma të ndalimit disiplinor.

Siç eshte permendur edhe ne raportet e meparshme te Avokatit te Popullit, objekt kryesor i punes së tij në funksion të Mekanizmit Kombetar te Parandalimit te Tortures, eshte inspektimi periodik i ambjenteve ku me ligj eshte privuar liria e individit si dhe kushtet e ambienteve te ndalimit. Ambjente te tilla jane edhe dhomat e ndalimit disiplinor ne repartet ushtarake. Dhoma e ndalimit disiplinor eshte mjedis brenda repartit ushtarak ku kufizohet ushtaraku qe ka marre mase disiplinore “*ndalim disiplinor*”. Ushtaraku mund te qendroje i izoluar ne kete mjedis deri ne 7 dite. Te drejtat qe gezon ushtaraku i ndaluar disiplinarisht parashikohen ne Ligjin Nr.9183, date 05.02.2004 “*Per Disiplinen Ushtarake ne Forcat e Armatosura te Republikes se Shqiperise*”, Urdherin Nr.398, date 14.06.2004 “*Rregullore per organizimin, perberjen, funksionimin e komisionit disiplinor dhe procedurat per dhenien, ekzekutimin e administrimin e masave disiplinore per ushtaraket e Forcave te Armatosura te Republikes se*

Shqiperise” dhe ne Urdhërin Nr.1861, datë 18.12.2009 “*Organizimi i jetes se brendeshme ne Forcat e Armatosura*”.

Gjate tre viteve të fundit jane kryer disa inspektime dhe riinspektime ne ambjentet e ndalimit disiplinor. Pas rekomandimeve te para ne lidhje me keto ambjente, komandat moren masa duke mbyllur ato dhoma qe nuk plotesonin kushtet e percaktuara ne legjislacion. Aktualisht jane ne perdorim dhomat e ndalimit disiplinor ne Batalionin e Policise Ushtarake Sauk dhe ato ne Repartin Ushtarak te Vaut te Dejes.

Gjatë inspektimit të kryer vjet, ne Batalionin e Policise Ushtarake Sauk, Institucioni i Avokatit të Popullit u informua se ishte propozuar projekti i ri për rikonstruksionin e dhomave të ndalimit disiplinor dhe me këtë rast sugjeruam që në këtë projekt të gjenin zbatim edhe disa standarte shtesë që përmirësojnë ndjeshëm trajtimin e ushtarakëve në këto ambjente. Si elementë të veçantë për përmirësim u kërkuan zgjerimi i hapsirave të dhomave, rregullimi i ambjenteve të ajrimit dhe ngrënies, rimodelimi i dhomës së takimit me familjarët, madje dhe krijimi i një salle pritjeje të familjarëve në hyrje të institucionit.

Këto kërkesa u paraqitën për të unifikuar trajtimin e barabartë të individëve të kufizuar nga liria që mbahen në institucione shtetërore të veçanta, duke referuar kriteret dhe standartet që aplikohen në ndërtimin e ambjenteve të burgjeve, paraburgimeve dhe dhomave të sigurisë në Policinë e Shtetit.

Ne inspektimin e vitit 2011 te kryer ne batalionin e Policise Ushtarake Sauk u konstatua se rekomandimet tona nuk kishin gjetur zbatim megjithese ne pergjigjen zyrtare qe kishim marre nga Shtabi i Përgjithshëm i FA, theksohej se rekomandimet e bëra nga ana jonë ishin pranuar dhe se ishte bashkëpunuar me Institutin e Studimeve dhe Projektimeve të Mbrojtjes që ato të gjenin zbatim në projektin e rikonstruksionit te dhomave të ndalimit disiplinor në vitin 2011.

Per kete arsye rekomanduam perseri kryerjen e investimeve në dhomat e ndalimit disiplinor ne Batalionin e Policise Ushtarake Sauk ne Tiranë.

Ne pergjigjen zyrtare te Ministrise se Mbrojtjes sqarohet se rekomandimi yne me Nr. Dok. 201100124 do te jete prioritet ne hartimin e projekt buxhetit per vitin 2012.

Në rekomandimet tona, lidhur me kushtet që duhet të plotësojnë dhomat e ndalimit disiplinor, i jemi referuar kryesisht kriterëve të përcaktuara në Rregulloren e Jetës së Brendshme të F.A, por edhe kërkesave ligjore të parashikuara për ndërtimin e dhomave të sigurisë në njësitë policore dhe dhomava në burgje, si dhe praktikës së mirë të ndjekur në

ambjentet e privimit të lirisë. Ambjentet e privimit të lirisë, në varësi të Ministrisë së Drejtësisë, Ministrisë së Brendëshme dhe Ministrisë së Mbrojtjes, pavarësisht cilësisë së personave të izoluar në këto vende, duhet të plotësojnë disa norma minimale të cilat duhet të jenë të përbashkëta dhe të unifikuara.

Institucioni i Avokatit të Popullit, në rastet kur ka konstatuar mungesë të kornizës ligjore brenda së cilës duhet të rregullohet veprimtaria e shtetit për ambjentet e privimit të lirisë, ka rekomanduar rregullimin ligjor të kësaj veprimtarie. Kërkesa kryesore ka qenë unifikimi i trajtimit të barabartë të individëve të kufizuar nga liria që mbahen në institucione shtetërore të veçanta. Shembull i mirë për t’ju referuar është *“Manuali për rregullat e trajtimit dhe sigurimin e të ndaluarve dhe arrestuarve në njësitë policore”* i miratuar me urdhër të Drejtorit të Përgjithshëm të Policisë së Shtetit. Në këtë Manual përcaktohen rregullat për ruajtjen, sigurimin dhe standardet e trajtimit të personave të arrestuar/ndaluar, normat e standardet që duhet të përmbushin ambjentet e sigurisë dhe detyrimet e punonjësve të policisë përgjegjës për këto ambjente.

Menduar se disa prej këtyre normave mund të vlenin edhe për ndërtimin e dhomave të ndalimit disiplinor në njësitë ushtarake. Këto norma do të plotësonin Rregulloren e Jetës së Brendshme sidomos me rregullat për kushtet që duhet të plotësojnë ambjentet e dhomave të ndalimit disiplinor dhe kriteret e ndërtimit të këtyre dhomave. Gjatë punës tonë kemi konstatuar se plotësimi i këtyre normave është garanci për jetën, shëndetin dhe trajtimi dinjitoz të personave që ju është privuar liria. Për këtë arsye, i sugjeruam me shkresën nr. Dok. 201100120 Ministrisë së Mbrojtjes përshtatjen e disa prej normave të Manualit dhe përfshirjen e tyre në rregullat e ndalimit disiplinor të ushtarakut.

Kreu IV

Informacion i përgjithshëm lidhur me veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit

Në këtë kapitull prezantohet informacioni më i rëndësishëm për bazën ligjore mbi të cilën mbështetet funksionimi i Institucionit të Avokatit të Popullit, pozicioni dhe kompetencat e tij, komunikimi me publikun, median, OJF-të, autoritetet publike, qendrore dhe vendore si dhe mjetet e komunikimit që Avokati i Popullit përdor në punën e tij. Ne i dedikuar një vëmendje të veçantë këtë vit faqes së publikuar të Institucionit të Avokatit të Popullit, me qëllim që ajo të ishte më informuese dhe më e aksesueshme nga publiku i gjerë.

Një vend të veçantë gjen prezantimi i të dhënave statistikore të punës së kryer gjatë vitit 2011, të cilin e kemi mbështetur në Rezolutën e Kuvendit për veprimtarinë e Institucionit të Avokatit të Popullit për vitin 2010. Të dhënat statistikore janë ndarë sipas të drejtave të cënuara nga veprimet e administratës publike si dhe japin një panoramë më të qartë për atë çka kemi bërë vitin për të cilin raportojmë.

Baza ligjore për veprimtarinë e Avokatit të Popullit

Praktika e qeverisjes së mirë dhe ndërveprimi midis autoriteteve publike dhe taksapaguesve sigurohen nga funksionimi i mekanizmave të pavarur e të paanshëm për të shqyrtuar mënyrën se si ka vepruar Qeveria. Avokati i Popullit si institucion i pavarur dhe kushtetues ka në fokusin e veprimtarisë së vet përmirësimin dhe konsolidimin e qeverisjes sa më demokratike duke synuar mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut ndaj veprimeve apo mosveprimeve të paligjshme të administratës publike. Sado e mirë qoftë, çdo qeverisje ka nevojë për mekanizma kontrolli e monitorimi në vijimësi. Pikërisht në këtë sistem, pranë sferës së qeverisjes dhe individit është vendosur Avokati i Popullit, në garanci të demokracisë dhe mirëqeverisjes. Parë në perspektivën e proceseve integruese të vendit tonë, nënvizojmë se, përveçse ndikimit pozitiv në mirëqeverisje, ngritja dhe

konsolidimi i Avokatit të Popullit në Shqipëri plotëson një kusht të kriterëve politike të Kartës së Kopenhagës, për pranimin në Bashkimin Europian.

Institucioni kushtetues i Avokatit të Popullit, si instancë kombëtare, garante e demokracisë, u parashikua për herë të parë në Kushtetutën e Republikës së Shqipërisë, të miratuar më 28 Nëntor 1998, e cila në 5 nene të saj përcakton detyrat, statusin dhe kompetencat e Avokatit të Popullit. Në zbatim të saj, në shkurt të vitit 1999, Kuvendi miratoi Ligjin Nr.8454, dt.04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i cili më pas u shtua dhe ndryshua me Ligjin 8600, datë 10.04.2000 dhe atë nr.9389, date 12.05.2005. Në të janë përcaktuar vlerat dhe parimet mbi të cilat vepron ky Institucion. Ato janë pavarësia, paanshmëria, profesionalizmi dhe konfidencialiteti, të përcaktuara si Parimet e Parisit e për të cilat Institucioni i Avokatit të Popullit është certifikuar edhe nga institucionet kompetente ndërkombëtare që mbikqyrin këto standarte.

Korniza ligjore mbi të cilën mbështet veprimtarinë e tij Avokati i Popullit, përfshin edhe disa akte të tjera ligjore siç janë ligji nr. 8485, datë 12.5.1999, “Kodi i Procedurave Administrative”, neni 45 germa “c”; ligji Nr. 8503, datë 30.6.1999, “Për të Drejtën e Informimit me Dokumentet Zyrtare”, neni 18 dhe ligji nr. 9135, date 11.9.2003 “Për Mbrojtjen e Konsumatorëve”, neni 55 i tij. Në përputhje me ratifikimin e Protokollit Opsional të Konventës për Parandalimin e Torturës dhe çdo Trajtimi tjetër Çnjerëzor dhe Degradues, Avokati i Popullit kryen dhe funksionin e Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Mbi këtë bazë, në ligjin 9888, datë 10.3.2008 “Për disa ndryshime dhe shtesa në Ligjin nr.8328, datë 16.4.1998 “Për te drejtat dhe trajtimin e të dënuarve me burgim”, janë shtuar 3 dispozita të reja mbi të cilat mbështet punën e tij Njësia për Parandalimin e Torturës pranë Avokatit të Popullit.

Misioni i Avokatit të Popullit është mbrojtja e të drejtave, lirive dhe interesave të ligjshme të individëve nga veprimet ose mosveprimet e paligjshme e të parregullta të organeve të administratës publike ose të tretëve që veprojnë për llogari të saj. Këtë mision, ai e kryen nëpërmjet forcës së rekomandimeve të tij, të cilat bëhen efektive nëpërmjet komunikimit me publikun.

Grupet mbi të cilat Avokati i Popullit mbështet veprimtarinë e tij janë:

- *individët apo grupet e individëve*, të cilët i drejtohen atij nëpërmjet ankesave, kërkesave apo njoftimeve për të drejta të cënuara nga organet e administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre;

- *shoqëria civile*, e cila është një burim jo vetëm i informacionit për shkelje të mundshme të të drejtave të njeriut, pasi ajo vepron në fusha të caktuara të mjedisit social, por edhe i propozimeve për eliminimin e

parregullsive, mungesave apo inefiçencës së autoriteteve publike në ushtrim të funksioneve të tyre;

- *autoritetet publike*, organet e qeverisjes qendrore, vendore dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre (që ushtrojnë autoritet publik), me të cilët Avokati i Popullit komunikon për trajtimin e rasteve që i bëhen prezent nga ankuesit për eliminimin e shkeljes apo parregullsive të konstatuara. Ai gjithashtu bashkëpunon me ta për parandalimin dhe promovimin e të drejtave dhe lirive të individëve;

- *media*, e cila shpërndan njohuritë mbi të drejtat e njeriut, vepron si transmetues për mesazhet e Avokatit të Popullit për publikun dhe mesazhet e publikut për Avokatin e Popullit si dhe,

- *organizatat ndërkombëtare* të cilat janë një burim i rëndësishëm i informacionit dhe standarteve të pranuar të mbrojtjes së të drejtave të njeriut, një burim njohurish dhe eksperiencash, një mekanizëm mbikqyrës për implementimin e detyrimeve të marra përsipër nga shteti nëpërmjet ratifikimit të Konventave dhe një burim i vazhdueshëm i influencës mbi shtetin dhe eliminimin e shkeljes sistematike të të drejtave të njeriut.

Marrëdhëniet me publikun Avokati i Popullit, i ka realizuar nëpërmjet mënyrave të ndryshme të komunikimit siç kanë qenë, intervistat, komunikimi me shkrim, me telefon, nëpërmjet takimeve me individë si edhe me përfaqësues të ndryshëm të autoriteteve publike, me publikime, nëpërmjet informacioneve të dhëna në faqen elektronike zyrtare, nëpërmjet organizimit të seminareve, tryezave të rumbullakta etj.

1. Marrëdhëniet e Avokatit të Popullit me publikun

Marrëdhëniet me publikun fillojnë që nga elementet etike në kontaktet e para me ankuesit, deri tek ato institucionale me zyrtarët e shtetit, pavarësisht nga hierarkia. Kontaktet me ankuesit, në Institucionin tonë, realizohen nëpërmjet Sektorit të Pritjes së Popullit. Në zbatim të Ligjit Nr. 8503, datë 30.6.1999, “Për të Drejtën e Informimit me Dokumentet Zyrtare”, kjo zyrë u krijua si pjesë e infrastrukturës për përballimin në vazhdimësi të fluksit në rritje të individëve, të cilët paraqiten pranë nesh për të parashtruar ankesa, kërkesa ose për të njoftuar në lidhje me shkelje të të drejtave dhe interesave të ligjshme të tyre.

Për këtë arsye, një nga juristët e institucionit, pret në çdo kohë gjatë orarit zyrtar, pa pengesa, me kulturë e profesionalizëm, ankesat e individëve të ndryshëm. Sektori i Pritjes së Popullit, si pikë takimi e parë e Marrëdhënieve me Publikun, ka ofruar shërbimin e tij, si nëpërmjet përpilimit të ankesës apo kërkesës që individë të ndryshëm parashtrojnë,

ashtu dhe nëpërmjet këshillimeve ose orientimeve ligjore profesionale që ata kërkojnë, kur çështja që parashtrohet prej tyre nuk është objekt i veprimtarisë së Avokatit të Popullit. Qytetarëve u ofrohet informacioni i kërkuar dhe njohja me legjislacionin në fuqi, si dhe u jepen sqarime të mëtejshme për rrugën që ndiqet pas ankesës së bërë.

Gjatë vitit 2011, numri i përgjithshëm i ankesave apo kërkesave të paraqitura pranë Zyrës së Pritjes së Popullit, është 1270. Në tabelën e mëposhtme pasqyrohen ankesat e paraqitura çdo muaj dhe numri i pranimit të atyre që kanë qenë brenda juridiksionit e kompetencave të Avokatit të Popullit.

Muaji	Ankesa gjithsej	Ankesa për tu shqyrtuar
Janar	96	34
Shkurt	108	42
Mars	98	47
Prill	91	40
Maj	75	28
Qershor	85	33
Korrik	103	53
Gusht		
Shtator	177	77
Tetor	208	101
Nëntor	140	62
Dhjetor	89	40
Totali	1270	557

Sikundër mund të shihet qartë nga numri i përgjithshëm i ankesave ose kërkesave verbale, që janë paraqitur pranë Zyrës së Pritjes së Popullit, janë pranuar për shqyrtim 557 ankesa apo kërkesa, ndërsa në 713 raste, ankuesve u është dhënë këshillim profesional, pasi një pjesë e konsiderueshme e tyre duhej të shqyrtoheshin nga organet përkatëse të administratës publike, pasi ata nuk kishin shteruar të gjitha rrugët e ankimit administrativ sipas procedurës përkatëse ligjore. Për ato çështje që nuk kanë qenë në juridiksion të Institucionit tonë, ankuesve u është treguar rruga ligjore që duhet të ndjekin.

Sektori i Pritjes së Popullit ka evidentuar me kujdes problematikat e ankesave që individët kanë paraqitur, të cilëve u është dhënë konsulenca e nevojshme juridike, për zgjidhjen e problemit të tyre. Nga ky evidentim del se ankesat jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit kanë patur të bëjnë me:

Kërkesa për përfaqësim në gjykatë 118
Konflikte midis individëve 55
Ankesa ndaj subjekteve private 51
Konflikte në familje 36
Ankesa ndaj kompanive të huaja private 54
Ankesa ndaj gjykatave të shteteve të huaja 46
Ankesa ndaj përfaqësive të huaja në Shqipëri 39
Ankesa ndaj shteteve të huaja 46
Ankesa ndaj organeve të policisë së shteteve të huaja 42

Të tjera 102

Ashtu siç mund të shihet në tabelën e mësipërme, numri më i madh i këtyre ankesave drejtohet ndaj gjykatave shqiptare të të gjitha niveleve. Këto ankesa zënë rreth 33.9% të të gjitha ankesave jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit të paraqitura në Zyrën e Pritjes së Popullit. Duke mos qenë dakort me vendimet e gjykatave, individët ankohen për korrupsion e mitmarrje.

Më pas vijnë ankesat lidhur me konfliktet në familje si dhe konfliktet midis individëve të cilat zënë rreth 12.7% të ankesave jashtë juridiksionit të Avokatit të Popullit. Në të shumtën e rasteve, problematika e këtyre ankesave ka patur të bëjë me probleme në familje, probleme trashëgimie, të pronës etj. Rreth 7.1% e ankesave kanë qenë kundër subjekteve private. Gjithashtu, një pjesë tjetër ankesash, është drejtuar ndaj institucioneve të shteteve të huaja, dhe kanë patur të bëjnë me padrejtësi të ndryshme të pretenduara ndaj shtetasve shqiptarë që jetojnë jashtë.

2. “Ditët e Hapura”

Gjatë vitit 2011 ne vazhduam praktikën e konsoliduar të komunikimit të drejtpërdrejtë me qytetarët, që e kemi quajtur “Ditët e Hapura”. Kjo ka rezultuar të jetë një praktikë shumë e frytshme që, jo vetëm shkurton procedurat burokratike, rrugët e gjata drejt Tiranës, shpenzimet ekonomike, por edhe manipulimet e mundshme me të drejtat e qytetarëve.

Gjatë vitit 2011 janë organizuar “Ditët e Hapura” në 40 bashki e komuna, nga ku janë pritur gjithsej 285 ankues. Nga këto, për 186 raste të parashtruara janë pranuar ankesat për shqyrtim ndërsa për 99 raste të tjera, ankuesit janë sqaruar apo këshilluar për rrugën që duhej të ndiqnin. Takimeve tona në “Ditët e Hapura” u kanë paraprirë bisedat në televizionet lokale si dhe njoftimet e bëra publikut, nga zyrtarët e bashkive dhe komunave përkatëse.

Përvoja e fituar në “Ditët e Hapura” dhe nga inspektimet me objekt të caktuar, siç kanë qenë inspektimet në burgje, takimet me efektiva të reparteve ushtarake etj, ka nxjerrë si domosdoshmëri që kjo punë të vazhdojë edhe në të ardhmen, me synim rritjen e efikasitetit dhe shpejtësisë së zgjidhjes së problemeve atje ku lindin.

3. Marrëdhëniet me median

Natyrisht, dimensionin e tyre më të plotë, marrëdhëniet me publikun e fitojnë përmes marrëdhënieve me pushtetin e katërt, pra me shtypin e shkruar dhe median në tërësi. Ne jemi të ndërgjegjshëm se në kohët e sotme, rruga më efikase e të bërit të njohur është përmes mediave. Metoda se si Avokati i Popullit ka menaxhuar njohjen dhe promovimin e punës së tij, kanë qenë kontaktet e përditshme me gazetarët dhe furnizimi i tyre me informacione në mënyrë profesionale, transparente, pa rendur pas lajmeve që shkaktojnë skandale, por edhe pa iu lidhur duart atyre vetëm me njoftime të thata për shtyp. Vetëm duke rritur shkallën e njohjes, duke ndryshuar dhe forcuar imazhin dhe pozicionuar Institucionin drejt në opinionin publik, ose goftë edhe në mendimin e një pjese të publikut, ne na rezultojnë që të kemi krijuar mirëkuptimin dhe mirëdashjen e nevojshme për të realizuar komunikimin me mjedisin dhe integritetin tonë institucional në shoqërinë shqiptare.

Marrëdhëniet me median gjithmonë i kemi parë me përparësi, sepse kemi patur dhe kemi si objektiv të rrisim besueshmërinë e publikut ndaj institucionit tonë në praktikë. Jemi të bindur se suksesi arrihet duke u bazuar në dy shtylla, të cilat janë zgjidhjet me kompetencë profesionale dhe transparenca në punën tonë. Ajo që kemi synuar është, mënjanimi i çdo elementi demagogjik në marrëdhëniet me median. Ne mendojmë se këtë e kemi arritur duke zbatuar një strategji disi të veçantë të informimit për punën tonë. Paradigma tashmë e konsoliduar në marrëdhëniet me median është përqëndruar në tre nivele komunikimi. E para, mediave u kemi dhënë materiale, kryesisht mbi bazën e rasteve konkrete. E dyta, jemi munduar të bëjmë edhe përgjithësime, duke shpjeguar rolin, kompetencat dhe juridiksionin tonë pas çdo rasti konkret, të trajtuar gjithmonë me mjaft transparenca nga ekspertët tanë. E treta, njoftimet për shtypin të shpërndara për median, sipas rasteve dhe aktivitetit të Zyrës.

Për vitin 2011, rezultojnë se Institucioni i Avokatit të Popullit, ka qenë 143 herë i pranishëm në Median e shkruar, dhe 45 herë në Median elektronike. Megjithatë, ne nuk e shohim praninë në shtyp si qellim në vetvete, pasi kjo është diçka e ndryshueshme nga viti në vit. Tregues cilësor

është zgjerimi i gjeografisë dhe shumëllojshmërisë tematike të këtij mbulimi mediatic. Një bashkëpunim konstant, institucioni i Avokatit të Popullit ka vendosur tashmë edhe me Gazetën Europiane të Strukturave Kombëtare për Mbrojtjen e të Drejtave të Njeriut, përmes së cilës ne shkëmbejmë përvojat tona me partnerët ndërkombëtarë. Në media kemi pasqyruar edhe debatet tona pranë Komisionit të Ligjeve pranë Kuvendit, ashtu edhe prononcimet tona të herëpashershme, për të kulmuar deri në pasqyrimin e aktivitetit vjetor që Avokati i Popullit organizon që nga krijimi i tij, e që për vitin që shkoi ishte “Siguria rrugore- sfidë për të shpëtuar jetë”. E drejta e pronës është trajtuar në media, përmes investimit të Avokatit të Popullit, si për çështje konkrete, ashtu edhe për rregullim sistemik.

E drejta e mostorturës dhe parandalimi i trajtimit çnjerëzor e poshtërues ka qenë një temë mjaft e ndjeshme, e pasqyruar në faqet e shtypit të shkruar por edhe në atë elektronik. Kontrollët e herëpashershme të Njësisë për Parandalimin e Torturës kanë zënë një vend qendror në pasqyrimin mediatic të veprimtarisë së Institucionit të Avokatit të Popullit, si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës. Krahas inspektimit rutinor të sistemit penitenciar të vendit, në media ka zënë vend edhe angazhimi i Avokatit të Popullit për rregullimin sistemik të problematikës në fjalë, përmes propozimeve të tij për përmirësimin e rregulloreve të burgjeve, për trajtimin e lejeve shpërblyese të të burgosurve, për përmirësimin e legjislacionit në fushën e shëndetit mendor por edhe për përmirësimin e trajtimit financiar të personelit që shërben në këto institucione.

Cilësia e shërbimeve publike ka qenë dhe mbetet një problematikë në ndjekje nga ana e Avokatit të Popullit dhe kjo kryesisht referuar problemeve dhe ankesave të qytetarëve për shërbime të tilla që kanë pasur të bëjnë me ndërveprimin e Entit Rregullator të Energjisë, me ndërmarrjen e sistemit të shpërndarjes, me atë të Entit Rregullator të Ujit dhe Drejtorive të Ujësjellës Kanalizimeve etj. Të kësaj natyre kanë qenë edhe ndërhyrjet e Avokatit të Popullit për sistemin e taksave vendore, moscënimin e të drejtës së jetës nga aksidentet në rrugë, të drejtat e ish të persektuarve politikë lidhur me dëmshpërblimin e tyre, e drejta për një proces të rregullt ligjor, e parë kjo si në rastin e mosnjoftimit të rregullt të qytetarëve, ashtu edhe në rastin e moszbatimit të vendimeve gjyqësore të formës së prerë. Tek media kemi patur aleatin më të sigurtë për tu bërë pjesë e opinionit publik, në rastet kur na është dashur të ndeshemi me rezistencën e atyre zyrtarëve publikë të cilët fatkeqësisht, ende e konsiderojnë rekomandimin e Avokatit të Popullit si diçka bezdisëse, aq më shumë ne rastet kur harrojnë se ky instrument, vërtetë është jo detyrues formalisht, por sa kohë që ai është i mirëbazuar në ligj, është e qartë se askush nuk i shpëton detyrimit për zbatimin e tij. Duke

përqafuar vlerësimin se gazetarët janë “rojtare publikë”, bashkëpunimin me ta e kemi parë si mjetin pa të cilin edhe publiku nuk do të dinte si të na drejtohej, sikundër edhe zyrtarët nuk do të njiheshin me forcën praktike të instrumentit tonë që është Rekomandimi i bazuar në ligj dhe i përpiluar me fuqinë më të madhe të mundshme argumentuese. Veçoria e rekomandimit të Avokatit të Popullit është se për të arritur deri tek ai, kërkohet dhe mundësohet një kohë më e madhe fizike dhe intelektuale, për më tepër kur operohet nga një këndvështrim dhe më i gjerë, sikundër është mbrojtja e të drejtave të njeriut. Informacionet nga shtypi përbëjnë bazën e një drejtimi të rëndësishëm të punës tonë, sikundër është vënia në lëvizje kryesisht, parashikuar nga neni 13-te i Ligjit “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

I gjithë spektri i shtypit të përditshëm filtrohet posaçërisht çdo ditë në zyrën tonë. Në strategjinë e mbulimit mediatic janë patur parasysh si ndërgjegjësimi i publikut, ashtu edhe efekti edukativ i informacionit. Kjo është bërë me pasqyrimin e vazhdueshëm në Media të të gjitha rasteve, kur administrata na ka mirëkuptuar duke rivendosur të drejtën e shkelur të qytetarit. Duke bërë herë pas here një analizë të secilit seksion për punën e kryer, ne kemi punuar paralelisht edhe për zbatimin e pikave bazë të strategjisë sonë në fushën e marrëdhënieve me publikun, sidomos përmes Medias. Në tërësinë e saj, Strategjia e mbulimit mediatic, si pjesa thelbësore e Marrëdhënieve me Publikun, është formuluar që në vitin 2000 dhe është publikuar edhe në raportet e viteve të mëparshme. E qëndrueshme ka qenë dhe do të mbetet qasja jonë ndaj gazetarëve si partnerë, duke u ofruar atyre informacione të përshtatura për shtypin, që u shërbejnë nevojave të mediave, si dhe duke i planifikuar nga ana strategjike temat, momentet e publikimit si dhe instrumentet e punës së mediave, për të përcjellë jo vetëm atë që synojmë të japim ne por edhe atë që publiku ka nevojë dhe të drejtë të dijë.

4. Bashkëpunimi me organizatat jofitimprurëse

Veprimtaria e Avokatit të Popullit nuk do të mund të ishte e suksesshme pa një bashkëpunim të vazhdueshëm me të gjithë aktoret dhe faktorët, të cilët japin kontributin e tyre në mbrojtjen dhe respektimin e të drejtave të njeriut.

Padyshim që ky bashkëpunim, është vlerësuar si një marrëdhënie ligjore me të gjithë organet e administratës publike dhe të tretëve që veprojnë për llogari të saj, në kuadër të oponentëve për mënyrën se si ofrohet mirëqeverisja nga ana e këtyre organeve për qytetarët, por edhe si një bashkëveprim me të gjitha ato struktura të shoqërisë civile, të cilat kanë dhënë dhe japin realisht kontribut, për ngritjen dhe konsolidimin e një

shoqërie demokratike dhe shtetit të së drejtës në vend. Me veprimtarinë e tyre ato bëhen pjesë e problemeve shoqërore dhe zëri i këtyre organizatave ka shërbyer kohë pas kohe në të mirë të politikave qeverisëse, sikundër edhe ka plotësuar dhe plotëson kuadrin pluralist të mendimit dhe organizimit të lirë të individëve. Ndër parimet mbi bazën e të cilave mbështetet veprimtaria e organizatave jofitimprurëse është parimi i mbrojtjes dhe i respektimit të të drejtave të njeriut të parashikuara në Kushtetute, ligje dhe marrëveshje ndërkombëtare të ratifikuara me ligj. Është pikërisht ky moment, i cili ka bërë që OJF të ndryshme që ushtrojnë veprimtari aktive dhe serioze në fushën e të drejtave të njeriut, të konsiderohen nga ana e institucionit të Avokatit të Popullit si partnerë shumë të vlefshëm, jo thjesht për përmbushjen e veprimtarisë së tij, por si institucione për mbrojtjen e të drejtave të njeriut, parë në këndvështrimin e parimeve të Kopenhagenit. Organizatat jofitimprurëse vendase dhe të huaja, luajnë një rol të rëndësishëm në procesin e zbatimit të të drejtave të njeriut dhe për promovimin e tyre. Shumë prej tyre ofrojnë shërbime të ndryshme për fëmijët-viktima, si asistencë ligjore falas, kryejnë punë hulumtuese, publikojnë raporte mbi gjendjen e të drejtave të fëmijëve si dhe organizojnë trajnime të ndryshme për edukimin e zyrtarëve publik, duke rritur ndërgjegjësimin e tyre.

Interaktiviteti ndërmjet strukturave të shoqërisë civile dhe Institucionit të Avokatit të Popullit është shumë i rëndësishëm, me qëllim që secili të realizojë me sukses dhe në mënyrë adekuate misionin e vet.

Për këtë arsye, pjesë e rëndësishme e punës së njërit prej seksioneve të institucionit të Avokatit të Popullit, përkatësisht të Seksionit të Përgjithshëm, është bashkëpunimi me organizatat jo fitimprurëse, sikurse përcaktohet në nenin 31, të Ligjit nr.8454 date 4.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Gjatë vitit 2011, në bashkëpunim me “Qendrën për nisma ligjore qytetare” dhe Akademinë e Shkencave të Shqipërisë, organizuam Konferencën Kombëtare “Roli i organizatave jofitimprurëse në mbrojtje të drejtave dhe lirive të njeriut, përmes instrumenteve kushtetuese ligjore”. Ky ishte aktiviteti i parë shkencor i institucionit të Avokatit të Popullit në të cilin u diskutua roli aktiv i organizatave jofitimprurëse, aftësimi dhe forcimi i tyre për të përdorur instrumentet e përcaktuara nga Kushtetuta e ligji si një garanci e rëndësishme për mbrojtjen e të drejtave dhe lirive të individëve.

Po kështu, në bashkëpunim me Shoqatën e Sigurisë Rrugore dhe Ambientit, me mbështetjen e misionit PAMECA, që prej muajit qershor 2011 e deri në nëntor 2011, organizuam disa tryeza të rumbullakta në zbatim të projektit “Siguria Rrugore – Sfidë për të shpëtuar jetë”. Shkak për

këtë shërbeu problematika e shtimit të vazhdueshëm të numrit të aksidenteve rrugore në vend si dhe nevoja e sensibilizimit të opinionit publik dhe institucioneve shtetërore të cilat ligji nr. 8378, datë 22.7.1998 “Kodi Rrugor i Republikës së Shqipërisë”, i ndryshuar, i ngarkon me marrjen e masave me qëllim rritjen e sigurisë së qarkullimit dhe parandalimin e aksidenteve në rrugët tona.

Në përfundim të këtij aktiviteti kombëtar hartuam një sërë rekomandimesh për institucionet që ligja ngarkon me marrjen e masave parandaluese për zvogëlimin e numrit të aksidenteve me pasojë vdekje dhe plagosje në rrugët tona. Rekomandimet e bëra përgjithësisht janë marrë në konsideratë dhe zyrës së Avokatit të Popullit i janë bërë me dije masat e marra nga institucionet përgjegjëse, qofshin ato vendore dhe qendrore. Nga ana jonë është konstatuar angazhimi institucional për të realizuar rekomandimet e bëra, por dhe justifikime për rastet e mosrealizimit për shkak të nevojave më të mëdha për mbështetje financiare, për realizimin e detyrimeve që burojnë nga ligji për këtë qëllim.

Nuk kanë munguar, gjatë vitit 2011, bashkëpunimet me një sërë organizatash të tjera jofitimprurëse, për çështje që ato na kanë bërë prezent dhe kanë kërkuar ndërhyrjen tonë si CRCA, shoqata “Amaro Drom”, Komiteti Shqiptar i Helsinkit etj .

5. Bashkëpunimi i Institucionit të Avokatit të Popullit me zyrat homologe dhe organizata të tjera ndërkombëtare

Institucioni i Ombudsmanit (Avokati i Popullit), ka një status unik dhe për këtë arsye ai forcohet më shumë dhe zhvillohet më tej përmes bashkëpunimit me zyrat homologe, me organizatat ndërkombëtare dhe ndërqeveritare që merren me të drejtat e njeriut, si dhe me Shoqatat e Ombudsmanëve.

Avokati i Popullit është aktualisht anëtar me të drejta të plota i Institutit Ndërkombëtar të Ombudsmanit, i Ombudsmanit Evropian dhe Shoqatës së Ombudsmanit Frankofon. Të drejtat dhe detyrimet që rrjedhin nga anëtarësia, Avokati i Popullit i realizon përmes pjesëmarrjes në aktivitete si brenda, ashtu edhe jashtë vendit.

Ne datën 15 shkurt 2011, Institucionin e Avokatit të Popullit e vizitoi Komisioneri për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Europës, z. Thomas Hammarberg, i cili zhvilloi një takim pune me përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit. Zyra e Komisionerit për të Drejtat e Njeriut pranë Këshillit të Europës dhe ajo e Avokatit të Popullit kanë tashmë një përvojë të

gjatë e të qëndrueshme bashkëpunimi për garantimin e të drejtave të individëve dhe mirëfunksionimin e institucioneve demokratike në vend.

Nga data 28.06.2011 deri më datë 01.07.2011, Institucioni i Avokatit të Popullit së bashku me një grup ekspertësh të huaj të ardhur nga Këshilli i Europës, Nënkomiteti i Parandalimit të Torturës i OKB-së, Komiteti kundër Torturës i Këshillit të Europës, Shoqata e Parandalimit të Torturës, Zvicër, organizoi në Tiranë një sërë vizitash të përbashkëta në burgje dhe polici.

Ky aktivitet u organizua në kuadër të Projektit të Këshillit të Evropës “Peer to Peer”, mbështetur nga Komisioni European për konsolidimin e Mekanizmave Kombëtarë kundër Torturës, nën bashkëdrejtimin e Avokatit të Popullit në Detyrë dhe Drejtorit të Strukturave të të Drejtave të Njeriut pranë Drejtorisë së Përgjithshme të Çështjeve Ligjore pranë Këshillit të Evropës.

Qëllimi i këtij aktiviteti ishte dhënia e eksperiencës ndërkombëtare për kryerjen e inspektimeve profesionale në vendet e privimit të lirisë, ofrimi i asistencës praktike gjatë vizitave në burgje dhe polici, vlerësimi i stadi të deritanishëm të metodave që ndiqen nga Institucioni i Avokatit të Popullit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës, si dhe lënia e detyrave dhe sugjerimeve për përmirësimin e punës në të ardhmen. Ky aktivitet ishte në vazhden e aktiviteteve të përbashkëta që Avokati i Popullit kryen prej vitesh në kuadrin e bashkëpunimit dhe shkëmbimit të përvojave me Këshillin e Evropës.

Bazuar në direktivën mbi forcimin e parandalimit të torturës në nivel kombëtar në të gjitha vendet anëtare të Këshillit të Evropës dhe në vijim të Projektit për krijimin e një rrjeti aktiv Evropian të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës, në kuadër të projektit “Peer-to-Peer Project II”, gjatë vitit 2011 përfaqësues nga Institucioni i Avokatit të Popullit, kanë marrë pjesë në workshop-e dhe takime konsultative të organizuara nga Këshilli i Europës.

Në vijim të shkëmbimit të eksperiencave midis zyrave homologe, në datat 15-18 nëntor 2011, një grup ekspertësh të Zyrës së Avokatit të Popullit të Kosovës, të shoqëruar nga njëri prej Komisionerëve të këtij institucioni dhe disa prej OJF-ve më të angazhuara me të drejtat e njeriut në Kosovë, morën pjesë në një vizitë studimore pranë zyrës sonë, për t’u njohur me përvojat më të mira të Avokatit të Popullit në Shqipëri, në kuadër të funksionit të tij si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës.

Në 20 dhjetor 2011, ndërmjet Institucionit të Avokatit të Popullit dhe Qeverisë së Mbretërisë të Danimarkës përfaqësuar nga Ministria e Punëve të Jashtme, u nënshkrua një Projekt Marrëveshjeje mbi “Mbështetjen e Ombudsmanit Shqiptar për të qenë më pranë komuniteteve vendore,

shoqërisë civile dhe medias”. Sipas saj, nëpërmjet një granti prej 4 milion DKK do të mbështetet Institucioni i Avokatit të Popullit për aktivitetin e tij sipas një projekt dokumenti të detajuar që do të nënshkruhet gjatë vitit 2012.

6. Aktivitete të tjera të Institucionit të Avokatit të Popullit gjatë vitit 2011

Krahas aktiviteteve ndërkombëtare, përfaqësues të Institucionit të Avokatit të Popullit kanë marrë pjesë dhe në shumë aktivitete të organizuara nga institucionet e tjera shtetërore dhe shoqëria civile. Në të gjitha këto aktivitete, Institucioni i Avokatit të Popullit ka promovuar rolin, kompetencat dhe juridiksionin e tij në ndërveprimin me problematikën e diskutuar në to, e cila ka ndihmuar në sqarimin e pozicioneve të ndryshme në të cilat ndodhemi, në raport me instancat të cilave u drejtohem, nisur nga ankesat konkrete që vijnë pranë zyrës tonë. Pjesëmarrja jonë ka qenë gjithmonë aktive, pasi bashkëpunimin me organet e administratës së të tre pushteteve si dhe me organizmat e shoqërisë civile e shohim si domosdoshmëri për perfeksionimin e mëtejshëm të punës tonë, si mbikqyrës të respektimit të të drejtave të njeriut në të gjitha dimensionet e tyre.

7. Struktura e zyrës së Avokatit të Popullit

Ligji nr. 8600, dt.10.04.2000, “Për disa ndryshime në ligjin 8454, datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit””, i jep Avokatit të Popullit të drejtën e përcaktimit të strukturës dhe numrit të personelit të tij, kurse pagat janë caktuar me vendim të veçantë të Këshillit të Ministrave.

Zyra e Avokatit të Popullit funksionon me tre seksione të specializuara, sikundër është përcaktuar në nenin 31 të ligjit nr.8454 datë 04.02.1999 “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar.

Seksioni i parë merret me ankesat dhe kërkesat për organet e administratës qendrore, pushtetit vendor dhe të tretëve që veprojnë për llogari të tyre,

Seksioni i dytë merret me ankesat dhe kërkesat për policinë, shërbimin sekret, burgjet, Forcat e Armatosura, prokurorinë dhe pushtetin gjyqësor,

Seksioni i tretë, trajton çështjet jashtë fushave të mësipërme, ndjek bashkëpunimin me organizatat joqeveritare dhe kryen studime në fushën e të drejtave dhe lirive themelore të njeriut,

Në kuadër të funksionit si Mekanizëm Kombëtar për Parandalimin e Torturës dhe çdo Trajtimi tjetër Degradues dhe Çnjerëzor, pranë Avokatit të Popullit që prej vitit 2008, funksionon Njësia për Parandalimin e Torturës, e

cila është në varësi direkt të Avokatit të Popullit. Organika e Institucionit të Avokatit të Popullit përbëhet nga 48 punonjës, prej të cilëve 26 janë juristë dhe merren direkt me trajtimin e ankesave, kërkesave apo njoftimeve të individëve, kurse pjesa tjetër përbën stafin ndihmës i cili ndihmon për realizimin e detyrave kryesore të institucionit. Ndërmjet punonjësve, 6 janë zyrtarë të lartë (Avokati i Popullit, tre Komisionerët, Sekretari i Përgjithshëm dhe Drejtori i Kabinetit), 30 janë punonjës që mbajnë statusin e nëpunësit civil dhe 12 punonjës të kontraktuar sipas dispozitave të Kodit të Punës.

Përsa i përket cilësive profesionale të personelit të zyrës sonë, 9 nga anëtarët e stafit kanë kryer studime pasuniversitare në fusha të ndryshme të së drejtës dhe administrimit dhe janë angazhuar në përputhje me aktet nënligjore përkatëse dhe Rregulloren e Brendshme të institucionit në fushën akademike.

8. Buxheti i Institucionit për vitin 2011

Për vitin 2011 Institucionit të Avokatit të Popullit, mbështetur në Ligjin nr.10355, date.02.12.2010 “Për buxhetin e shtetit të vitit 2011”, i është akorduar një buxhet në shumën prej **86.170.000** leke, në fillim të vitit dhe me rishikimin e tij në bazë të ligjit nr.10450 date.14.07.2011, buxheti i institucionit u ul 2.700.000 lekë në zërin e shpenzimeve operative dhe 1.000.000 lekë në zërin e investimeve. Buxheti përfundimtar për periudhën objekt raportimi ka qenë **82.470.000** lekë. Ajo që duam të nënvizojmë është fakti se buxheti nga viti në vit ka ardhur duke u reduktuar. Konkretisht për 5 vitet e fundit buxheti është reduktuar si më poshtë:

Për vitin 2007 - **113.972.000 leke**

Për vitin 2008 - **93.418.000 leke**

Për vitin 2009- **93.000.000 leke**

Për vitin 2010- **87.351.960 leke**

Për vitin 2011- **82.470.000 leke**

Siç mund të vihet re lehtësisht nga tabela e mësipërme për vitin 2011 kemi patur në dispozicion 4.881.960 leke më pak se në vitin 2010. Për një institucion i cili si pjesë të rëndësishme të veprimtarisë së vet, ka inspektimin, kjo shumë ka qenë e ndjeshme.

Nr. Llog.	Emërtimi	Plani fillestar	Pakësime	Plani ndryshuar	Fakti

600	Pagat	60.500.000	- 307.415	60.192.585	55.786.960
601	Sigurim shoqeror	7.000.000		7.000.000	7.000.000
602	Shp operative	15.000.000	-2.608.585	12.391.415	11.445.466
605	Kuote anetaresie	670.000		670.000	260.096
606	Transf. individe		216.000	216.000	216.000
231	Pajisje	3.000.000	-1.000.000	2.000.000	1.951.284
	Totali	86.170.000	-3.700.000	82.470.000	76.659.806

Institucioni ynë, referuar ndryshimeve në buxhetin e vitit 2011, ka rishikuar politikat e veta ekonomike, për një menaxhim sa më të mirë dhe me efektivitet të shpenzimeve buxhetore, duke planifikuar shpenzimet e kontraktuara si dhe shpenzimet e tjera më të domosdoshme të vitit 2011.

Fondi i pagave është realizuar në zbatim të strukturës organizative të miratuar. Gjatë vitit 2011, numri mesatar i punonjësve është realizuar 47 persona deri në datën 23 dhjetor 2011, pasi Avokati i Popullit u zgjodh në datën 22 dhjetor 2011 nga Kuvendi i Shqipërisë. (48 është numri i personelit të miratuar për institucionin e Avokatit të Popullit).

Fondi për shpenzime operative për vitin 2011, në mbështetje të buxhetit të rishikuar dhe të miratuar nga Ministria e Financave, është planifikuar në vlerën 12,300,000 lekë dhe është realizuar 100%.

Për vitin 2011 shpenzimet operative, janë përdorur për blerje kancelarish, mjete pastrimi, energji elektrike, ujë, për shërbimin e ALBTELEKOM, VODAFON, AMC, internet, abonime gazeta, shërbimi postar, karburant, pjese këmbimi automjete, shpenzimet e siguracionit, parkim automjete, dieta brenda vendit, shërbime mirëmbajtjeje, fotokopje e printera, shpenzime pritje-përcjellje të të huajve që kanë vizituar zyrën tonë gjatë vitit 2011 etj.

Në lidhje me kuotat e anëtarësisë ne bëjmë pagesën në Institutin Europian të Ombudsmanëve, Institutin Ndërkombëtar të Ombudsmanëve, Shoqatën e Ombudsmanëve Frankofonë, Shoqatën e Ombudsmanëve të vendeve Mesdhetare (AOM), dhe Shoqatën e Ombudsmanëve në Shtetet e Bashkuara të Amerikës (USOA), pagesa të cilat janë kryer në kohën e duhur.

9. Statistika përmbledhëse e vitit 2011

(Rastet sipas fushave përkatëse dhe mënyra e përfundimit të tyre)

Gjatë vitit 2011 nga Zyra e Avokatit të Popullit janë trajtuar **3108** ankesa, kërkesa dhe njoftime (duke përfshirë dhe ato të Zyrës së Pritjes së Popullit, të cilave ju është dhënë përgjigje menjëherë). Nga **3108** ankesa, **370** kanë qenë të mbartura nga viti 2010, **2025** janë raste të regjistruara në

vitin 2011 dhe **713** janë raste të cilave u është dhënë përgjigje menjëherë në Zyrën e Pritjes së Popullit. Në mbështetje të Rezolutës së Kuvendit për Raportin Vjetor 2010, gjatë vitit 2011, Institucioni i Avokatit të Popullit ka rritur numrin e çështjeve të nisura me iniciativën e tij. Gjatë vitit 2011, ne kemi filluar hetimin e **153** rasteve me iniciativë, mbështetur në nenin 13 të ligjit nr. 8454, datë 04.02.1999, “Për Avokatin e Popullit”, i ndryshuar. Avokati i Popullit ka kryer inspektime në institucionet publike dhe autoritetet e tjera administrative. Shumica e inspektimeve janë kryer në institucionet, ku liria e personit është e kufizuar (paraburgim, burgje, spitale psikiatrike etj). Po kështu janë kryer inspektime dhe ndaj autoriteteve të tjera administrative, si p.sh. në qendrat rezidenciale për fëmijë (shtëpitë e fëmijës), qendrat rezidenciale për të moshuarit etj.

Avokati i Popullit ka kryer inspektime në përputhje me Protokollin Opsional të Konventës së Kombeve të Bashkuara kundër Torturës dhe Trajtimeve të tjera Çnjerëzore e Poshtëruese (OPCAT). Numri i inspektimeve të kryera në funksion të Mekanizmit Kombëtar për Parandalimin e Torturës për vitin 2011, është 161. Gjatë vitit për të cilin po raportojmë janë përfunduar së shqyrtuari gjithsej **1855** ankesa, nga të cilat ka rezultuar se **154** ankesa, ose 8.3% e tyre, kanë qenë jashtë juridiksionit dhe **529** ankesa ose 28.5% e tyre kanë qenë jashtë kompetencës. Këtu përfshihen ankesat që kanë patur të bëjnë me vendimet gjyqësore dhe çështje të tjera të administrimit gjyqësor të cilat nuk janë në juridiksion të Avokatit të Popullit, çështje që kanë të bëjnë me çështje private të pronësisë, me mosshërim të rrugëve të ankimit administrativ nga ankuesit etj. Në të gjitha këto raste ankuesit janë sqaruar për rrugën ligjore që duhej të ndiqnin deri në zgjidhjen e problemit të tyre. **264** ose 14.2% e ankesave kanë rezultuar të pabazuara, kurse **833** ose 44.9% e tyre janë zgjidhur në favor. Për **57** raste, ose 3.1% të tyre, të paraqitura për shqyrtim pranë nesh, ankuesit kanë hequr dorë gjatë procesit të shqyrtimit. Për ankesat e gjetura të bazuara, për **231** prej tyre janë bërë rekomandime apo propozime përkatëse me shkrim, drejtuar autoriteteve publike me qëllim që të rritet cilësia e administrimit publik dhe të sigurohen standarte mirëqeverisje. Për pjesën tjetër zgjidhjet pozitive janë arritur që në fazën e marrjes së shpjegimeve apo ndërmjetësimit tonë verbal me organet e Administratës Publike të cilat pas komunikimit me ne, kanë rregulluar gabimin e bërë ose kanë hequr dorë nga qëndrimet refuzuese apo negative që kanë mbajtur me ankuesit. Rekomandimet e bëra nga Avokati i Popullit dhe të pranuar nga organet të cilave ato u janë drejtuar, tregojnë për ndërhyrje të argumentuara nga institucioni ynë për rivendosjen në vend të të drejtave të shkelura të qytetarëve. Nga **231** rekomandimet dhe propozimet drejtuar organeve përkatëse të administratës për shkelje të konstatuara prej tyre, nga

zyra jonë, **18** prej tyre, janë refuzuar. Janë pranuar plotësisht dhe ekzekutuar **82** rekomandime. Për **72** rekomandime, organet te cilave i jemi drejtuar e kanë pranuar ne parim rekomandimin që i kemi dërguar, por nuk e kanë ekzekutuar atë për shkaqe të tilla, si mungese fondesh, mosnxjerrje akti administrativ nga organi kolegjal ose jo kolegjal dhe shkaqe të tjera. Janë pranuar pjesërisht nga organet te cilave i jemi drejtuar **9** rekomandime (që do të thotë kanë pranuar vetëm një pjesë të rekomandimit tone, p.sh ne rastet që i kemi rekomanduar organit përkatës marrjen e masave të caktuara ndaj një efektivit të policisë për shkelje të konstatuar gjatë ushtrimit të detyrës, është pranuar shkelja e bere, por jo ndëshkimi në mënyrën e kërkuar prej nesh). Për **50** rekomandime nuk kemi marrë përgjigje akoma ndonëse për pjesën me të madhe të tyre (sidomos për rekomandimet që kanë të bëjnë me ekzekutimin e vendimeve gjyqësore) i kemi përsëritur kërkesën për t’iu përgjigjur rekomandimit, organi te cilit i jemi drejtuar siç parashikohet në ligjin organik të AP-se.

Në 57 raste ankuesit kanë hequr dorë nga shqyrtimi i rastit të tyre prej zyrës sonë, pasi kanë mundur t’a zgjidhin atë, pa patur nevojë për ndërhyrje të mëtejshme prej nesh.

Përsa i përket ankesave të cilat kanë kaluar për shqyrtim në vitin 2012, të cilat janë **170** të tilla, duhet të themi se një pjesë e tyre nuk kanë mundur të përfundojnë se shqyrtuari për shkak të mosdhënies së përgjigjes nga autoriteti te cilit i jemi drejtuar apo mosdhënies së përgjigjes për rekomandimin për rastet për të cilat i jemi drejtuar autoriteteve të administratës publike.

Në këtë Raport Vjetor do të prezantojmë, rastet e regjistruara gjatë vitit 2011 të ndara sipas të drejtave të garantuara dhe të cënuara nga veprimet e organeve të administratës publike dhe në një tabelë të veçantë do të mund të gjeni rastet e ndara sipas ministrive përkatëse dhe organeve apo enteve të tjera të Administratës Publike Shqiptare në vartësi të tyre.

Tabela 1

	Nr. i rasteve
E drejta e pronës	329
Kufizime të lirisë së personit	318
Çështje të administrimit të drejtësisë	268
E drejta e mbrojtjes shoqërore të punës	200
Mbrojtja e konsumatorit	160
E drejta për të përfituar nga sigurimet shoqërore	143
Ndihma ekonomike dhe përfitimi i shpërblimit në bazë të nenit 41, pika 4 të ligjit nr.10129 dt.11.05.2009	106
Plotësim i nevojave të shtetasve për strehim	72


Veprime ose mosveprime të organit të Prokurorisë	101
E drejta për informim	59
E drejta për mjedis të shëndetshëm	58
E drejta për kujdes shëndetësor	21
E drejta për arsimim	15
Barazia para ligjit dhe ndalimi i diskriminimit	3
Të tjera	172
Totali	2025

Tabela 2


1. Këshilli i Ministrave	19
nga të cilat	
për vetë Qeverinë	7
- ALUIZNI	12
2. Ministria e Drejtësisë	474
nga të cilat:	
për vetë ministrinë	36
a. Për burgjet dhe paraburgimet	250
b. Zyrat e Përmbarimit	72
c. Zyrat e Regjistrimit të Pasurive të Paluajtshme	76
	76
d. Agjensia e Kthimit dhe Kompensimit të Pronave	40
	40
3. Organet e pushtetit gjyqësor	102
4. Prokuroria	101
5. Ministria e Brendshme	405
nga te cilat:	
Organet e policisë	175
Organet e pushtetit vendor	230
a. Komunat	25
b. Bashkite	174
c. Prefekturat	14
d. Qarqet	2
dh.Gjendja Civile	15

6. Ministria e Mbrojtjes	71
7. Ministria e Financave	209
Për vetë ministrinë	81
a. Drejtoria e Pergjithshme e Tatimeve dhe deget ne varesi te saj	1
b. Drejtoria e Pergjithshme e Doganave dhe degët në varesi te saj	1
c. Agjensia Kombetare e Privatizimit	1
ç. Instituti i Sigurimeve Shoqërore	124
8. Ministria e Punëve Publike, Transportit dhe Telekomunikacionit	251
nga të cilat:	
Për vetë ministrinë	64
a. Inspektoratet ndërtimore	84
b. Ujësjiellës kanalizime	86
c. Albtelekom dhe telefonia mobile	7
ç. Posta Shqiptare	1
d. Enti Kombëtar i Banesave	9
9. Ministria e Ekonomisë, Tregtisë dhe Energjitikës	132
nga të cilat:	
Për vetë ministrinë	66
CEZ	49
ERE	17
10. Ministria e Shëndetësisë	28
11. Ministria e Arsimit dhe Shkencës	35
12. Ministria e Punëve të Jashtme	5
13. Ministria e Punës, Çështjeve Sociale dhe Shanseve te Barabarta	14
14. Ministria e Bujqësisë, Ushqimit dhe Mbrojtjes se Konsumatorit	6
15. Ministria e Mjedisit, Pyjeve dhe Administrimit të Ujërave	26
16. Ministria e Turizmit, Kulturës, Rinisë dhe Sporteve	1
17. Ministria e Integritimit	1
Të tjera	145
TOTALI	2025 ankesa


Ankesa te trajtuara gjate vitit 2011
Totali 3108



**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave të përfunduara gjatë vitit 2011, pavarësisht nëse kanë qenë brenda ose jashtë juridiksionit
Totali 1855**




**Mënyra e zgjidhjes së ankesave dhe kërkesave që kanë qenë brenda
juridiksionit gjatë vitit 2011
Totali 1172**




- Ankesa të padrejta
- Ankesa në favor
- Me rekomandim ose propozim te refuzuar
- Heqje dore

**Ankesa dhe kërkesa të paraqitura verbalisht pranë
Zyrës së Pritjes së Popullit gjate vitit 2011
Totali 1270**




- Ankesa verbale të regjistruara në sekretari për shqyrtim, pasi u bënë me shkrim
- Ankesa dhe kërkesa verbale, të cilave iu është dhënë përgjigje menjëherë, në zbatim të nenit 17/a dhe 17/b të ligjit.

**Krahasimi i ankesave të ardhura për vitet 2000 - 2011,
(përfshirë edhe ato që ju është dhënë përgjigje menjëherë)
Totali 38268**



Ankesa te ardhura ne vite

Krahasimi i ankesave të zgjidhura ne favor për vitet 2000 - 2011, Totali 6982



Shpërndarja e ankesave të regjistruara gjatë vitit 2011 sipas të të shkelura Totali 2025 raste

